

LIBËR MËSUESI

për tekstin shkollor

MENTOR HAJRIZI
ALEKSANDRA JANAQI

EVELINA DOKA
NATASHA KALEMAJ
MANJOLA BRAHAJ



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI 11

(për gjimnazin e shkencave shoqërore gjuhësore
dhe të shkencave natyrore)



BOTIME SHKOLLORE ALBAS

**MENTOR HAJRIZI
ALEKSANDRA JANAQI
EVELINA DOKA
NATASHA KALEMAJ
MANJOLA BRAHAJ**

**Libër mësuesi
për tekstin shkollor**

**GJUHA SHQIPE 11
DHE LETËRSIA 11**

(për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore
dhe për gjimnazin e shkencave natyrore)



albas

Botues:

Latif AJRULLAI

Rita PETRO

Drejtor botimi:

Driton AJRULLAI

Kryeredaktor:

Fatlum HETEMI

Redaktore përgjegjëse:

Natasha PEPIVANI

Ervisa PALOKA

Recensentë:

Kadire BINAJ

Dr. Naim BERISHA

Arianit BEHRAMI

Salie GAJTANI

Arti grafik:

Ela LUMANI

Kopertina:

Eva KUKALESHI

© Albas, 2019

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

ISBN 978-9951-15-084-2

Shtëpia botuese Albas

Në Prishtinë: Rr. "Muharrem Fejza", p.n.

Tel: 00377 45 999 770

e-mail: albas_pr@yahoo.com

Në Tiranë: Rr. "Donika Kastrioti", pallati 14, ap. 4D.

Tel: 00355 45800160; e-mail: info@albas.al

Në Tetovë: Rr. "Ilinden", nr. 105

Tel: 00389 44 344 047; e-mail: albas_te@yahoo.com

Shtypur në shtypshkronjën: 

PËRMBAJTJA

Model i planit vjetor	7
Njësia mësimore: Gjuha shqipe, gjuhë indoeuropiane (Model I)	18
Njësia mësimore: Gjuha shqipe, gjuhë indoeuropiane (Model II)	20
Njësia mësimore: Teza ilire për gjuhën shqipe	23
Njësia mësimore: Gjuha shqipe, dëshmitë e para	25
Njësia mësimore: Teksti dhe koherenca e teksteve (2 orë)	28
Njësia mësimore: Teksti dhe llojet e tij	36
Njësia mësimore: Fjalìa dhe gjykimi	40
Njësia mësimore: Ligjërimet në gjuhën shqipe (i thjeshtë, bisedor, libror)	42
Njësia mësimore: Formimi i emrave abstraktë dhe afektivë me anë të prejardhjes	46
Njësia mësimore: Formimi i emrave abstraktë dhe afektivë me anë të kompozimit dhe përngjitjes	48
Njësia mësimore: Formimi i emrave abstraktë dhe afektivë me anë të nyjëzimit dhe konversionit	50
Njësia mësimore: Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras	52
Njësia mësimore: Gjuha standarde shqipe dhe dialektet	55
Njësia mësimore: Teksti përshkrues bindës	61
Njësia mësimore: Teksti argumentues	64
Njësia mësimore: Fjalimi politik	69
Njësia mësimore: Kryeartikulli dhe reklama	74
Njësia mësimore: Eseja argumentuese	80
Njësia mësimore: Eseja argumentuese (2 orë)	83
Njësia mësimore: Teksti udhëzues (2 orë)	88
Njësia mësimore: Procesverbali	94
Njësia mësimore: Stili administrativo-juridik	96
Njësia mësimore: Fjalìa e thjeshtë dhe fjalìa e përbërë	99
Njësia mësimore: Përshtatja e kallëzuesit foljor me kryefjalën	103
Njësia mësimore: Kallëzuesi i përbërë foljor	105
Njësia mësimore: Metonimia, antiteza, hiperbola, litota	106
Njësia mësimore: Sinonimet në gjuhën shqipe	108
Njësia mësimore: Antonimet në gjuhën shqipe	111
Njësia mësimore: Homonimet në gjuhën shqipe	115
Njësia mësimore: Eseja letrare	118
Njësia mësimore: Stili i letërsisë artistike	120
Njësia mësimore: Veçoritë gjuhësore në tekstet joletrare	122
Njësia mësimore: Konotacioni dhe denotacioni	124
Njësia mësimore: Fusha leksikore	126

GJUHA FIGURATIVE

Gjuha figurative	128
Figurat stilistike	130

EPOKA E ROMANTIZMIT

Romantizmi në letërsi	134
<i>Letra e Tatianës</i> (A. Pushkin) – <i>lexime të komentuara</i>	137
<i>Për vetveten</i> (Xh. Leopardi) – <i>lexime të komentuara</i>	
<i>Vilhelm Tel</i> (F. Shiler) – <i>lexime të komentuara</i>	

JOHAN V. GËTE

Brezi “Stuhi dhe vrull”	140
Krijimtaria	142
<i>Fausti</i> – analizë	145
<i>Natë</i> – koment	149
<i>Në kopsht</i> – koment	152

VIKTOR HYGO

Prijësi i romantizmit	155
<i>Katedralja e Parisit</i> – analizë	158
<i>Esmeralda</i> – koment	161
Shtylla e turpit	164
Diskutim mësimor	168
Ese letraro - filozofike	171

XHORXH BAJRON

Poeti i lirisë	175
<i>Shtegtimet e Çajld Haroldit</i> – analizë	179
<i>Shqipëria dhe shqiptarët</i> – koment	183
Diskutim mësimor	187

LETËRSIA E RILINDJES KOMBËTARE (ROMANTIZMI SHQIPTAR)

Letërsia romantike shqiptare	190
------------------------------	-----

JERONIM DE RADA

Temat dhe ligjërimet	193
<i>Këngët e Milosaos</i> – analizë	196
<i>Kënga I</i> – koment	201
<i>Kënga V</i> – koment	204
Diskutim mësimor	207

Studim teksti: “Fjalët e qiririt”	222
Portofoli i nxënësit	226
EPOKA E REALIZMIT	
Lexime të komentuara	229
Balzaku, jeta dhe vepra	233
Analizë, “Xha Gorio”	235
Koment “Xha Gorio”	238
Koment “Xha Gorio”	242
Diskutim mësimor, Balzaku	246
Gustav Floberi, jeta dhe vepra	249
Gjergj Fishta, simboli i madhështisë së poezisë shqipe	252
1. Analizë: Lahuta e Malcis, Gjergj Fishta.	255
2. Koment Vranina.	255
Koment Kënga e Lulashit (Fragment i marrë nga Kënga Pater Gjoni)	260
NDRE MJEDA	
Poeti paramodern	
“Andrra e jetës” - analizë	264
“Andrra e jetës” - analizë	265
“Autobiografia - F. Noli	266
“Samsoni e Dalila” - koment	268
Modeli kritik	269
“Vaje”- koment	270
Portofoli i nxënësit	272
Teste për tremujorin e tretë	276

HYRJE

Të nderuar mësime dhe mësues, Shtëpia Botuese "ALBAS" po sjell për ju librin e mësuesit *Gjuha shqipe dhe letërsia 11*, hartuar mbi programin e ri të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në librin që keni në duar, do të gjeni planin vjetor dhe modele orësh mësimore, testesh dhe projektsh, të cilat sugjerojnë se si mund të ndahen dhe të organizohen orët mësimore.

Sipas këtij plani, sugjerohet që Gjuha shqipe të zhvillohet në 37 orë gjatë gjithë vitit mësimor, si për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore, ashtu edhe për gjimnazin e shkencave natyrore, ndërsa orët e tjera janë planifikuar për letërsinë.

Tekstet *Gjuha shqipe 11* dhe *Letërsia 11* janë të digjitalizuara dhe mund të shkarkohen prej mësuesve dhe nxënësve.

Teksti i digjitalizuar krijon mundësinë që të shpjegohet apo të mësohet në mënyrë interaktive. Ai përmban dije shtesë, që përcillen përmes videove, audiove, fotove dhe lehtëson kryerjen e detyrave, ushtrimeve, e testeve me anë të plotësimeve, nënvizimeve e mbajtjes së shënimeve. Librin elektronik ju mund ta shkarkoni në kompjuter përmes kodit përkatës të secilit libër. Ju ftojmë të na ndiqni në faqen zyrtare të shtëpisë botuese "Albas", ku do të mund të gjeni shkarkoni materiale ndihmëse. Shpresojmë që me këtë botim të kemi ndihmuar për rritjen e cilësisë së mësimit të lëndës së *Gjuhës shqipe dhe të letërsisë*.

Mirëpresim çdo mendim dhe sugjerim nga ju.

PLANI VJETOR

VITI SHKOLLOR: 2019 – 2020

FUSHA E KURRIKULËS: GJUHË DHE KOMUNIKIM
LËNDA: GJUHË SHOQIPE DHE LETËRSI

KLASA: XI

PROFILI: SHOQËROR (37 javë 4 = 148 orë)

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				
PERIUDHAT	PERIUDHA (I)	PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)	
MUAJT	shtator – tetor (32 orë)	janar – shkurt (32 orë)	mars – prill (32 orë)	
TEMATIKAT	Gjuha figurative: 1. Gjuha figurative 2. Figurat stilistike (2 orë)	Letërsia e Rilindjes Kombëtare(Romantizmi shqiptar): 1. Letërsia romantike shqiptare 2. Veçoritë e romantizmit shqiptar 3. <i>Kënga e sprasme e Balës</i> (G. Dara) 4. Jeronim de Rada. Temat dhe ligjërimet 5. <i>Këngët e Milosatos</i> – analizë 6. <i>Kënga I</i> – koment	Letërsia e Rilindjes Kombëtare(Romantizmi shqiptar): 1. Zef Serembe – <i>Elegji</i> , koment 2. Orë praktike 3. Sami Frashëri. Diskursi real dhe mitologjik 4. <i>Besa</i> – analizë 5. Sami Frashëri. <i>Shqipëria ç'ka qenë,</i> <i>ç'është...?</i> – koment I	Pararendësit e modernitetit (epoka e simbolizmit): 1. Simbolizmi në letërsi dhe simbolistë të mëdhenj 2. <i>Rondelë</i> (S. Malarme) 3. <i>Ëndrra ime e zakonshme</i> (P. Verlen) 4. <i>Ofelia</i> (A. Rembo) 6. Eklipsi 7. Sharl Bodler –
			Pararendësit e modernitetit shqiptar: 1. Gj. Fishta - <i>Lahuta e Malcis</i> – analizë 2. Vranina, Kënga e Lulashit – komente 3. Diskutim mësimor 4. N. Mjedja – poeti paramodern 5. <i>Vaji i Bylbylit</i> – analizë 6. <i>Andrra e jetës</i> – analizë	

<p>TEMATIKAT</p>	<p>Gjuha dhe historia:</p>	<p>7. <i>Kënga V</i> – koment 8. Skedat e komentit 9. Diskutim mësimor 10. Kostandin Kristoforidhi. Përkthimet dhe vlerat e tyre 11. <i>Gjahu i malësorëve. Hieja e Tomorrit</i> – analizë 12. <i>Gjahu i malësorëve. Hieja e Tomorrit</i> – koment 13. Diskutim mësimor 14. Naim Frashëri. Temat dhe ligjërimet 15. <i>Lulet e verësë</i> – analizë 16. <i>Bukuria</i> – koment 17. <i>Bagëti e Bujqësia</i> – koment 18. <i>Fjalët e qiririt</i> – koment 19. Ndikimi nga poezia e Lindjes 20. Diskutim mësimor 21. Zef Serembe – Temat dhe diskutet personale. Veçori të stilit 22. <i>Vrull</i> – koment (22 orë) Fjalori abstrakt dhe</p>	<p>6. <i>Sami Frashëri. Shqipëria ç'ka qenë, ç'është...?</i> – koment II 7. Diskutim mësimor (7 orë)</p>	<p>Pylli i simboleve 8. Paris dhe splin 9. <i>Lulet e së keqes</i> – analizë 10. <i>Himni i bukurisë</i> – koment 11. <i>Spleen</i> – koment 12. Diskutim mësimor për Bodlerin 13. E.A. Po – Krijuesi i rrëfimit detektivë 14. <i>Korbi</i> – analizë 15. <i>Korbi</i> – koment 16. <i>Macja e zezë</i> – koment (16 orë)</p>	<p>7. Diskutim mësimor 8. F.S.Noli – Biografia dhe autobiografia noline 9. <i>Israelitë e filistinë</i> – analizë 10. Album – analizë 11. <i>Hymni i flamurit, Syrgjyn vdekur, Samsoni e Dalila</i> – komente 12. A.Z.Çajupi – model kritik. <i>Baba Tomorri</i> – analizë 13. <i>Vaje</i> – koment (13 orë)</p>	<p>Stilistika sintaksore në gjuhën shqipe:</p>
<p>TEMATIKAT</p>	<p>Gjuha dhe historia:</p>	<p>Fjalori abstrakt dhe</p>	<p>Kulturë dhe kritikë:</p>	<p>Fjalët dhe raportet mes tyre:</p>	<p>Stilistika sintaksore në gjuhën shqipe:</p>	

	<p>1. Gjuha shqipe, gjuhë indoevropiane</p> <p>2. Teza ilire për gjuhën shqipe</p> <p>3. Gjuha shqipe, dëshmitë e para</p> <p>(3 orë)</p>	<p>afektiv:</p> <p>1. Formimi i emrave abstraktë dhe afektivë</p> <p>2. Formimi i fjalëve me anë të prejardhjes, kompozimit dhe përngjitjes</p> <p>3. Formimi i fjalëve me anë të nyjzimit dhe konversionit</p> <p>4. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes</p> <p>(4 orë)</p>	<p>1. Rilindja Kombëtare Shqiptare</p> <p>2. Modelet kulturore</p> <p>3. Letërsia dhe shoqëria</p> <p>(3 orë)</p>	<p>1. Sinonimet në gjuhën shqipe</p> <p>2. Antonimet në gjuhën shqipe</p> <p>3. Homonimet në gjuhën shqipe</p> <p>4. Orë praktike</p> <p>(4 orë)</p>	<p>1. Stili i letërsisë artistike</p> <p>2. Veçoritë gjuhësore në tekstet letrare</p> <p>(2 orë)</p>
<p>TEMATIKAT</p>	<p>Epoka e Romantizmit:</p> <p>1. Romantizmi në letërsi</p> <p>2. <i>Letra e Tatiianës</i> (A. Pushkin)</p> <p>3. <i>Për vetveten</i> (Xh. Leopardi)</p> <p>4. J. V. Gëte – Brezi stuhi dhe vrull</p> <p>5. Krijimtaria</p> <p>6. Fausti – analizë</p> <p>7. Natë – koment</p> <p>8. Diskutim mësimor</p> <p>9. V. Hygo – Prijësi i romantizmit</p>	<p>Gjuha argumentuese dhe bindëse:</p> <p>1. Arti i bindjes në Antikitet</p> <p>2. Teksti argumentues dhe karakteristikat e tij</p> <p>(2 orë)</p>	<p>Gjuha argumentuese dhe bindëse:</p> <p>1. Fjalimi politik</p> <p>2. Reklama</p> <p>Veçoritë e funksionimit të niveleve gjuhësore:</p> <p>1. Teksti udhëzues</p> <p>2. Procesverbali</p> <p>3. Stili administrativo – juridik</p> <p>(5 orë)</p>	<p>Shkrimi letrar:</p> <p>1. Eseja letrare</p> <p>2. Analizim i esesë</p> <p>3. Orë praktike</p> <p>(3 orë)</p>	<p>Konotimi dhe denotimi:</p> <p>1. Konotimi dhe denotimi</p> <p>2. Fusha leksikore</p> <p>(2 orë)</p>

<p>TEMATIKAT</p>	<p>10. <i>Katedralja e Parisit</i> – analizë 11. <i>Esmeralda</i> – koment 12. <i>Shtylla e turp</i> – koment 13. <i>Kurrizoja i Katedrales së Parisit</i> – filmi 14. Diskutim mësimor 15. Xh. Bajron – Poeti i lirisë 16. Bajronizmi 17. <i>Shtegtimet e Çajlid Haroldit</i> – analizë . 18. <i>Shqipëria dhe shqiptarët</i> – koment 19. <i>Vajza nga Saragoza</i> – koment 20. <i>Kënga e lamtumirës</i> – koment 21. Diskutim mësimor (21 orë)</p>	<p>Përpunim njohurish; ese, përsëritje dhe test (VP1) (4 orë)</p>	<p>Nga fjalia e thjeshtë tek ajo e përbërë: 1. Fjalia e thjeshtë dhe e përbërë</p>	<p>Pararendësit e modernitetit shqiptar: 1. Periudhat historike 2. Format e</p>	<p>Përpunim njohurish; ese, test (VP3) (3 orë)</p>
-------------------------	--	---	--	--	--

	3. Ligjërimet në gjuhën shqipe (i thjeshtë, bisedor, libror) (3 orë)		(1 orë)	krijimtarisë 3. Vetëdija për letërsinë 4. Gj. Fishta – Simboli i madhësitë së poezisë shqipe 5. Lirikat, llojet 6. Tekstet dramatike – llojet 7. Satira e Fishtës (7 orë)	
TEMATIKAT	Shqipja standarde dhe dialektet: 1. Gjuha standarde shqipe 2. Dialektet e gjuhës shqipe (2 orë)	-	Epoka e realizmit: 1. Realizmi në letërsi dhe Realizmi dhe natyralizmi 2. Shkrimtarë realistë 3. <i>Në ballo</i> (L. Tolstoi) 4. <i>Takimi me njeriun e madh</i> (N. Gogol) 5. <i>Shtëpi kukulle</i> (H. Ibsen) 6. <i>Krim dhe ndëshkim</i> (Dostojevski) 7. <i>David Koperfeld</i> (Ç. Dikens) 8. Balzak – <i>Komedia njerëzore</i> 9. Kryetemat balzakiane 10. <i>Xha Garioi</i> – analizë 11. <i>Vdekja e Garioit</i> – koment 12. Diskutim mësimor (12 orë)	Përpunim njohurish; përsëritje, test (VP2) (2 orë)	-
TEMATIKAT	Përpunim njohurish;	-	Folja, marrëdhëniet	-	-

	vlerësim me gojë (1 orë)		sintaksore dhe figurat e stilit: 1. Përshatja e kallëzuesit foljor me kryefjalën 2. Kallëzuesi i përbërë foljor 3. Metonimia, antiteza, hiperbola, litota (3 orë)		
TEMATIKAT	-	-	Përpunim njohurish; projekt (1 orë)	-	-
Kontributi në rezultatet e nxëniet për kompetencat kryesore të shkollës	I.1.2.3.4.5.6.7.8;	II.1.2.4.5.8.9;	III.1.2.3.4.5.6.7.8.9;	IV-1,3,5,6,8,9;	V. 2,3,4,6,8;

PLANI VJETOR

VITI SHKOLLOR: 2019 – 2020

FUSHA E KURRIKULËS: GJUHË DHE KOMUNIKIM

LËNDA: GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA: XI

PROFIL: NATYROR (37 javë x 3 = 111 orë)

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				
PERIUDHAT	PERIUDHA (I)	PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)	
MUAJT	shtator – tetor (24 orë)	janar – shkurt (24 orë)	mars – prill (24 orë)	
TEMATIKAT	<p>Gjuha figurative:</p> <p>1. Gjuha figurative</p> <p>2. Figurat stilistike</p> <p>(2 orë)</p>	<p>Epoka e realizmit:</p> <p>1. Realizmi në letërsi.</p> <p>2. Realizmi dhe natyralizmi</p> <p>3. Shkrimtarë realistë</p> <p>4. <i>Në ballo</i> (L. Tolstoi)</p> <p>5. <i>Ditëlindja</i> (Dostojevski)</p> <p>6. <i>David Koperfeld</i> (Ch. Dickens)</p> <p>7. Diskutim mësimor</p> <p>8. Balzak – <i>Komedia njerëzore</i></p> <p>9. Kryetemat balzakiane</p>	<p>Veçoritë e funksionimit të niveleve gjuhësore:</p> <p>1. Procesverbali</p> <p>2. Stili administrativo – juridik</p> <p>(2 orë)</p>	<p>Fjalët dhe raportet mes tyre:</p> <p>1. Sinonimet dhe antonimet në gjuhën shqipe</p> <p>2. Homonimet në gjuhën shqipe</p> <p>(2 orë)</p>

<p>TEMATIKAT</p>	<p>Gjuha dhe historia:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjuha shqipe, gjuhë indoevropiane 2. Teza ilire për gjuhën shqipe 3. Gjuha shqipe, dëshmitë e para <p>(3 orë)</p>	<p>Fjalori abstrakt dhe afektiv:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Formimi i emrave abstraktë dhe afektivë 2. Formimi i fjalëve me anë të prejardhjes, kompozimit dhe përngjitjes 3. Formimi i fjalëve me anë të nyjëzimit dhe konversionit 4. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes 	<p>Gjuha argumentuese dhe bindëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Arti i bindjes së Antikitit 2. Teksti argumentues dhe karakteristikat e tij 3. Fjalimet 4. Diskutim mësimor 5. Ese argumentuese 6. Reklama <p>(6 orë)</p>	<p>Nga fjalia e thjeshtë tek ajo e përbërë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fjalia e thjeshtë dhe e përbërë <p>(1 orë)</p>	<p>Pararendësit e modernitetit shqiptar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Scodra</i> – komente 2. A.Z. Çajupi – model kritik 3. <i>Baba Tomorri</i> – analizë 4. <i>Vaje</i> – koment 5. F.S.Noli – Biografia dhe autobiografia nollane 6. Album – analizë 7. <i>Hymni i flamurit</i>, 8. <i>Syrgjyn vdekur</i>– 	<p>10. Xha Goriol – analizë 11. Vdekja e Goriolit – koment 12. Diskutim mësimor</p> <p>(12 orë)</p>
		<p>6. Kostandin Kristoforidhi. Përktimet dhe vlerat e tyre</p> <p>7. <i>Gjahu i malësorëve. Hieja e Tomorrit</i> – analizë</p> <p>8. Naim Frashëri. Temat dhe ligjërimet</p> <p>9. Naim Frashëri. <i>Lulet e verësë</i> – analizë</p> <p>10. Naim Frashëri. <i>Bagëti e Bujqësi</i> – koment</p> <p>11. Sami Frashëri. Diskursi real dhe mitologjik</p> <p>12. Sami Frashëri. <i>Shqipëria ç'ka qenë, ç'është...?</i> – koment</p> <p>(12 orë)</p>				

TEMATIKAT	<p>Epoka e Romantizmit:</p> <ol style="list-style-type: none"> Romantizmi në letërsi <i>Letra e Tatianës</i> (A.Pushkin) J.V. Gëte – Brezi stuhi dhe vrull Krijimtaria <i>Fausti</i> – analizë <i>Natë</i> – koment V. Hygo – Prijësi i romantizmit <i>Katedralja e Parisit</i> – analizë <i>Esméralda</i> – koment <i>Kurrizoja i Katedralës së Parisit</i> – filmi Xh. Bajron – Poeti i lirisë Bajronizmi <i>Shtegtimet e Çajld Haroldit</i> – analizë . <i>Shqipëria dhe shqiptarët</i> – koment <p>(14 orë)</p>	<p>(4 orë)</p> <p>Kulturë dhe kritikë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rilindja Kombëtare Shqiptare Modelet kulturore Letërsia dhe shoqëria <p>(2 orë)</p>	<p>Pararendësit e modernitetit (epoka e simbolizmit):</p> <ol style="list-style-type: none"> Simbolizmi në letërsi dhe simbolistë të mëdhenj Sharl Bodler – Pylli i simboleve <i>Paris dhe splin</i> <i>Lulet e së keqes</i> – analizë <p>(4 orë)</p>	<p>Pararendësit e modernitetit (epoka e simbolizmit):</p> <ol style="list-style-type: none"> E. A. Po – Krijuesi i rrëfimit detektivë <i>Korbi</i> – analizë <i>Korbi</i> – koment <p>(3 orë)</p>	<p>komente</p> <p>(8 orë)</p> <p>Stilistika sintaksore në gjuhën shqipe:</p> <ol style="list-style-type: none"> Stili i letërsisë artistike dhe veçoritë gjuhësore në tekstet letrare <p>(1 orë)</p>
TEMATIKAT	<p>Fjalta, teksti,</p>	<p>Shqipja standarde dhe</p>	<p>Veçoritë e funksionimit</p>	<p>Pararendësit e</p>	<p>Konotimi dhe</p>

	<p>ligjërimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Teksti dhe koherenca e teksteve 2. Fjalë dhe gjykim 3. Ligjërimet në gjuhën shqipe (i thjeshtë, bisedor, libror) 4. Ligjërimet në gjuhën shqipe, (orë praktike) <p>(4 orë)</p>	<p>dialektet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjuha standarde shqipe 2. Dialektet e gjuhës shqipe <p>(2 orë)</p>	<p>të niveleve gjuhësore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Teksti udhëzues <p>(1 orë)</p>	<p>modernitetit shqiptar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Periudhat historike 2. Format e krijimitarisë 3. Vetëdija për letërsinë 4. Gj. Fishta – Simboli i madhësisë së poezisë shqipe 5. Lirikat, llojet 6. Tekstet dramatike – llojet 7. Satira e Fishtës 8. <i>Lahuta e Malcis</i> – analizë 9. <i>Lahuta e Malcis</i> – komente 10. Diskutim mësimor 11. N. Mjeda – poeti paramodern 12. <i>Vaji i Bylbylit</i> – analizë 13. <i>Andrra e jetës</i> – koment <p>(13 orë)</p>	<p>denotimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Konotimi dhe denotimi. Fusha leksikore <p>(1 orë)</p>
<p>TEMATIKAT</p>	<p>Përpunim njohurish; vlerësim me gojë</p> <p>(1 orë)</p>	<p>Përpunim njohurish; ese, përsëritje dhe test (VPI)</p> <p>(4 orë)</p>	<p>Përpunim njohurish; projekt</p> <p>(1 orë)</p>	<p>Folja, marrëdhëniet sintaksore dhe figurat e stilit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përshatja e kallëzuesit foljor me kryefjalën 2. Kallëzuesi i përbërë foljor 	<p>Përpunim njohurish; ese dhe test (VP3)</p> <p>(3 orë)</p>

				3. Metonimia, antiteza, hiperbola, litota (3 orë)	
TEMATIKAT	-	-	-	Përpunim njohurish; përsëritje dhe test (VP2) (2 orë)	-
Kontributi në rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës	I.1.2.3.4.5.6.7.8.9;	II.1.2.4.5.8;	III.1.2.3.4.5.6.7.8;	IV-1,3,5,6,8,9;	V. 2,3,4,6,8,9;

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Gjuha dhe historia		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon variacionet historike, shoqërore dhe kulturore të përdorimit të gjuhës.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 1; II. Mendimtar kreativ: 2; III. Nxënës i suksesshëm: 2.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjuha shqipe, gjuhë indoeuropiane (Model I)			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgon pemën gjenealogjike të gjuhëve për të kuptuar vendin e shqipes në të; • Liston grupet e gjuhëve indoeuropiane; • Veçon elementet indoeuropiane të shqipes; • Prezanton konkluzione mbi kontributin e albanologëve në përcaktimin e shqipes si gjuhë indoeuropiane. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • gjuhë indoeuropiane • albanologë • gjuhë veriore • gjuhë lindore 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Vështron pemën gjenealogjike dhe nxjerr përfundime mbi njohuritë e marra më parë; • Klasifikon grupet e gjuhëve indoeuropiane; • Tregon se te cili grup i gjuhëve bën pjesë shqipja; • Flet mbi kontributin e albanologëve në përcaktimin e shqipes si gjuhë indoeuropiane. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve, materiale të ndryshme nga interneti, Histori e gjuhës shqipe.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave. Shkenca dhe shoqëria.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			

Hyrja:

Mësuesi/ja u paraqet nxënësve të zmadhuar pemën gjenealogjike të gjuhëve dhe u kërkon të japin njohuritë që kanë në lidhje me grupimin e gjuhëve indoeuropiane (njohuri të marra në gjeografi, në ciklin 9-vjeçar) dhe çfarë përfundimesh nxjerrin në lidhje me vendin e shqipes në të (për këtë shfrytëzohet libri digital ose mund të shkarkohet nga internet).

Realizimi i kuptimit:

Ndahet klasa në grupe ekspertësh, pasi mësuesi/ja u ka dhënë këtë material plotësues mbi klasifikimin e gjuhëve indoeuropiane dhe vendin e shqipes në to.

Grupi I. Gjuhët indoeuropiane dhe grupimi i tyre.

Grupi II. Përfundimet e Franc Bopit, që e klasifikojnë shqipen si gjuhë indoeuropiane. Grupi III. Përfundimet e Gustav Majerit për vendin që zë shqipja si gjuhë indoeuropiane.

Mësuesi/ja duhet të sqarojnë disa terma dhe koncepte që lidhen me indoeuropianishten dhe gjuhët indoeuropiane.

- Çështë indoeuropianishtja?

Termi “indoeuropian” u përdor si term për të shënuar një kulturë nga India në Europë (termi i vjetër është indogjerman).

Kjo lidhet me faktin se nisin në Indi dhe përfundojnë me gjuhët gjermanike në Islandë. Është përdorur edhe termi “gjuhë ariane”.

Termi “indoeuropian” nuk shënon një gjuhë të caktuar, por pjesë gjuhësh e kulturash, që kanë prodhuar gjuhë me tipare të përbashkëta, duke gjeneruar në familjet e gjuhëve indoeuropiane. Gjuhët indoeuropiane janë të dëshmuara përmes shkrimeve të gjetura.

2. Familjet e gjuhëve. Grupimi i gjuhëve në familje bëhet sipas origjinës së tyre nga gjuhë me të njëjtat tipare dhe karakteristika strukturore.

Grupet e gjuhëve indoeuropiane janë:

Indishtja (quhet dhe sanskritishte, term i vjetër dhe flitet dhe në dialekte)

Iranishtja (përfshin persishten, afganishten)

Gjuhët italice (gjuhët latine)

Gjuhët kelte (irlandisht, skotisht, britanisht)

Gjuhët gjermanike (nordisht, islandisht, norvegjisht, suedisht, danisht, gjermanisht, holandisht etj.)

Gjuhët baltike (lituanisht, letonisht, prusisht.)

Gjuhët sllave (sllovenisht, serbokroatisht, maqedonisht, bullgarisht, polonisht, çekisht, sllovenisht, rusisht etj.)

Armenishtja

Shqipja

Greqishtja (jonishtja, dorishtja).

Tri gjuhët e fundit janë gjuhë të vjetra që prej burimit. Shqipja dhe armenishtja nuk futen në ndonjë grupim. Ekzistojnë dhe disa gjuhë të vjetra, si: hetishtja dhe tokarishtja, frigishtja, luvishtja.

Në Ballkan janë folur ilirishtja, maqedonishtja dhe trakishtja.

Më pas grupet e ekspertëve japin informacionet e tyre duke u përqendruar në veçoritë thelbësore të shqipes që e kanë klasifikuar si gjuhë indoeuropiane, si dhe kontributet e materialet që kanë sjellë albanologët për ta klasifikuar shqipen si të tillë. Për sa u përket termave “kentium” dhe “satem”, përkatësisht “perëndimore” dhe “lindore”.

Klasifikimi i gjuhëve në kentium e satem ka disa veçori, por më i rëndësishmi është ai që nga fondi indoeuropian, bashkëtingëlloret k, g ruhen siç janë apo ndryshojnë në th dhe dh.

Kentium i ruan ato siç janë, satemi i ndryshon.

Shqipja bën pjesë tek ato satem, por në disa raste shfaq dhe veçori të gjuhëve kentium, ndaj nuk ka një ndarje të prerë se cilit grup i përket.

Reflektimi:

Ushtrimi 1. Mund të përdoret si referencë klasifikimi i mësipërm i gjuhëve.

Pra, në të njëjtin grup bëjnë pjesë:

Italishtja dhe rumanishtja (gjuhët italice)


Polonishtja dhe çekishtja (gjuhët sllave)

Rusishtja dhe ukrainishtja (gjuhët sllave)

Bullgarishtja dhe serbishtja (gjuhët sllave)

Punohen ushtrimet 2 dhe 3.

Pamja e hartës së ngjyrosur është kjo:



Vlerësimi i nxënësve: Sipas gjykimit të mësuesit/es, me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Kërkoni: pika 1 dhe 2 mund të përdoren si detyra dosjesh. Materialet të paraqiten në formë recensionit ose eseje.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Gjuha dhe historia		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon variacionet historike, shoqërore dhe kulturore të përdorimit të gjuhës.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 1; II. Mendimtar kreativ: 2; III. Nxënës i suksesshëm: 2.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjuha shqipe, gjuhë indoeuropiane (Model II)			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Zgjeron njohuritë mbi familjen e gjuhëve indoeuropiane; • Njeh figurat e studiuesve të historisë së gjuhës; • Argumenton pse gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoeuropiane; • Analizon elementet e trashëguara indoeuropiane në gjuhën shqipe. 		<ul style="list-style-type: none"> • gjuhë indoeuropiane • albanologë • gjuhë veriore • gjuhë lindore 	
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> • Rikujton njohuritë e marra ndër vite mbi familjet e gjuhëve indoeuropiane; • Jep informacione rreth studiuesve të shqipes si gjuhë indoeuropiane; • Përmes provave që sjell, sqaron se gjuha shqipe është pjesë e gjuhëve indoeuropiane; • Paraqet në një skemë elementet e trashëguara indoeuropiane në gjuhën shqipe. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, shumësia me ngjyra, fisha të përgatitura, tabela të shkruara, tekste të llojeve të ndryshme, materiale nga interneti për familjet e gjuhëve.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Identiteti kombëtar, historia dhe shkenca.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			

Hyrja:

Mësuesi/ja fillon orën e mësimit me një bisedë të shkurtër, duke rikujtuar njohuritë e marra ndër vite për familjet e gjuhëve. Nxënësve mund t'u drejtohet me këto pyetje:

A kanë ngjashmëri gjuhët ndërmjet tyre?

Klasifikoni gjuhët sipas afrive që ato kanë në grupe gjuhësore.

Po gjuha shqipe, a ka afri me ndonjë gjuhë tjetër?

Realizimi i kuptimit:

Kjo metodë ka si qëllim nxitjen e nxënësve që të diskutojnë për një përmbajtje të mësuar. Organizohet nën udhëheqjen dhe drejtimin e mësuesit/es. Mësuesi/ja shkruan një pjesë ose skemë në dërrasën e zezë dhe ftohen nxënësit të shkruajnë një përgjigje për pyetjen që drejton mësuesi/ja. Qëllimi është angazhimi i nxënësve në diskutim.

Shkruhet materiali i mëposhtëm në dërrasën e zezë.



Mësuesi/ja ndihmon nxënësit me pasqyrimin e gjuhëve indoeuropiane sipas pemës së familjes së gjuhëve dhe u kërkon nxënësve që të vendosin përbri çdo grupi të gjuhëve, gjuhët që kanë më tepër afri.

Reflektimi:

Paraqet në tabelë ose të shkruara në tabakë të mëdhenj me shkrim të dukshëm e me ngjyra, materiale të ndryshme mbi elementet e trashëguar indoeuropiane në gjuhën shqipe.

Shtron çështjen: Veçori të gjuhëve indoeuropiane.

Mësuesi/ja nxit diskutimin dhe drejton orën e mësimit për shpjegimin dhe argumentimin e elementeve të trashëguar indoeuropiane në gjuhën shqipe.

Organizon idetë e nxënësve nëpërmjet stuhisë së mendimeve.

Elemente të trashëguara indoeuropiane

emrat: bijë, bir, dhëndër, vjehërr, motër, ballë, njeri etj.
mbiemrat: i bardhë, i zi, i gjatë, i madh, i lig etj.
përemrat vetorë dhe dëftorë: unë, ti, ai, ky, këta etj.
foljet që pësojnë ndryshime në temë: bie-rashë, rri-ndenja.
numërorët nga një në dhjetë: një, dy, tre...

Studiuesit e vendit të shqipes në grupin e gjuhëve indoeuropiane



(Shënim: Për njohuri më të plota rreth kësaj teme, mësuesi/ja mund t'i referohet veprës së Eqrem Çabej "Hyrje në historinë e gjuhës shqipe".

Për përmbylljen e orës së mësimit shfrytëzohen për t'u punuar ushtrimet e dhëna në libër. Punohen ushtrimi 1 dhe 2 e diskutohet rreth tyre. Shembuj përgjigjesh:

Ushtrimi 1

- a) anglishtja dhe gjermanishtja
- a) italishtja dhe rumanishtja
- a) rusishtja dhe portugalishtja
- a) polonishtja dhe çekishtja
- a) lituanishtja dhe shqipja
- b) anglishtja dhe italishtja
- b) italishtja dhe holandishtja
- b) rusishtja dhe ukrainishtja
- b) polonishtja dhe greqishtja
- b) bullgarishtja dhe serbishtja

Ushtrimi 2

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
një	dy	tre	katër	pesë	gjashtë	shtatë	tetë	nëntë	dhjetë
one	tëo	three	four	five	six	seven	eight	nine	ten
uno	due	tre	quattro	cinque	sei	sette	otto	nove	dieci
un	deux	trois	quatre	cinq	sixieme	septieme	huit	neuf	dix
ein	zëei	drei	vier	funf	sechste	siebte	acht	neun	zehn

Vlerësimi i nxënësve:

Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i nxënësve pjesëmarrës dhe vlerësohet ora e mësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Për detyrë shtëpie jepen ushtrimet 1 dhe 2 (f.8), me qëllim që nxënësit të kenë mundësi të punojnë me material nga biblioteka kombëtare.

Punë e diferencuar:

Duke punuar me veprat e Çabejit, kërkoni material rreth studiuesve të shqipes si gjuhë indoeuropiane.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Gjuha dhe historia		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon variacionet historike, shoqërore dhe kulturore të përdorimit të gjuhës.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 2; III. Nxënës i suksesshëm: 2.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teza ilire për gjuhën shqipe			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Zgjeron njohuritë mbi tezën ilire për gjuhën shqipe; Njeh përfaqësuesit kryesorë të tezës ilire; Flet për afrimet e shqipes me ilirishten e me mesapishten; Tregon për analogjitë mes ilirishtes dhe shqipes. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> teza ilire fisi ilir përfaqësuesit onomastika etnografia 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> Rikujton njohuritë e marra mbi tezën ilire; Përmend përfaqësuesit e tezës ilire; Tregon se me kë ka afri gjuha shqipe; Diskuton për ngjashmëritë mes ilirishtes dhe shqipes. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve, materiale të ndryshme nga interneti, Histori e gjuhës shqipe.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave. Shkenca dhe shoqëria.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Hyrja: Mësuesi/ja kontrollon dhe vlerëson detyrat e shtëpisë. Duke u bazuar nga ajo që nxënësit kanë mësuar nga ora e kaluar mësimore, nxënësve u parashtrohet pyetja: 1. Cila mendoni se është hipoteza më e përhapur për burimin e gjuhës shqipe? Nxënësit duhet të tregojnë se hipoteza më e përhapur për burimin e gjuhës shqipe është ajo e prejardhjes ilire të kësaj gjuhe. Në rast se nxënësit nuk janë në gjendje të tregojnë se cila është hipoteza më e përhapur, atëherë tregon mësuesi/ja dhe fillon me fazën tjetër të orës mësimore. Realizimi i kuptimit: Nxënësit udhëzohen që ta lexojnë tekstin “Teza ilire për gjuhën shqipe” dhe të mbajnë shënime në fletoret e tyre. Pas leximit të tekstit dhe shënimeve të marra, nxënësit duhet të jenë në gjendje të tregojnë se cilët janë përfaqësuesit kryesorë të tezës ilire, ku janë mbështetur ata për studimet e tyre, te cili fis janë bërë studimet më të rëndësishme etj. Punohet ushtrimi 2.			

Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.

Reflektimi:

Në fund të kësaj ore mësimore, nxënësit do ta vëzhgojnë portikun e qytetit me shtatë kamare dhe tjegullën me vulë. Diskutim i lirë.



Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/es, me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni informacione për albanologët e huaj që kanë dhënë një kontribut me shumë vlerë për studimet në fushën e shqipes (Norbert Jokli, Martin Lik, Holger Pedersen).

Kërkoni informacione për albanologët shqiptarë që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për studimet në fushën e shqipes: Shaban Demiraj, Eqrem Çabej, Idriz Ajeti, Besim Bokshi etj., dhe plotësoni skedat e jetës dhe të veprimtarisë së tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Gjuha dhe historia		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon variacionet historike, shoqërore dhe kulturore të përdorimit të gjuhës.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 5; III. Nxënës i suksesshëm: 2.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjuha shqipe, dëshmitë e para			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Zgjeron informacionin mbi gjuhën shqipe dhe emrin “shqiptar”; • Identifikon vendin e gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve indoeuropiane; • Përcakton vlerën e dokumenteve të para, si dëshmi të shkrimit shqip; • Heton për origjinën e emrit “shqiptar”; • Diskuton mbi dy tezat në lidhje me emrin “shqiptar”. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • gjuhë shqipe • emri shqiptar • dokumentet e para • origjinë • tezë 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Diskuton për njohuritë paraprake mbi gjuhën shqipe dhe emrin “shqiptar”; • Shpjegon për vendin e gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve indoeuropiane • Vlerëson rëndësinë e dëshmive të para; • Sjell informacione mbi emrin “shqiptar” dhe tezat e prejardhjes së tij; • Parashtron dy tezat mbi emrin “shqiptar”. 			
Burimet: Teksti mësimor Gjuha shqipe 11, burime të tjera nga jeta e përditshme dhe interneti, si tabela të ndryshme, foto, materiale, dëshmi të para të gjuhës shqipe, video.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): histori, kulturë gjuhe.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Hyrja:


Hapi I. Diskutim për njohuritë paraprake.

Mësuesi/ja e nis mësimin me diskutimin mbi mënyrën e të shprehurit me anë të komunikimit verbal të atij joverbal.

Realizimi i kuptimit:

Hapi II: Pema e mendimit.

Pjesa e dytë e orës së mësimin lidhet me punën hulumtuese të nxënësve rreth dokumenteve të para të shqipes. Mësuesi/ja shkruan në dërrasë grupin emëror Gjuha shqipe dhe shkruan gjithë përgjigjet e nxënësve rreth tij. Nxënësit shoqërojnë përgjigjet edhe me materialet që kanë hulumtuar.



Në fund nxënësit i përmbledhin të dhënat në tabelën e mëposhtme:

√	+	-	?

Hapi III. INSERT, prezantim i punës hulumtuese.

Mësuesi/ja tërheq vëmendjen e nxënësve të njohuritë e prezantuara në tekst. Nxënësit lexojnë materialin në tekst dhe vendosin shenjat përkatëse. Pasi përfundojnë punën, plotësojnë tabelën në fletore, kurse katër nxënës dalin në tabelë dhe plotësojnë secili nga një ndarje. Në fund bëhet verifikimi i njohurive që kanë pasur nxënësit, ato që kanë fituar të reja dhe ato që gjatë punës i kanë rindërtuar. Njohuritë e tekstit pasurohen edhe me njohuritë e reja, që kanë sjellë nxënësit nga hulumtimi i tyre.

Diskutim i lirë. Pas prezantimit, nxënësit duke identifikuar faktet e nxjerra nga teksti, si dhe nga hulumtimet e nxënësve, vlerësojnë rëndësinë e këtyre dëshmimeve.

Reflektimi:

Hapi III: Di, Dua të di, Mësoj.


Mësuesi/ja shkruan në tabelë nënçështjen e mësimin: Emri shqiptar. Ndahet tabela në tri pjesë. Në pjesën e parë shkruhet çdo informacion që kanë nxënësit për emrin shqiptar. Në këtë shtyllë shkruhen edhe materiale që mund të kenë sjellë nxënësit nga puna e tyre hulumtuese mbi emrin shqiptar dhe tezat e prejardhjes së tij. Në shtyllën e dytë shtrohen pyetjet që iu lindin nxënësve, si dhe dy çështjet kryesore që do të sqarohen në mësim.

Në shtyllën e tretë paraqitet informacioni i ri, që lidhet me pyetjet e shtruara.

Di	Dua të di	Mësoj
Lashtësia e popullit shqiptar Emri – shqiptar, albanes Shënim. Në këtë tabelë do të shkruhet i gjithë informacioni që sjellin nxënësit.	Kur është përdorur për herë të parë emri albanes? Po shqiptar Cilat janë tezat për të shpjeguar emrin shqiptar?	Emri albanes ka qenë përdorur prej vendasve. Në shek.II nga Ptolemeu, albanoi – Albanopolis në Shqipërinë e Mesme 1072 – kronikani bizantin – Arbanenses n– Arbanum. Në mesjetë Arbanum ishte Kruja. - Emri shqiptar filloi të përhapej në fund të shek. XVII. Tezat: Gustav Majer: nga fjala latine excipere = kuptoj Lambertz: e shpjegon emrin nga shqiponja. Kjo lidhet edhe me simbolin e shqipes që është në flamur që në kohën e Skënderbeut.

Tabela plotësohet me informacionin e ri që merr nxënësi.

Për të mbajtur mend informacionin e ri mund të përdoret edhe një grafik organizues: Tezat për dorimin e emrit shqiptar.



Majeri	Vajgandi	Lambertzi
Nga fjala latine <i>excipere</i> = kuptoj	i shqiptoi - kuptoi	nga emri i shqiponjës. E gjejmë te → Plutarku → Edit Durham → flamuri i Skënderbeut

Hapi V. Praktikë e pavarur.

Nxënësit punojnë në grupe ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5. Prezantimi i punës së tyre në klasë.

Ushtrimi 1	Ushtrimi 2
Shekulli II i e.r – Albanoi 1166 - arbanenses 1204, 1250 – vendin Arbanum 1271 - albanenses, që u përdor deri në fund të shek. XVII.	1. vjen nga latinishtja dhe do të thotë <i>kuptoj</i> (G.Majer), (G.Vajgand) mbështet tezën: shqip = shqip, qartë, kuptueshëm 2. Sipas M. Lambertz prejardhja lidhet me <i>shqiponjën</i> , si: totem, kafshë që adhurrohej nga vendasit, dhe, sipas tij, është shprehja e kombësisë.

Zgjidhje ushtrimesh

Ushtrimi 3

- a) Autori anonim – Këtu shqiptarët e lartpërmendur...
b) Guiliem Adami – Sado që shqiptarët kanë një gjuhë...

Ushtrimi 4

- a) i gabuar b) i gabuar c) i vërtetë d) i vërtetë e) i gabuar f) i gabuar
g) i gabuar h) i gabuar i) i gabuar j) i gabuar k) i vërtetë l) i gabuar

Ushtrimi 5

- a) Gjon Buzuku – *Meshari* b) Arnold fon Harfi – *Fjalorthe*
c) Pal Ëngjëlli – *Formula e pagëzimit e ritit latin* (8 nëntor 1462)

Vlerësimi i nxënësve:

Në fund të orës së mësimin bëhet vlerësimi i nxënësve pjesëmarrës. Mësuesi/ja vlerëson nxënës të niveleve të ndryshme për punën e bërë. Kujdes tregohet mbi punën e bërë në grup. Mësuesi/ja mund të vlerësojë aspekte të ndryshme të punës së nxënësve dhe mund të kërkojë nga nxënësit të vlerësojnë punën e shokëve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Sillni në klasë fjalë, tekste të dialekteve të shqipes.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjala, teksti, ligjërimi		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon diskurset e ndryshme (letrare, joletrare, sociale, kulturore, politike, administrative etj.).	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 2; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teksti dhe koherenca e teksteve (2 orë)			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon se çështë teksti; • Identifikon tekstin; • Dallon karakteristikat e tekstit; • Heton mangësitë e një teksti të paplotë plotësuar; • Përdor elementet e ndërtimit të tekstit në të shkruar; • Përshtat situatat me përdorimin e llojeve të teksteve. 		<ul style="list-style-type: none"> • tekst • karakteristika të tekstit • paragraf • plan leksikor • plan gramatikor • koherent • homogjen 	
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton rreth tekstit; • Dallon një pjesë të tekstit; • Përmend disa nga karakteristikat e tekstit; • Gjen disa nga mangësitë e tekstit të paplotë; • Bën saktë strukturën e tekstit; • Paraqet situata sipas llojeve të teksteve. 			
Burimet: Teksti mësimor Gjuha shqipe 11, libri digjital; teksti mësimor, tekste të llojeve të ndryshme.			

Përdorimi i TIK-ut: Po.

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): /

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Ora I.

Hyrja:


Hapi I. Diskutim, përmbledhje e strukturuar

Mësuesi/ja paraqet në tabelë, të shkruara në tabakë të mëdhenj me shkrim të dukshëm e me ngjyra, tekste të formave dhe natyrave të ndryshme. Shtron çështjen: - Çfarë është shkruar në tabakët e vendosura në tabelë?

Përgjigjet e nxënësve mund të jenë: fjalë, fjali, tekste, fragmente teksti, grup fjalësh etj.

Mësuesi/ja nënvizon fjalën tekst dhe pyet: - Çështë teksti?

Mbledh idetë e nxënësve me anë të *stuhisë së mendimeve*.



Mësuesi/ja shënon përkufizimin në tabelë:

Teksti është njësia bazë e aktivitetit tonë gjuhësor, që i përgjigjet një qëllimi komunikues.

Ai mund të ndërtohet nga **një fjalë** e vetme a nga disa fjalë, nga **një fjali** (e thjeshtë ose e përbërë), nga **disa fjali, paragrafë, krerë a pjesë** në varësi të situatës në të cilën përdoret dhe qëllimit që synohet të arrihet.

Analizon me nxënësit nëse kryejnë këtë funksion tekstet që janë shënuar në tabelë.

- Çfarë e kushtëzon një grup fjalësh që të jetë tekst?

Në planin leksikor
(të përdoret leksiku i saktë dhe i pasur)

Teksti duhet të jetë i saktë:

Në planin gramatikor
(të respektojnë rregullat e gjuhës, në të cilën shkruhet)

→ realizohet me anë të:

- përshtatjes morfologjike të fjalëve
- rimarrjes së fjalëve
- përemrave, ndajfoljeve,
- zëvendësimit
- sinonimeve
- hiperonimisë
- parafrazës
- hiponimisë
- konektorëve

Teksti duhet të jetë:

I plotë → (argument, temë themelore, trajtë)

I rregullt → (fakte, ide, zhvillohet organikisht)

Koherent → (lidhje logjike e kuptimore, vazhdimësi)

Homogjen → (në situatën komunikuese etj. - marrësi, qëllimi ... etj.)

Realizimi i kuptimit:

Hapi II. Punë në grup

Pas çdo hapi të shpjegimit të elementeve përbërëse të tekstit, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të hetojnë në grup nëse tekstet e paraqitura në tabelë i kanë këto veçori. Diskutohen tiparet dhe veçoritë për secilin rast.

Hapi III. Praktikë e drejtuar

Mësuesi/ja u tërheq vëmendjen nxënësve të përbërësit të tekstit. Koherenca është elementi që kërkon koordinimin e të gjithë përbërësve. Lihen të lirë nxënësit për 3 minuta të vëzhgojnë tekstin e ushtrimit 3 dhe më pas analizojnë realizimin e këtyre përbërësve së bashku me nxënësit.

Hapi IV. Punë e pavarur

E njëjta praktikë ndiqet edhe për punimin e Ushtrimit 1. Nxënësit nxjerrin përfundime në mënyrë të pavarur. Diskutojnë zgjidhjet e tyre individuale duke argumentuar.

Zgjidhje ushtrimesh

Ushtrimi 1. Teksti A. Ky tekst është koherent, sepse na përcjell një informacion që lidhet me faktin se ka disa probleme, siç është vaksinimi i fëmijëve apo mësimi i anglishtes në shkollë, për të cilat nuk ekzistojnë politika të majta apo të djathta për zgjidhjen e tyre. Megjithatë, ai nuk është i rregullt, sepse fjala mënyrë është përdorur në vend të fjalës politikë.

Nuk ka mënyra, po politika të djathta apo të majta.

Teksti B. Ky tekst është koherent për nga stili. Të gjithë përbërësit e tij kanë lidhje logjike dhe kuptimore me njëri-tjetrin. Ai na përcjell në mënyrë korrekte një fakt: Ura e Mesit, monument kulture... është kthyer në vatër mbeturinash, pasojën: turistët .. mbetën të zhgënjyer dhe shkakun: ...askush nuk është kujdesur

Teksti është i saktë në pikëpamje leksikore dhe gramatikore: fjalët dhe fjalitë janë të lidhura me njëra-tjetrën me logjikë dhe sipas rregullave të gjuhës, konektorët (dhe, ndonëse), fjalët zëvendësuese (ata – turistët), përemri (askush) janë përdorur saktë.

Teksti C është jokohorent. Pjesët e fjalisë nuk lidhen në mënyrë logjike e kuptimore me njëra-tjetrën, mungojnë konektorët, nuk respektohen shenjat e pikësimit.

Le të shohim të dhënat që jep shkrimi, si dhe lidhjen logjike që duhet të kishin pjesët e fjalisë:

Mbi urën e vjetër, që është monument kulture. Në asnjërin krah të saj (urës) nuk ka një tabelë që të tregojë emërtimin e vitit kur është ndërtuar, (po) sheh, jo rrallëherë, veç njerëzve dhe kafshëve të ngarkuara që kalojnë mbi të, dhe mbeturina.

Nxënësit së bashku me mësuesin/en analizojnë ndërtimin e fjalisë së përbërë dhe lidhjen logjike e gramatikore të pjesëve të saj.

Reflektimi:

Hapi V. Punë e pavarur në grup

Punohen në mënyrë të pavarur me grupe ushtrimet 2, 4, 5, 6, 7. Nxënësit mund të punojnë në çift dhe diskutojnë opinionet e tyre me njëri-tjetrin.

Zgjidhje ushtrimesh

Ushtrimi 2. Proverbat janë tekste të plota.

Mos u ngut, se vonohesh. Ha sa të kesh, fol sa duhet. E keqja s' harrohet.

Mos e prek gjarprin në bisht, se të ha në gisht. Ai shkon të ndajë e merr pjesë për vete.

Nxënësit nxjerrin mesazhet që komunikojnë ato.

Ushtrimi 3.

Teksti i dhënë ka disa komponentë përbërës që lidhen midis tyre nga tema:

- Fjalja e parë paraqet faktin. (hyrja)
- Fjalja e dytë tregon reagimin e Institutit të Shëndetit Publik ndaj këtij fakti dhe sjell dy argumente pse reagimi i tyre nuk merret në konsideratë. (zhvillimi)
- Fjalja e tretë tregon masat që janë marrë nga Ministria për ta zgjidhur këtë problem në të ardhmen. (mbyllja)

Ushtrimi 4.

1. Autori kërkon të marrë informacion.
2. Autori dëshiron të sqarojë një keqkuptim dhe të kërkojë ndjesë.
3. Autori reklamon një produkt të caktuar, me qëllim që ta shesë atë.
4. Autori uron protagonistët, duke vlerësuar shfaqjen.

Teksti është koherent.

Nuk ka një marrës të caktuar, por disa: 1- njerëzit e thjeshtë, të cilët janë të interesuar për ndotjen e ajrit; 2- biznesmenët që merren me tregtinë e naftës (marrëveshja me OBT-në etj.)... Synimi për të cilin është shkruar është i qartë, kërkon të informojë publikun dhe grupet e interesuara për ndotjen e mjedisit dhe shqetësimi i palëve të interesuara për të. Është i rregullt nga pikëpamja leksikore dhe gramatikore.

Teksti është koherent.

Nuk ka një marrës të caktuar, por disa: 1- njerëzit e thjeshtë, të cilët janë të interesuar për ndotjen e ajrit; 2- biznesmenët që merren me tregtinë e naftës (marrëveshja me OBT-në etj.)... Synimi për të cilin është shkruar është i qartë, kërkon të informojë publikun dhe grupet e interesuara për ndotjen e mjedisit dhe shqetësimi i palëve të interesuara për të. Është i rregullt nga pikëpamja leksikore dhe gramatikore.

Ushtrimi 6

- a) Informon mbi vendndodhjen e një objekti të caktuar. Përdoret si udhërrëfyes në rrugë.
- b) Udhëzon mbi ruajtjen e një objekti të caktuar. Përdoret në vende, të cilat kanë pyje.
- c) Ndalon përdorimin e një objekti të caktuar. Përdoret në mjedise publike.
- d) Reklamë, ofron një shërbim të caktuar. Përdoret në fletëpalosje të ndryshme, të cilat promovojnë aktivitetin e një institucioni të caktuar (bankë).

Ushtrimi 7

1. dhe (lidhëz bashkërenditëse shtuese); 2. sepse (lidhëz nënrenditëse shkakore); 3. sepse, dhe (lidhëza nënrenditëse dhe bashkërenditëse); 4. sepse (lidhëz nënrenditëse); 5. sepse (lidhëz nënrenditëse).

Hapi VI. Shkrim i lirë, parashikim me terma paraparakë

Shkrimi i lirë është një teknikë që i vë nxënësit të shkruajnë pa u ndalur për 5 ose 10 minuta rreth detyrës që u është dhënë, ku të shprehin mendimin e tyre të pavarur.

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë disa terma paraprakë, si: mjedisi, ndotja, problemet e hasura, shëndeti i njeriut dhe u kërkon nxënësve të ndërtojnë një tekst mbi mjedisin duke pasur parasysh përbërësit e tij e të identifikojnë elementet përbërëse. (Tekstet mund të përbëhen nga 2-3 fjali, mjafton që të përmbushin parametrat e duhur.) Nëse koha për zhvillimin e këtij ushtrimi nuk është e mjaftueshme, mësuesi/ja mund t'ua japë këtë ushtrim edhe si detyrë shtëpie.

Shënim. Sipas kohës që ka në dispozicion, mësuesi/ja mund të japë edhe ushtrime rreth elementeve të tjera përbërëse të tekstit, si: të argumentojnë saktësinë në planin morfologjik e sintaksor, të zbulojë argumentet që përmban teksti dhe llojet e fjalive me nënrenditje që përdoren (shih Ushtrimin 5) etj.

Detyrë shtëpie. b) Sillni në klasë tekste me strukturë të gjatë; pjesë, krerë etj.

Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i nxënësve pjesëmarrës dhe vlerësohet ora e mësimit.

Informacion plus

Duke qenë se koherenca është një element i rëndësishëm i ndërtimit të tekstit dhe një koncept i ri dhe gati i panjohur për një pjesë të mësuesve, më poshtë jepet një material plotësues.

Ora II.

Hyrja:


Bëhet një përmbledhje e orës së kaluar mësimore dhe më pas mësuesi/ja fillon t'i pyesë nxënësit se çfarë dinë ata për koherencën, a është e njëjtë koherenca me kohezionin dhe si shprehet koherenca.

Koherenca

Kohezioni dhe koherenca janë dy elemente mjaft të rëndësishme që realizojnë njësinë “tekst”.

Koherenca shpreh qëndrueshmërinë ose vazhdimësinë kuptimore të tekstit.

Nëse tekstin do ta paraqesim si më poshtë:



Plotësi = përkim i plotë me qëllimin për të cilin teksti është projektuar dhe ndërtuar dhe me kontekstin në të cilin është përfshirë.

Duke parë skemën vëmë në dukje se koherenca shprehet me elementet logjike, semantike dhe stilistikore.

Realizimi i kuptimit:

Ora mësimore vazhdohet me koherencën logjike.

Koherenca logjike realizon ekuilibrin e tërësisë tematike të një teksti, temat e të cilit zhvillohen në mënyrë harmonike, për të vënë në pah qëllimin dhe temën qendrore. Jo më pak e rëndësishme është prania e koherencës semantike, e cila ka të bëjë me leksikun, me kuptimet e fjalëve të pranishme në tekst dhe realizon vazhdimësinë kuptimore të tekstit. Edhe aspekti i tretë, koherenca stilistikore, paraqitet si një element i nevojshëm i tekstualitetit, sidomos kur bëhet fjalë për tekste me shtrirje të gjatë (si: narracion, përshkrim), tekste që kërkojnë një stil dhe gjuhë të zgjedhur.

Çdonjëri prej nesh arrin të dallojë pak a shumë, që në pamjen e parë një tekst “të lidhur” nga një tekst “të palidhur”. Më e vështirë do të ishte të përcaktonim kushtet e nevojshme kur një tekst përmbush kriteret për t’u përkufizuar si koherent.

Për të vënë në dukje dallimin ndërmjet një teksti koherent (tekst “i vërtetë”) dhe një teksti jokohorent (pseudotekst), po sjellim shembuj:

(1) Lotaritë e shumta që çdo ditë po tërheqin më shumë njerëz të interesuar për to janë bërë një mundësi fitimi dhe aq më tepër, kur këto transmetohen dhe nëpërmjet ekranit të televizionit. Një ndër to është dhe lotaria 6 nga 45, e cila dhe sonte mund të bëjë të lumtur shumë prej jush. Por, edhe nëse nuk fitoni, e rëndësishme është të marrësh pjesë.

(2) Një koncert vokal – instrumental është dhënë këto ditë në Vlorë // Për çdo kontratë “The artist” apo i famshmi Prince kërkon shifra marramendëse. // Ende enigmë fajtorët për vrasjen e minorenit 15-vjeçar E.M. // Trupa speciale kundër trafikut të klandestinëve në Vlorë.

(Gazeta Shqiptare, po aty)

Shembulli (1) të krijon përshtypjen se flitet për të njëjtën gjë; shembulli (2) nuk na e krijon këtë përshtypje, edhe pse nga pikëpamja gramatikore është plotësisht i saktë. Por çfarë e dallon tekstin (1) nga teksti (2)? Themi se shembulli (1) është koherent, sepse gjatë marrjes së tij, jemi në gjendje të **AKTIVIZOJMË** një **PAKETË** të ngjeshur dijesh të akumuluar (d.m.th., të rikujtojmë dhe të nxitim njohuritë tona), pra, një pjesë të **enciklopedisë** sonë, që për ne është mjaft e rëndësishme. Kjo pjesë e enciklopedisë, në shembullin (1), përbëhet nga disa “njësi” informuese:

- a. lotaritë e shumta po tërheqin çdo ditë e më shumë njerëz;
- b. ato janë mundësi fitimi;
- c. një ndër to është lotaria 6 nga 45;
- d. e rëndësishme është të marrësh pjesë etj.

Shembullin mund ta plotësojmë me njohuritë tona vetjake: p.sh., përse pjesëmarrja në një lotari ngjall gjithashtu interes etj.

Me ndihmën e njohurive të tilla mund të mbushim “boshllëqet” e krijuara nga formulimi i tekstit sipërfaqësor, mund të mbushen nga njohuri që çdonjëri prej nesh zotëron: “koherenca plotëson zbrazëtinë e lënë nga kohezioni”.

Shembulli (2) nuk na lejon aktivizimin e asnjë pakete njohurish paraprake, që të lidhë pjesët përbërëse. Ç’lidhje ka, p.sh., i famshmi Princ me trupat speciale të Vlorës? Nëse në tërësinë e njohurive tona enciklopedike nuk gjejmë asnjë paketë njohurish mjaftueshmërisht kompakte, që të lejojë organizimin e fjalive në një të tërë, nuk mund të flasim kurrsesi për koherencë në shembullin (2). Pra, koherenca e një teksti, siç është në shembullin (1), nuk qëndron në karakteristikat e mëvetësishme gjuhësore, por në tërësinë e njohurive enciklopedike paraprake. Dhe, meqenëse shembulli (1) u përgjigjet disa prej njohurive tona enciklopedike, të cilat i kemi skematizuar në fjalitë (a-d), këtë tekst e vlerësojmë si koherent. Kështu, ndërsa analiza e kohezionit zhvillohet praktikisht e tëra në kuadrin e dukurive gjuhësore, analiza e koherencës na çon dhe më larg, drejt kufirit delikat midis ligjërimit, njohjes dhe mendimit, që gjuhësia të paktën deri më sot, i ka quajtur “kolonat e Herkulit”. Në të vërtetë, analiza e koherencës lidhet me mekanizmat nëpërmjet të cilëve mendja njerëzore organizon njohjen, të cilën e sjell në kujtesë, kur ka nevojë dhe e përdor për të interpretuar njohuritë e reja. Për këtë arsye, studimi i koherencës fut në lojë dhe disiplina të tjera, si: psikologjinë, shkencën njohëse, inteligjencën artificiale, që duken se janë më të afta të dalin nga kufijtë e territorit gjuhësor.

Thamë në fillim se koherenca u referohet funksioneve të botës tekstuale (konceptet dhe lidhjet konceptuale). “Koncepti është përvijimi i njohurive që mund të aktivizohen apo të risillen në kujtesë në mënyrë të harmonishme dhe konkrete”. Në aktin ligjërimit, kur flasim apo dëgjojmë dikë tjetër, aktivizojmë pjesën (depozitën) aktive të kujtesës sonë. Gjithashtu, konceptet që bëjnë pjesë në kujtesën tonë, nëpërmjet komponentëve të tyre përbërës, krijojnë lidhje të ndryshme, si:

- lidhje njohëse të qëndrueshme (p.sh., të gjithë njerëzit janë qenie të vdekshme);
- lidhje tipike (p.sh., njerëzit jetojnë zakonisht në shoqëri, pra janë qenie sociale);
- lidhje të rastësishme (p.sh., disa njerëz janë biondë).

Në aktin e komunikimit aktivizojmë konceptet dhe marrëdhëniet konceptuale të së ashtuquajturës depozitë apo ‘kujtesë aktive’. Që kujtesa jonë aktive të ketë shkallë të lartë vlefshmërie, njohuritë e ndryshme që marrim çdo ditë, duhet të kenë formën e **MODELEVE TË PËRGJITHSHME**.

Studiuesit Beaugrande /Dressler parashtrojnë katër modele të përgjithshme të magazinimit të njohurive: Frames – Kornizat janë strukturat globale që përmbajnë njohuri të përgjithshme rreth një koncepti qendror të caktuarKëto korniza tregojnë, në vija të trasha, "...lidhjet , por jo rendin sipas të cilit këto fjalë, të lidhura reciprokisht, duhet të shprehen". "Skemat janë "...struktura globale të ngjarjeve dhe rrethanave të vendosura në sekuenca të organizuara dhe të lidhura nga afërsia kohore dhe shkakore "Në dallim nga kornizat, skemat kanë një vendosje sekuencale në progresion, e tillë që lejon të zhvillojmë hipoteza mbi atë që, në vazhdimësi, do të thuhet në një "kohë të caktuar tekstuale". "Projektet ose Planet janë "... modele të përgjithshme ngjarjesh dhe rrethanash që synojnë drejt një qëllimi të paramenduar". Këto projekte ose plane ndryshojnë nga skemat për faktin se projektuesi (d.m.th., krijuesi i tekstit) i vlerëson të gjitha sipas mënyrës se si këto elemente lëvizin drejt qëllimit të paravendosur. "Scripts – Dorëshkrimet janë "... projekte të qëndrueshme që përdoren shpesh për të saktësuar rolet dhe veprimet e pjesëmarrësve në komunikim".

Reflektimi:

Jepen informacione shtesë për njësinë mësimore dhe diskutohet për të.

Informacion plus

Në disa literatura gjejmë të përdoret dhe termi tekst joverbal. Sipas disa studiuesve, një tekst mund të formulohet edhe me kode të tjera, veç kodit të gjuhës së shkruar dhe të folur.

Kështu një tekst mund të përdoret:

gjuhën e figurave - një vizatim, një pikturë, një skulpturë ose një shenjë rrugore.

gjuhën muzikore - të përbërë nga notat, për shembull, të tilla janë tekstet muzikore, si një fugë e Bahut ose një koncert i Bethovenit.

Gjithashtu në një tekst mund të përdoren në të njëjtën kohë disa kode: figura, fjalët, muzika etj., p.sh.: fumeti (revistë me vizatime e me fjalë, përgjithësisht për fëmijë) ose një pjesë humoristike e ilustruar.

Shënim. Mësuesi/ja mund t'i përdorë edhe tekstet e mëposhtme:

Portreti i Skënderbeut, Ismail Kadare

Dy brirë dhie kish në krye

Emblemë e vjetër e çuditshme

Sikur ta dinte që mes brinjëve Dy perandorë do godiste

"Po ia hëngre pulën tjetrit, lidhe tënden te magjja" "Ua! Paska rënë borë!"

E dashur nënë !

Këtë kartolinë po ta shkruaj nga Moska.

Së bashku me mallin për ty, po përjetoj edhe dëshirën për të vizituar ato vende, ku ti ke jetuar dikur. Shpresoj të kem kohë, të të dërgoj disa foto.

Me dashuri e mall nga larg,

Blerina

Pjesët e nënvizuara janë tregues i elementeve gramatikore dhe leksikore të tekstit.

Ndriçimi i dobët në klasa dhe mungesa e ndërgjegjësimit për të kryer një vizitë të syve, ka bërë që jo pak prej nxënësve të shkollave 9-vjeçare të kenë probleme me shikimin. Të dhënat e Institutit të Shëndetit Publik dëshmojnë këtë fenomen. Sipas studimit të kryer nga specialistët, rreth 21 % e fëmijëve nga 6-14 vjeç kanë çrregullime pamore.

Dhe pasi fola për shkrimtarët, do t'ju them një gjë: kam vënë re se librat e lutjeve fetare, ndërsa kanë lutje për çdo shkollë e zanat, s'kanë ndonjë lutje të veçantë për shkrimtarët. Unë nuk jam shumë fetar, por ndonjëherë më hipën zjarri për një besim të shkurtër. Jam në një gjendje të tillë dhe kam gatuar një lutje të shkurtër të cilën ju kërkoj leje të këndoj.

(Lutja e shkrimtarit, Faik Konica)

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/es.

Detyrat dhe puna e pavarur: /

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalja, teksti, ligjërimi		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon diskurset e ndryshme (letrare, joletrare, sociale, kulturore, politike, administrative etj.).	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 2; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teksti dhe llojet e tij			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Klasifikon tekstet e llojeve të ndryshme; • Bën tabelën e klasifikimit të llojeve të ndryshme të teksteve; • Dallon tekstet letrare nga tekstet joletrare; • Përcakton veçoritë e llojeve të teksteve nëpërmjet synimit të tyre; • Identifikon llojet e teksteve nëpërmjet funksionit të tyre. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • lloje tekstesh • klasifikim i teksteve • tekst letrar • tekst joletrar • funksion praktik/ estetik 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Dallon llojet e teksteve; • Shkruan llojet e teksteve në tabelë; • Veçon tekstin letrar nga ai joletrar; • Shpjegon për veçoritë e llojeve të teksteve; • Sqaron se cilat tekste kanë funksion praktik dhe cilat estetik. 			
Burimet: Teksti mësimor Gjuha shqipe 11, libri digjital; teksti mësimor, tekste të llojeve të ndryshme letrare/ tekste joletrare.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): /			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Hyrja:

Hapi I. Diskutim

Mësuesi/ja e nis mësimin me diskutimin e detyrës së shtëpisë. Diskutohet si janë ndërtuar tekstet në bazë të titujve që u janë sugjeruar, përqendrohet vëmendja te pjesët përbërëse të tyre duke bërë kështu një përsëritje të njohurive.

Realizimi i kuptimit:

Hapi II. Pema e mendimit

Pema e mendimit ose përvijimi i të menduarit është një teknikë që nxit nxënësit të mendojnë rreth temës dhe të krijojnë sa më shumë lidhje që të mundin.

Shkruan në tabelë titullin e mësimit “Llojet e teksteve”. Mësuesi/ja ndan klasën në pesë grupe dhe u shpërndan tekste të llojeve të ndryshme: letrare dhe joletrare. Nxënësit kanë njohuri për llojet e teksteve nga klasat e mëparshme, të cilat u rikujtohen nëpërmjet pyetjeve, duke i shkruar në tabelë:


- Çfarë janë fragmentet?
- Pse janë tekste?
- Cili është qëllimi i tyre? Të ç’lloji janë këto tekste?
- Ç’veçori kanë ato?

Çdo grup do të japë përgjigjet e veta, të cilat do të kenë anët e tyre të përbashkëta: janë tekste, janë njësi komunikimi që kanë një qëllim të caktuar, dhe përgjigje të ndryshme, që lidhen me qëllimin: të informojë, të udhëzojë, të shprehë ndjenja..., me llojet: letrare ose joletrare dhe me nënlojet e tyre etj.

P.sh.: Kalaja e Petrelës, nga zbulimet e bëra, është ndërtuar në kohën e sundimit bizantin Justinianit, në shek. VI, pas Krishtit. Është ngritur në një terren me shpate mjaft të pjerrëta, të cilat e kanë bërë kalanë shumë të mbrojtur. U ngrit në momentet kur kalaja e Vilës, e cila ndodhej përballë saj, humbi rëndësinë e saj... Nga pika më e lartë e kalasë shihet një pamje e mrekullueshme e zonës kodrinore të Petrelës...

Këto fjali janë përshkruese, qëllimi i tyre është të përshkruajë, teksti ka karakter praktik, pasi përdoret në guida turistike.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit për të realizuar objektivin e orës së mësimit, që nxënësit të dallojnë llojet e teksteve duke plotësuar organizuesin grafik *pema e mendjes*.



Reflektimi:

Hapi III. Punë në grup, grafik organizues

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha që do të analizojnë:

Grupi I - tekste me funksion praktik – **tekstet joletrare;**

Grupi II - tekste me funksion estetik – **tekstet letrare.**

Grupet ndahen edhe në nëngrupe, sipas llojit të tekstit.

Mësuesi/ja përgatit në dy tabakë të mëdhenj letrë organizuesin grafik për llojet e teksteve: letrar e joletrar dhe ia vë përpara çdo grupi. Nxënësit punojnë në grup dhe plotësojnë së bashku tabelën e klasifikimit të teksteve me anë të organizuesit grafik.

Tekstet me funksion praktik – tekstet joletrare

Teksti	Ç'bën?	Synimi	Lloji i tekstit
<i>Rrëfyes</i>	Tregon ngjarje reale me personazhe dhe vende reale.	Të nxitë fantazinë e lexuesit.	Kronika, shënime udhëtimi, biografi, intervista etj.
<i>Përshkrues</i>	Përshkruan karakteristikat e njerëzve, kafshëve, sendeve, vendeve, objekteve.	Të përshkruajë cilësi fizike e psikologjike, që lexuesi i percepton mendërisht.	Guida, traktate teknike, tekste shkencore etj.
<i>Paraqitës</i>	Paraqet të dhëna, informacione, shpjegon koncepte, teori mbi një argument të caktuar.	Të shpjegojë, të sqarojë, të ilustrojë një teori.	Njoftime, zërat e enciklopedive, përmbledhje etj.
<i>Argumentues</i>	Mbështetin opinione, teza, vlerësohen fakte, gjëra, persona.	Të bindë lexuesin për vlefshmërinë e tezës dhe të gjykimit të vet.	Ese, artikuj politikë dhe propagandistikë etj.
<i>Udhëzues</i>	Jep udhëzime, këshilla, urdhra.	Të udhëzojë, këshillojë, detyrojë, urdhërojë lexuesin që të ndjekë një qëndrim ose të kryejë veprime sipas një radhe të caktuar.	Ligje, vendime, udhëzime, urdhra, receta, udhëzues përdorimi etj.

Tekstet me funksion estetik – tekstet letrare

Teksti	Ç'bën?	Synimi	Lloji i tekstit
<i>Tregimtar</i> <i>Rrëfyes ose narrativ</i>	Rrëfen për ngjarje ose personazhe reale ose të trilluara, ndërtohet sipas një strukture artistike.	Të pasqyrojë jetën nëpërmjet figurave artistike dhe të shkaktojë përjetime dhe emocione të caktuara te lexuesi.	Miti, legjenda, romani, novela, tregimi etj.
<i>Poetik</i>	Rrëfen për ngjarje ose personazhe nëpërmjet vargjeve dhe organizimeve të ndryshme tingullore. Shpreh ndjenja e emocione nëpërmjet gjuhës së figurshme.	Të ndikojë thellë në mendjen, në zemrën e në ndjenjat e lexuesit, duke shfrytëzuar mjetet shprehëse të gjuhës.	Poema epike, eposi, ciklet e këngëve, poezia etj.
<i>Dramatik</i>	Rrëfen nëpërmjet personazheve vepruese dhe lojës së aktorëve në skenë,	Të pasqyrojë jetën nëpërmjet gjuhës skenike (dialogëve dhe monologëve) dhe të shkaktojë përjetime dhe emocione të caktuara te shikuesi.	Tragjedia, komedia, drama, farsa etj.

Vlerësimi i nxënësve: Sipas gjykimit të mësuesit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësit punojnë të ndarë në grupe ushtrimin 1, 2. U kërkohet nxënësve të përcaktojnë llojin dhe funksionin e tekstit.

Zgjidhje ushtrimesh

Ushtrimi 1: a) përshkrues, b) udhëzues, c) paraqitës, d) argumentues.

Ushtrimi 2: a) të informojë,

- të ndikojë te lexuesi,
- të argumentojë për një qëndrim të caktuar,
- të shprehë emocione,
- të ndikojë emocionalisht për dukurinë,
- të shpjegojë,
- të udhëzojë.
-

Kontrollohet puna e nxënësve. Diskutohen përgjigjet e ushtrimeve, jepen argumente mbi to duke iu referuar fragmenteve.

Detyrë

Gjeni një tekst letrar dhe joletrar përcaktoni qëllimin, funksionin, synimin e autorit. Jepni argumente. Sillni në klasë tekste të ndryshme përshkruese.

Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i nxënësve pjesëmarrës dhe vlerësohet ora e mësimit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalja, teksti, ligjërimi		Rezultati i të nxënit të temës Identifikon diskutet e ndryshme (letrare, joletrare, sociale, kulturore, politike, administrative etj.).	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 7; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalja dhe gjykimi			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon se çështë fjalja dhe gjykimi; • Specifikon dy anët e fjalisë; • Dallon fjalinë nga gjykimi; • Sqaron si shprehet gjykimi. 		<ul style="list-style-type: none"> • fjalja • ana kuptimore • ana formale • gjykimi 	
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton rreth fjalisë dhe gjykimit; • Rendit anën kuptimore dhe atë formale; • Formon një tabelë dhe paraqet disa nga dallimet mes fjalisë dhe gjykimit; • Tregon mënyrën e shprehjes së gjykimit. 			
Burimet: teksti mësimor Gjuha shqipe 11, tekste të llojeve të ndryshme letrare/tekste joletrare, interneti.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): /			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			

Hyrja:

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

1. Çfarë mendoni se është fjalja e çfarë gjykimi?

Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e mësimit “Fjalja dhe gjykimi”. Në dërrasë të zezë formon një tabelë dhe aty fton nxënësit me radhë t’i paraqesin dallimet mes fjalisë dhe gjykimit. Kur nxënësit t’i japin mendimet e tyre për dallimin mes fjalisë dhe gjykimit, atëherë mësuesi/ja udhëzon që nxënësit ta hapin librin dhe ta lexojnë në heshtje tekstin “Fjalja dhe gjykimi”. Kërkon nga nxënësit t’i mësojnë me theks të veçantë dallimet mes tyre dhe përkufizimin fjali-gjykim.

Fjalìa	Gjykimi
Është formë e gjuhës.	Është formë e të menduarit.
Sintaksa dallon fjalitë nxitëse, pyetëse etj.	Logjika nuk gjen formë gjykimi te fjalitë që shprehin ndjenjë, vullnet, ose te pyetja.
Fjalìa, si njësi e gjuhës, mund të ketë si gjymtyrë kryesore (kryefjalë dhe kallëzues) dhe gjymtyrë të dyta (përcaktor, rrethator, kundrinor etj.) Fjalìa mund të jetë: - dykryegjymtyrëshe: <i>Ditët kaluan.</i> <i>Nxënësit po shkruajnë.</i> - njëkryegjymtyrëshe: <i>Nuk erdhi në kohë.</i> e pagjymtyrëzueshme (e pazbërthyeshme në gjymtyrë, as në kryefjalë, as në kallëzues): <i>Natë. Qiell i errët.</i>	Gjykimi ka vetëm: Subjektin (logj. Ajo pjesë e gjykimit e cila pasqyron atë për të cilën bëhet fjalë dhe për të cilën pohohet ose mohohet diçka.) Predikatin (logj. Pjesë e gjykimit, e cila bën fjalë për subjektin dhe pasqyron atë që pohohet ose mohohet për të.)

Reflektimi:

Punohet ushtrimi 1. Nxënësit përcaktojnë nëse informacioni është i vërtetë apo i pavërtetë. Rrethojnë përgjigjen e saktë. Lexohen përgjigjet e nxënësve.

Ushtrime

1. Përcaktoni nëse informacioni i mëposhtëm është i vërtetë (V) apo i pavërtetë (G). Rrethoni përgjigjen e saktë.

- Fjalìa është formë e gjuhës. (V, G)
- Gjykimi është formë e të menduarit. (V, G)
- Logjika nuk gjen formë gjykimi te fjalitë që shprehin ndjenjë, vullnet, ose te pyetja. (V, G)
- Predikati është pjesë e gjykimit e cila pasqyron atë për të cilën bëhet fjalë dhe për të cilën pohohet ose mohohet diçka. (V, G)
- Fjalìa, si njësi e gjuhës, mund të ketë vetëm gjymtyrë kryesore. (V, G)
- “U largua në heshtje.” është një fjali dykryegjymtyrëshe. (V, G)
- “Qetësi.” është një e pagjymtyrëzueshme. (V, G)
- Kategoria gramatikore e kallëzuesisë është uniteti i pandashëm i kategorisë së modalitetit sintaksor, të kohës sintaksore dhe të vetës sintaksore. (V, G)
- Mënyra dëftore e tregon procesin si diçka të mundshme. (V, G)
- Qëndrimi i folësit mund të shprehet dhe me fjalë modale. (V, G)
- “Mbase” është një fjalë modale që tregon sigurinë e folësit. (V, G)
- “Sigurisht” është një fjalë modale që tregon dyshimin e folësit. (V, G)
- Në fjalinë: “A shkojmë sonte në kinema?” folja është përdorur me kuptimin sintaksor të së tashmes. (V, G)
- Me anë të intonacionit mund të shprehim modalitete të ndryshme. (V, G)
- Fjalìa është mjeti kryesor për formimin, shprehjen e kumtimin e mendimit. (V, G)

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/es, me gojë ose me shkrim.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni në internet të dhëna për fjalinë dhe gjykimin. Mbani shënime.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalìa, teksti, ligjërimi		Rezultati i të nxënìt të temës: Identifikon diskurset e ndryshme (letrare, joletrare, sociale, kulturore, politike, administrative etj.).	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ligjërimit në gjuhën shqipe (i thjeshtë, bisedor, libror)			
Rezultatet e të nxënìt për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Përkufizon ligjërimit si lloj i gjuhës së gjallë; Përcakton llojet e ligjërimeve në gjuhën shqipe; Liston veçoritë e secilit ligjërimit; Krahason ligjërimit mes tyre; Analizon ligjërimit e teksteve të ndryshme. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> ligjërimit të folur gjuhë e gjallë ligjërimit libror ligjërimit bisedor ligjërimit i shkujdesur 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> Flet rreth ligjërimit si lloj i gjuhës së gjallë; Lexon disa fragmente dhe tregon për llojet e ligjërimeve në ato fragmente; Bën një listë të secilit ligjërimit; Bën krahasimin e ligjërimeve; Bën analizën e teksteve sipas ligjërimit. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve. https://www.youtube.com/watch?v=_IAKJWWR6pk https://www.youtube.com/watch?v=zqXZwtiuH3g			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<p>Hyrja:</p> <p>Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të ndërtojnë skemën e komunikimit dhe të specifikojnë gjuhën lidhur me marrësin e kontekstin, pra si ndryshon kodi i përdorur në varësi të marrësit e kontekstit të dhënies së mesazhit.</p>			
<pre> graph LR DHENESI --> KANALI1[KANALI] KANALI1 --> MESAZHI MESAZHI --> KANALI2[KANALI] KANALI2 --> MARRESI KODIMI1[KODIMI] --- KANALI1 DEKODIMI1[DEKODIMI] --- KANALI2 KONTEKSTI --- KODIMI1 KONTEKSTI --- DEKODIMI1 DEKODIMI2[DEKODIMI] --- MARRESI KODIMI2[KODIMI] --- MESAZHI KODI --- KODIMI2 </pre>			
<p>Realizimi i kuptimit:</p> <p>U jepet nxënësve për të analizuar tekstet e mëposhtme, duke pasur si bazë për analizë pyetjet e dhëna më poshtë.</p>			

Matematika përbën një fushë të njohurive abstrakte të ndërtuara me ndihmën e arsytimeve logjike mbi koncepte të tilla, si: numrat, figurat, strukturat dhe transformimet. Në Greqinë antike matematika përjetoi një zhvillim të paparë nga një plejadë e tërë matematikanësh, siç janë Pitagora, Talesi, Platoni, Eudoksi, Euklidi, Arkimedi etj. Grekët e vjetër matematikën e kuptonin në sensin e gjeometrisë dhe të parët ishin ata që të vërtetat matematikore, të cilat ato i quanin teorema, i vërtetonin. Njohuritë matematikore të grekëve të vjetër më vonë i përvetësuan dhe i pasuruan arabët, të cilët quhen edhe themelues të algjibrës. Përkthimet arabe të veprave të matematikanëve grekë në mesjetë depërtuan në Europë. Pastaj shtytjen dhe zhvillimin e matematikës e morën në dorë evropianët...

Lumenjtë

Natyra shqiptare është mjaft e pasur me burime ujore, lumenj dhe përrenj të shumtë. Numërohen rreth 200 burime me prurje uji mbi 200 litra në sekondë. Burime me vlera të kurative janë edhe ato të ujërave termale të quajtura llixha. Këto burime ndodhen në Leskovik (Vronomero), në Dibër, në Elbasan, në Fushë-Krujë (Bilaj), dhe në afërsi të Përmetit (Bënjë). Janë të shquar për bukurinë dhe veçantinë e tyre burimet e ujërave të Syrit të Kaltër në Delvinë, të Ujit të Ftohtë në Tepelenë, të Syrit të Sheganit pranë liqenit të Shkodrës, të Drilonit afër liqenit të Ohrit, të Viroit në Gjirokastër...

Plaku dhe këpucët

Një ditë kishte qenë një plak dhe kishte dëshirë me ble një palë këpucë. Ai vendosi një ditë me ble një palë këpucë dhe shkon me i ble. Kur hyn në shitore dhe i thotë shitësit a bën me i provu ato këpucë dhe shitësi ia jep këpucët me i provu. Plaku i provon këpucët dhe ato i vinin të vogla. Atëherë shitësi i thotë plakut merri këpucët se rriten, plaku i thotë shitësit leje pra atje, kur të rriten unë vij e i marr.

“Gjahu i malësorëve”

-Ç' muaj është tashi?

-Kallënduar.

-Sa ka muaji sot?

-Sot ka pesmbëdhjetë ditë.

-Thuaj se dolli edhe ky muaj.

-Është kohë e bukurë.

-Ka bërë mot të mirë.

-A dalëmë nesër për gjah?

-Dalëmë.

-Me të vërtetë?

-Po, besa.

-Mbë, ç'anë?

-Vemi ndë Malt të Tomorrowit.

-Po atje të vemë e të gjuajmë, sepse atje ka mjaft egërsira. Atje ka edhe bisha, atje ka derra t'egërë, e ujë e çakaj, e harusha, e ndrej, e kapruaj, e dhi t'egëra, e dhelpëra, e lepuj. Po atje ka dhe thllëna mali: ndë marrishin erë qëntë e të biemë në ndonjë tufë të madhe, kemi për të vrarë shumë nga ato. Nesër pra të dalëmë për gjah.

- Fort mirë.

Fragment nga 14 vjeç dhëndër

Tana

Dëgjo, burrë...

Vangjeli

Ç'ke, moj grua?

T. (Rënkon.)

Jam sëmurë.

V.

Që kur?! Ç'thua?

T.

Ç'them? Ja them që jam sëmurë,
koka më digjet si furrë,
s'e kesh pësuar kurrë.

V.

Po tani, vallë, ç'pësove?
Më duket se u ftove;
gjithë natën u zbulove
dhe s'më lë fare të flerë!

T.

Gjithë ditën ç'keshe bërë?

Ti për bar e për dru s'vete
dhe qahesh se nukë fle?
Tërë ditën ngas qetë
dhe drek' e darkë bëj vetë,
gjithë puna përmi mua!

V.

Përse të kam marrë grua?
Gratë për punë po janë.

T. (Qesëndis.)

Edhe burratë të hanë
dhe të rrinë nat' e ditë!

V. (Me inat.)

Mos më bën të të godit.
se zakonë s'e harrova,
sonde shumë të durova.
Nga hunda s'më heq dot kurrë,
se nuk' jam si çdo burrë!

Ngrehu të biem të flëmë
dhe këto fjalë t'i lëmë.

T.

Bjer e fli, mua s'më flihet.

V.

Adhamutnë.

T.

S'e shoh dot me sy çifutnë,
as për mace s'i vë besë!

V.

Mos kuvendo kështu, moj grua.

T. (Me inat.)

Nuk' e dua, nuk' e dua!
Pse s'shëron gruan e tij?
Se nga ajo ha e pi...
Ndaj e mori me një sy,
i daleinë që të dy.

Fragment nga "Pallati 176"

Vani - Kur bën dashuri dhe i biri i tetos, Sandër Mafishja, mos mbettë djalë në këmbë, mos mbettë!

Elsa - Do të shkoj t'ua them të gjitha çfarë keni thënë ju për ta: tëk e tëk e tëk.

Liria - Na, moj Elsa, ku shkon, kthehu mbrapa! Elsa! Elsaaa! (pauzë) Elsaaaaa!

...

Vani - Ç'sinema mo, ç'sinema! Po pazaret kush do t'i bëjë, unë dhe krushku?!

Drejtori - Mo, po çfarë t'u bëj atyre të dyve që duhen, pa unë me ty... krushqi unë me ty?! Puu, puu, puu!

Mësuesi/ja u jep nxënësve fisha me fragmentet e mësipërme dhe u kërkon të nxjerrin këto veçori:

- Sa rigoroz është përdorimi i standardit?
- Dalloni emrat në shumës dhe evidentoni si e kanë formuar atë.
- Llojet e fjalive (bashkërenditëse, nënrenditëse, të përziera, raporti mes tyre dhe fjalive të thjeshta).
- Dalloni GE dhe thoni si janë formuar.
- Raporti i GE me GF.
- Forma më e përdorur e foljeve (veprorë apo joveprorë).
- Llojet e fjalëve kompozitë.
- Llojet e shprehjeve lidhëzore e parafjalore më të përdorura.
- Prania e krahinorizmave.
- Prania e leksikut terminologjik dhe leksikut të përditshëm.
- Prania e huazimeve.
- Përdorimi i enumeracionit, pyetjeve retorike.
- Roli i intonacionit.
- Prania e shkurtesave në GE dhe emrat e njerëzve.
- Sa vend zënë përsëritjet e shkurtesave ose pjesëzave e pasthirmave.
- Mungesa ose tepria në përdorim e zanores ë.
- Prania e shprehjeve përshëndetëse dhe e thënieve frazeologjike.
- Prania e figurave letrare, si: hiperbolë, krahasim, metaforë.
- Sa të shmangura janë fjalët nga norma nëse ka të atilla.
- Prania e barbarizmave e arkaizmave.
- Pjesëza e pasthirrma në të folurin e përditshëm.

Nxënësit diskutojnë duke ecur paralel me konkluzionet e tekstit për veçoritë e ligjërimeve dhe nxjerrin vetë përmes këtyre fragmenteve karakteristikat e tyre.

Reflektimi:

Materialet e mësipërme nëse vendosen në video u kërkohet të mbajnë disa shënime dhe diskutojnë edhe për nga intonacioni e mimika që lidhen gjithashtu në gjuhën e folur dhe kategorizojnë ligjërimet.

Ushtrimi 1. Nxënësit argumentojnë përmes veçorive të secilit tekst përgjigjet mbi llojet e ligjërimeve.

- Teksti A, ligjërim i shkujdesur
- Teksti B, ligjërim libror
- Teksti C, ligjërim bisedor.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim me notë sipas gjykimit të mësuesit/es për nxënësit.

Detyrat dhe puna e pavarur: /

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalori abstrakt dhe afektiv		Rezultati i të nxënit të temës: Pasuron fjalorin abstrakt dhe afektiv.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Formimi i fjalëve me anë të prejardhjes			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Zgjeron njohuritë për fjalorin abstrakt dhe atë afektiv; Formon emra abstraktë dhe emra afektivë; Shkruan drejt emrat. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> emrat abstraktë emrat afektivë prejardhja 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> Rikujton njohuritë për fjalorin abstrakt dhe për fjalorin afektiv; Përdor emrat abstraktë dhe afektivë; Respekton drejtshkrimin e emrave. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve, fjalorë, tekste të shkëputura nga literatura të ndryshme.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): artet, letërsia.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<p>Hyrja: Pas kontrollimit të detyrave të shtëpisë, nxënësit rikujtojnë njohuritë e tyre për fjalorin abstrakt dhe atë afektiv.</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin: 10px 0;"> <p>Kujtojmë!</p> <p>Fjalori abstrakt Në fjalorin abstrakt bëjnë pjesë <i>emrat abstraktë</i>, pra emrat që tregojnë veprime, gjendje, cilësi dhe veçori të abstraktuara ose nocione abstrakte: <i>lëvizje, mendim, gjykim, bukuri</i> etj. Kur përdoren në kuptimin e tyre themelor, si p.sh.: <i>mendjemadhësi, fatmirësi, krenari</i> etj., këta emra nuk kanë forma të numrit shumës dhe nuk përcaktohen nga numërorë themelorë, Kur emërtojnë shfaqje konkrete të veprimeve, gjendjeve, proceseve, cilësive dhe veçorive, mund të përdoren pjesërisht dhe në shumës, si dhe të përcaktohen dhe nga numërorë: <i>bukuritë (e natyrës), dy ndalime</i> etj. Me përjashtim të disave emrave, si: <i>frikë, gaz, hare, jetë, kohë, punë</i> etj., që janë fjalë të thjeshta, shumica e emrave abstraktë formohen me anë të prejardhjes.</p> <p>Fjalori afektiv Në fjalorin afektiv bëjnë pjesë <i>emrat</i> me ngjyrimë përkëdhëlie a zvogëlimi njëkohësisht, ose vetëm zvogëlimi (<i>shtëpizë, babush</i>), si dhe me kuptime përbuzëse a keqësuese (<i>frikacak, trashalug</i>).</p> </div>			

Realizimi i kuptimit:

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësit lexojnë tekstin e mëposhtëm dhe dallojnë. Ata i nënvizojnë emrat e formuar me anë të parashtesave dhe të prapashtesave. Tregojnë se cilët nga këta janë emra abstraktë dhe i vendosin në tabelën në fund të tekstit.

Që nga viti 1999, kur UNESCO-ja shpalli 21 shkurtin si Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, çdo vit, kudo në botë organizohen manifestime kombëtare e ndërkombëtare për ruajtjen dhe promovimin e gjuhëve amtare.

Mbrojtja e gjuhëve në botë, lufta kundër zhdukjes së tyre dhe ruajtja e identitetit të kombeve me anë të gjuhës, janë qëllimet e manifestimeve që organizohen në nivel botëror çdo 21 shkurt. Këto aktivitete të përbotshme synojnë që të rinjtë të thellojnë njohuritë e tyre mbi tiparet dhe prejardhjen e gjuhëve, si dhe të nxitet diskutimi ndërveprues mbi rëndësinë e ruajtjes së gjuhës amtare e trashëgiminë e saj ndër breza si pasuria më e madhe kulturore e gjithsecilit.

Gjuha është pjesë e pandashme e identitetit të një populli. Me anë të gjuhës shprehet shpirti dhe kultura e një populli. Gjuha përfaqëson një reflektim të vërtetë për diversitetin kulturor të njerëzimit. Duhet shumë përkrahje dhe përkujdesje në veçanti nga qeveritë e vendeve me popullsi të vogla, në mënyrë që këto gjuhë të përdoren bashkë me gjuhët e tjera, pasi në tre shekujt e fundit ka një zvogëlim drastik të numrit të gjuhëve sidomos në kontinentin e Amerikës së Veriut dhe të Jugut, si dhe në Australi.

Nga media

Me parashtesim	Me prapashtesim	Me parashtesim dhe prapashtesim
zhdukje	diskutim	përkrahje

Kur ta mbarojnë detyrën, nxënësit lexojnë në heshtje tekstin për formimin e emrave abstraktë dhe të atyre afektivë.

Reflektimi:

Punohen ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/es, me shkrim ose me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Gjeni në medien online raste të përdorimit të të dyja varianteve të fjalëve dhe përcaktoni variantet që përdoren më shumë. Gjeni fjalë të reja të fjalorit abstrakt dhe afektiv, të formuara me prejardhje në një vepër të një shkrimtari shqiptar nga të gjitha trojet shqipfolëse.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalori abstrakt dhe afektiv		Rezultati i të nxënit të temës: Pasuron fjalorin abstrakt dhe afektiv.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.		I. Të dëgjuarit dhe	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Formimi i fjalëve me anë të kompozimit dhe përngjitjes			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Jep përkufizimin për kompozimin dhe përngjitjen; Diskuton për llojin e veçantë të kompozitave – shkurtesat; Shkruan drejt emrat.		Fjalët kyç: • kompozimi (përbërja) • shkurtesat • përngjitja	
Kriteret e suksesit: • Tregon se çfarë është kompozimi dhe çfarë përngjitja; • Klasifikon llojin e kompozitave; • Respekton drejtshkrimin e emrave.			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve, fjalorë, tekste të shkëputura nga literatura të ndryshme.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): artet, letërsia.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Hyrja: Nxënësit japin përkufizimin për kompozimin (përbërjen) e përngjitjen dhe menjëherë punojnë me tekstin e mëposhtëm, duke nënvizuar emrat e formuar me anë të kompozimit, përngjitjes dhe prejardhjes.			

në jetën shpirtërore të shqiptarëve, në rritjen dhe në konsolidimin e vetëdijes kombëtare të tyre. Epopeja shqiptare e shek. XV frymëzoi intelektualë të shquar shqiptarë që ta përjetësonin atë në vepra historike monumentale e nga më të shquarat e kohës me të cilat nisi jetën e vet historiografia shqiptare. Themeluesi i saj u bë Marin Barleci (Barleti), historian humanist i shquar i përmasave ndërkombëtare.

Me rënien e Shkodrës në duart e osmanëve, si shumë bashkëqytetarë, M. Barleci u largua nga vendlindja e tij, mori rrugët e mërgimit dhe u vendos në Itali. Këtu ai plotësoi shkollimin e vet, u bë njohës i thellë i letërsisë antike e i gjuhës latine dhe u shfaq si një intelektual humanist nga më të shquarit evropianë të kohës.

Vepra e parë e Marin Barleci është “Rrethimi i Shkodrës”, e botuar latinisht në Venedik në vitin 1505. I mbështetur në shënimet e në kujtimet e veta si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në ngjarjet që rrëfen, libri i kushtohet jetës politike e ushtarake gjatë rrethimit të dytë të Shkodrës më 1478. Ngjarjet dramatike të Shkodrës gjatë viteve 70 kishin nxitur edhe pena të tjera të shquara që t’i pasqyronin ato. Humanisti i njohur Gjergj Merula botoi më 1474 një rrëfim prej 24 faqesh mbi zhvillimet politike dhe ushtarake në Shkodër gjatë rrethimit të parë. Kjo ngjarje si dhe rrethimi i dytë i Shkodrës, vendosja e shkodranëve në Venedik, episode nga jeta politike e këtij qyteti gjatë shekujve të mesjetës dhe lidhjet e shkodranëve me Venedikun kanë zënë vend në panegjericun e humanistit shkodran Marin Beçikemi, të botuar më 1503 (ose më 1504) dhe që i drejtohej dukës Loredan Loredanit dhe Senatit të Republikës së Shën Markut. Edhe pse bashkëkohësi dhe bashkëqytetari i të njëjtit fat me M. Barlecin, M. Beçikemi, po ashtu si Gj. Merula, ishin humanistë me emër për kohën; veprat e tyre për ngjarjet e Shkodrës gjatë viteve 70 të shek. XV mbetën të harruara. Jetëshkrimi më i hershëm për Skënderbeun është shkruar gjatë viteve 1481-1482 prej peshkopit të Ulqinit, Martin Segonit nga Novobërda.

Nga interneti

me kompozim (përbërje)	me prejardhje

Realizimi i kuptimit:

Lexohet dhe mësohet teksti për kompozimin, shkurtesat dhe përngjitjen.

Kompozimi është mënyra e formimit të fjalëve të reja nga bashkimi i dy ose i më shumë temave, p.sh: ditëlindje, pikëpamje, vetëdije etj. Në bazë të marrëdhënieve që kanë temat mes tyre, fjalët e përbëra (kompozitat) ndahen në dy grupe: a) këpujore dhe b) përcaktore. Kompozitat përcaktore emra janë disallojëshe.

Një lloj i veçantë kompozitash janë shkurtesat. Ato janë vetëm emra.

Përngjitja është mënyra e formimit të fjalëve të reja me anë të bashkimit të dy a më shumë fjalëve të veçanta, për shkak të përdorimit të gjatë të tyre pranë njëra-tjetrës: ecejak (ec e jakë), farefis (farë e fis), thashetheme (thashë e them) etj.

Reflektimi:

Punohen ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjyqimit të mësuesit/es.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni: Gjeni emra abstraktë të formuar me përbërje në tekste, që gjenden në faqet zyrtare online të institucioneve të Kosovës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalori abstrakt dhe afektiv		Rezultati i të nxënit të temës: Pasuron fjalorin abstrakt dhe afektiv.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Formimi i fjalëve me anë të nyjzimit dhe konversionit			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon nyjzimin dhe konversionin; • Dallon nyjzimin nga konversioni; • Sqaron mënyrat e përziera. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • nyjzimi • konversioni • mënyrat e përziera 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Sqaron se çfarë është nyjzimi dhe çfarë konversioni; • Veçon nyjzimin nga konversioni; • Flet për mënyrat e përziera. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve, fjalorë, tekste të shkëputura nga literatura të ndryshme.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): artet, letërsia.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<p>Hyrja: Nxënësit japin fillimisht përkufizimin për nyjzimin dhe konversionin, më pas ata fillojnë t’i nënvizojnë fjalët e formuara me nyjzim, konversion dhe mënyra të tjera të përziera në tekstin e mëposhtëm:</p> <p>Unë, Aleksandri, bir i Filipit, mbretit të maqedonasve, mishërim i monarkisë, krijues i Perandorisë Greke, biri i Zeusit, bashkëbisedues i Brahmanëve dhe i Pemëve, i diellit dhe hënës, triumfues mbi mbretëritë e Persëve e të Medëve, Zoti i Botës prej ku lind dhe ku perëndon dielli, nga Veriu në Jug, pinjoll i farës së shquar të popujve ilirikë të Dalmacisë dhe Liburnisë dhe të popujve të tjerë të së njëjtës gjuhë që popullojnë Danubin dhe zonën qendrore të Trakisë, u sjell dashurinë, paqen dhe përshëndetjet e mia dhe të të gjithë atyre që ndjekin sundimin e botës.</p> <p>Duke qenë se ju gjithmonë më jeni treguar të besës, të fortë e të pathyeshëm në betejat e bëra krah meje, ju jap dhe ku dorëzohet juve në zotërim të lirë gjithë hapësirën e Akuilonit e deri në skaj të Italisë së Jugut. Askush tjetër, veç jush, të mos guxojë të vendoset dhe të qëndrojë në ato vende dhe po u gjet ndonjë i huaj, ai do të mund të qëndrojë vetëm si skllavi juaj, dhe pasardhësit e tij do të jenë skllavë të pasardhësve tuaj.</p> <p>U shkrua në kështjellën e qytetit të Aleksandrisë, e themeluar prej meje buzë lumit madhështor të Nilit në vitin XII. Me vullnet të perëndive që nderohen në mbretëritë e mia, Zeusit, Marsit, Plutonit dhe Minervës, perëndisë së perëndive. Dëshmitar të këtij akti janë Atleti, dhe 11 princa të tjerë, të cilët unë po i emëroj si trashëgimtarë të mi dhe të të gjithë botës, meqenëse po vdes pa lënë pasardhës.</p> <p>Aleksandri i Madh i Maqedonisë, në vitin 325 p. e. s.</p>			

Realizimi i kuptimit:

Pasi të kenë punuar me tekstin, nxënësit e lexojnë dhe e mësojnë tekstin për nyjëzimin, konversionin dhe mënyrat e përziera. Disa nga nxënësit e shpjegojnë mësimin, pastaj punojnë ushtrimin 1. Dallojnë fjalët e formuara me konversion dhe nyjëzim.

Reflektimi:

Punohet ushtrimi 2.

Nxënësit dallojnë mënyrën e formimit të fjalëve dhe diskutojnë për to: përshpirtje, pjesëmarrje, pikëpamje etj.

Vlerësimi i nxënësve:


Sipas gjykimit të mësuesit/es, me shkrim ose me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni: Gjeni emra të formuar me nyjëzim dhe konversion në tekste të llojeve të ndryshme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalori abstrakt dhe afektiv		Rezultati i të nxënit të temës: Pasuron fjalorin abstrakt dhe afektiv.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Zgjeron njohuritë në drejtim të drejtshkrimit; Përdor si duhet rregullat e drejtshkrimit të fjalëve ndaras; Përdor si duhet rregullat e drejtshkrimit të fjalëve pa vizë në mes. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> drejtshkrim fjalët njësh fjalët ndaras 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> Rikujton njohuritë në drejtim të drejtshkrimit; Respekton gjatë të shkruarit rregullat e drejtshkrimit të fjalëve ndaras; Respekton gjatë të shkruarit rregullat e drejtshkrimit të fjalëve pa vizë në mes. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve, fjalorë, tekste të shkëputura nga literatura të ndryshme.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlydhura (korrelacioni): artet, letërsia.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<p>Hyrja: Diskutim Kontrollohen dhe diskutohen detyrat e shtëpisë. Mësuesi/ja organizon mësimin me pyetje nga mësimi i kaluar, për të nxitur diskutimin në klasë.</p> <p>Realizimi i kuptimit: Paraqet në tabelë ose të shkruara në tabakë të mëdhenj me shkrim të dukshëm e me ngjyra, tekste të formave dhe natyrave të ndryshme. Shtron çështjen:</p> <ul style="list-style-type: none"> Cilat janë rregullat drejtshkrimore për përdorimin e fjalëve ndaras dhe pa vizë në mes? <p>Përgjigjet e nxënësve mund të jenë përkufizime rregullash, fjalë, fjali ose shembuj modelesh.</p> <p>Mësuesi/ja vendos tematikën në tabelë dhe pyet:</p> <ul style="list-style-type: none"> Cilat fjalë shkruhen njësh, si një fjalë e vetme? <p>Mësuesi/ja organizon idetë e nxënësve nëpërmjet stuhisë së mendimeve.</p>			



Reflektimi:

Mësuesi/ja u tërheq vëmendjen nxënësve, duke i vënë përpara një tekst të shkëputur, në të cilin duhet të vënë re përdorimin e fjalëve njësh dhe ndaras.

“Nata ishte e lagësht dhe me mjegull. Nga shtëpia ku ndodhej klubi, në fund të një rruge të periferisë, në atë largësi të errët midis dy radhësh të pandriçuara çinarësh, vinte një ndriçim, një lëvizje zhurmëmadhe dritash e makinash. Ishin të ftuarit që arrinin. Në korridor kalonin fol e qesh gratë me fustanet e tyre të lehta dhe burrat me frak. Salloni ishte i gjerë dhe i lartë sa vetë shtëpia. Vendi i kërcimit me parmakë prej druri të lyer me ngjyrë qielli, ndodhej në lartësinë e katit të dytë. Vallëzimi kishte mbaruar dhe, meqenëse njerëzit po kalonin ngadalë në dhomën e bufesë, ai i ftoi në katin e dytë ku i priste një shishe shampanjë”.

Punohen në mënyrë të pavarur ushtrimet. Nxënësit mund t’i diskutojnë me njëri-tjetrin idetë e tyre.

Shembuj përgjigjesh

Ushtrimi 1

Më duket se kjo ka ndodhur kur ishim të vegjël..., njëherë e një kohë. 2. Takimin e shoqatës sonë e kemi lënë një herë në javë. 3. Përse duhet të shkojmë kaq herët? 4. A ka mundësi të na sqaroni për se është fjala? 5. Ka qëkur (qyshkur) që të kam thënë t’i marrësh ata libra në bibliotekë. 6. Gjithçka ndryshoi që kur mori vesh se do të konkurronin së bashku. 7. Nëse do të udhëtojmë me Erlën, atëherë t’i presë biletat njëra nga ne. 8. Që të pëlqen të kundërshtosh e shoh, por nuk e kuptoj në se i mbështet këto ide. 9. Tha se nuk do të ishte në takimin e sotëm ngase s’kishte marrë njoftim. 10. Kishte kureshtje të madhe nga se bëheshin ato veshje që dukeshin si lëkure. 11. Më mirë të lodhesh duke punuar, sesa të mbërrish në fund të ditës pa bërë asgjë. 12. Nuk jam i sigurt se sa kohë mund të kërkojë përkthimi i këtij materiali. 13. Seç ndjeva një kënaqësi të papritur, teksa e shikoja të përpiqej aq shumë. 14. Nuk e kuptoj se ç’kërkesa të tjera mund të kenë akoma.

(Dallimi i fjalëve ose ndajfoljeve që shkruhen njësh, nga përdorimet e pjesëve përbërëse të tyre si fjalë të veçanta.)

Ushtrimi 2

fotoekspozitë foto ekspozitë
zëvendës ministër zëvendësministër
gjithsekush gjithë se kush
drejt për së drejti drejtpërsëdrejti
përveçse përveç se
vaj peshku vajpeshku
Mirësevini! Mirë se vini!
fjalë për fjalë fjalëpërfjalë
nëqoftëse në qoftë se
pesëpërqind pesë për qind

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/es.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Punohet ushtrimi 3.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Shqipja standarde dhe dialektet; zbatimi i normës në të folur dhe të shkruar		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon gjuhën standarde nga dialektet dhe zbaton normën gjuhësore në të folur e të shkruar.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjuha standarde shqipe dhe dialektet			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Dallon në hartë zonën ku shtrihen dialektet dhe nëndialektet e shqipes; Krahason veçoritë e dialekteve dhe nëndialekteve të shqipes; Identifikon shtrirjen dhe përdorimin e standardit të shqipes brenda dhe jashtë Shqipërisë; Shkruan fjalë e tekste dialektore në shqipen standarde.		Fjalët kyç: dialekt/ nëndialekt shqipe standarde veçori të dialekteve	
Kriteret e suksesit: Përdor hartën duke përmendur dialektet dhe nëndialektet e shqipes; Bën krahasimin e veçorive të dialekteve dhe të nëndialekteve të shqipes; Tregon rreth shtrirjes dhe përdorimit të standardit të shqipes; Kthen fjalë e tekste dialektore në shqipen standarde.			
Burimet: teksti mësimor Gjuha shqipe 11, burime të tjera nga jeta e përditshme dhe interneti, si tabela të ndryshme, foto, materiale për dialektet e gjuhës shqipe.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): artet, letërsia.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			

Hyrja:

Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e mësimit Dialektet e shqipes dhe drejton pyetjen:

- Ç'janë dialektet?

Me anë të një stuhie mendimesh, nxënësit shfaqin idetë dhe njohuritë e tyre rreth dialekteve.




Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja e drejton vëmendjen e nxënësve te harta e Shqipërisë dhe përcakton së bashku me ta zonat e shtrirjes së dialekteve. Pasi të kenë lexuar këtë pjesë të tekstit, nxënësit kufizojnë në hartën e tekstit zonat ku shtrihen dy dialektet.

Dialekti gegë: në të gjithë territorin e Shqipërisë që ndodhet në veri të lumit Shkumbin. Përdoret: nga shqiptarët e Maqedonisë në zonat mes Strugës dhe Dibrës..., nga shqiptarët në Kosovë...

Dialekti toskë: në të gjithë territorin e Shqipërisë që ndodhet në jug të lumit Shkumbin. Përdoret nga shqiptarët në Greqi, Çamëri, Ohër...

Mësuesi/ja tërheq vëmendjen e nxënësve te dy hartat e tekstit. Nxënësit duke ndjekur ngjyrat dallojnë shtrirjen e të folmeve të gegërishtes e të toskërishtes. Ndërkohë në tabelë punohet organizuesi grafik pema e mendimit.



Në grafik vendosen edhe karakteristikat dalluese për të folmet.

Mësuesi/ja ndan klasën në dy grupe të mëdha dhe u jep dy fragmentet e shkëputura nga “Vëna shtatë vjeçe” e E. Koliqit dhe “Të mukëtit” e Lumo Skëndos. Nxënësit punojnë në heshtje rreth 5 minuta për të identifikuar dialektet dhe karakteristikat e tyre përkatëse. Diskutohet rreth tyre mbështetur edhe në përvojat individuale të nxënësve. Zbulojnë veçoritë, fjalët dialektore dhe plotësojnë organizuesin grafik.

Fjalor:

nonse - ndonëse
 mandi - man-i
 zditë - me
 ndriçu
 tue - duke
 t'epër - më të
 larta
 ndry - mbyll
 mbrëndë -
 brenda

Dialekti gegë	Dialekti toskë
vëna, denduna	perëndimnë, shtohetë, vdesën gjithënjë
dritoret	zëmrë shuhetë, dritësë, bëhetë, të pikëlluarë, duanë
çardakut	t'errëtit
kah, nonse	tfaqetë
urtija, ndije	flak', syt', cip', hyn'
gjashtëdhetëvjet	malevet
asnji, qi, nji	mejtohem, mi, lint
zbët, zditë	bje
tue shikue, fluturue, së kulluet, tue mos kujtue	qetim
ma t'epër	ahere
hënë, ambëlsisht, bante, mà	çkëlqejnë, të çkëlqyerë
hyj	dhen, dhet
me dalë, mos me ndry, me ikë	yj, yjvet
mbrëndë, mandi	gas,
	brënda

Dialekti toskë	Dialekti gegë
Mungojnë zanoret hundore: gjë, zë, lëmë, është	zanoret hundore: gjâ, zâ, lâm, âsht
â hundore është shndërruar në ë dhe n - r: bëra, vura, prura, huri	zanorja hundore â: Bâna, vunâ, prunâ, hûni.
Va: vaj, vatër, vajta	grupi nistor vo: Voj, votër, vojta,
E formon paskajoren: për të punuar	paskajorja me punue
grupet mb, nd, ng, ngj: mbush, mbaj, mbes, thumb, hunda, ngjyej, ngarkoj, ndryshoj, ngjala, ngjesh	Asimilimi i grupeve mb, nd, ng, ngj: Mush, maj, mes, thum, huna, njeje, narkoj, nryshoj, njala, njesh

Rrjeti i diskutimit

Rrjeti i diskutimit është një teknikë që ndërtohet mbi bazën e një pyetjeje të hapur që pranon si përgjigje pozitive, ashtu edhe negative. Kjo pyetje prek drejtpërdrejt thelbin e çështjes.

Lexohen disa prej detyrave të nxënësve dhe kalohet në rrjetin e diskutimit. Shtrohet pyetja:

PO

JO

A ka ndryshime themelore ndërmjet dialekteve të shqipes?

Nxënësit sjellin argumente pro dhe kundër dhe në fund arrihet në përfundime që lidhen me ndryshimet në:

- leksik
- morfologji
- sintaksë
- fonetikë

Punohen ushtrimet 1, 2, 3. Diskutohet rreth tyre.

Zgjidhje ushtrimesh

Ushtrimi 1

<i>Gjuha standarde</i>	<i>Dialekti juaj</i>	<i>Dialekti tjetër</i>
qumësht	t'amël	qumësht
gjalpë	t'lyn	gjalpë
këndes	gjel	kokosh
vrapoj	turru	vrapoj
i ëmbël	i àmbël	i ëmbël
vajzë	gocë/çikë	çupë/vajzë
djalë	çun	djalë

Ushtrimi 2


<i>Gjuha standarde</i>	<i>Dialekti juaj</i>
vëllanë e nënës	dajë, ungj
motrën e nënës	teze, motër, mëmë
vëllanë e babait	axhë, ungj, xhaxha, mixhë
motrën e babait	hallë, motërtatë
babanë e babait	babë, gjysh, babagjysh
nënë e babait	Nëne, nânë, ije, mome, anë
babanë e nënës	babë, gjysh
nënë e nënës	Nëne, nânë, ije, mome, anë

Ushtrimi 3

Mirëmëngjes!	Nadja mirë
Mirëdita!	
Mirëbrëma!	Mramja mirë
Ditën e mirë!	
Natën e mirë!	
Mirupafshim!	

Reflektimi:

Mësuesi/ja duke u mbështetur në njohuritë që kanë nxënësit plotëson skemën me karakteristikat kryesore të gjuhës standarde.



Liston katër drejtimet kryesore të standardizimit:

1. Rigjallërimi i fjalëve dhe strukturave dialektore.
2. Krijimi i fjalëve të përbëra.
3. Krijimi i fjalëve me shmangie klase.
4. Shqipërimi i fjalëve të huaja.

Nxënësit ilustronjë me shembuj.

Nxënësit punojnë ushtrimin 4. Gjeni se në cilin dialekt janë shkruar tekstet. Ktheni në gjuhën standarde disa fjalë dhe shpjegoni çfarë dukuri gjuhësore ndodhin në dialektin përkatës.

Shembuj përgjigjesh:

Fragmenti i parë është shkruar në gegërisht. Fjalë dialektore të kthyera në gjuhën standarde: mret-mbret, një-një, kte-këtë, myll-mbyll, mrena-brenda, ly-lyer, boj-bojë, shifte-shihte, gja - gjë, kishte pas ushqy - kishte pasur ushqyer, tul-tule, kishte pas vu-kishte pasur vënë, dadë - dado, bajte - bënte, masanaj - mbandaj, goca - vajza, ktij - këtij, mërzitë - mërzitur, ene - edhe, dadës vet - dados së saj, kte të ngranme - këtë të ngrënë, bāj - bëj, të bij-të bie (të sjell), koc-kockë.

Fragmenti i dytë është shkruar në dialektin toskërisht. Fjalë dialektore të kthyera në gjuhën standarde: çupa - vajza, urdhëri - urdhri, mirpo - mirëpo, shumë' i mërzitur - shumë i mërzitur, të vinte - të shkonte,

i jati - i ati, mos u marzi - mos u mërzit, ushtar vete unë - ushtar shkoj unë, bij e babajt - bijë e babait.

Vlerësimi i nxënësve:

Në fund të orës së mësimin bëhet vlerësimi i nxënësve pjesëmarrës dhe vlerësimi i orës.

Diskutim i lirë. Pas prezantimit, nxënësit duke identifikuar faktet e nxjerra nga teksti, si dhe nga hulumtimet e nxënësve, vlerësojnë rëndësinë e këtyre dëshmimeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

a) Gjeni nga letërsia artistike fragmente tekstesh të shkruara në dialektet e gjuhës shqipe. Identifikoni veçoritë e tyre. Kthejini në gjuhën standarde.

b) Sillni në klasë tekste të natyrave të ndryshme.

Shënim. Mësuesi/ja mund të shfrytëzojë si burim të teksteve që përmbajnë elemente dialektore edhe vepra të autorëve të tjerë, si Martin Camaj, Ali Asllani, Gjergj Fishta.

Vëna shtatë vjeçe, Ernest Koliqi (fragment i shkëputur nga përmbledhja me tregime Tregtar famujsh)

Dritoret e mëdhaja të çardakut ishin hapë kah oborri. Nonse asnji frymë ere s'levitte, degët e dënduna të mandit aty para dritoreve, qi drita e zbët e kandilave dilte me zditë paksa, epshin tue i shikue si nji ndije freskie. Sipër gjethve mà t'epër, nji qiell pa hânë, por përplot me hyj. Qielli i Shkodrës qi aq àmbëlsisht priret mbi qytet ndër net maji bante me fluturue mendimet e Lecit. Ishte natë me dalë, mos me ndry aty mbrëndë, me dalë e me thithë ajrin e natës së kulluet, me ikë nga ajo mërzi qi e ngërthente aty pranë plakut, i cili predikonte papushue, tue mos kujtue aspak se maji ishte shumë mà i fortë se urtija

grumbullue prej tij në gjashtëdhjetëvjet jete.

Të mukëtit, Lumo Skëndo

Brënda në të errët shikoj nga finestra perëndimnë. Drita humbet, ca nga ca t'errëtit shtohetë, botën e mbulon një mjegull e zezë: n'atë kohë që tfaqetë nga perëndimi një flak' e hollë majë malevet, pandeh njeriu se drita, dita po vdesën për gjithënjë.

T'errëtit si tym i zi më hyn' në shpirt dhe në zëmrë.

Mejtohem; pse lint dielli çdo mëngjes dhe pse shuhetë çdo natë! Them: pse pas dritësë na vjen kjo cip' e zezë!

Ca nga ca pushimi bëhetë më i thellë, çdo gjë bje më një qetim.


Ahere syt' e yjvet çelen dhe shikojnë dhen e nxirë, të pikëlluarë.

Them: pse shikojnë kështu këtë yj? a po duanë të hedhinë pak' gas mi dhet të nxirë, mi njerëzit. Këta sy ngjajnë me syt' e tu, o njeri. Po të tutë qeshin, qajnë, gëzohen, helmohen, çkëlqejnë, dhe shuhënë. Ata sipër atje në qiell, ata janë gjithënjë të çkëlqyerë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Format e ligjërimit, gjuha argumentuese dhe ajo bindëse		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon format e ligjërimit, veçan gjuhën (diskursin) argumentuese dhe atë bindëse.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teksti përshkrues bindës			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon tekstin përshkrues bindës; • Dallon elementet e një teksti përshkrues bindës; • Analizon strukturën e tekstit përshkrues bindës; • Evidenton elementet gjuhësore në tekstin përshkrues bindës; • Përdor teknikat e shkrimit të tekstit përshkrues bindës. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • tekst përshkrues • tekst përshkrues bindës • bind 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Veçon tekstin përshkrues bindës nga tekstet e tjera; • Specifikon elementet e tekstit përshkrues bindës; • Bën strukturën e këtij teksti; • Jep hapat nëpër të cilët duhet të kalojë përshkrimi; • Shkruan sipas teknikave të shkrimit. 			
Burimet: teksti Gjuha shqipe 11, lloje të ndryshme tekstesh përshkruese bindëse, shkumësa me ngjyra, tabela.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, bashkëjetesa paqësore.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			

Hyrja:



Mësuesi/ja lexon dy lloje tekstesh përshkruese bindëse (tekst që përmban vetëm fakte, tekst që përmban fakte dhe opinion):

Jepet me qira kati i parë i një vile dykatëshe me dhomë gjumi e kuzhinë të kompletuar, ballkon, korridor dhe banjë.

Jepet me qira kati i parë i një vile të mrekullueshme dykatëshe, me dhomë gjumi të pajisur me shumë shije, kuzhinë të kompletuar, ballkon të madh dhe të bukur, korridor dhe banjë.

Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe dhe u kërkon të përshkruajnë shtëpinë e tyre në dy mënyra: duke u mbështetur vetëm në fakte;

duke u mbështetur në fakte dhe opinionin e tyre personal.

Për këtë arsye mësuesi/ja ndërton ditarin trepjesësh ku shënon hapat në të cilët duhet të kalojë përshkrimi:

Hapi I	Hapi II	Hapi III
Faktet	Opinione dhe gjuhë bindëse	Mënyrat e shkrimit
<p>Shkruani faktet.</p> <ul style="list-style-type: none"> Planifikoni përshkrimin. Bëni një listë ose skemë. <p>Filloni me një hyrje të përgjithshme (numrin e dhomave, tarracën, oborrin etj.), të ndjekur nga vendi (në qendër të qytetit, afër dyqaneve, afër rrugës etj.)</p> <p>Përmendni karakteristika të veçanta (zonë e veçantë etj.).</p>	<p>Imagjinoni sikur ju po përpiqeni ta shisni shtëpinë (ose ta jepni me qira).</p> <p>Rishkruani përshkrimin që bëtë duke përdorur gjuhë të figurshme interesante dhe bindëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> Përdorni mbiemra për të zgjeruar informacionin për shtëpinë tuaj. Mendoni për gjuhën bindëse. <p>Qëllimi juaj është që të bindni njerëzit të vijnë dhe të shohin shtëpinë tuaj.</p> <ul style="list-style-type: none"> Fjalitë të jenë të qarta dhe të sakta. 	<p>Shkruajeni përshkrimin tuaj në kompjuter.</p> <ul style="list-style-type: none"> Ju mund të përdorni përmasa të ndryshme shkronjash. Shtojini përshkrimin një figurë. Bëni një fotografi të shtëpisë dhe shtojini në dokument.

Filloni me një hyrje të përgjithshme (numrin e dhomave, tarracën, oborrin etj.), të ndjekur nga vendi (në qendër të qytetit, afër dyqaneve, afër rrugës etj.)

Përmendni karakteristika të veçanta (zonë e veçantë etj.).

Imagjinoni sikur ju po përpiqeni ta shisni shtëpinë (ose ta jepni me qira).

Rishkruani përshkrimin që bëtë duke përdorur gjuhë të figurshme interesante dhe bindëse.

- Përdorni mbiemra për të zgjeruar informacionin për shtëpinë tuaj.
- Mendoni për gjuhën bindëse. Qëllimi juaj është që të bindni njerëzit të vijnë dhe të shohin shtëpinë tuaj.
- Fjalitë të jenë të qarta dhe të sakta.
- Shkruajeni përshkrimin tuaj në kompjuter.
- Ju mund të përdorni përmasa të ndryshme shkronjash.
- Shtojni përshkrimin një figurë.
- Bëni një fotografi të shtëpisë dhe shtojeni në dokument.
- Lexohen disa nga përshkrimet e nxënësve, evidentohen specifikat e përshkrimit bindës.

Reflektimi:

Nxënësit punojnë me ushtrimet 1, 2.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve mbi punën e bërë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Punohet ushtrimi 3.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Format e ligjërimit, gjuha argumentuese dhe ajo bindëse		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon format e ligjërimit, veçan gjuhën (diskursin) argumentuese dhe atë bindëse.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teksti argumentues			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon tekstin argumentues; • Tregon funksionin e tekstit argumentues; • Dallon karakteristikat e tekstit argumentues; • Identifikon nëpërmjet skemës mënyrën e paraqitjes së argumentit; • Gjen argumentet dhe veçoritë gjuhësore në një tekst argumentues. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • tekst argumentues • tekst përshkrues bindës • bind • argument • opinion • fakt • tezë • antitezë • kundërargument • strukturë 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Veçon tekstin argumentues nga tekstet e tjera; • Flet për funksionin e tekstit argumentues; • Specifikon disa nga karakteristikat e tekstit argumentues; • Paraqet mënyrën e paraqitjes së argumentit; • Nënvizon argumentet në një tekst argumentues. 			
Burimet: teksti mësimor Gjuha shqipe 11, libri digjital; tekste argumentuese të llojeve të ndryshme, shkumësa me ngjyra, tabela.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): /			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			

Hyrja:

Mësimi nis me detyrën e shtëpisë. U kërkohet nxënësve të lexojnë disa nga tekstet argumentuese të sjella në klasë.

Pasi dëgjon tekstet, mësuesi/ja drejton këto pyetje:

Pse është tekst argumentues?

Çfarë të bën ta klasifikosh këtë tekst si të tillë?

Ç'kuptoni me fjalën "argument"?

Ç'do të thotë për ju të argumentosh?

Pasi dëgjon përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja shpjegon fjalët: argument, të argumentosh, fakt.

Shpjegimi sipas *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*

Argumenti është një element arsyetimi – një fakt, një vërejtje, një gjykim, një analizë mbi të cilin mbështetet autori për të përligjur tezën. Këtë gjë ai e bën duke u mbështetur në shembuj, të cilët janë fakte reale, referenca konkrete që shërbejnë për të ilustruar argumentimin.

Të argumentosh do të thotë të paraqitësh argumente për një çështje, të vërtetosh me argumente, dhe prova vërtetësinë e tezës së hedhur, pra të mbrosh argumentin duke u mbështetur pikërisht në këta shembuj që janë pjesë reale e faktit për ta bërë atë të prekshëm dhe të kuptueshëm.

Fakti

1. Ngjarje a veprim që ka ndodhur në të vërtetë; diçka që ekziston objektivisht e realisht, diçka që është e vërtetë. *Fakt historik. Fakt gjuhësor. Është fakt.*
2. Dëshmi a diçka tjetër që njihet e pranohet si e vërtetë dhe shërben për të argumentuar, për të provuar a për të kundërshtuar një mendim, një tezë etj., ose për të arritur një përfundim.

Mësuesi/ja rikthen vëmendjen e nxënësve te tekstet që ata kanë sjellë dhe u kërkon të vëzhgojnë dhe zbulojnë:

Çfarë trajton? - Ide ose teza për çështje të ndryshme.

Cili është funksioni? – Të bindë marrësin e tekstit për vlefshmërinë e tezave që trajtohen.

Cili është lloji i tekstit argumentues? – Fjalim, artikull problemor, opinion, ese shkencore, filozofike, historike, kulturore, reklamë etj.

Paraqet në tabelë një tekst argumentues, i cili është i zbërthyer në pjesët e tij përbërëse. Nxënësit do të nënvizojnë tezën dhe argumentet që sillen për ta mbrojtur atë.

Teksti argumentues ndërtohet nga:

teza – problemi që paraqet dërguesi i tekstit dhe që është në bazë të tekstit,

argumentet – faktet, provat, që mbështetin tezën. Së bashku me nxënësit zërthehet struktura e tekstit:

Situata në media

Hyrja. Ende në media nuk ekziston një koncept i qartë rreth kuptimit bashkëkohor mbi problemet gjinore, mbi barazinë dhe perspektivën gjinore.

Teza + argumentet. Shpesh ato kuptohen dhe trajtohen si probleme vetëm të gruas dhe të komunitetit të saj. Si të tilla nuk zënë vendin që meritojnë në mediet shqiptare. Edhe kur trajtohen në shtypin e shkruar, zënë vendet më të padukshme e më të parëndësishme dhe minutazhin më të shkurtër në kronikat televizive, duke përjashtuar analizën e gjerë shoqërore.

Antiteza + kundërgjegje. Në këtë formë mënyra e trajtimit nuk ka peshë, sensibilizimi nuk është i mjaftueshëm, pasi informimi rreth tyre merr formën e një skup-i vetëm në website (faqe interneti) dhune, përdhunimi apo trafikimi.

Përfundimi. Pa mohuar rëndësinë e asaj që është bërë deri tani, duhet thënë se ka ardhur koha për një hap të ri cilësor, gjë që e pengojnë, përveç të tjerash, edhe mangësitë në formimin dhe specializimin e gazetarëve. Shpesh njohuritë e tyre në këtë fushë janë të copëzuara dhe sporadike.

Kjo lejon të anashkalohen problemet e vërteta, të mos këmbëngulet në peshën shoqërore të problemit, në pasojat dhe kërkesat për hapa dhe zgjidhje institucionale dhe perspektive.

Marrë nga botimi "Konferenca kombëtare për shëndetin", f. 78

Hyrja - Paraqitet problemi që do të trajtohet dhe që tërheq vëmendjen e marrësit.

Teza - Argumentet për të mbështetur tezën.

Një antitezë për ta kundërshtuar.

Argumente të kundërta me antitezën.

Përfundimi - Tema që trajton.

Teza	Në kohën e tanishme, viti 2006, çështja e raporteve të shqiptarëve me kontinentin mëmë është ende në zhvillim e sipër. Të ndërgjegjshëm për një pjesë të gjërave, shqiptarët paraqiten po aq të pandërgjegjshëm për të tjerat.
Argumenti 1	S'është për atë pjesë të Shqipërisë që, ndonëse s'guxon të dalë haptas, është kundër Europës. Është folur për mafian dhe krimin e organizuar, duke mos njohur komb e atdhe. Është folur për politikanë të korruptuar që, ashtu si mafia, tmerrohen nga ligjet e demokracisë e standardet e Ballkanit... Të gjitha këto dihen. E keqja është se kujtesa e politikës shqiptare është e shkurtër dhe, veç kësaj, disa nga politikanët tanë dinakërinë e tyre e quajnë zgjuarsi. Ata kujtojnë se me dredhitë e pazareve të pluhurosura të dikurshme, mund të hyjnë në institucionet e demokracisë kontinentale.
Argumenti 2	Është e kuptueshme që dhe haxhiqamilizmi e komunizmi shqiptar do të linin pas vetes një frymë të sëmurë kundëreuropiane. Është e kuptueshme që shumë njerëz do të ndihen keq në familjen e sotme të popujve. Problem i mirëkuptimit ose moskuptimit shqiptar me kontinentin, është në thelb mirëkuptimi ose moskuptimi me vetveten.
Argumenti 3	Raportet me Europën s'mund të jenë veçse të qarta pa dyfytërsi. Mesazhi i Europës në 1997-n dhe 1999-n ishte i qartë. Ajo na quante të vetët ashtu siç ishim, me atë identitet që kishim. E vetmja kërkesë e saj ishte ajo që iu bë të gjithë popujve të tjerë të ish-Lindjes komuniste: emancipimi dhe demokracia.
Argumenti 4	Trillet, nazet dhe dyshimet nuk janë pa një burim. Një pjesë vijnë nga keqkuptimet tona të vjetra, një pjesë nga dredhitë e sotme. Ende si disa vite më parë. Por në pranverë të këtij viti, ato janë të tepërta. Pengesat që s'na lënë ose na duket se s'na lënë t'i afrohem Europës, përpara se t'i kërkojmë jashtë, duhet t'i kërkojmë brenda nesh. Nuk është pengesë asnjëra nga fetë, e sidomos nuk është myslimanizmi ndaj të cilit dyshimi ngjan më i lehtë... Një shqiptar mysliman është po aq i natyrshëm si shqiptar dhe si evropian sa një katolik e po aq, sa një ortodoks...
Përfundimi	Siç u tha më lart, kombet nuk ndryshohen as nga pushtimet e as nga konvertimet. Këto të fundit, duke përfshirë edhe kthimin në islamizëm, i kanë njohur disa popuj të Europës si shqiptarët, grekët (kretasit), spanjollët, sllavët e jugut. E, megjithatë, pikërisht Europa mbetet rrafshi i parë i identiteteve të pandryshueshme.

Ka disa forma për dhënien e argumentit. Mësuesi/ja ilustron modelet me shembuj konkretë. U kërkon nxënësve t'i identifikojnë në materialet e sjella prej tyre ose te materialet që ka shpërndarë mësuesi/ja.

- Dhënia e tezës në fund të argumentit.
- Mosdhënia e tezës.
- Mosdhënie e tezave të kundërta.
- Mosdhënie e argumenteve të mbrojtjes së tezës.

Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja përqendron vëmendjen e nxënësve në përcaktimin e llojeve të argumenteve bazë, duke u shpërndarë nga një paragraf me tipat e argumenteve. Identifikon së bashku me ta.

- Argumente që sjellin fakte konkrete.
- Argumente të autoriteteve të fushës përkatëse.
- Argumente logjike.
- Argumente pragmatike.

Argument që sjell fakte konkrete

Shekulli XIX ishte me të vërtetë i veçantë në letërsinë shqipe. Ai ishte shekulli i Rilindjes Kombëtare, kur pas një nate robërie katërqindvjeçare, ndihej që mëngjesi nuk ishte larg. Mendjet e të gjithëve ishin kthyer drejt tij.

Ishin me dhjetëra, për të mos thënë me qindra, ata që morën penën për të shkruar një vepër, një poemë, një faqe ose një strofë në letërsinë shqipe. Në krye të kësaj armate të pafundme ishin poetët e mëdhenj Naim Frashëri e Jeronim de Rada. Fill pas tyre, vinin poetët e tjerë të shquar Anton Zako Çajupi, Ndre Mjeda e Zef Serembe. Dhe pas tyre një aradhë e tërë shkrimtarësh, poetësh, eseistësh, filozofësh, publicistësh, oratorësh, polemistësh etj.

Vit pas viti, stinë pas stinë e ditë pas dite plotësuan kronikën e asaj kohe të paharruar.

Ismail Kadare, MIGJENI, Vepra

Argument të autoriteteve të fushës përkatëse

Në fillim të këtij punimi u propozua një zgjidhje “kompromisi” në përcaktimin gjinor të “Pasqyrave të Narçizit”, për një vendosje mes prozës dhe poezisë. Analiza e deritanishme i është qasur këtij problemi nisur nga proza, në elemente të tilla si monologimi, dialogimi dhe prania, në forma të ndryshme, e instancës së zërit. Para se të kalojmë tek analiza e elementeve poetike në “Pasqyrat e Narçizit” duhet ritheksuar edhe një herë arsyeja pse analiza tekstore e kësaj vepre fillon me shqyrtimin e elementeve të prozës dhe të poezisë në të. “Pasqyrat e Narçizit” kanë në qendër dialogimin e dy zërave: atë të narratorit-poet dhe atë të Narçizit (a varianteve të tij), të cilët marrin përsipër modelime të ndryshme të botës, njëri atë prozaik (rrëfen për mënyrën sesi krijohet poezia) dhe tjetri atë poetik (krijon poezinë). Pra, arsyet e zgjedhjes së këtij këndvështrimi gjinor na diktohen nga vetë struktura e veprës. Këndvështrimi gjinor do të jetë përcaktues edhe përgjatë gjurmimit të elementeve të poezisë në këtë vepër...

Dhurata Shehri, Koliqi mes malit dhe detit

Argument logjik

Vjershëtarët (bejtexhinjtë) krijojnë një letërsi vetjake, individuale. Në këtë vështrim ata janë autorët e vërtetë të letërsisë shqiptare.

Shkrimet e tyre nuk i mbështesin temat në mësimin fetar, por mbi ide vetjake, shpesh dhe mbi një emocionalitet të theksuar, si te Nezimi. Te Hasan Zyko Kamberi, letërsia bëhet imituese jo vetëm e ideve, por edhe e jetës, duke i shfaqur edhe trajtat e pamjet e saj me një qëndrim kritik të autorit. Shfaqjet e jetës përpara shfaqjes së ideve, realiteti dhe aktualiteti përballë përjetësisë, janë veçori që e dallojnë tërësisht letërsinë e tij nga autorët biblikë. Trajta e shkrimit jeton ende me përsëritje të mëdha dhe me tregim në vargje. Këtë tregim në vargje e bën metodë krijuese Muhamed Kyçuku, një trajtë kjo që më vonë do të rishfaqet në letërsinë e romantizmit shqiptar.

Format poetike të vjershëtarëve janë format poetike të Lindjes: kasida, gazela, rubaia dhe divani, që është forma më e ndërliqshme poetike e këtyre letërsive.

Pra, letërsia e vjetër shqiptare mbështet në kulturat e Lindjes dhe në kulturat e Perëndimit; në trashëgiminë biblike, në trashëgiminë Lindore (myslimane) dhe në krijimet humaniste evropiane. Sabri Hamiti, Letërsia e vjetër shqiptare

Teksti lexohet nga mësuesi/ja ose nga nxënësit. Pastaj ndahet në disa pjesë, të cilat janë shkruar paraprakisht në rripa letre dhe i jepet një grupi nxënësish, ku secili anëtar merr një pjesë nga teksti. Lihen për një kohë të caktuar ta lexojnë pjesën dhe pastaj u kërkohet t'i renditin pjesët siç duhet. Punohet me teknikën Dora e fshehtë. Nxënësit lexojnë në tekst esenë "Dhuna në sport" ose një ese tjetër që mësuesi/ja e ka zbërthyer sipas strukturës dhe në rripa letre ua shpërndan nxënësve. Grupi i nxënësve duhet të rindërtojë tekstin argumentues duke renditur si duhet tezën, argumentet dhe përfundimin.


Grupi i nxënësve lexon tekstin e formuar, kurse të tjerët bëjnë vlerësimin e punës.

Klasa mund të ndahet edhe në grupe të tjera, ku secili grup punon me një tekst argumentues të dhënë.

Reflektimi:

Pasi ndërtojnë tekstin, u kërkohet nxënësve të analizojnë tiparet e gjuhës së përdorur në të.

Ndihmohen nxënësit me këto pyetje:



Vlerësimi i nxënësve:

Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve në grup dhe në mënyrë individuale, kujdes tregon në kontributin e punës së nxënësit në aspekte të veçanta. Vlerësohet ora e mësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Punohen ushtrimet 1 dhe 2.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Format e ligjërimit, gjuha argumentuese dhe ajo bindëse	Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon format e ligjërimit, veçan gjuhën (diskursin) argumentuese dhe atë bindëse.		
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalimi politik			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Përdor teknikat e shkrimit në një fjalim politik; • Analizon elementet gjuhësore në një fjalim politik; • Shkruan një fjalim me temë të zgjedhur prej tij. 	Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • fjalim politik • teknika të shkrimit të fjalimit politik • elemente gjuhësore të fjalimit politik 		
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Përgatit fjalimin politik sipas teknikave të shkrimit; • Zbërthen stilin e ndërtimit të fjalimeve politike; • Bën gati një fjalim politik. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, lloje të ndryshme të teksteve argumentuese, shkumësa me ngjyra, fjalor i gjuhës shqipe, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): letërsi, gjuhë e huaj, artet, histori, TIK.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Hyrja: Materiale shtesë <div style="background-color: #e0e0e0; padding: 10px; margin-top: 10px;"> <p>Fjalimi mbi gjendjen e vendit nga presidenti Obama</p> <p>Ndërtesa e Kongresit të Shteteve të Bashkuara Uashington DC. 21:12 EST</p> <p>Ju faleminderit të gjithëve!</p> <p>Kryetar i Kongresit, zëvendës-presidenti Çeni, anëtarë të Kongresit, anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe të trupave diplomatikë, miq të nderuar dhe bashkëqytetarë,</p> <p>... Sa herë që jam përpara këtij podiumi, unë jam i prekur nga privilegji dhe i vetëdijshëm për historinë që kemi përjetuar së bashku. Ne jemi mbledhur në ndërtesën e Kongresit në momente të zisë kombëtare dhe të arritjeve kombëtare. Ne i kemi shërbyer Amerikës në një nga periudha e saj më të rëndësishme... dhe ka qenë nderi im që ju kam shërbyer juve.</p> <p>Për t'u përballur me problemet e mëdha përpara nesh, ne duhet të veprojmë në një frymë të vullnetit të mirë dhe me respekt për njëri-tjetrin... dhe unë do të bëj pjesën që më takon. Sot, gjendja e vendit (Bashkimit) paraqitet e fortë... dhe së bashku do ta forcojmë më shumë.</p> </div>			

(Duartrokitje.) Në këtë vit vendimtar, ju dhe unë do të marrim zgjedhje, të cilat përcaktojnë si të ardhmen, ashtu edhe karakterin e vendit tonë. Ne do të zgjedhim për të vepruar me besim në përndjekjen e armiqve të lirisë... ose të tërhiqemi nga detyrat tona me shpresën e një jete më të lehtë. Ne do të zgjedhim të ndërtojmë begatinë tonë duke drejtuar ekonominë botërore... ose të largohemi nga tregtia dhe mundësitë. Në një kohë të ndërlikuar dhe sfiduese, rruga drejt izolimit dhe proteksionizmit mund të jetë e gjerë dhe joshëse..., por ajo përfundon me rrezik dhe në rënie. E vetmja rrugë për të mbrojtur njerëzit tanë, e vetmja rrugë për të siguruar paqen, e vetmja rrugë për të kontrolluar fatin tonë, është përmes udhëheqjes sonë..., në mënyrë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të vazhdojnë të jenë në krye. (Duartrokitje.) Jashtë vendit, kombi ynë është përkushtuar drejt një qëllimi historik, afatgjatë dhe ne kërkojmë përfundimin e tiranisë në botën e sotme. Disa e përjashtojnë atë qëllim si idealizëm i keqdrejtuar. Në të vërtetë, siguria e ardhshme e Amerikës varet nga ajo. Më 11 shtator, 2001, ne zbuluam se problemet që e kishin zanafillën në një shtet të dështuar dhe shtypës, 7000 milje larg, mund të sillnin vrasje dhe shkatërrim për vendin tonë....

Mësuesi/ja e nis mësimin me diskutimin e detyrës së shtëpisë (ushtrimi 21, duke përqendruar vëmendjen në njohuritë që kanë nxënësit për tekstin argumentues dhe fjalimet politike, si një lloj i tekstit argumentues. Idetë e tyre shkruhen në tabelë.

Model përgjigjeje

Problemi - Argumente në favor të tezës - Rrëzimi i argumenteve - Antiteza - Argumente në favor të antitezës - Teza dhe përfundimi

- Problemi - Inteligjent lind apo bëhesh?
- Teza - Në fakt inteligjent lind dhe bëhesh.
- Argument në favor të tezës - Kjo përzierje mes kulturës dhe kromozomeve mund të ndryshojë në bazë të përvojave personale (si mjedisore, ashtu dhe gjenetike).
- Antiteza - Dihet që ka persona që kanë një talent të lindur më të theksuar se të tjerët...
- Argument në favor të antitezës - E gjithë historia është e mbushur me njerëz gjenialë në çdo fushë, të cilët shquhen për aftësitë e tyre të lindura dhe nga një edukim jo veçanërisht i shkëlqyer. Kjo është e vërtetë jo vetëm për inteligjencën, por për të gjithë larminë e talenteve të tjera "brendashkruar" qarkut cerebral: muzikë, matematikë, gjuhë, pikturë.
- Rrëzimi i argumenteve në favor të antitezës - Po aq e dallueshme është se askush nuk mund të bëjë matematikë apo muzikë, të pikturojë ose edhe të flasë, nëse nuk i ka mësuar këto gjëra në mjedisin ku jeton.
- Përfundimi - Mjedisi ka një rol shumë të rëndësishëm, sepse është në gjendje të zhvillojë prirjet individuale nga zeroja deri në pafundësi.

Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe me nga 6 nxënës. Duke u bashkuar sipas numrave përkatës, nxënësit ndahen në grupe ekspertësh:

Grupi I identifikon marrëdhëniet që kanë fjalitë e ndryshme me njëra-tjetrën në fjalimet politike.

Grupi II identifikon veçoritë e leksikut të përdorur në të.

Grupi III identifikon veçoritë e terminologjisë së përdorur.

Grupi IV analizon stilin e ndërtimit të fjalimeve politike.

Grupi V referon disa njohuri që kanë të bëjnë me fushën e retorikës.

Grupi VI evidenton rëndësinë dhe përdorimin e figurave letrare.

Secili grup, pasi përpunon materialin teorik dhe e pasqyron atë të përmbledhur në skica e tabakë letre, ku identifikon veçoritë specifike të tekstit të dhënë, rikthehet në grupet bazë për ta realizuar detyrën e tij brenda grupit.

Model përgjigjeje

Grupi I. Rëndësi të veçantë ka marrëdhënia që kanë me njëra-tjetrën fjalitë e llojeve të ndryshme.

Fjalimi i Ismail Qemalit ditën e Shpalljes së Pavarësisë

Shpall Shqipërinë të pamvarur!

Oh! Sa të lumtur që e ndiej vehten sot, që shoh, këtu në Vlorë, kaqë burra Shqipëtarë të mbledhur tok, tuke pritur me kureshti e padurim përfundimin e kësaj mbledhjeje historike, për fatin e Atdheut tonë të dashur. - *(Fjali thirrmore, e dëshirore, i bëjnë thirrje dëgjuesit për pjesëmarrje).*

Plot me gaz e me lot ndër sy, nga mallëngjimi, pra, po dal këtu para jush që t'ju gëzoj me sihariqin e madh, se sot, edhe këtë minutë, Kongresi çpalli mëvehtësinë e Shqipërisë, tuke lajmëruar gjithë botën mbarë për këtë punë e duke më ngarkuar mua kryesin' e qeveris së përkohshme të Shqipërisë së lirë. - *(Fjalitë dëftore shërbejnë për të dëftyer (treguar) për një objekt a problem në mënyrë të thjeshtë dhe objektive. Përdorimi i fjalive të shkurtra, me informacion të qartë e të thjeshtë është tregues i kujdesit që ka autori për ta bërë tekstin sa më të kuptueshëm.)*

Porsi ëndërr më duket ky ndryshim i madh i vendit t'onë, që hoqi e voi të zezat e të lirit pesëqind vjet me radhë ndënë sundimin turk, por që tani në kohët e fundit, ishte gati të jepte shpirtin përgjithnjë, të shuhej e të çfarrorej krejtësisht nga faqia e dheut, këjo Shqipëri, që, dikur, shkëlqente nga trimërija e pashoqe e bijve të saj; kjo Shqipëri, që kur i kërcënohej rreziku Europës nga pushtimet e Turqisë, ndënë kryetrimin e pavdekur të saj, Skënderbejnë, u bë porta e hekurtë kundra sulmeve më të tërbuara të sulltanëve më t'egër që ka pas Turqija. Mirëpo, desh Zoti, që me punën, me trimërinë dhe guximin e pashoq të Shqipëtarëve, sot e tutje të marrin fund mjerimet dhe vuajtjet e Atdheut t'onë, sepse, këtu e kështu, jemi të LIRË të PAVARUR dhe MËVEHTE.

Prandaj qeshni e gëzoni! - *(Fjalitë nxitëse synojnë të të bindin me anë të kërkesës, këshillës e propozimeve të bëra):*

Për t'ia arrijtur kësaj dite të bardhë e të madhe, na ka ndihmuar gjaku i dëshmorëve dhe puna e vlefshme e patriotëve t'anë dhe e të gjithë shokëve që muarnë pjesë në këtë mbledhje dhe e të gjithë juve, që tani po ju gufon zemëra nga gazi i madh që ndieni; mirëpo mbledhja si më plak që jam, m'a ngarkoi mua ngritjen e shënjtë të shënjës t'onë Kombëtare, të flamurit t'onë të ëndërruar e të dashur (nxjerr Flamurin, të cilin e ka të vendosur në një shtizë hekuri, natyrisht të vogël, dhe të pshehur nën pallto dhe pasi e mba një sekondë në dorë e ngul në shtyllat e ballkonit. - *(Fjali dëftore)* Amatorët, posa e shohin Flamurin, thërrasin me gëzim e me zë të lartë:

Rroftë Flamuri, Rroftë Shqipërija e Lirë). - *(Fjali dëshirore)*

Ja, pra, ky është Flamuri Ynë i kuq e me shqiponjën dykrenare të zezë në mes. - *(Fjali dëftore)*

Dhe tani, të gjithë bashkë, si një trup i tërë dhe i pandarë, le të punojmë për t'a mburuar, për t'a përparuar e për t'a qytetëruar si i ka hije Atdhenë t'onë të Lirë. Tuqe përfunduar, s'më mbetet gjë, veçse t'i drejtoj një lutje Zotit të Madh, që, bashkë me bekimet e Tij që i lipij të na japë për të qenë të denjë të kësaj dite, të pranojë që këtë e tutje të jem unë dëshmori më i parë i Atdheut, ashtu siç pata nderin dhe fatin që të jem i pari ta puth e ta bëj të valvitet i Lirë, Flamuri i ynë, n'atdhenë t'onë të lirë. - *(Fjali nxitëse).*

Rroftë Flamuri!

Grupi II. Leksiku, përdorimi i emrave dhe mbiemrave, epitetet etj. (nga fjalimi i A. Zogut, ditën e shpalljes mbret) (Shërbyesin e palodhur të Atdheut, detyrën e rëndë dhe të naltë të shtetit, bashkëpunëtor të idealit të përbashkët, përgjegjësi morale, popullin trim shqiptar, detyrën e shenjtë, populli sovran, fjalët e nalta të krenave...) Përemrat japin informacion për pozicionin e folësit me publikun:

(Ju drejtohem, unë, bijtë e Shqipërisë, tregojmë, paguajmë, shpresojmë, shtyjmë, mbaroni, keni vënë, të ktheheni në vendet tueja, keni për ta gjetur.)

Mbiemrat dhe epitetet shërbejnë për të treguar gjendjen emocionale: shëmbëlltyrën besnike, sheshin e qytetëruar, fjalët e nalta të krenave të ndershëm të stolisur me kunorë...

Grupi III. Identifikon veçorinë e terminologjisë së përdorur në fjalim:

fusha semantike: - (kryesinë e shtetit shqiptar, një faktor paqësor, relacionet që ekzistojnë sot me shtetet fqinje, të drejtat kombëtare, për t'ia arritur qëllimit të lartë, atë ideal që na ka falur natyra e na ka shënuar historia...)

Grupi IV. Analizon stilin e ndërtimit të fjalimeve politike: gjuha e folur jep informacion mbi origjinën e folësit (Mbretit Zog), po ashtu dhe stili zyrtar: "fjalët e nalta të krenave të ndershëm të stolisur me kunorë... Në regjimin e ri Shqipëria ka për të qenë një faktor paqësor në Ballkan etj).

Grupi V. Referon disa njohuri që kanë të bëjnë me fushë e retorikës.

Hyrja: Zotni kryetar dhe asamblista,

Në mesazhin që ju drejtova para disa ditëve, duke ju uruar sukses ju etërve të kombit..

Teza e parë: Nëse në fjalimin tim nuk do të gjeni fjalët... Do të veprojmë duke marrë parasysh

përgjegjësinë morale, të cilën herët a vonë do ta çmojë populli shqiptar për lartësimin e vendit.

Teza e dytë (folësi paraqet vizionin e tij): Bota e ka marrë vesh se po të lihen të qetë bijtë e shqipes, mund të krijojnë shtet... është pasuria e gjithë dhe ideali i botës mbarë.

Zgjidhja e problematikës: Vetëm në këtë mënyrë, duke i siguruar vendit tonë një të ardhme të lirë, mund të paguajmë një detyrë historike...

Efektet e dëgjuesit dhe bindja e tyre: Si të mbarojnë detyrën e shenjtë... gati për t'i sakrifikuar të gjitha, nëse është nevoja edhe jetën, mbas dëshirës së tij dhe për të mirën e vendit...

Grupi VI. Evidenton rëndësinë dhe përdorimin e figurave letrare: metafora, epitete etj. (fjalët e Nalta të krenave të ndershëm të stolisur me kunorë; shërbyesin e palodhur të Atdheut).

Reflektimi:

Nxënësit punojnë në grupe bazë për ushtrimin 14.

Model përgjigjeje: Edhe gratë mund të shërbejnë në ushtri

Vëllezër dhe motra,

Është kënaqësi t'ju jem pranë dhe të ndaj me ju shqetësimet dhe problemet tuaja. E di që është e re për të gjithë ne, por do të desha t'ju parashtroja idenë time për pjesëmarrjen e grave në shërbimin ushtarak. A duhet me të vërtetë gruaja të kryejë një detyrë kaq burrërore, kur shumë mirë mund të kryejë detyra në fusha të tjera ose të përkujdeset për familjen dhe fëmijët e saj?!

Kjo pyetje qëndron. Me të vërtetë shërbimi ushtarak është i vështirë. Kërkon forcë, energji dhe përgatitje të mirë fizike dhe profesionale. Por unë mendoj se gruaja shqiptare i ka këto mundësi. Mjafton të rikujtojmë kontributin e vlefshëm të grave e vajzave në luftën për çlirim dhe përkushtimin që i dhuruan ato kësaj kauze. Edhe në të shkuarën e afërt ajo inkuadrohej në formacionet ushtarake efektive e vullnetare dhe dallohej për përkushtim. Por ndryshimi ndërmjet dy kohëve është thelbësor: nëse në atë kohë kjo pjesëmarrje i kërkohej me detyrim, tani jeni ju vajza të reja që e kërkon

si një të drejtën tuaj të kryeni shërbim ushtarak. A është kërkesë e të gjitha vajzave e grave? Pa dyshim që jo. Ka edhe djem që i shmangen këtij shërbimi. Por unë kam bindjen që ato vajza që e shtrojnë këtë kërkesë, do t'i përgjigjen detyrës me përgjegjësi të lartë. Ato janë të afta të kryejnë si detyra që kërkojnë përgatitje fizike e profesionale, dhe ato që kërkojnë përgatitje shkencore, e që i përgjigjen stadi të sotëm të një ushtrie moderne. Brenda shpirtit të tyre ka shumë dashuri, forcë dhe iniciativë. Gruaja ka arritur të ndërtojë një imazh të saj inkuadrohej në formacionet ushtarake efektive e vullnetare dhe dallohej për përkushtim. Por ndryshimi ndërmjet dy kohëve është thelbësor: nëse në atë kohë kjo pjesëmarrje i kërkohej me detyrim, tani jeni ju vajza të reja që e kërkon si një të drejtën tuaj të kryeni shërbim ushtarak. A është kërkesë e të gjitha vajzave e grave? Pa dyshim që jo. Ka edhe djem që i shmangen këtij shërbimi. Por unë kam bindjen që ato vajza që e shtrojnë këtë kërkesë, do t'i përgjigjen detyrës me përgjegjësi të lartë. Ato janë të afta të kryejnë si detyra që kërkojnë përgatitje fizike e profesionale, dhe ato që kërkojnë përgatitje shkencore, e që i përgjigjen stadi të sotëm të një ushtrie moderne. Brenda shpirtit të tyre ka shumë dashuri, forcë dhe iniciativë. Gruaja ka arritur të ndërtojë një imazh të saj inkuadrohej në formacionet ushtarake efektive e vullnetare dhe dallohej për përkushtim.

Unë, si kandidatja juaj për deputete, nëse do të më jepni votën tuaj, në parlamentin e ardhshëm do të bëj të gjitha përpjekjet që në ligjin për shërbimin ushtarak, të zërë vend edhe mundësia që gratë dhe vajzat të kryejnë shërbim ushtarak. Përveçse është detyra e lartë ndaj atdheut, këtë pjesëmarrje të gruas, ligjvënësit duhet ta shohin si një mundësi të barazisë së gruas me burrin në të gjitha aspektet, duke u bërë kështu një faktor i rëndësishëm jo vetëm në familje, por edhe në zgjidhjen e detyrave të vështira, siç është çështja e Atdheut.

Ju falënderoj nga zemra për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim!

Vlerësimi i nxënësve:

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë mbi përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimi. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nëse koha për zhvillimin e kësaj detyre është e pamjaftueshme, nxënësit mund të vazhdojnë detyrën në shtëpi. Në klasë nxënësit mund të ndërtojnë vetëm skemën me argumente, duke shkëmbyer opinionet dhe duke sugjeruar mënyrën se si do të ndërtojnë tekstin me njëri-tjetrin.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Format e ligjërimit, gjuha argumentuese dhe ajo bindëse		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon format e ligjërimit, veçan gjuhën (diskursin) argumentuese dhe atë bindëse.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kryeartikulli dhe reklama			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon karakteristikat e një kryeartikulli dhe reklame si lloje të tekstit bindës; • Përcakton teknikat e shkrimit të tyre; • Analizon nga ana gjuhësore një kryeartikull dhe një reklamë; • Shkruan një kryeartikull dhe një reklamë. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • kryeartikull • reklamë • teknika shkrimi • karakteristika gjuhësore 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Dallon karakteristikat e kryeartikullit dhe të reklamës; • Përgatit kryeartikullin dhe reklamën sipas teknikave të shkrimit të tyre; • Zbërthen anën gjuhësore të kryeartikullit dhe të reklamës; • Bën gati një kryeartikull dhe një reklamë. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve, modele tekstesh argumentuese artikuj e kryeartikuj, e-libri.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): letërsi, histori, TIK, gjuhë e huaj.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Hyrja:

Mësuesi/ja e nis mësimin duke u treguar nxënësve faqen e parë të një gazete të përditshme dhe u kërkon të identifikojnë kryeartikullin dhe artikujt e tjerë. Ndërkohë, ngre pyetjet dhe me përgjigjet e nxënësve ndërton hartën e mendimit.



- Çështë kryeartikulli i një gazete, po reklama?

Cili është kryeartikulli në këtë gazetë?

Nga dallon ai nga artikujt e tjerë?

Cili është roli i titullit ku përqendrohet ai?

Gjeni reklamatat dhe vëzhgojini ato.



Model përgjigjeje

Kryeartikulli është artikulli më i rëndësishëm i një gazete a reviste, titulli i të cilit shënohet në faqen e parë të gazetës me shkronja të dallueshme. Vihet në një vend të dukshëm për të tërhequr vëmendjen në lidhje me problemin që trajton. Dallohet nga artikujt e tjerët të gazetës, për shkak të rëndësisë së problemit që trajton.

Realizimi i kuptimit:

Reklama

Mësuesi/ja ndan klasën në dy grupe. Nxënësit lexojnë në dyshe artikullin dhe reklamën, evidentojnë veçori të kryeartikullit dhe reklamës dhe shënojnë karakteristikat e tyre në organizuesin grafik.

Grupi I

Veçoritë e artikullit	Ilustrime nga teksti	Struktura e artikullit
Materiali që trajton duhet të jetë në funksion të argumentimit të tezës	Dhuna në futboll dhe niveli i përfaqësimit...	Titulli dhe nëntitulli
Titulli përmban tezën kryesore	...sikurse dhuna në fushat sportive apo stadiumet e ndryshme	problemi
Struktura	Në aspektin sportiv, dhuna ndaj gjyqtarit është krejt e papranueshme	Teza 1
	Pa dashur të fajësoj gjyqtarët, nuk duhet të harrojmë që gjyqtari...	Argumenti
	Nervozoi lojtarët dhe luajti me ndjenjat e tifozëve në stadium...	Kundërshtimi i antitezës
	Aspekti i dytë është ai i protagonistëve, jo rrallëherë ka ndodhur si në rastin...	Teza 2
	Kur një deputet dhuron një person që ka njëfarë statusi...	Argumenti
Përdorimi i regjistrit të duhur gjuhësor	Nivelin e ulët të disa përfaqësuesve...	Kundërshtimi i antitezës
	Tani kur ka ngelur diçka më shumë nga...	Përfundime

Mësuesi/ja tërheq vëmendjen e nxënësve mbi aspekte gjuhësore të organizimit të artikullit. Në shkrimin e artikujve përdoret kryesisht gjuha standarde.

Ndërtimi sintaksor i fjalisë bëhet në përputhje me çështjen që trajtohet. Përdoren fjali të thjeshta, kryesisht të zgjeruara e të përbëra, me marrëdhënie bashkërenditëse e veçanërisht nënrenditëse, ku mbizotërojnë fjalitë filluese (sqarojnë e saktësojnë), kohore (për të dhënë informacion për kohën kur ndodh ngjarja a me të cilën lidhet çështja që trajtohet. Duke qenë se artikulli është një tekst argumentues, përdoren shumë fjalitë shkakore e rrjedhimore.

Tregues për këtë është përdorimi i konektorëve: lidhëzave bashkërenditëse kundërshtore, shkakore, rrjedhimore, filluese, qëllimore etj.: përemrave lidhorë, që, i cili dhe i fjalëve lidhëse. Përgjithësisht mungojnë figurat retorike, por në artikujt ku qëndrimi subjektiv është i dukshëm, si opinionet, analizat etj., këto figura zënë vend të rëndësishëm, sepse kërkohet të ndikohet më shumë te lexuesi a dëgjuesi.

Grupi II përqendrohet te teknikat e bindjes në një reklamë.
Gjuha e përdorur në reklama

Tipar përbërës/teknikat e bindjes	Shembuj nga teksti
Përdorimi i përemrit “ti” ose i ligjërimin të drejtpërdrejtë, konfidencial: përdorimi i ligjërimin kinematografik (batuta të shpejta)	Në reklamën tonë kemi përdorimin e batutave të shpejta, si ekstrakte të pastra nga lulet më të mira... rezultat efikas dhe i dukshëm/ slogan lule nga zemra e luleve
Manipulimi i përdoruesve përmes figurës, gruas, burrit, fëmijës në përdorimin e produkteve të ndryshme që përdorin.	Në rastin e kësaj reklame kemi përdorimin e figurës së vajzës së buzëqeshur/perceptohet portreti i vajzës së bukur, me një fytyrë të përsosur të lëmuar dhe të freskët, me sy të mbyllur dhe në fytyrën e saj spikasin lëkura që shkëlqen si pasojë e bukurisë dhe dhëmbët e bardhë. Në analogji me këto tipare të bukurisë dhe freskisë kemi në cep të syrit lulen me petale të gjata e delikate, si tregues i të njëjtave elemente të freskisë dhe bukurisë me fytyrën e vajzës.

Mësuesi/ja u sugjeron nxënësve të vëzhgojnë modelet ndryshme të reklamave shoqërore.
Modele përgjigjesh

Teksti 1

Kjo është një reklamë shoqërore, ku reklamohet një linjë kombëtare e këshillimit për fëmijë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. I drejtohet të gjithë shoqërisë dhe në mënyrë të veçantë u përgjigjet fëmijëve dhe të rinjve sipas nevojave që ata kanë.

Mesazhi që ajo realizon është me anë të shenjës së telefonit dhe numrit të shkruar në të, që evidenton pikërisht qëllimin për të cilin realizohet kjo reklamë. Ngjyra e përdorur, jeshilja, është ngjyra e ndihmës (e filizave që rriten dhe janë të njomë e të brishtë) dhe unitetit të figurës së fëmijëve, që të realizuara në reklamë përforcojnë qëllimin e organizatës, që është në fakt dhe dërguesi i reklamës.

Karakterizohet nga slogani: Kur një fëmijë telefonon, ne përgjigjemi gjithmonë. Një numër telefoni për të gjithë fëmijët.

Reklama shfrytëzon shenjën e telefonit në funksion të realizimit të rrugëve të komunikimit, që pretendohet të vendoset në rast nevoje dhe kjo theksohet edhe nëpërmjet sloganeve të shënuara në reklamë.

Ka një sërë figurash retorike të pranishme: si metafora, e cila realizohet nëpërmjet shenjës së telefonit dhe numrit, dhe figurave të fëmijëve të kapur dorë për dorë. Pikërisht shenja e telefonit, numri dhe fëmijët e kapur dorë për dorë, tërheqin vëmendjen e lexuesit, shikuesit në atë që ata promovojnë: ndihmën kundrejt fëmijëve. Në pjesën e pasme të këtij promovimi jepen informacione mbi organizatën që ofron këtë shërbim, grupet shoqërore që ajo u drejtohet dhe logot e simbolet që ata përdorin.

Teksti 2

Promovimi i vlerave dhe pasurive turistike të vendit tonë

Qëllimi i reklamës është një fushatë promovimi për vlerat turistike të Shqipërisë, e cila realizohet nëpërmjet disa komponentëve.

Fotoja e parë pasqyron harmoninë e një familjeje që pushon në bregdetin shqiptar. Larmia e ngjyrave dhe të objekteve që kanë në dorë pushuesit, simbolizon larminë e argëtimit, një sërë vlerash kulturore dhe paqes e qetësisë që të ofron riviera shqiptare. Sfondi i saj plotësohet me një lulëkuqe, me ngjyrat tradicionale të simboleve të flamurit. Kuptohet që mes tyre ekziston ndjenja e dashurisë. E njëjta harmoni dhe paqe ekziston edhe mes çiftit të dashuruar, të cilët gjejnë në brigjet e Shqipërisë veten apo i riu, të cilit ky mjedis i larmishëm i ofron një sërë mundësish për zbavitje. Në sfond paraqitet deti me pafundësinë e hapësirës, e cila mund të nënkuptohet si një pafundësi mundësish për argëtim.

Ekzistojnë një sërë figurash retorike, si: metafora e familjes dhe e harmonisë që ekziston në brigjet e detit shqiptar: lulëkuqja me ngjyrat e simboleve shqiptare: por njëkohësisht e krahasuar me dashurinë apo edhe pamja e maleve dhe lumit mes tyre, që ofron misterin dhe kuriozitetin e rrugës për ta zbuluar. E gjithë kjo plotësohet nga slogani: Albania a neë mediterranean love!

Reflektimi:

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të shkruajnë një kryeartikull dhe spotin publicitar të shkollës (hedhin ide si duhet të jetë ai).

Model përgjigjeje (kryeartikulli)

Çarmatosja botërore është e vetmja shpresë për paqe në botë.

- A duhet të ketë luftëra në shek. XXI?

Është një çështje që gjithmonë e më shumë hap debate rreth e qark globit.

Luftërat e shumta të zhvilluara përgjatë historisë së njerëzimit kanë sjellë gjithmonë e më shumë dëme materiale dhe shpirtërore. Pavarësisht kësaj, ende nuk është kuptuar ose më saktë nuk ekziston vullneti i mirë për t'i shmangur ato.

Por luftërat kanë pasur gjithmonë të njëjtin qëllim: mbisundim, pasurim, zotërim, lakmim etj. Kjo ka qenë motoja e çdokujt, i cili ka hapur luftë ndaj më të dobët, më inferiorit, më të pazhvilluarit. Gjithsesi, pavarësisht nëse lufta ka pasur një kauzë të drejtë ose jo, pavarësisht se ajo ka vënë shpeshherë në vend të drejtat e mohuara, ajo asnjëherë nuk i ka realizuar këto pa sakrificë, pa të dëmtuar, pa humbur jetë. Sot, kur zhvillimi njerëzor ka arritur kulmin, falë kapaciteteve mendore mund të gjenden me mijëra mënyra për të zgjidhur konfliktet pa dëmtuar jetën.

Shtrohet me të drejtë pyetja: - A duhet të ketë luftë?!

Përgjigja është e thjeshtë: Jo.

Arsyeja është më se e kuptueshme: Në emër të asaj që është më e shtrenjta për këdo dhe kurdoherë, në emër të jetës njerëzore.

Vlerësimi i nxënësve:

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë mbi përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruani një kryeartikull për gazetën e shkollës dhe një spot publicitar për të.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Format e ligjërimit, gjuha argumentuese dhe ajo bindëse		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon format e ligjërimit, veçan gjuhën (diskursin) argumentuese dhe atë bindëse.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 4; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Eseja argumentuese			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon esenë argumentuese si lloj i tekstit argumentues; • Përcakton elementet e strukturës së esesë argumentuese; • Shkruan argumente në favor të tezës që mbron; • Shkruan një ese argumentuese. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • ese argumentuese • teknika të shkruar • tezë • kundërtezë • argument 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Dallon esenë argumentuese nga esetë e tjera; • Analizon elementet e strukturës së esesë argumentuese; • Sjell argumente të interpretuara nga një këndvështrim subjektiv; • Përgatit një ese argumentuese duke respektuar rregullat e drejtshkrimit. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve, modele tekstesh argumentuese, e-libri.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): letërsi, artet, histori, TIK, gjuhë e huaj, të drejtat e njeriut.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Hyrja: Mësuesi/ja e nis mësimin me leximin e detyrës së shtëpisë. Nxënësve u është kërkuar të shkruajnë një fjalim politik duke supozuar se aspirojnë për deputet. Lexohen disa nga detyrat, vëmendja përqendrohet tek elementet e fjalimit politik dhe më tej te struktura e tekstit argumentues.			
Realizimi i kuptimit: Në këtë fazë të mësimin vëmendja përqendrohet tek eseja argumentuese, teksti i dhënë në librin e nxënësit. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin dhe të përcaktojnë pse është një ese argumentuese. Është ese argumentuese sepse përcjell një opinion individual të mbështetur në argumente dhe fakte të interpretuara nga një këndvështrim subjektiv. Mësuesi/ja kërkon të analizojnë strukturën e një eseje argumentuese:			

- Problemin
- Tezën
- Argumentet
- Antitezën
- Argumentet në favor të saj
- Përfundimet

Eseja: Inteligjent lind apo bëhesh	
Problemi	Inteligjent lind apo bëhesh? Në të vërtetë kjo është një pyetje, së cilës nuk mund t'i përgjigjesh duke zgjedhur njërin apo tjetrën mundësi.
Teza	Në fakt, inteligjent lind dhe bëhesh.
Argumentet	Dhe kjo përzierje mes kulturës dhe kromozomeve mund të ndryshojë në bazë të përvojave personale (si mjedisore, ashtu dhe gjenetike).
Antiteza	Dihet se ka persona që kanë një talent të lindur më të theksuar se të tjerët (sepse kjo i takon një lloj strukture të veçantë të qarkut të tyre cerebral).
Argumentet në favor të saj	Fundja, e gjithë historia është e mbushur me njerëz gjenialë në çdo fushë, të cilët shquhen për aftësitë e tyre të lindura dhe jo nga një edukim veçanërisht i shkëlqyer (dihet se Ajnshtajni shkante keq në mësim...).
Rrëzimi i argumenteve në favor të saj	Kjo është e vërtetë jo vetëm për inteligjencën, por për të gjithë larminë e talenteve të tjera “brendashkruar” qarkut cerebral: muzikë, matematikë, gjuhë, pikturë etj.
Përfundimet	Ndërkohë dihet se askush nuk mund të merret me matematikë apo muzikë, të pikturojë ose edhe të flasë, nëse nuk i ka mësuar këto gjëra në mjedisin ku jeton.
	Mjedisi ka një rol shumë të rëndësishëm, sepse është në gjendje të zhvillojë (ose jo) prirjet individuale nga zeroja, deri në pafundësi.

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe, duke synuar praktikën e nxënësve në ndërtimin dhe shkrimin e argumenteve dhe i kërkon:

Grupit I: Shkruani disa argumente për të bindur prindërit tuaj t'ju regjistrojnë në një grup sportiv.

Grupit II: Shkruani disa argumente në favor të modës së tatuazheve dhe një tjetër kundër kësaj mode.

Grupit III: Shkruani dy argumente: njëri i përgjigjet pozitivisht e tjetri negativisht pyetjes: Është mirë të banosh në qytet?

Grupit IV: Jepni argumentet pro dhe kundër për përdorimin e telefonit celular në shkollën fillore.

Grupet prezantojnë punën e tyre para shokëve dhe vlerësojnë mënyrën e ndërtimit të argumenteve.

Reflektimi:

Në këtë fazë të mësimit mësuesi/ja u kërkon nxënësve të punojnë të pavarur mbi temën e esesë “Pse më pëlqen/nuk më pëlqen të lexoj?” Lexohen disa nga argumentet e sjella nga nxënësit. Nëse koha për zhvillimin e esesë nuk është e mjaftueshme, nxënësit mund ta përfundojnë esenë në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve:

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë mbi përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënësit.

Detyrat dhe puna e pavarur: /

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Format e ligjërimit, gjuha argumentuese dhe ajo bindëse		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon format e ligjërimit, veçan gjuhën (diskursin) argumentuese dhe atë bindëse.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 4; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Eseja argumentuese (2 orë)			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon esenë argumentuese; • Analizon elementet e strukturës së esesë argumentuese; • Dallon veçoritë gjuhësore të një eseje argumentuese; • Analizon paragrafët në një ese argumentuese; • Shkruan ese argumentuese duke u nisur nga disa argumente; • Redakton dhe rishikon esenë argumentuese. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • ese argumentuese • karakteristika një eseje argumentuese • struktura e një eseje argumentuese • lloje të esesë argumentuese 	
Kriteret e suksesit: Dallon esenë argumentuese nga esetë e tjera; Bën zërbërthimin e elementeve të strukturës së esesë argumentuese; Tregon për veçoritë e një eseje argumentuese; Dallon paragrafët argumentues të esesë; Jep disa argumente në ese; Respekton kulturën gjuhësore të shkrimit të esesë argumentuese.			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, lloje të ndryshme esesh paraqitëse krahasim-kontrasti në letërsi, shkumësa me ngjyra, tabela.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, të drejtat e njeriut, mjedisi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			

Sugjerime për mësuesin/en

Kjo temë synon t'iu shërbejë nxënësve të zhvillojnë aftësitë për të përdorur sa më mirë argumentimin në shkrimin e një eseje e për të mbajtur një qëndrim kritik ndaj dukurive të ndryshme. Për realizimin me sukses të këtij synimi, nxënësi do të gjejë në tekst shtjellimin e njohurive praktike nëpërmjet shembujve konkretë, si:

kujdesi në përzgjedhjen e temës,

mënyrat e organizimit të përmbajtjes së esesë, si gërshetimi i fakteve me argumentet, shembujt etj. ndërtimi strukturor i esesë;

ç. rruga për redaktimin e materialit dhe vëmendja për kulturën gjuhësore.


Tema do të zhvillohet në 2 orë, nga të cilat 1 orë do të përdoret për marrjen e njohurive teorike të gërshetuara me shembujt konkretë dhe do të zhvillohen ushtrimet që janë në tekst, 1 orë do të përdoret për të shkruar dhe korrigjuar një ese të shkurtër argumentuese. Për t'ua lehtësuar punën, në tekst ka tema që shoqërohen me argumentet që mund të përdorë nxënësi.

Ora I

Hyrja:

Shtrohet para nxënësve pyetja:

- Cili është qëllimi i esesë argumentuese?



Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit në leximin e vëmendshëm të esesë, duke koduar ato pjesë të tekstit që kanë të bëjnë me elementet përbërëse të përmbajtjes së esesë argumentuese.

Për t'i bërë sa më pjesëmarrës nxënësit në përfitim të njohurive teorike, mund t'ua kërkohet që, me anë të teknikës "Shkrimi argumentues-bindës", të vëzhgojnë mënyrën e ndërtimit të esesë model të dhënë në tekst. Nxënësit mund të ndahen në dy grupe. Leximi me kodim të imët i tekstit, i cili është pjesë e teknikës së shkrimit argumentues bindës, do t'ua shërbejë nxënësve për të vënë në dukje veçoritë e esesë argumentuese, të cilat nxënësit do t'i hetojnë në modelet e dhëna dhe do t'i ngulitin.

Kriteret për përzgjedhjen e temës:	<ul style="list-style-type: none"> - tema të jetë specifike dhe e ngushtë; - të përmbajë një argument të caktuar; - të gjenden statistika dhe materiale që e mbështesin këtë argument; - dhënia në fillim e argumenteve pro temës që trajton, për të kaluar më pas te trajtimi i argumenteve kundër dhe kundërshtimi i tyre.
-Mbrojtja e pikëpamjes nga ana e shkruarit:	<ul style="list-style-type: none"> - eseja mund të fillojë dhe me trajtimin e argumenteve kundër për të kaluar më pas te trajtimi i argumenteve të veçanta pro/ - të trajtohen një për një argumentet kundër.) - duke pranuar faktin se ky argument edhe mund të pranohet, por janë më të shumta argumentet që e hedhin atë poshtë (p.sh deri diku është e drejtë të thuhet se...) - duke e hedhur poshtë në mënyrë kategorike këtë argument (p.sh: siç duket nga argumentet që u sollën në këtë ese, nuk mund të biem dakord me ...)
- Kundërshtimi i tezës:	<ul style="list-style-type: none"> - duke e konsideruar argumentin të papërshtatshëm me temën që trajtohet). - Informacion i shumtë: shembujt, statistika; - Të mos ketë pohime të përgjithshme. - Burimet e informacionit të jenë të besueshëm.
Mbështetësit për argumentimin	

Struktura Pjesa hyrëse – Teza: Pse duhen studiuar ndryshimet e sotme kulturore, shoqërore dhe politike? Çfarë shmangin ato?	
Çështja	
Trungu – shtjellimi i argumenteve Argumentet pro	
Argumenti 1	
Argumenti 2 Informacion mbështetës	
Argumentet kundër Argumenti 1 Argumenti 2 Informacion mbështetës	
Përfundimi	

Reflektimi:

Nxënësit lexojnë shembullin e dhënë në libër dhe nxjerrin thelbin e informacionit nga eseja argumentuese e dhënë. Punohen ushtrimet 1 dhe 2 të tekstit (shih përgjigjet e dhëna në rubrikën “sugjerime mësuesit”). Gjithashtu, nxënësit të ndarë në dy grupe ushtrohen për të shkruar një ese argumentuese duke u mbështetur në kërkesën e ushtrimit 3 (Ushtroni për të shkruar ese argumentuese duke u nisur nga argumentet e mëposhtme).

Ora II

Hyrja:

Nga çdo grup mësuesi/ja mund të përzgjedhë e të lexojë një ese.

Çdo prezantues duhet të paraqesë përpara shokëve mënyrën e organizimit të esesë, të cilat kanë të bëjnë me mënyrat e ndryshme të hartimit të hyrjes, të trungut apo të paragrafëve mbështetës dhe të paragrafit përmbyllës, mënyrat e ndryshme se si janë përzgjedhur detajet për t'i bërë të qartë lexuesit këndvështrimin e autorit.

Nxënësit mund të ndërtojnë një Diagram Veni, ku të evidentojnë të përbashkëtat dhe të veçantat e eseve.

	Të përbashkëtat	Të veçantat
Përmbajtje/Në argument		
Në strukturë		

Redaktimi i eseve është një nga fazat e rëndësishme për të mësuar se si shkruhet çdo ese. Mësuesi/ja të kërkojë që në grup nxënësit të marrin dhe të redaktojnë një nga esetë e shokëve duke demonstruar më pas kriteret dhe rregullat që ndoqën gjatë redaktimit.

Redaktimi duhet të përqendrohet në:

- në zbatimin e strukturës së esesë;
- në argumentet bindëse që sillen;
- në pasurinë e fakteve dhe detajeve;
- në organizimin e paragrafëve, në mënyrë që të evidentohen sa më mirë çështja që argumentohet;
- në kulturën gjuhësore të shkrimit, si:
 - Gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore.
 - Përdorimi i saktë i shenjave të pikësimit të tilla, si: presja, pika etj.

Realizimi i kuptimit:

Përgjigje të ushtrimeve

Ushtrimi 1

- Titulli – Mbi sublimen
- Paragrafi I – me synim paraqitjen e krahasim-kontrastit, mbizotëron krahasimi dhe kontrasti: ...jo proza, por fakti ose shkenca. Njëra i drejtohet besimit, tjetra ndjenjave. Njëra punon nëpërmjet bindjes, tjetra nëpërmjet prekjes së ndjenjave...
- Paragrafi II – me synim shpjegimin e përkufizimit. Në këtë paragraf përkufizimi gërshetohet edhe me elemente të krahasim-kontrastit, që ndihmojnë përkufizimin. Elementet që e bëjnë të dukshme janë: ...këto mendime nuk janë të pamjaftueshme për ta përkufizuar poezinë. Ne e kemi dalluar nga diçka, por jemi të detyruar ta dallojmë nga gjithçka tjetër...por ka një dallim thelbësor midis interesit që zgjon një tregim, nga interesi që zgjon një poezi... të dyja burimet e interesimit u korrespondojnë dy karaktereve të veçanta...
- Paragrafi III – synimi të argumentojë: Këto dy lloje karakteresh bashkohen, ashtu si edhe karakteret më të palidhshme, por ato nuk kanë lidhje natyrore ... burimi i emocionit prej poezisë sjell krijimin e një gjendjeje ose të disa gjendjeve të ndjeshmërisë njerëzore... 5. Paragrafi i fundit ka si synim të vërë në dukje lidhjen shkak-pasojë: ...ai është poet jo sepse ka ide të ndonjë lloji të veçantë, por sepse rrjedha e ideve është pasojë e rrjedhës së emocioneve...

Ushtrimi 2

Teksti i përmbahet strukturës së esesë:

- Titulli: Me mënyra të ndryshme arrihet qëllimi i dëshiruar
- Paragrafi I
- Teza që ngre: Mënyra më e zakonshme për të zbutur zemrat e atyre që kemi fyer ...është të dish t'i mallëngjesh duke iu drejtuar përdëllimës e shpirtbutësisë së tyre.
- Paragrafi II
- Shembujt që sjell për ta mbështetur dhe argumentuar tezën: • Eduardi, princi i galëve, nuk ndalej prej thirrjes së popullit dhe të grave e fëmijëve ... për të ndalur kasaphanën... duke shkuar nëpër qytet, vuri re tre fisnikë frëng që me guxim të pabesueshëm i bënë ballë goditjes. Vlerësimi dhe nderimi për një virtut aq të shquar e zbuti kulmin e zemërimit ...ai tregoi mëshirë për banorët. • Skanderbeuku, princ i Epirit, iu qep pas një ushtari nga të vetët për ta vrarëmë në fund ai vendosi që ta priste fundin e tij me shpatë në dorë....
- E përbashkëta mes sjelljes së dy princërve lidhet me evidentimin e vlerave të tilla, si: forca, kuraja, besimi, guximi.
- Fjalia e fundit mund të lidhet me interpretime ose keqinterpretime mbi aftësitë e figurës së Skënderbeut.
- Eseja përbëhet nga argumente pro tezës që ngre.
- Përdor informacione nga burime të sigurta.
- Karakterizohet nga një gjuhë e pasur dhe fjali të gjata.

Reflektimi:

Në fund të orës mësimore, mësuesi/ja bën vlerësimin e nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.

Detyrat dhe puna e pavarur: /

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Veçoritë e funksionimit të niveleve gjuhësore		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon karakteristikat gjuhësore të akteve zyrtare të shkruara në kohë të ndryshme.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teksti udhëzues (2 orë)			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon lloje të teksteve udhëzuese (rregulloret, ligjet e nenet, udhëzuesit, recetat); • Përcakton karakteristika të teksteve udhëzuese; • Zbulon veçoritë gjuhësore e strukturore të teksteve udhëzuese; • Shkruan tekste të ndryshme udhëzuese. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • tekst udhëzues • rregullore • ligj • nen • recetë gatimi • rregulla • udhëzime 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Veçon llojet e teksteve udhëzuese nga llojet e teksteve të tjera; • Jep karakteristikat e teksteve udhëzuese; • Pasqyron veçoritë gjuhësore dhe strukturore të teksteve udhëzuese; • Përgatit tekste udhëzuese. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, teksti digjital, lloje të ndryshme tekstesh udhëzuese, shkumësa me ngjyra, tabela.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, të drejtat e njeriut, mjedisi.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Ora I

Hyrja:


Lexohen në klasë tekste udhëzuese: rregullore, ligj, nen, recetë gatimi.

Neni 84

1. Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.
2. Ligji quhet i shpallur, në qoftë se Presidenti i Republikës nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe në paragrafin 1 të nenit 85.
3. Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.
4. Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i

- 2.5 Kush arrin me vonesë pas orës së caktuar për fillimin e mësimit (në raste të rralla) mund të pranohet në klasë me miratimin e mesuesit kujdestar të klases.
- 2.6 Vonesat e shpeshta do t'u njoftohen familjeve dhe do të kenë masa disiplinore.
- 2.7 Gjatë kohës së mësimit duke përfshirë edhe pushimet asnjë nxënës nuk duhet të dalë nga shkolla pa leje të drejtorisë.
- 2.8 Shkolla nuk mban asnjë përgjegjësi për daljet pa leje.
- 2.9 Kërkesa për t'u larguar nga shkolla, përpara përfundimit të mësimeve, duhet të motivohet e t'i drejtohet mesuesit kujdestar.
- 2.10 Kërkesa për të dalë para përfundimit të mësimeve e kërkuar nga prindi dhe e pranuar nga mesuesi kujdestar i heq shkollës çdo përgjegjësi që nga momenti në të cilin nxënësi del nga shkolla.
- 2.11 Nga të gjithë kërkohet një qëndrim korrekt dhe i edukuar. Në mjediset e shkollës nuk lejohen zhurma, shprehjet e pahijshme, çrregullimet, lojrat e papërshtatshme dhe dëmtimet e bazës materiale të shkollës.

Sallatë me spinaq dhe luleshtrydhe



Luleshtrydhet janë një nga frutat që i përshfatan mrekullisht të gjitha gatimeve, si ato të kripura ashtu dhe të embra.

Përbërësit:

- 400gr luleshtrydhe
- 100gr spinaq me gjethë të vogla
- 50gr rukola ose sallatë jeshile
- 200gr djath i bardhë dhe ose dele
- 4 lugje vaj ulliri
- lengun e 1/2 limoni
- stika pishellarrabajamefajti
- kripe

Mësuesi/ja rikujton me nxënësit njohuritë e marra për tekstin udhëzues me anë të organizuesit grafik: teksti udhëzues jep udhëzime, dikton rregulla, tregon norma, për mënyrën se si duhet të sillemi në situata të caktuara;

marrësi i tekstit njeh autoritetin e dërguesit;

u përkasin disa prej stileve të ligjërimit, si: stilit tekniko-shkencor (udhëzuesit e përdorimit, recetat e gatimit, guidat turistike etj.) dhe stilit administrativ-juridik (rregulloret, ligjet, udhëzuesit etj.);

përdor leksikun e gjuhës së përditshme;

terminologjia e veçantë, sipas fushave përkatëse;

administrative, teknike, juridike;

forma joveprore e foljeve;

ndërtimi i tekstit sipas modeleve të përcaktuara;

renditja kohore e fakteve;

qartësia e informacionit;

fjali të qarta e të sakta, të shkurtra;

folje në mënyrën urdhërore, veta II;

përdoren ilustrime, foto, skica.

Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe, për të diskutuar mbi veçoritë e tyre.

Grupi I

analizon rregulloren:

Rregulla për udhëtimin me avion/ Rregullorja e Universitetit të Tiranës

Veçoritë	Ilustrime
Strukturë e veçantë (ndarje në kapituj, ligje, nene, rregulla me numër rendor)	
Rendi kronologjik i veprimeve	
Informacion i saktë dhe i qartë	
Fjali të shkurtra	
Leksik i stilit administrativ/gjuhës së përditshme	
Folje në mënyrën urdhërore/lidhore, (veta II shumës), forma joveprore e foljeve	

Grupi II

analizon tekstin ligjet nga Kushtetuta e Shqipërisë/Kanuni i Lekë Dukagjinit

Veçoritë	Ilustrime
Strukturë e veçantë (ndarje në kapituj, ligje, nene, rregulla me numër rendor)	
Rendi kronologjik i veprimeve	
Informacion i saktë dhe i qartë	
Fjali të shkurtra	
Leksik i stilit administrativ/gjuhës së përditshme	
Folje në mënyrën urdhërore/lidhore, (veta II shumës), forma joveprore e foljeve	

Grupi III

analizon udhëzuesit

Udhëzues në rast aksidenti

Veçoritë	Ilustrime
Strukturë e veçantë (pjesë sqaruese, pjesë këshilluese)	
Rendi kronologjik i veprimeve	
Informacion i saktë dhe i qartë	
Fjali të shkurtra	
Leksik i gjuhës së përditshme/ terminologjie fushës së mjekësisë	
Folje në mënyrën urdhërore/lidhore, (veta II shumës), forma joveprore e foljeve	

Grupi IV

analizon recetat e gatimit

Veçoritë	Ilustrime
Strukturë e veçantë (pjesë sqaruese, pjesë këshilluese)	
Renditje kohore e veprimeve	
Informacion i saktë dhe i qartë	
Fjali të shkurtra, fjali me pjesë të bashkërenditura, të lidhura me lidhëza etj.)	
Leksik i gjuhës së përditshme	
Folje në mënyrën urdhërore (veta I shumës), forma joveprore e foljeve,	

Reflektimi:

Diskutim mbi këto tekste.

Ora II

Hyrja:

Në orën e dytë të mësimit mësuesi/ja e përqendron vëmendjen e nxënësve në zbatimin e ushtrimeve të tekstit.

Ushtrimi 1.

Teksti që shkruhet për gazetën	Teksti që shkruhet për televizionin
Titulli kryesor është shumë i rëndësishëm; ai duhet të jetë i shkurtër; titulli duhet ta ndihmojë marrësin që të përzgjedhë informacionin.	Titujt vijnë përpara emrave.
Fjalja e dytë e një lajmi jep burimin e informacionit, nëse kjo është e rëndësishme, dhe rimerr mesazhin e titullit kryesor.	Mënjanohen shkurtime, edhe kur u referohen për herë të dytë.
Më pas jepen fakte të rëndësishme ose më pak të rëndësishme,	Mënjanohet ligjërata e drejtë.
duke i shtuar detajet kryesore	Përmendet burimi përpara citimit dhe jo pas tij.
ndërhyrje të shkurtra	Përdoren pak shenja pikësimi.
këndvështrime të ndryshme të protagonistëve	Personalizohen lajmet.

Jepet ngjarja; vendi, koha dhe arsyeja pse ka ndodhur ngjarja: protagonistët.	Mënjanohet përdorimi i përemrave.
Përhapja e informacioneve për një fakt të aktualitetit që i drejtohet një publiku të gjerë	Mënjanohet përdorimi i ndajshimeve.
Sintaksë e thjeshtë. Leksik i qartë, i përpiktë, i kuptueshëm për një masë të gjerë të publikut.	Përdoret koha e tashme.
Shkruhet në vetë të tretë, përdoren pyetje retorike dhe lloje të ndryshme fjalish për ta përfshirë emocionalisht lexuesin.	Mënjanohet hapja e lajmit me një fjali të varur.

Realizimi i kuptimit:

Nxënësit të ndarë në grupe punojnë ushtrimet e librit të nxënësit për të shkruar një nga llojet e teksteve udhëzuese. Nxënësit lexojnë tekstet e shkruara dhe diskutojnë mbi mënyrën e ndërtimit të tyre.

Reflektimi:

Diskutim i lirë.

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruani një tekst udhëzues.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Veçoritë e funksionimit të niveleve gjuhësore		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon karakteristikat gjuhësore të akteve zyrtare të shkruara në kohë të ndryshme.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Procesverbali			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon procesverbalin; • Identifikon procesverbalin; • Analizon strukturën e procesverbalit; • Harton procesverbalin. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • procesverbal • hyrje • zhvillim • përfundim 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon se çështë procesverbali; • Dallon procesverbalin nga llojet e ndryshme të teksteve; • Di ta bëjë analizën e strukturës së procesverbalit; • Përgatit procesverbalin sipas rregullave të tekstit informues. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, modele të procesverbalit, lloje të ndryshme tekstesh udhëzuese, shkumësa me ngjyra, tabela.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, të drejtat e njeriut, mjedisi.			


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Hyrja:

Jepet përkufizimi për procesverbalin.

Procesverbali është një tekst informues-paraqitës sintetik, i hartuar për të dëshmuar për fakte, deklarata, mendime dhe opinione që shfaqen në një mbledhje, në një gjyq, në një ngjarje, në një proces pune etj. Këto të dhëna të sakta mund të shërbejnë më pas si dëshmi për të ndërtuar argumente që mund të jenë objekt i një diskutimi, i një vlerësimi etj.

Në tabelën e klasës bëhet skema bazë e procesverbalit. Diskutohet në strukturën e tij.



Realizimi i kuptimit:

Për ta pasur më të qartë mënyrën se si hartohet një procesverbal, mësuesi/ja ose një nxënës që lexon rrjedhshëm lexon procesverbalin e një mbledhjeje të senatit të një shkolle të mesme të paraqitur në tekstin bazë dhe të tjerët e përcjellin tekstin dhe më pas komentojnë për të.

Analizojnë strukturën e procesverbalit të mbajtur nga Gjergj Qiriazhi për Kongresin e Manastirit (14–22 nëntor 1908).

Reflektimi:

Imagjinoni sikur në familjen tuaj mbahet një mbledhje “zyrtare” me rendin e ditës si më poshtë. Hartoni procesverbalin.

- Të blihet apo jo një televizor tjetër?
- Të lyhet apo jo shtëpia?
- Të lejohen apo jo fëmijët të mbajnë secili çelësat e shtëpisë?

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses, me gojë ose me shkrim.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Punohen ushtrimet 2, 3 dhe 5.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Veçoritë e funksionimit të niveleve gjuhësore		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon karakteristikat gjuhësore të akteve zyrtare të shkruara në kohë të ndryshme.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Stili administrativo-juridik			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon funksionin e teksteve të stilit administrativo-juridik; • Shpjegon kategoritë e këtyre teksteve; • Ndërton një tekst të stilit administrativo-juridik; • Specifikon disa nga veçoritë gjuhësore të stilit. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • stil • ndërtim i teksteve • gjuhë standarde • leksik 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Sqaron për funksionin e tekstit të stilit administrativo-juridik; • Reflekton mbi kategoritë e teksteve të këtij stili; • Shkruan një tekst të stilit administrativo-juridik; • Përmend disa veçori gjuhësore. 			

Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, modele të stilit administrativo-juridik, lloje të ndryshme tekstesh udhëzuese.

Përdorimi i TIK-ut: Po.

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, të drejtat e njeriut, mjedisi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Hyrja:

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që ta analizojnë leksikun në tekstin e mëposhtëm. Sugjerohet që ata t'i nënvizojnë foljet dhe ta dallojnë mënyrën dhe kohën e tyre.

Neni 13 Aftësia juridike

1. Aftësia juridike e personit fizik fitohet në momentin e lindjes, me kusht që të lind i gjallë.
2. Fëmija kur lind i gjallë gëzon aftësinë juridike që nga koha e zënies.
3. Aftësia juridike e personit fizik përfundon me vdekjen e tij.

Neni 14 E drejta në emër

1. Çdo person fizik e gëzon të drejtën në emër sipas dispozitave ligjore.
2. Kontestimi i emrit dhe çështjet tjera rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 15 Moshë madhore

1. Moshë madhore fitohet me arritjen e moshës 18-vjeçare.

Realizimi i kuptimit:

Për të kuptuar më shumë rreth stilit administrativo-juridik, nxënësit lexojnë mësimin për sferën e stilit, ndërtimin e teksteve, leksikun dhe veçoritë gjuhësore të stilit.

Bëhen analiza të teksteve. Punohen ushtrimet 1, 2 dhe 3.

Reflektimi:

Plotësohet formulari i mëposhtëm. Analizohen karakteristikat e stilit.

 REPUBLIKA E KOSOVËS	0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë		
	Drejtoria / Njësia	Data <small>(dita / muaj / vit)</small>	

1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:		Mos shkruani në këtë pjesë Pranuar nga: Numri i protokollit: Vendim: po jo Nga: Data:
Emri dhe mbiemri	Liqi dhe numri i dokumentit identifikues	
Data e lindjes <small>(dita / muaj / vit)</small>	Adresa e vendbanimit <small>(numri i shtëpisë/banesës, rruge, fshat/rijet, kod postar)</small>	
Numri i tel. fiks	Numri i tel. mobil	
E-mail adresa		

2 Selektu llojin:

Kërkesë Ankesë

3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë _____ vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta. _____ (Mëshkrimi)

(Emri i plotë i aplikuesit)

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni: Ndahuni në katër grupe. Secili grup të gjejë një tekst sipas llojeve të teksteve të këtij stili dhe të analizojë veçoritë e tij.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Nga fjalia e thjeshtë tek ajo e përbërë		Rezultati i të nxënësve të temës: Zhvillon shkathtësitë e zhvillimit të fjalisë së thjeshtë në fjali të përbërë dhe në paragraf.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalia e thjeshtë dhe fjalia e përbërë			
Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Klasifikon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra; • Bën tabelën e klasifikimit të fjalive të thjeshta dhe të përbëra; • Përcakton tiparet e përbashkëta dhe dallimet e secilit lloj fjalie; • Identifikon raportet e barazisë dhe të pabarazisë në fjalitë e thjeshta dhe të përbëra. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • fjali e thjeshtë • fjali e përbërë • raport barazie • raport varësie 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbërë; • Grupon në tabelë fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra; • Paraqet tiparet dhe dallimet në disa lloje fjalish; • Tregon kur kemi raporte të barazisë dhe të pabarazisë. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, përvoja të nxënësve, shkumësa me ngjyra, fletë formati A4, skeda.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): histori, letërsi, qytetari.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Ora I

Hyrja:

Kontrollohen e diskutohen detyrat e shtëpisë. Mësuesi/ja organizon mësimin me pyetje nga mësimet e kaluara për të nxitur diskutimin në klasë, duke pyetur:

- Çështë fjalë e thjeshtë?
- Çështë fjalë e përbërë?
- Cilat janë veçoritë e fjalëve të thjeshta?
- Cilat janë veçoritë e fjalëve të përbëra?
- Në cilat raste vendosen marrëdhënie barazie ndërmjet fjalëve?
- Në cilat raste vendosen marrëdhënie varësie ndërmjet fjalëve?
- Ilustroni me shembuj secilin lloj fjalie.

Nxënësit ndahen në çifte dhe midis tyre diskutohet pjesa e lexuar në tekst. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të ndajnë fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra. Duke përcaktuar secilin lloj, nxënësve u kërkohet që të bëjnë klasifikimin e tyre. Ngrihen nxënës në tabelë dhe në gjysmën e ndarjes së tabelës shkruhen fjalitë e thjeshta, ndërsa në ndarjen tjetër fjalitë e përbëra.

Në dërrasën e zezë shkruhet pyetja:
Cilat janë disa karakteristika të fjalëve të thjeshta?

Disa karakteristika të fjalëve të thjeshta janë:

- Fjalitë e thjeshta kanë kuptim relativisht të plotë.
- Fjalitë e thjeshta kanë intonacion të mbaruar.
- Edhe pse mund t'u mungojë një gjymtyrë kryesore, fjalë ka kuptim.
- Struktura e saj mund të jetë me të dyja gjymtyrët kryesore ose vetëm me një të tillë.

Më pas pyetja e radhës është:

Cilat janë disa karakteristika të fjalëve të përbëra?

Disa karakteristika të fjalëve të përbëra janë:

- Fjalitë e përbëra përbëhen nga njësi kallëzuesore, që i quajmë pjesë fjalie, të cilat përgjithësisht nuk kanë kuptim të plotë.
- Pjesët e fjalisë nuk kanë intonacion të plotë të mbaruar, nëse nuk përdoren si një fjali e plotë.
- Pjesët e varura plotësojnë gjymtyrën që mungon në pjesën kryesore.
- Fjalë e përbërë mund të jetë me dy a më shumë pjesë, të zgjeruara ose të pazgjeruara.

Për sa u përket marrëdhënieve kuptimore dhe sintaksore të fjalitë e thjeshta kemi raporte barazie kur gjymtyrët e fjalisë qëndrojnë në të njëjtin rrafsh, pra të gjymtyrët homogjene.

Ndërsa të fjalitë e përbëra kemi raporte barazie:

- mes pjesësh të pavarura me bashkërenditje;
- mes pjesësh kryesore të bashkërenditura, prej të cilave varet një pjesë tjetër;
- mes pjesësh të varura të të njëjtit lloj të bashkërenditura me njëra-tjetrën, që varen nga e njëjta pjesë kryesore;
- mes pjesësh të lidhura pa lidhëza e fjalë lidhëse.

Raportet e pabarazisë vendosen kur gjymtyrët qëndrojnë në rrafshje varësie prej njëra-tjetrës.

Te fjalitë e thjeshta ndodhin kur gjymtyrët plotësohen prej njëra-tjetrës.

Te fjalitë e përbëra raporte pabarazie kemi kur ndeshim një pjesë kryesore dhe pjesë të varura prej saj.

Ato shprehen me fjalë lidhëse, ose me lidhëza nënrenditëse.

Të gjitha rregullat ilustrohen me shembuj.

Realizimi i kuptimit:

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës, mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve në mënyrë të pavarur. Jepen për t'u punuar ushtrimet. Shembuj zgjidhjesh.

Ushtrimi 1

Klasifikoni fjalitë e mëposhtme në fjali të thjeshta dhe të përbëra. Thoni veçoritë e secilës.

Shkrimet e para për ekzistencën e Tetovës si vendbanim datojnë nga periudha antike, me emrin antik Enea. (fjali e thjeshtë) Sipas disa të dhënave, të cilat disponojmë, fusha e Pollogut dikur ka qenë liqen. (fjali e përbërë)

Këto të dhëna mbështeten në shenjat e zbuluara në Balltepe, ku gjendet rrafshnalta me shkëmbinj të liqenit me lartësi mbidetare prej 770 m. (fjali e përbërë) Sipas të dhënave turke të dokumentuara, Tetova në shekullin XIV është trajtuar si fshat në fushën e Pollogut. (fjali e thjeshtë) Në vitin 1689 Tetova emërohet si qytet. (fjali e thjeshtë)

Në Tetovë ka edhe kisha, të cilat në varësi nga periudha kohore që u takojnë, kanë edhe vlerat e tyre të veçanta historike. (fjali e përbërë) Një zhvillim intensiv i Tetovës ndodh në pjesën dytë të shek. XIX deri të luftërat ballkanike, kur Tetova bëhet qendër tregtare dhe zejtare. (fjali e përbërë)

Ushtrimi 2

Gjeni dhe krahasoni fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra, duke u bazuar në veçoritë e përbashkëta dhe dallimet mes tyre.

Zyrtarisht, ndeshja nuk do të luhet sonte. (fjali e thjeshtë)

Ndeshja do të rifillojë nesër, në orën 14:00, ku do të luhen minutat e mbetura të ndeshjes. (fjali e përbërë)

Pritet vendimi i gjyqtarit, që të caktohet ora e ndeshjes ditën e nesërme. (fjali e përbërë) Stadiumi është boshatisur dhe një pjesë e tifozëve janë në tribunën kryesore, e cila është e mbuluar. (fjali e përbërë)

Ndeshja u ndërpre në minutën e 77-të, për shkak të shirave të dendura. (fjali e thjeshtë)
Deri në këtë minutë, ndeshja ishte me rezultatin 1-1. (fjali e thjeshtë)
Goli i parë u shënua në minutën e nëntë, kurse goli i barazimit u shënua në minutën e 51-të.
(fjali e përbërë)

Gjatë pjesës së dytë, Shqipëria bëri dy zëvendësime. (fjali e thjeshtë)
Në minutën e 32-të, një gol për skuadrën shqiptare u anulua nga gjyqtari për pozicionin jashtë loje. (fjali e thjeshtë)
Ishte rasti më i mirë për Shqipërinë që të dyfishonte rezultatin. (fjali e përbërë)
Urojmë që minutat e mbetura që do të luhen nesër, të jenë me fat për ne. (fjali e përbërë)

Ushtrimi 3. Përcaktoni nëse gjymtyrët në fjalitë e thjeshta dhe pjesët në fjalitë e përbëra janë në marrëdhënie barazie apo pabarazie.

Një prej dënimeve për refuzimin e pjesëmarrjes në politikë, është se përfundon të qeverisë nga inferiorët. Ky qytet është ai që është, sepse qytetarët tanë janë ata që janë.

Vlera e një njeriu është ajo që bën kur ka pushtet.

Mund të zbulosh më shumë për atë person në një orë loje se në një vit bisedash. Tregohu i mirë, sepse kushdo që takon, po përballlet me një betejë të vështirë.

Kurrë mos e shkurajo dikë që bën përparime të vazhdueshme, sado të ngadalta qofshin. Që një njeri të arrijë të zotërojë vetveten, është nga fitoret më fisnike dhe më parësore. Çdo njeri mund t'i bëjë dëm fare lehtë tjetrit, por jo çdo njeri mund t'i bëjë mirë tjetrit.

Një hero lind mes qindrave, një i mençur mund të gjendet mes mijërave, por një njeri i vetërealizuar mund të mos gjendet as mes qindra-mijë njerëzve.

Ushtrimi 4. Analizoni kallëzuesit foljorë në fjalitë e thjeshta dhe në fjalitë e përbëra.

- Për të treguar se të udhëtuarit është një çelës për të hyrë në shtëpinë e lumturisë, ka ndërhyrë (kallëzues foljor, i shprehur me folje, mënyra dëftore, koha e kryer) edhe shkenca...

- Ka nga ata që udhëtojnë shpesh, sepse e kanë të shkruar në ADN.

(Kallëzues të thjeshtë foljorë, të shprehur me folje në kohën e tashme, mënyra dëftore.)

- Sipas një studimi të fundit, dëshira për të udhëtuar është e lidhur me kuriozitetin dhe rregullon nivelin e dopaminës në tru, duke e bërë kështu njeriun më entuziast sa herë që shkon në një udhëtim.

(Kallëzues të thjeshtë foljorë, të shprehur me folje në kohën e tashme, mënyra dëftore.)

- Sipas studiuesve, në botë, këtë tipar e kanë 2 në 20 njerëz.

(Kallëzues i thjeshtë foljor, i shprehur me folje në kohën e tashme, mënyra dëftore.)

- Lexoni (kallëzues i thjeshtë foljor) ca arsye të tjera pse duhet të udhëtoni

(kallëzues i përbërë foljor).

- Të jesh (kallëzues i thjeshtë foljor) në kontakt me banorët e një vendi të huaj, të njohësh (kallëzues i thjeshtë foljor) kulturën, zakonet e tyre vë (kallëzues i thjeshtë foljor) në lëvizje atë që shkencëtarët e quajnë (kallëzues i thjeshtë foljor) "fleksibiliteti njohës".

- Sa më shumë vende të vizitosh e sa më shumë njerëz të njohësh, bindesh se në botë nuk janë të gjithë të këqij, ka njerëz të mirë për të zbuluar, prandaj udhëtimi ndihmon (kallëzues të thjeshtë foljorë).

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Pasi bëhen vlerësimet për nxënësit, mësuesi/ja jep detyrën e shtëpisë: kërkoni.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Folja, marrëdhëniet sintaksore dhe vlerat modale e kohore të foljeve		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon vlerat modale dhe kohore të foljeve përbrenda ligjërit	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përshtatja e kallëzuesit foljor me kryefjalën			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon se me kë përshtatet kallëzuesi foljor; • Dallon kallëzuesit foljorë (të thjeshtë dhe të përbërë); • Gjen kallëzuesit dhe bën analizën morfologjike të foljeve. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • kallëzues foljor • kryefjalë • folje 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon se kallëzuesi foljor përshtatet me kryefjalën; • Specifikon kallëzuesin foljor të thjeshtë nga ai i përbërë; • Nënvizon kallëzuesit dhe analizon foljet. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, libra të ndryshëm, interneti.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): /			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Hyrja: Ora mësimore nis me diskutimin për argumentet që sillen më poshtë në lidhje me leximin. Nxënësit sjellin argumentet e tyre për temën e dhënë në tekstin e paraqitur.			

Çdo herë që hapim një libër, ne kujdesemi për veten tonë. Këtë e thonë ekspertët që të biblioterapia shohin një kurë që është në gjendje të kurojë çdo shqetësim që ka lidhje me humurin. Mes faqeve të një libri gjenden raste të panumërta për të reflektuar mbi veten. Por të lexosh është e dobishme edhe për të zhvilluar aftësitë empatike, për të jetuar më mirë, për të kuptuar me më shumë lehtësi personat që na rrethojnë. Të lexuarit u bën mirë të rriturve dhe akoma më shumë u bën mirë të vegjëleve: identifikimi me personazhet e një historie të caktuar i ndihmon ata të zbulojnë anë të fshehura të karakterit. Ka disa libra që mund të jenë më efikasë se të tjerët: librat me përfundime të hapura, me shumë zhvillime psikologjike të karaktereve, që na shërbejnë për të bërë gjimnastikën e mendjes dhe për të zhvilluar kapacitetin tonë. Të lexuarit na ndihmon të kuptojmë më mirë të tjerët dhe veten tonë. Pra, të lexosh është një investim i mirë për shëndetin. Lexuesit më të etur janë në gjendje të kenë empati më të madhe me personat e tjerë. Një studim i universitetit të Sussex-it në Britaninë e Madhe ka treguar që për të ulur nivelin e stresit, mënyra më e mirë është leximi. Në faqet e një libri mund të gjejmë edhe kurajën për t'u përballur me problemet e jetës. Të lexosh historinë e dikujt që ka tejkaluar vështirësi të ngjashme me të vetat, e ndihmon lexuesin të ketë një motivim më të madh për të arritur qëllimet dhe objektivat e tij në jetë. Kush lexon, nuk ka frikë të qëndrojë vetëm; di të dëgjojë dhe ka një kujtesë të madhe për detajet.

Realizimi i kuptimit:

Lexohet paraprakisht mësimi për përshtatjen e kallëzuesit foljor me kryefjalën, për të vazhduar tutje me punimin e ushtrimeve 1, 2, 3 dhe 4.

Reflektimi:

Diskutohet rreth ushtrimeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykitimit të mësuesit/mësueses, me shkrim ose me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Gjeni tekste të shkurtra në libra ose në internet për traditat e arbëreshëve të Italisë dhe analizoni kallëzuesit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Folja, marrëdhëniet sintaksore dhe vlerat modale e kohore të foljeve		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon vlerat modale dhe kohore të foljeve përbrenda ligjëritimit	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kallëzuesi i përbërë foljor			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Shpjegon se prej kujt përbëhet kallëzuesi i përbërë foljor; Nënvizon kallëzuesit e thjeshtë dhe ata të përbërë; Shpjegon si janë formuar kallëzuesit.		Fjalët kyç: - kallëzuesi i përbërë foljor - foljet - formë e pashtjelluar	
Kriteret e suksesit: Tregon se kallëzuesi i përbërë foljor përbëhet nga dy fjalë kuptimplota; Lexon një tekst dhe thekson kallëzuesin e përbërë foljor; Sqaron si formohen kallëzuesit.			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, libra të ndryshëm.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): histori, letërsi, qytetari.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<p>Hyrja: Nxënësit nënvizojnë kallëzuesit e përbërë foljorë në tekstin e mëposhtëm.</p> <p>Më poshtë po rendisim disa gjëra të rëndësishme, prej të cilave mund të mësoni si ta jetoni jetën më mirë. Sikurse thuhet, askush s'mund të kthehet pas në kohë dhe të ketë një fillim të ri, por cilido mund të fillojë sot dhe garantojë një fund të ri.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Koha nuk duhet kaluar me njerëz të gabuar. Jeta është shumë e shkurtër, për të kaluar kohën me njerëz që iu heqin mundësinë për të qenë të lumtur. Duhet të mbani mend mirë se miqtë tuaj më të mirë janë ata që qëndrojnë pranë jush në ditët më të vështira. - Filloni të përballemi me problemet tuaja. Sfidat në jetë vijnë duke u shtuar, por ne duhet të mësojmë prej tyre, të përshtatemi, dhe t'i zgjidhim ato. 			

- Nuk duhet të fiksoheni pas së shkuarës. Ne nuk mund të nisim kapitullin e ardhshëm të jetës suaj, në rast se vazhdojmë të rilexojmë kapitullin e shkuar.
- Pushoni së kërkuari lumturinë të tjerët! Nëse nuk jeni të kënaqur me atë që keni brenda vetes, s'do të jeni të lumtur në një marrëdhënie me askënd tjetër. Duhet të ndërtoni një stabilitet në jetën tuaj, para se të mund ta ndani këtë të fundit me dikë tjetër.

Realizimi i kuptimit:

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës, mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve në mënyrë të pavarur. Jepen për t'u punuar ushtrimet 1, 2 dhe 3.

Reflektimi: Diskutohet rreth ushtrimeve të dhëna.
Vlerësimi i nxënësve: Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.
Detyrat dhe puna e pavarur: Punohet ushtrimi 4.
Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Figurat e stilit; (zëvendësimi; kundërvënia; insistimi, zmadhimi/zvogëlimi, analogjia)		Rezultati i të nxënësve të temës: Identifikon dhe përdor figurat e stilit. Dallon aspektin stilistik të shqipes; sekuenca, stili, diskutet; gjuha kritike dhe ajo kreative.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Metonimia, antiteza, hiperbola, litota			

<p>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon figurën stilistike; • Përkufizon figurat e fjalës dhe të kuptimit; • Gjen figurat e stilit. 	<p>Fjalët kyç:</p> <ul style="list-style-type: none"> • figurë e stilit • figurë e fjalës • figurë e kuptimit
<p>Kriteret e suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon se çështë figura stilistike; • Tregon se çfarë është figura e fjalës dhe çfarë ajo e kuptimit; • Përdor figurat e stilit. 	
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, libra të ndryshëm, interneti.</p>	
<p>Përdorimi i TIK-ut: Po.</p>	
<p>Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): letërsi.</p>	
<p align="center">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</p>	
<p>Hyrja: Mësuesi/ja pyet nxënësit: 1. Çështë figura stilistike? 2. Cilat janë disa nga figurat stilistike?</p> <p>Realizimi i kuptimit: Për t’u kuptuar më mirë mësimi, nxënësit përqendrohen te secila figurë veç e veç. Nxënësit duhet të lexojnë dhe të mësojnë për këto figura stilistike: metoniminë, antitezën, përsëritjet, hiperbolën dhe litotën. Mësuesi/ja shpjegon dhe sqaron.</p> <p>Reflektimi: Punohen ushtrimet 1, 2 dhe 3.</p>	
<p>Vlerësimi i nxënësve: Sipas gjyqimit të mësuesit/mësueses.</p>	
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Kërkoni në internet më shumë të dhëna për figurat e stilit.</p>	
<p>Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:</p>	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalët dhe raportet e tyre; (sinonimet dhe antonimet)		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon raportet leksikologjike të identitetit dhe të kundërvënies së fjalëve. Shpjegon vlerën emocionale të fjalëve në një një fushë leksikore.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Sinonimet në gjuhën shqipe			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Zgjeron njohuritë për sinonimet; • Përcakton si klasifikohen sinonimet; • Gjen sinonimet në krijime të ndryshme. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • sinonime • klasifikim • antitezë 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Rikujton njohuritë e marra për sinonimet; • Tregon si dallohen sinonimet; • Përdor drejt sinonimet në krijime të ndryshme. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe”, fjalorë, tekste të ndryshme.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): artet, letërsi.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Hyrja:

Bëhet një përmbledhje e orës së kaluar mësimore dhe nxënësve u parashtrohen pyetjet:

Sa keni mësuar më parë për sinonimet?

Ç'janë sinonimet?

Pse përdoren?

Si formohen ato?

Menjëherë pasi nxënësit t'i japin përgjigjet e tyre për pyetjet e dhëna, mësuesi/ja ua rikujton përkufizimin e sinonimeve dhe u tregon po ashtu se nga vjen fjala "sinonim".

Sinonimet janë fjalë të ndryshme me kuptim të njëjtë apo të përafërt. Fjala "sinonim" vjen nga greqishtja e vjetër: syn (bashkë) + onoma (emër).

Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që ta lexojnë tekstin e dhënë dhe më pas të punojnë me tekstin.

- **Zëvendësoni fjalët me të pjerrëta me sinonimet e tyre. Vini re ndryshimet që pëson teksti.**

Një buçimë e thellë, e fortë, po e thatë, pa shkrepetimë, pështolli *fushën* si nën ndonjë krah *luvgjie*. Troktharaku hoqi kapuçin e gunës që të dëgjonte më mirë, ndërsa Leksi kthente kokën andej-këtej për të parë ku u pat zbrazur vetëtima: në pyllin Mbret apo në grykën e veshur të Semanit. Pasi nuk kuptoi gjë, ktheu kokën e ia nguli sytë fytyrës *qull* të bariut. Sytë e çobanit, që vështronin nga deti, sa vinin e hapeshin, siç hapej nëpër fushë dhe *uturima* e fortë.

- O zot, ç'është kjo kështu: Po ngjitet lumi andej nga zbret!... u tmerrua bariu nga Griza.

Leksi, si pa që nga të gjitha anët ujët shtonte, shtyu Ndonin drejt kopesë, duke i bërtitur:

- Hipi *kërres* plakë dhe vër pelat përpara, drejt Lumit të Vdekur... Unë po mbledh lopët e po marr pak më lart... Po bridh të hedhësh vahun e Rosave sa pa ardhur vala.

Sa të qëndrojë e të mendohet robi, lumi që s'ka mend, ia kaloi...

Jakov Xoxa, *Lumi i vdekur*

Nxënësit i shkruajnë në fletore fjalët më të pjerrëta. Me radhë ata dalin dhe i shkruajnë në tabelë sinonimet e tyre dhe diskutohet për to. Pasi t'i zëvendësojnë fjalët, nxënësit duhet ta lexojnë tekstin për sinonimet në gjuhën shqipe. Kur të lexojnë për sinonimet, ata do të shpjegojnë se përse përdoren, si krijohen dhe si dallohen ato.

Reflektimi:

Në klasë, nxënësit duhet t'i punojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3.

1. Gjeni dhe nënvizoni sinonimet në çiftet e mëposhtme.

mbikalim – nënkallim, i thartë – i athët, gjëmon (ndjek dikë) – gjëmon (moti), keq – mjaftueshëm – mirë, çuditëm – mahnitem, i qetë – i trazuar, gaz (gjendje e trupave) – gaz (gëzim), krah (gjymtyrë) – krah (i rrugës), drejt – shtrembër – mirë, shkurt (muaj) – shkurt (ndajfolje), shapkë (pantofël) – shapkë (shpend uji), gazetë – e përditshme.

2. Gjeni në fjalitë e mëposhtme sinonimet e fjalës *i athët*.

1. Edlira, sapo e provoi pijen, tha: "Obobobo, sa thartanik qenka!" 2. Tërë atë pasdreke folëm dhe mendimi i të gjithëve ishte i pakëndshëm për të, aq sa nuk e di si vazhdoja ta mbështetja. 3. I sivjetshmi ishte një dimër zemërak, si rrallëherë më parë. 4. Sipas tij, njeriu i politikës duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të mos qenë idhnak si disa politikanë të deritashëm. 5. Limoni vazhdon të jetë një frutë jo shumë e pëlqyer për t'u ngrënë, ngaqë është shumë e thartë e kjo ndodh, sepse përmban acid citrik.

3. Dalloni sinonimet me kuptim të afërt në dyshet e mëposhtme dhe shpjegoni pse.

kokë – krye, shmang – evitohet, djalë – çun, tryezë – tavolinë, rrugë – udhë, vështroj – shikoj, hetoj – hulumtoj, qumësht – tamël, xham – gastare, fqinj – gjithon, tjegull – qeramidhe, ftoj – grish, shkoj – iki.

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Punohen ushtrimet 4 dhe 5.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalët dhe raportet e tyre; (sinonimet dhe antonimet)		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon raportet leksikologjike të identitetit dhe të kundërvënies së fjalëve. Shpjegon vlerën emocionale të fjalëve në një një fushë leksikore.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Antonimet në gjuhën shqipe			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Zgjeron njohuritë për antonimet; • Përcakton si klasifikohen antonimet; • Gjen antonimet në krijime të ndryshme. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • antonime • klasifikim • antitezë 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Rikujton njohuritë e marra për antonimet; • Tregon si dallohen antonimet; • Përdor si duhet antonimet në krijime të ndryshme. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe”, fjalorë, tekste të ndryshme.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): artet, letërsi.			


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Hyrja:

Kontrollohen e diskutohen detyrat e shtëpisë. Organizohet ora e mësimi me pyetje nga mësimi paraardhës

- Ç'janë sinonimet?
- Pse përdoren ato?
- Si formohen çiftet apo vargjet sinonimike?
- Ilustroni me shembuj.

Mësuesi/ja vijon në mënyrë të natyrshme me mësimin e ri, pasi janë diskutuar se si formohen sinonimet. Duke rikujtuar njohuritë e marra për antonimet, tërhiqet vëmendja e nxënësve, duke punuar me anë të metodës "Organizuesi grafik". Shkruhet tema e mësimi në tabelë dhe plotësohet organizuesi grafik me informacionet e marra deri tani, si dhe me informacione të reja.



Për të përforcuar më tej njohuritë mbi antonimet, mund të përdoret metoda e rrjetit të diskutimit, duke vendosur në qendër një pyetje dhe nxënësit argumentojnë pro ose kundër. Për këtë mund të përdoret një tabelë e shkruar dhe nxënësit paraqesin argumentet e tyre përbri tabelës.

Shtrohet pyetja:

PO	A ndahen antonimet në të plota?	JO
PO	A ndahen antonimet në kontekstore?	JO

Nxënësit shkruajnë argumentet e tyre pro dhe kundër, duke arritur në përfundimin se antonimet janë fjalë të ndryshme me kuptime të kundërta. Termi antonim vjen nga greqishtja e vjetër: anti (kundër) + onoma (emër). Ato ndahen për nga ndërtimi në:

- antonime fjalësh të ndryshme, kur janë fjalë pa lidhje prejardhjeje fjalëformuese, p.sh: i ëmbël – i hidhur, hap – mbyll, marr – jap etj.
- antonime të formuara me prejardhje, kur fjalët antonimike formohen me parashtesa me kuptim të kundërt, si: anti-, ç-/ sh-, / zh-/ s-/ z-, kundër-, mos-. P.sh.: lodhem – çlodhem, i aftë – i paaftë, kamje – skamje etj.

Realizimi i kuptimit:

Punohen ushtrimet.

Shembuj përgjigjesh**Ushtrimi 1**

keq – mjaftueshëm – mirë, shami – pecetë, i sjellshëm – i pasjellshëm, krah (pjesë e trupit) – krah (i shpendëve), bukuri – shëmti, shqiptar – arbëror, plumb (metal) – plumb (i pushkës), mund (emër) – mund (folje), nëntokë – mbitokë, tregtar – bakall, togë (njësi ushtarake) – togë (veshje e romakëve).

Ushtrimi 2

- Ftohtë, ngrohtë, ne do të nisemi herët nesër në mëngjes.
- Shkurt, gjatë, kësaj bisede duhet t'i jepet drejtim.
- Ngrin, shkrin situata, ne do të marrim masa.
- Mirë, keq, ne nuk kemi zgjidhje tjetër.
- I bukur, i shëmtuar, unë do të martohem me të.
- Sot ose nesër do të kemi një zgjidhje.
- I mirë, i keq ai ka qenë gjithnjë pranë nesh.

Ushtrimi 3

- E zymtë, e vranët, sterrë në fytyrë, perëndonte nata e së kaluarës; e kthjellët, e qeshur, e shpresëdhënëse, agonte dita e së ardhmes.
- Në fillim galat u trembën dhe u ngritën me krokërima, por pas pak u doli frika dhe zbritën prapë.
- Domo do, kishin edhe dasma, të hyra e të dala, që donin shumë miell për bukë.
- U lëkunda sa u lëkunda midis gjumit e pagjumit në përrallën e atyre tri çupave të mullixhiut.
- U gëzua gjithë miqësia, afër e larg.
- Ç'të keqe mund të na bëjë kjo vashë e nusëruar po e pamartuar?
- Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, gjyshja ndërroi prapë fletën.
- E shponin në zemër, si turjelë, gozhdët e opingave të Gjatollinjve, që shkonin e vinin aty, mbi udhë, me armët e Sefedinit në sup.
- Kështu tërë ditën, ngjit e zbrit, qëkur lindte dielli tutje në det, sa një rrotë i kuq, e gjer perëndonte, gjene sa një rrotë, gjene i kuq, po në fushë.
- Unë kam ardhur këtu të marr e jo të jap.
- Një vajzë ishte ulur në ballkonin lart dhe shikonte se ç'po bëhej poshtë në oborr.
- Ata e duan mbretin e tyre plak, sepse thonë është i drejtë, dorëgjere e zemërbardhë, i pari në sulm dhe i fundit në tërheqje.

Reflektimi:

Punohen edhe ushtrimet 4, 5 dhe 6.

Ushtrimi 4

i përvëlur – i papërvëlur i shijshëm – pa shije
i lodhur – i çlodhur i urryer – i dashur
plot – bosh i lashtë – i tanishëm
mbledh – shpërndaj thur – shtur robërues – lirues

Ushtrimi 5

Sinonime Antonime
i gjerë – i ngushtë
i tejskajshëm – i skajshëm

Ushtrimi 6

Mua më pëlqen të kem një bashkëshort që mund të kujdeset për mua. Ai duhet të jetë tip sportiv, punëtor, me këmbë në tokë, i ndershëm dhe romantik. Unë nuk mund të jetoj me një njeri të mjerë e mendjengushtë. Personi me të cilin do të kaloj jetën duhet të jetë i gëzuar, mendjehapur dhe optimist. Unë jam person i turpshëm. Për këtë arsye tërhiqem nga vajza të shkathëta dhe me autostimë. Do të më pëlqente të kisha pranë një njeri të ndershëm dhe që të dijë të gatujë.

Fjalët nga teksti	Sinonime	Antonime
bashkëshort	burrë	grua
sportiv	vital	klasik
mendjengushtë	mendjevogël	mendjegjerë
i gëzuar	i ngazëllyer	i hidhëruar
mendjehapur	mendjegjerë	mendjengushtë
i turpshëm	i ndrojtur	i hedhur

Vlerësimi i nxënësve: Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.

Detyrat dhe puna e pavarur: Punohet ushtrimi 7.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Fjalët dhe raportet e tyre; (sinonimet, antonimet dhe homonimet)		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon raportet leksikologjike të identitetit dhe të kundërvënies së fjalëve. Shpjegon vlerën emocionale të fjalëve në një një fushë leksikore.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.		I. Komunikues	
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.		I. Të dëgjuarit dhe	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Homonimet në gjuhën shqipe			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Zgjeron njohuritë për homonimet; Klasifikon homonimet sipas llojit të tyre; Dallon homonimet sipas formës e kuptimit të tyre.		Fjalët kyç: - homonime - klasifikim - antitezë	
Kriteret e suksesit: Rikujton njohuritë e marra për homonimet; Shpjegon klasifikimin e homonimeve; Tregon se si dallohen homonimet sipas formës dhe kuptimit të tyre.			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe”, fjalorë, tekste të ndryshme.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): artet, letërsi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<p>Hyrja</p> <p>Kontrollohen e diskutohen detyrat e shtëpisë. Mësuesi/ja organizon mësimin me pyetje nga mësimi i kaluar, për të nxitur diskutimin në klasë, duke pyetur:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ç’janë sinonimet e antonimet? 2. Si klasifikohen ato? 3. Ilustroni me shembuj për secilin rast të përmendur. <p>Mësuesi/ja fillon mësimin duke prezantuar pjesën e tekstit që do të lexohet dhe zgjedh njërën nga nxënësit për të bërë të mundur leximin e pjesës së zgjedhur në krye të mësimin. Leximi bëhet i shtruar, me qëllim që nxënësit të kenë mundësi të shkruajnë në fletore sa më shumë fjalë që i fiksohen. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të mbajnë shënim për sa më shumë homonime (fjalë të njëjta nga forma, por me kuptim të ndryshëm) që dëgjojnë.</p>			

Nëpërmjet teknikës së shqyrtimit kategorizues, mësuesi/ja do të synojë shqyrtimin e fjalëve të zgjedhura nga nxënësit, duke realizuar një analizë kuptimore të tyre. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të shkruajnë në një tabelë veçoritë kuptimore që kanë fjalët e zgjedhura. P.sh.: pres shokun – pres mishin (forma të njëjta, por kuptime të ndryshme).

Kështu veprohet për të gjithë fjalët që kanë zgjedhur nxënësit. E përqendrojmë vëmendjen e nxënësve në përdorimin e homonimeve.

Japim përkufizimin për homonimet:

Homonimet janë fjalë që përputhen nga forma, por dallohen nga kuptimi.

Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/ja vijon me shpjegimin e njohurive të reja duke përdorur metodën e organizuesit grafik, me qëllim që nxënësit të shpjegojnë homonimet dhe dallimin ndërmjet fjalëve polisemike e homonimike.

Polisemia	Homonimia
Një fjalë që mbart shumë kuptime. Polisemia e ushqen homoniminë. Shpërbërja e polisemisë na çon në homonimi.	Fjalë të njëjta me kuptime të ndryshme. Homonimet kanë lindur në gjuhë për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur historikisht. Formohet nga: formimi i fjalëve të reja, huazimet, nga fjalë të fondit të standardit me ato dialektore, por edhe nga zbërthimi i polisemisë në fjalë të ndryshme.

Mësuesi/ja vijon shpjegimin me klasifikimin e homonimeve:

- Homonime të pjeshme: pjek (gatuaj) – pjek (tako), verë (stinë) – verë (pije) etj.
- Homoforma, kur përputhet vetëm në një trajtë: bredh-i (emër) – bredh (folje); zë (emër) – zë (folje) etj.
- Homografe, kur shkruhen njësoj, por dallohen vetëm nga theksi: fole – fole, ari – ari, gjeni – gjeni.
- Homofone, kur fjalët përputhen vetëm në shqiptim: lag – lak, qepë – qep etj.

Organizuesi grafik shkruhet në tabelë me shkumësa me ngjyra, ose në tabela dhe u shërben nxënësve për të vijuar me punën praktike.

Reflektimi:

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet.

Ushtrimi 1

mbitokë – nëntokë, dje – sot – nesër, gocë – vajzë, i shpejtë – i ngadalshëm, palë “e fustanit” – palë “në bisedime”, furrë “vend ku pjekim” – furrë “sasia e bukëve që piqen njëherësh: Hëngri dy furrë bukë”, liri – robëri, sipër – poshtë, bri (i lopës) – bri (mjet për sinjal), mësues – dhaskal, rreth “figurë gjeom.” – rreth (për flokët).

Ushtrimi 2

Profesori çek do të mbante disa leksione interesante mbi antropologjinë. Nuk e dinte se çfarë qe: çek i bardhë apo çek i paplotësuar. Në hyrje të rrugicës ishte një ah i bardhë. Me ah e me bah me rënkime të mëdha, duke u ankuar për çdo gjë. Bëni një rrotullim të plotë në drejtim të akrepave të sahatit. Vaj akrepi, bar që përgatitet me vaj e me helmin e akrepit dhe që përdoret në mjekësinë popullore. I dha gaz (i pakësoj gazin) motorit, që të arrinte sa më shpejt. Iu mbush zemra me gaz, i dukej sikur do t'i shpërthente nga lumturia. Hapi partiturat të shikonte notat nën pentagram. Pas asaj ngjarjeje, përfaqësuesi i Ministrisë dërgoi një notë zyrtare. Dëgjo mirë, pa fol me argumentet e duhura. E sotmja dukej një ditë e zymtë pa diell.

Ushtrimi 3

i pagëzuar (që ka marrë pagëzimin), i pagëzuar (që nuk ka gëzuar);
pajtohem (rivendos përsëri marrëdhënie të mira a miqësore me dikë), pajtohem (përputhet me diçka tjetër, përshtatet.);
rrëshqitje (veprimi sipas kuptimeve të foljes “rrëshqas”), rrëshqitje (lloj kërpudhe që hahet);
barbarizëm (veprim i egër, i pamëshirshëm e çnjerëzor), barbarizëm (fjalë ose shprehje e vjetër e huazuar);
sirenë (pajisje që lëshon tinguj të mpërthtë e të vazhdueshëm për të lajmëruar diçka), sirenë (figurë mitologjike e vajze gjysmënjeri e gjysmëpeshk);
disiplinë (zbatimi i detyrueshëm i disa rregullave), disiplinë (degë e një shkence);
sjell (mbart diçka nga vendi ku është dhe e vë diku me afër), sjell (vij e njoftoj diçka nga ana e një tjetri);
diktoj (zbuloj dikë a diçka pasi e kam gjurmuar), diktoj (lexoj a them diçka qartë, ngadalë e me zë të lartë).

Ushtrimi 4

nis, pjek, qepa, kanë, pata, drejtori, dhe, zë, ka, çaj, qe, fik, bredh, gjeni, zihem.

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/es.

Detyrat dhe puna e pavarur: Punohet ushtrimi 6.

Sinonimet: progresiv (asimilim), –paravajtës, tregtar–bakall, shoh–shiko, humnerë–greminë

Antonime: mbikalim – nënkallim, përbuz (një njeri) – përçmoj

Homonime: krah “pjesë e turpit”–krah “mbështetje”, majë (emër)–majë (parafjalë), bagëti “kafshë shtëpiake” – bagëti “njeri i trashë nga mendja”, (kombi shqiptar) – komb “pikë, gllënjikë” – komb “shtrëngim në fyt”, krasit (pemën) – krasit (vras në masë, korr me breshëri), brez (i leshtë) – brez (gjeografik).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Shkrimi letrar - lindja e projektit, eseja		Rezultati i të nxënit të temës: Praktikon modele dhe mënyra të shkrimit në formë projekti e eseje.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 4; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Eseja letrare			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon përse shërben eseja letrare; • Tregon strukturën e esesë së krahasim-kontrastit; • Redakton esenë. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • ese • krahasim-kontrasti • redaktim 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon se eseja letrare përdoret për të bërë krahasime; • Flet për strukturën e esesë së krahasim-kontrastit; • Respekton kulturën e shkrimit të esesë. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): letërsi, modele të eseve letrare.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			

Hyrja:

Mësuesi/mësuesja pyet nxënësit:

1. A keni shkruar më parë ese letrare?
2. Çfarë mendoni se dini për të?
3. Cila mendoni se është struktura e saj?
4. Pse duhet të redaktohet eseja?

Pas përgjigjeve të nxënësve, mësuesi/ja hap librin me dy portrete me ngjyra dhe kërkon nga nxënësit ta bëjnë krahasimin e këtyre dy portreteve:



Gruaja me kapelë, Peter Paul Rubens



Gruaja me kapelë, Henri Matisse

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Realizimi i kuptimit:

Mësuesi/mësuesja udhëzon nxënësit që në fazën e kësaj ore mësimore ta lexojnë në heshtje mësimin për esenë letrare. Njëri nga nxënësit më pas me zë të lartë lexon modelin e esesë së krahasim-kontrastit dhe nxënësit bashkë me mësuesin/en diskutojnë për strukturën e esesë në pika më të thella (diskutohet për hyrjen, trungun dhe përmbylljen e esesë).

Reflektimi:

Në tabelë mësuesi/ja shkruan në formën e gabuar fjalitë e mëposhtme, ndërkaq nga nxënësit kërkon që t'i kontrollojnë ato për gabime drejtshkrimore dhe gramatikore (pa e hapur librin). Katër nga nxënësit dalin në tabelë dhe bëjnë korrigjimet e nevojshme. Kur nxënësit t'i bëjnë korrigjimet sipas mendimit të tyre, atëherë mësuesi/ja u thotë ta hapin librin në faqe 93 dhe ta lexojnë pjesën e mësimin për redaktimin e esesë (strukturën e fjalisë).

Gabim

1. Qyteti i pëlqente shumë por nuk kalonte shumë kohë atje.
2. Atje kishte shumë miqë vetëm se familjen e kishte larg.
3. Qyteti i dukej ndryshe edhe pse pak kohë kishte që ishte larguar.
4. U përpoq të përshtatej me këtë situat ndonëse i dukej e vështirë.

<p>Drejt</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Qyteti i pëlqente shumë, por nuk kalonte shumë kohë atje. 2. Atje kishte shumë miq, vetëm se familjen e kishte larg. 3. Qyteti i dukej ndryshe, edhe pse pak kohë kishte që ishte larguar. 4. U përpoq të përshtatej me këtë situatë, ndonëse i dukej e vështirë.
<p>Vlerësimi i nxënësve: Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Punohen ushtrimet 1, 2, 3, 4, 6 dhe 7.</p>
<p>Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:</p>

<p>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: V</p>	<p>Klasa: XI</p>
<p>Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor</p>			
<p>Tema: Stilistika e bashkërenditjes dhe nënrenditjes në shqip (poezia, proza, teksti joletrar)</p>		<p>Rezultati i të nxënit të temës: Dallon stilistikën e fjalisë dhe të periudhës.</p>	
<p>Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.</p>			
<p>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.</p>			
<p>ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</p>			
<p>Njësia mësimore: Stili i letërsisë artistike</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sqaron se çfarë përfshin stili i letërsisë artistike; • Mëson për organizimin gjuhësor në prozë dhe në ligjërimin poetik; • Analizon paraqitjen e komunikimit gjuhësor, leksikun. 		<p>Fjalët kyç:</p> <ul style="list-style-type: none"> • tekst • stil i letërsisë artistike • funksion estetik • organizim gjuhësor 	

Kriteret e suksesit:

- Tregon se stili i letërsisë artistike përfshin krijimet artistike (të shkruara dhe të folura);
- Bën organizimin gjuhësor në prozë dhe në ligjërimin poetik;
- Bën analiza të ndryshme.

Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, tekste të ndryshme letrare.

Përdorimi i TIK-ut: Po.

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): letërsi, tekste të ndryshme letrare.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Hyrja:**

Në fillim të orës mësimore, nxënësit do të bëjnë krahasimin e dy teksteve të dhëna në krye të mësimit.:

Realizimi i kuptimit:

Mësohet mësimi për stilin e letërsisë artistike, përkatësisht mësohet për sferën e letërsisë artistike, organizimin gjuhësor në prozë dhe atë në ligjërimin poetik. Shpjegohet dhe komentohet mësimi nga nxënësit.

Reflektimi:

Nxënësit do t'i punojnë në klasë ushtrimet 1, 2 dhe 3. Nxënësit në këto ushtrime analizojnë paraqitjen e komunikimit gjuhësor, më pas leksikun e përdorur nga shkrimtari Ismail Kadare dhe ritmin, figurat letrare dhe sintaksën në poezinë “Gjuha Shqype” të Ndre Mjedës.

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/es, me gojë ose me shkrim.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Analizoni fjalorin e shkrimtarit tuaj të parapëlqyer, duke u ndalur te fjalët e reja që ka krijuar.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Stilistika e bashkërenditjes dhe nënrenditjes në shqip (poezia, proza, teksti joletrar)		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon stilistikën e fjalisë dhe të periudhës.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Veçoritë gjuhësore në tekstet joletrare			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon përse përdoren tekstet joletrare; • Klasifikon tekstet joletrare sipas përmbajtjes; • Analizon strukturën e teksteve sintaksore. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • tekst joletrar • leksik i gjuhës standarde • veçori sintaksore 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Sqaron se tekstet joletrare përdoren për t'u informuar, për të ditur dhe për të mësuar; • Tregon se sipas sferës së përdorimit dallohen lloje të teksteve të ndryshme; • Numëron disa nga veçoritë sintaksore të stilit përkatës. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, tekste të ndryshme letrare.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): letërsi, tekste të ndryshme letrare.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Hyrja:

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

1. Përse mendoni se përdorim një tekst joletrar?
2. Si klasifikohen tekstet joletrare sipas përmbajtjes?
3. Po sipas sferës së përdorimit?

Realizimi i kuptimit:

Mësohet mësimi për veçoritë gjuhësore në tekstet joletrare. Mësuesi/ja ua përcakton pjesët e mësimi nxënësve të ndarë nëpër grupe sipas sferave të stileve:

1. Sfera e stilit politiko-shoqëror;
2. Sfera e stilit administrativo-politik;
3. Sfera e stilit tekniko-shkencor.

Secili nga përfaqësuesit e grupeve shpjegojnë pjesën e tyre të përcaktuar për ta. Me përfundimin e shpjegimit të pjesëve të mësimi, grupet ua parashtrojnë njëri-tjetrit nga një pyetje.

Reflektimi:

Klasa ndahet në pesë grupe. Kërkon dhe gjen tekste sipas këtyre kategorive të teksteve. Analizon veçoritë e tyre sintaksore.

Grupi I – Burimet të drejtpërdrejta të informacionit shkencor

Grupi II – Burime referuese

Grupi III – Tekstet vlerësuese

Grupi IV – Tekstet për komunikim gojor

Grupi V – Tekste udhëzuese

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Punohen ushtrimet 2 dhe 3.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Konotacionet, semantika dhe fusha leksikore		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon raportet leksikologjike të identitetit dhe të kundërvënies së fjalëve.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Konotacioni dhe denotacioni			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon konotacionin dhe denotacionin; • Sqaron se çfarë shprehin nuancat kuptimore; • Shpjegon për ligjërimet dhe vlerën emocionale të fjalës. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • konotacioni • denotacioni • vlera emocionale e fjalës 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon se çfarë është konotacioni dhe çfarë denotacioni; • Flet për shprehësinë e nuancave kuptimore; • Diskuton për ligjërimet dhe vlerën emocionale të fjalës. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, fjalori.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): /			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Hyrja: Bëhet një përsëritje e njësisë së kaluar mësimore dhe më pas mësuesi/ja pyet nxënësit: <ol style="list-style-type: none"> 1. Çfarë mendoni se dini për konotacionin? 2. Po për denotacionin? 			
Realizimi i kuptimit: Mësohet mësimi për kuptimin denotativ e atë konotativ, si dhe për ligjërimet dhe vlerën emocionale të fjalës. Jepet kuptimi i fjalës “gjelbër” dhe diskutohet për kuptimin e kësaj fjale.			

GJELBËR mb.

Ngjyra e gjelbër; bojë e gjelbër. E gjelbër e hapët (e mbyllët). Lyej me të gjelbër.

1. Që ka ngjyrën e barit të njomë a të gjetheve të bimëve, i blertë. Ngjyrë e gjelbër. Gjethe të gjelbra. Bari i gjelbër. Sallatë e gjelbër. Pëlhurë (basmë) e gjelbër. Dritë e gjelbër. Shenja e gjelbër shenja që tregon se rruga është e lirë për kalim. Bëhet i gjelbër.

2. Që vjen si i kaltër në të verdhë. U bë i gjelbër në fytyrë.

3. Që është i mbuluar me bar të njomë a me gjethe, që ka bimësi të njomë, i blertë. Fushë (lëndinë) e gjelbër. Dru i gjelbër. Rri i gjelbër gjithë vitin nuk i bien gjethet.

4. Që nuk është pjekur ende (për frutat). Mollë të gjelbra. Rrush i gjelbër.

5. bujq. Që përbëhet prej bimësh të njoma. Ushqim i gjelbër. Plehërim i gjelbër. Konvejer i gjelbër.

6. bujq. Që bëhet kur bima ka nxjerrë gjethe. Shartim i gjelbër. Krasitje e gjelbër. Harrje e gjelbër.

7. Përdoret si pjesë e dytë e disa emërtimeve të përbëra të kafshëve e të bimëve, që kanë ngjyrën e barit. Çimka e gjelbër. Karkaleci i gjelbër. Morri i gjelbër. Pleshti i gjelbër. Myku i gjelbër. Çaji i gjelbër.

** Ari i gjelbër shih tek AR, -I. Kafë e gjelbër diçka me pasoja të padëshirueshme, punë a ngatërrësë, në të cilën nuk duhet të përziheshim. Tryeza (coha) e gjelbër vjet. tryeza e bisedimeve diplomatike.*

Reflektimi:

Punohen ushtrimet 1 dhe 3. Diskutohet për to.

Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni në fjalor përdorime të ndryshme të fjalës zemër, denotative dhe konotative.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor			
Tema: Konotacionet, semantika dhe fusha leksikore		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon raportet leksikologjike të identitetit dhe të kundërvënies së fjalëve.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën V: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën V: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 4; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fusha leksikore			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon fushën leksikore; • Tregon si përcaktohet ajo; • Grupon sipas klasave dhe formimit fjalët e një fushe leksikore. 		Fjalët kyç: <ul style="list-style-type: none"> • fushë leksikore • vlera emocionale e fjalëve • fjalë e përgjithshme 	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon se çështë fusha leksikore; • Sqaron se fusha leksikore përcaktohet me një fjalë të përgjithshme; • Pasqyron shembuj ku kemi marrëdhëniet ndërmjet fjalëve të një fushe leksikore. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 11”, fjalori.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): /			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE



Hyrja:

Mësuesi/mësuesja pyet nxënësit:

Çfarë mendoni se është fusha leksikore?


Realizimi i kuptimit:

Mësohet mësimi për vlerën emocionale të fjalëve dhe fushën leksikore (f.105). Në dërrasë të zezë bëhet skema e mëposhtme dhe skema tjetër pas saj dhe diskutohet për to.



Reflektimi:

Nxënësit ndërtojnë me ndihmën e fjalorit familjen e fjalës i bardhë.



Vlerësimi i nxënësve:

Sipas gjykimit të mësuesit/mësueses.

Detyrat dhe puna e pavarur: /

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi / Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi Shkalla e kurrikulës 5/ Klasa: XI

Tema (nga– plani dymujor): Gjuha e figurshme - stilistika

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Njohin dhe dallojnë stilet, retorikën, figurat letrare, figurat e mendimit.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Komunikues efektiv:1,3,4; Mendimtar kreativ: 1,2,3,; Nxënës i suksesshëm: 3,4; Kontribues produktiv: 1,2,3; Individ i shëndoshë: 1; Qytetarë i përgjegjshëm: 1,2,5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :Të dëgjuarit dhe të folurit: 1,2,3,4,5,6,7
Të lexuarit dhe të shkruarit: 1,3,4,5,6,7,8

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Stilistika

Fjalët kyç: Stilistika, stili, retorika, gjuha e figurshme, shprehje artistike

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Dallon gjuhën e figurshme

Tregon çfarë është stili dhe dallon llojet e tij

Dallon retorikën dhe kupton lidhjen e saj me stilin

Kriteret e suksesit:

Tregon çfarë është gjuha e figurshme

Tregon çfarë është stili dhe nga rrjedh si emërtim

Tregon çfarë është retorika dhe çfarë e lidh me stilin

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti shkollor, materiale si libri ose materiale nga interneti, fjalor

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: histori, gjeografi, art

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Stuhi mendimesh, lexim dhe diskutim në grup, ushtrim përmes leximit

Fillimisht, i udhëzojmë që të ndahen në tri grupe, ndërsa ne shënojmë orën. Pastaj, në fazën e parë të orës, stimulojmë një stuhi mendimesh rreth gjuhës së figurshme, duke matur kështu njohuritë e mëhershme të nxënësve rreth gjuhës së figurshme – stilistikës. Mund të parashtrojmë pyetje si:

Çfarë kuptoni me gjuhën e figurshme? (kjo pyetje do t'i bëjë të japin përgjigje nga më të ndryshmet dhe mund të ketë nevojë të domosdoshme të ndërlidhet edhe mësimdhënësi) **Çfarë kuptoni me stilin? Çfarë është retorika? Cilat figure letrare ju bien në mend?**

Ndërkohë që ata japin mendime, mësimdhënësi shkruan në tabelë disa nga ato, shkurt. Sa më shumë, aq më mirë, sepse ndonje nxenes mund të mos ndjehet mirë nëse nuk shënohet një fjalë së paku nga mendimi që dha.

Në fazën e dytë të orës, u japim flatët e shtypura me pjesët nga libri i letërsisë.

GRUPI I: - Dy paragrafët e parë nga libri

- Figura stilistike shton fuqinë dhe mënyrën e të shprehurit, dhe zgjeron kuptimin e asaj që themi dhe shkruajmë.

- Stylos-i, shkop me të cilin shkruhej në tabelat e dyllit. Stylos, nga latinishtja.

- Kuptime të tjera: stili i punës, stili i lojës, stili i veshjes, stili i jetës etj.

- Stilistika moderne

- Stilistika është dija, që studion stilet e shprehjes së individit dhe kolektivitetit, në të folur dhe në të shkruar, e ndryshme nga gramatika.

GRUPI II: - Paragrafin tre dhe katër

- Prejardhja e stilit si dije gjuhësore

- Retorika – arti i të folurit në antikën greke
- Retorika – **inventio** (gjetunia e ideve), **dispositio** (mbarështrimi), **elocutio** (shprehësia), **memoria** (të mbajturit mend), **actio** (ligjërimi)

GRUPI III: - Paragrafin pesë dhe gjashtë

- Retorika – respektimi i temës për të cilën shkruhej
- Mënyrat themelore të shkrimit – *stili i lartë (temat e heronjve dhe luftës)*, *stili i mesëm (qëndron mes dy stileve)*, *stili i ulët (temat e përditshme, pastorale e të punës së zakonshme)*. *Kujtojmë Aristotelin dhe ndarjen komedi – tragjedi (opsionale)*
- *Letërsia – art i bukur*
- *Retorika – kujdesi për shprehësinë, stilet e shkrimit letrar, kompozicioni dhe figurat.*
- *Retorika antike → dekadencia → stilistika moderne*
- *Poetët – shprehja figurative*

I orientojmë ta lexojnë individualisht dhe pastaj të nxjerrin në fletë të bardhë duke diskutuar bashkë, pikat kryesore, që mësuar. Kete e bëjnë për 10 – 15 minuta. Pasi të jenë gati, mësimdhënësi i jep fjalën një nxënësi nga grupi që të tregojë para klasës atë, që kanë mësuar. Njëjtë vazhdohet me secilin nga tre grupet. Gjatë kohës së diskutimit para klasës, mund të ndërlidhen të gjithë nxënësit, çoftë me pyetje, çoftë me diskutim shtesë. Mësimdhënësi, derisa flet nxënësi, mund të shënojë fjalë të reja në tabelë, përballë mendimeve nga fillimi i orës dhe të kyçet aty ku sheh zbrazëtira ose nevojë për të shtuar ose përmirësuar.

Mund të përmendim ndërkohë studimet e para mbi stilin, si: “Mbi stilin” – Demetriusi (viti 100, era e re) si studim mbi stilin, kurse si stilistikë të parë “Traktat i stilistikës frënge” nga Charl Baji dhe ne raport me retorikën mund te permendim *Shkollën e Retorikës* në Athinë, e themeluar ne vitin 431, para erës së re. (Nuk është patjetër të përmenden, por po mbeti kohë, pse jo.)

Në fazën e fundit të orës, mund të masim njohuritë dhe korigjojmë njohuritë, që kanë fituar, përmes pyetjeve të ndryshme. Mund të përdorim edhe pyetjet nga libri i letërsisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie : Detyrën 6, nën B, faqe 9

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi / Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi Shkalla e kurrikulës 5/ Klasa: XI	
Tema (nga– plani dymujor): Gjuha e figurshme - stilistika	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njohin dhe dallojnë stilet, retorikën, figurat letrare, figurat e mendimit.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Komunikues efektiv:1,3,4; Mendimtar kreativ: 1,2,3;; Nxënës i suksesshëm: 3,4; Kontribues produktiv: 1,2,3; Individ i shëndoshë: 1; Qytetarë i përgjegjshëm: 1,2,5	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :Të dëgjuarit dhe të folurit: 1,2,3,4,5,6,7 Të lexuarit dhe të shkruarit: 1,3,4,5,6,7,8	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Figurat e mendimit – (krahasimi, similituda, metafora, katakreza, metonimia)	
Fjalët kyç: Tropet, figurat e fjalës, krahasimi, vargjet, similituda, metafora, katakreza	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Tregon figurat e fjalës Tregon kuptimin e figurave letrare Dallon figurat e fjalës në tekst Kriteret e suksesit: Cilat janë figurat e fjalës Çfarë i dallon figurat dhe tropet Çfarë kuptimi dhe ndikimi kanë figurat e fjalës në tekst	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti shkollor, materiale si libri ose materiale nga interneti, fjalor	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: histori, art	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Bashkëbisedim, DLTA, shembuj nga nxënësit	
<p>Ora fillon me pyetjen: “A dallojnë figurat nga tropet? Nëse po, ku apo si?”. I japim hapësirë nxënësve që të bëjnë dallimin mes tyre, dhe pastaj i pyesim se cilat trope i njohin nga të mësuarit e mëhershëm. Derisa ata flasin, mësimdhënësi shënon në tabelë vetëm katër figurat, që do ti zhvillojë gjatë kësaj ore mësimore: Krahasimi, metafora, similituda, katakreza, por nuk i nderpret nxënësit kur përmendin figurat tjera. E mira është që po harruan një nga tropet, ta përmend mësimdhënësi, patjetër.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dy grupimet themelore - <i>figurat</i> dhe <i>tropet</i>. - <i>Figurat</i> – e ruajnë kuptimin e fjalëve, por ndërrojnë trajtën apo mënyrën e të shprehurit duke i dhënë gjuhës së përdorur theks të veçantë. - <i>Tropet</i> apo <i>figurat e fjalës</i> – ndryshojnë edhe kuptimin, edhe trajtën e fjalëve - Tropet – figurat themelore: <i>krahasimi</i> e <i>similituda</i>, <i>metafora</i> – <i>epiteti metaforik</i> dhe <i>katakreza</i>, <i>metonimia</i> dhe <i>sinekdoka</i>, <i>personifikimi</i>, <i>eufemizmi</i>, <i>epiteti</i>, <i>alegoria</i>, <i>simboli</i>, <i>ironia</i>, <i>antiteza</i>, <i>grotesku</i>, <i>hiperbola</i> dhe <i>litota</i>. 	

Në fazën e dytë vazhdojmë me DLTA. Ndoshta më e udhës është që të lexojë mësimdhënësi, dhe gjatë leximit të vargjeve mund të vejë theksin në figurat e fjalës dhe të presëpastaj që nxënësit ti identifikojnë ato.

- Çfarë çenka krahasimi?

Krahasimi – përfytyrim apo imagjinim.

- Cilat lidhëza i gjejmë kur krahasojmë dy sende apo dukuri?

Gjatë krahasimit gjejmë lidhëzat: *si, porsì apo sikur*

- Gjërat që krahasohen, përngjajnë në ndonjë pikë, por dallojnë në shumë aspekte tjera, çfarë shembulli tjetër mund të thoni përveq *shqiponja* dhe *rrufeja*, që na e dha libri?

Dëgjojmë me vëmendje shembuj nga nxënësit dhe i komentojmë bashkë.

Lexojmë vargjet e Çajupit dhe theksim e vemë te krahasimet.

Similituda (krahasimi i zgjeruar) – krahasim i një gjendjeje, sendi a veprimi me një radhë të renditur parafytyrimesh.

- Çfarë çenka metafora?

Metafora – figura më e përdorur – mbretëresha e tropeve. Lidhje e drejtpërdrejtë me përgjasimet.

Metafora – nuk përdor lidhëzat, por bën shndërrimin në diçka tjetër.

Shembulli se si behet një krahasim dhe kur kemi metaforë në libër u lexua. Na thoni ju ndonje shembull?

Dëgjojmë dy – tre shembuj nga nxënësit.

Metafora → metaforë emër → *qafë mali, buzë deti*.

Metaforë mbiemër → epitet metaforik → *Drini plak, dielli i bardhë* etj.

Metafora folje → *ecin retë, udha dredhon* etj.

Poezi me përdorim të dendur metaforik (lexojmë vargjet e Nolit)

Poezi metaforike (lexojmë vargjet e Lasgush Poradecit)

- Çfarë çenka katakreza?

Katakrenza → nënloj metaforik → *muri ka lëshuar bark*.

Çfarë çenka metonimia?

Metonimia → nënloj i metaforës → përftohet nëpërmjet lidhjes së varshmërisë.

Metonimi shkakore → *Veriu na i thau bimët*.

Metonimi e rrjedhës → *Fshatin e mbuloi tymi*.

Metonimi e abstraksionit → *Bujaria s'ka kufi*.

Mësimdhënësi lexon fragmentin nga Anton Pashku, duke vënë theksin mbi figurën e metonimisë.

Sinekdoka → nënfigurë e metonimisë → zëvendëson tërësinë → *Punën e kryej me gishtin e vogël*.

Orën e mbyllim me leximin e vargjeve në libër dhe shembuj nga nxënësit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie : Pyetjet 1,2,3,4, faqe 20.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi / Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi Shkalla e kurrikulës 5/ Klasa: XI	
Tema (nga– plani dymujor): Gjuha e figurshme - stilistika	Rezultati i të nxënësve të temës (nga plani dymujor): Njohin dhe dallojnë stilet, retorikën, figurat letrare, figurat e mendimit.
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Komunikues efektiv:1,3,4; Mendimtar kreativ: 1,2,3; Nxënës i suksesshëm: 3,4; Kontribues produktiv: 1,2,3; Individ i shëndoshë: 1; Qytetarë i përgjegjshëm: 1,2,5	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :Të dëgjuarit dhe të folurit: 1,2,4,5 Të lexuarit dhe të shkruarit: 1,3,4,5,6,7,8	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Figurat e mendimit – Eufemizmi, personifikimi, alegoria, simboli, epiteti, hiperbola	
Fjalët kyç: Eufemizmi, personifikimi, vargu, poezia, alegoria, simboli, epiteti, hiperbola, litota	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore: Dallon gjuhën e figurshme Flet rreth figurave të mësuara sot Dallon figurat e fjalës në tekst Kriteret e suksesit: Trego çfarë kuptimi apo roli kanë figurat e fjalës Cilat figura i mësuam sot? Merr ndonjë shembull me figurat e zhvilluara sot	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti shkollor, materiale si libri ose materiale nga interneti, fjalor	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: histori, art	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Përsëritje, lexim dhe diskutim në grup, shembuj me figurat e fjalës	
<p>Fillimisht, i udhëzojmë që të ndahen në katër grupe. Derisa nxënësit formojnë grupet, mësimdhënësi mund të shënojë orën mësimore në ditar. Pas kësaj, pasiqë mësimi lidhet me orën e kaluar, për të mos thënë që është vazhdim i asaj ore, bëjmë një përsëritje rreth 5 minuta.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cfarë ishin tropet? Cilat figura të fjalës ju kujtohen? Çfarë ishte metafora? Po, krahasimi? Kush na jep një shembull të krahasimit? Cilat lloje të metonimisë kishim? Kush na jep një shembull me sinekdokë? <p>Tani i udhëzojmë të hapin librin e letërsisë në faqe 14. Ua ndajmë materien si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grupi I: Eufemizmi, personifikimi dhe alegoria - Grupi II: Simboli, epiteti dhe antiteza - Grupi III: Ironia, sarkazmi dhe grotesku - Grupi IV: Hiperbola dhe litota <p>I udhëzojmë që brenda grupit të ndahen dhe një herë. Në grupet me gjashtë nxënës, dy nxënës lexojnë paragrafin që flet rreth një figure, dy të tjerë paragrafin me figurë tjetër, e kështu me radhë. Lexojnë rreth 7 minuta dhe pastaj diskutojnë bashkë rreth asaj që lexuan dhe mësuam. Kështu, secila dyshe ndan informacionin me grupin, dhe në fund mësimdhënësi i jep fjalën një nxënësi nga secili grup që të prezantojë para klasës atë që kanë mësuar dhe kuptuar. Mund tu themi që po prezantojnë gjetjet e reja, dhe ata do të ndjehen më të dobishëm. Për të mos lënduar sedrën e ndonjërit, përzgjedhjen e bëjmë me “lapsat në mes”. Nxënësit vendosin lapsat në mes, dhe mësimdhënësi zgjedh një laps, pronari i të cilit prezanton para klasës. Ta kemi parasysh, gjithmonë duke nxitur dhe të tjerët të bëjnë pyetje ose të shtojnë diçka nga njohuritë e veta, dhe patjetër, plotësimet</p>	

ngamësimdhënësi.

Eufemizmi – nënfigurë e metonimisë → zbut të folurit, e bën më të kujdesshëm.

Eufemizmi → etika, respekti, kujdesi

Shembull: “*Përtac*” zëvendësohet me “*nuk i pëlqen puna*”, “*dreq*” me “*qoftëlargu*”.

Pas diskutimit të nxësit nga grupi, mësimdhënësi lexon vargjet e Ndre Mjedes duke vënë theksin te eufemizmat.

Personifikimi – familje e metaforës.

Gjërave abstrakte, gjërave të pashpirta, dukurive natyrore dhe ideve të ndryshme u japim veti njerëzore.

Shembull: *Lahuta e shurdhër, hëna lakmitare* etj.

Mësimdhënësi lexon vargjet e Migjenit duke theksuar personifikimet.

Alegoria → metaforë e zgjeruar e shprehjeve, bartje e kuptimeve.

Vepra letrare si alegori → përrallat, poezitë, epet, romanet etj.

Shembuj: “*Shkëndij*” e *diellit ndaj manushaqes*” – Naim Frashëri.

Mësimdhënësi lexon vargjet e Azem Shkrelit duke theksuar alegorinë.

Simboli → zëvendësim i fjalëve.

Shembull: Kur përdorim fjalën shqiponjë nënkuptojmë flamurin tonë dhe shqiptarët.

Mësimdhënësi lexon vargjet Lasgush Poradecit dhe martin Camajt, duke theksuar simbolet.

Epiteti → mbiemër, frazë mbiemërore.

Romakët e vjetër e quajtën figurë të stolisë.

Mësimdhënësi lexon vargjet e Naim Frashërit duke theksuar epitetet e shumta.

Antitez → kontrasti → kundërshtim mes dy ideve të vendosura pranë njëra –tjetrës.

Shembull: *Të gabosh është njerëzore, të falësh është hyjnore.*

Lexon mësimdhënësi me theks te antitezat:

Anës detit i palarë,

Anës dritës i paparë.

Pranë sofrës i pangrënë,

Pranë dijes i panxënë.

(Anës lumenjve, Fan S. Noli)

Ironia → fjala e folur apo e shkruar, përmban një mendim të fshehur, të ndryshëm nga domethënia e dukshme.

Shembull: Një njeriu shtatlartë i themi : *sa i shkurtër qenke.*

Ironia → prani më e madhe në poezinë satirike.

Mësimdhënësi lexon vargjet e Fishtës duke theksuar ironinë.

Sarkazmi → shkallë më e lartë e ironisë.

Lexojmë vargjet e Migjenit.

Grotesku → shprehje e çudisë, kureshtjes dhe shtrembërimit të skajshëm të reales → fantazi e fuqishme.

Elementet themelore groteske → çrregullimi, fantazia e fantastikja dhe e shëmtuara.

Lexojmë vargjet e Sabri Hamitit.

Hiperbola → zmadhim i veprimit apo dukurisë

Litota → e kundërta e hiperbolës.

Orën e mbyllim me shembuj të nxënësve me figurat e fjalës, dhe pyetje të ndërsjellta.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie :

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: Romantizmi në letërsi		Nxënësi njih dhe ndërton kuptimin e duhur mbi konceptet letrare dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin hap pas hapi të letërsisë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: diskuton në grup në mënyrë konstruktive duke dhënë dhe marrë informacion mbi temën; dallon periudhat letrare dhe përfaqësuesit e saj; fiton aftësitë e nevojshme për të kuptuar natyrën e letërsisë dhe në veçanti klasifikimin e saj në periudha të ndryshme letrare dhe historike.		Fjalë kyç: periudha letrare epoka e romantizmit kontekst historik kontekst letrar proza romantike poezia romantike drama romantike	
Burimet: teksti i letërsisë, libri digjital, fjalor i gjuhës shqipe, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe dhe gjuhë e huaj, arte, histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pema e mendimeve, bashkëbisedimi, një pyetje-shumë përgjigje, pema e mendimeve, metoda e Kllasterit, vëzhgimi, punë e pavarur</i>			

Organizimi i orës së mësimt

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve

Në fillim të kësaj ore mësimi sjellim në kujtesë me anë të *pemës së mendimeve* dhe *metodës së bashkëbisedimit* zhvillimin e drejtimeve letrare që kemi studiuar deri tani.



Letërsia gojore



Antikiteti



Mesjeta



Rilindja dhe humanizmi



Klasicizmi



b. Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, një pyetje-shumë përgjigje, lexim i drejtuar, pema e mendimeve, metoda e Kllasterit

Në këtë fazë të orës së mësimt ftojmë nxënësit në *bashkëbisedim* me anë të pyetjes:

Ç'kuptoni ju me termin romantizëm?

Flala romantizëm është e lidhur pazgjidhshmërisht me lirizmin. Por në fakt romantizmi ishte pa diskutim arti i ri që lindi bashkë me Revolucionin dhe luajti një rol të rëndësishëm në zhvillimin e artit veçanërisht.

Përmes leximit të drejtuar nxënësit përpiqen të ndërtojnë një kllaster me zhvillimin e romantizmit në aspektin historik dhe letrar. Mësuesi/ja bën plotësimet e nevojshme nëse e sheh të arsyeshme.



Nga fundi i shek. XVIII deri në gjysmën e parë të shek. XIX romantizmi u përhap në mbarë Europën Perëndimore deri në Rusi, duke u bërë kështu drejtimi mbizotërues në letërsi dhe në arte të tjera si pikturë e muzikë.


Sinjali i parë letrar i romantizmit erdhi nga **Skocia** nga poeti **Makperson**.

Poeti tjetër skocez **Robert Bërn** u bë i njohur me poezitë e tij të stilit rapsodik.

Valter Skoti spikati me romanin historik.

Romantikët e përtërinë letërsinë me forma të reja dhe e demokratizuan atë, madje e zbritën nga sallonet mondane duke e çuar artin pranë njeriut.

Më poshtë me anë të një kllasteri mësuesi/ja prezanton përhapjen e romantizmit në Europë duke veçuar secilin lloj letrar.



Proza romantike

- Spikati proza e gjatë.
- Themelues i romanit modern historik V. Skot (Skoci), A. Manxoni (Itali), V. Hygo dhe A. Dyma (Francë)
- Temat: historike dhe ekzotike.
- Në kult: ndjenja kundrejt arsyes, natyra kundrejt artificiales, liria krijuese kundër dogmës.
- Arti i metaforës, kontrastit, zmadhimit dhe shpirtëzimit.



Poezia romantike

- Poeti romantik shprehet në vetën I (uni poetik dhe njerëzor)
- Poetët romantikë synojnë universalen.
- Liria - çelësi i tyre.
- 1. Poetët melankolikë (të dëshpëruar) larg botës, pranë natyrës ose në vetmi: Blejku, Holderlini, Vinji, Leopardi, Lermontovi.
- 2. Poetët energjikë që i kushtohen një ideali a misioni historik: Bajroni, Shelli, Pushkini, Hygoi, Lamartini, Manxoni etj.



Drama romantike

- U bë kalimi nga tragjedia në dramë.
- Teksti dramatik braktisi vargun drejt prozës.
- Drama romantike pranoi ndikimin nga Shekspiri.
- Temat: historike me nota legjendare, individit, problematika lirike e unit.
- Heroi është udhëheqësi popullor i masave, heroit i vetmuar përballë padrejtësive.
- Gëtja, Shileri, Hygoi, Pushkini.

Në vazhdim të orës së mësimi, me anë të *teknikës lexim i drejtuar* kërkojmë nga nxënësit të ndërtojmë hartën e përhapjes dhe zhvillimit të romantizmit në Europë.
Më poshtë është pasqyruar një tablo e saj.

Romantizmi European në letërsi					
Gjermani: vëllezërit Shlegel, Novalis, Brentano, vëllezërit Grim	Angli: Vordzuërth, Kolrixi, Bajron, Kitsi, Shelli	Francë: Hygo, Dyma Plaku, Dyma Biri, Lamartini, Myseja	Itali: Leopardi, Foskolo, Manxoni,	Rusi: Pushkini, Lermontovi	Shqipëri: Dara, de Rada, Fishta, Frashëri

c. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *metoda e bashkëbisedimit, vëzhgimi, puna e pavarur*

Për të realizuar këtë moment të orës së mësimi ftojme nxënësit të njihen me rubrikën e vëzhgimit.

Në tablonë “Udhëtari” të piktorit gjerman Kaspar David Fridrih, gjejmë gjithë karakteristikat e artit romantik. Artisti gjerman e konsideronte temën e natyrës si më interesanten për t’i dhënë jetë frymës së re që po lindte. Tabloja e paraqet njeriun si një pjesë të vogël të natyrës madhështore, i cili sodit i mrekulluar madhështinë e saj, vargjet e pafundme të maleve dhe retë që i mbulojnë.

Për Fridrihun, ashtu si dhe për të gjithë artistët romantikë, natyra është mjeti për t’u shkëputur nga monotonia e jetës së përditshme, për të kuptuar dhe admiruar pafundësinë e botës. Ajo bëhet personazhi kryesor i veprës dhe pasqyrë e ndjenjave të artistit.

Diskutojmë në klasë rreth tablosë dhe veçanërisht rreth tipareve të romantizmit të mishëruar aty.

Vlerësimi

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimi. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur

Lexoni me kujdes fragmentet e dhëna në tekst në f. 18-23.

Hulumtoni, nëse mundeni, rreth shkrimtarëve dhe veprave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: Romantizmi në letërsi Lexime të komentuara		Nxënësi njih dhe ndërton kuptimin e duhur mbi konceptet letrare dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin hap pas hapi të letërsisë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: diskuton në grup në mënyrë konstruktive mbi temën e romantizmit; dallon zhvillimin e romantizmit dhe përfaqësuesit e tij; fiton aftësitë e nevojshme për të kuptuar natyrën e letërsisë; fiton aftësinë për të zbërthyer tekste letrare.		Fjalë kyç: periudha letrare epoka e romantizmit kode letrare hero romantik ndjenjë universale mjedis mbyttës	
Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i gjuhës shqipe, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe dhe gjuhë e huaj, arte, histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Pema e mendimeve, bashkëbisedimi, harta e koncepteve, punë në grup, punë e pavarur, metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve, puna e pavarur			

Organizimi i orës së mësimi

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve, harta e koncepteve

Në fillim të kësaj ore mësimi mes *bashkëbisedimit* ndërtojmë me nxënësit konceptet letrare lidhur me letërsinë romantike.

Ç'është romantizmi?

Pse fjalët lirizëm dhe romantizëm janë sinonimike?

Ndërtoni kontekstin historik dhe letrar të periudhës së romantizmit.

Përmendni autorë përfaqësues të romantizmit europian

Po ju a keni lexuar ndonjë autor a vepër të kësaj periudhe?

b. Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, puna në grup, puna e pavarur

Ky moment i orës së mësimi ndërtohet mbi *punën në grup*, duke e ndarë klasën në tri grupe pune.

Më herët, orën e kaluar, nxënësve iu është lënë detyrë të lexojnë me kujdes fragmentet e dhëna në tekst. Nxënësit të pozicionohen sipas tërheqjes që patën me fragmentet ose vetë mësuesi/ja bën ndarjen e grupeve. Seicili grup punon me detyrat e caktuara.

Grupi I – “Letra e Tatjanës” A. Pushkin

Fragmenti i dhënë është momenti më i famshëm i poemës “Eugjen Onjegini”, çasti kur Tatjana merr guximin të shkruajë një letër të ndierë dashurie për Onjeginin. Ajo guxon të ngrihet kundër zakonit dhe normave hipokrite të shoqërisë së kohës. Si lloj është cilësuar si roman në vargje.

Dashuria shfaqet në këtë këngë si një **ndjenjë universale** që ekziston brenda njeriut, si një frymë jetësore që i jep kuptim jetës njerëzore dhe e nxit njeriun të bëjë vepra të mira në jetë.

Gjeni vargjet që e shprehin këtë dhe diskutoni për konceptin e Pushkinit për ndjenjën e dashurisë, si poet romanik që është.

Tatjana i kërkon Onjeginit “mbrojtje” për ndjenjën e saj. A është e vetëdijshme ajo për **mjedisin mbytës provincial** ku jetonte? Ku duket kjo? A ia jep asaj këtë të drejtë ndjenja e dashurisë? Shprehni opinionin tuaj. Tatjana është femra e parë (në letërsi) që merr guximin të shprehë ndjenjat e saj. Ajo është e vetëdijshme për mjedisin në të cilin jeton (në fshat të heshtur ju mërzi.../ na gjettë tek ky vend i qetë). Ndjenja që ka, e bën Tatjanën të guximshme duke dalë mbi çdo paragjykim dhe të përlulur ndaj dashurisë.

E di, se është e drejta juaj

Të më dënoni me përçmim.

Po ju që shihni si po vuaj

Me pak mëshirë, sado pak,

Nuk do më mprapsni zemërak!

Në këtë fragment **pyetjet retorike** kanë një funksion të dukshëm. Gjejini dhe shpjegoni përdorimin e tyre stilistik.

Ç’do deshit më veç shpirtit tim?

Nuk do më mprapsni zemërak!

Na gjettë tek ky vend I qetë?

Kush je ti? Ëngjëlli me shpresë, / Apo një lajkatar pa besë?

Me anë të këtyre pyetjeve retorike të shumta autori e ka më të thjeshtë të na bëjë të qartë gjendjen e Tatjanës. Ajo është e dashuruar kokë e këmbë dhe e çoroditur, sepse kjo është dashuria.

Grupi II – “Për veten” “Gjineshtra” Xh. Leopardi

Leopardi edhe sot është ndër poetët më të lexuar në Itali. Ai është i njohur edhe në botë. Cila është veçoria kryesore që e bën të mundur këtë?

A jeni të mendimit se motivet poetike më parë duhet të përjetohej nga vetë poeti dhe pastaj të rikrijohen poetikisht, apo mund të shprehen poetikisht edhe pa qenë të jetuara nga poeti? Diskutoni.

Si janë mendimet e Leopardit për dashurinë dhe vdekjen: me natyrë të përgjithshme njerëzore, apo vrunduj të shpirtit të lënduar dhe të vuajtur të poetit?

Xh. Leopardi përfaqëson në letërsinë italiane poetin romantik më pesimist, e më të përvuajtur, kurse në letërsinë botërore përfaqëson poetin e pikëllimit botëror dhe të pikëllimit të njeriut që përpiqet të sigurojë gjatë jetës lumturi e lavdi, por kjo mbetet e papërfillshme në pafundësinë e botës. Kjo prire e çon Leopardin vetvetiu drejt formave të mendimit filozofik.

Grupi III – “Vilhelm Tel” F.Shiler

Vini re notat romantike me të cilat paraqitet figura e Vilhelm Telit. *Njeriu nuk lind hero, ai bëhet*

i tillë. Janë pikërisht shtypja dhe padrejtësia që zgjojnë te njeriu ndjenjën e revoltës dhe të qëndrimit heroik.

Gjeni momentet kryesore ku shprehet kjo.

Si evoluon qëndrimi i Vilhelm Telit përgjatë kësaj skene? A ka vërtetësi psikologjike ky personazh?

Bëni interpretimin tuaj për mesazhin e dramës, duke u ndalur në dy pika kyç:

nënshtrimi i verbër ndaj sundimtarit,

mospërulja ndaj sundimtarit.

Në dramën e Shilerit lufta e popullit të Zvicrës për liri simbolizon aspiratat liridashëse të mbarë popujve të botës dhe vendosmërinë e tyre për t’u çliruar nga autoriteti despotik. Në linja të përgjithshme, Shileri ndjek besnikërisht rrëfimin popullor për heroin, *duke ruajtur të dhënat e supozuara historike* që ekzistojnë lidhur me figurën e Vilhelm Telit.

Drama e Shilerit u jep ngjarjes dhe heronjve *trajta epike*. Ajo bën të lindë kulti i vërtetë i Vilhelm Telit si një hero legjendar mbarëpopullor, që ndez në zemra flakën e pashuar të lirisë. Shileri, si njohës i mirë i psikologjisë njerëzore, e jep heroin e vet në *evolucion psikologjik*. Është pikërisht *vërtetësia psikologjike* e figurës gjaë kalimit gradual nga një situatë në tjetrën, që e bën të pranueshëm në sytë e lexuesit dhe të shikuesit një kapërcim të tillë marramendës nga një fshatar i thjeshtë në hero frymëzues të kombit.

Pasi nxënësit kanë marrë kohën e favorshme për të ndërtuar përgjigjet e tyre për diskutim i shpalosin ato sipas grupeve.

c. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve, puna e pavarur

Në këtë moment të orës së mësimit mes *pemës së mendimeve* ftojmë nxënësit të pasqyrojnë në tabelë disa nga tiparet më thelbësore të romantizmit që vunë re të përdoren në fragmentet e punuara më sipër.

A mund t'i konsiderojmë ato si një model platforme të periudhës së romantizmit?

Ndërtojmë diskutimin.

Vlerësimi:

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë mbi progresin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit. Disa nxënës vlerësohen me shkrim për punët e sjella në klasë. Nxënësit nxiten për të realizuar punë cilësore.

Detyrat dhe puna e pavarur

Pika 4

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi njih dhe ndërton kuptimin e duhur mbi konceptet letrare dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin hap pas hapi të letërsisë.	
Tema mësimore: Romantizmi. “Stuhi dhe vrull”			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: diskuton në grup në mënyrë konstruktive mbi temën e romantizmit; dallon zhvillimin e romantizmit dhe përfaqësuesit e tij; njeh dhe veçon lëvizjen “Stuhi dhe vrull” me tiparet e saj; fiton aftësitë e nevojshme për të kuptuar natyrën e letërsisë.		Fjalë kyç: periudhë letrare epoka e romantizmit “Stuhi dhe vrull” epoka e gjenive klasicizmi vajmaras olimpiku i Vajmarit	
Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i gjuhës shqipe, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, arte, histori, TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pema e mendimeve, bashkëbisedimi, harta e koncepteve, metoda e Kllasterit, një pyetje-shumë përgjigje, lexim i drejtuar, punë e pavarur, hulumtimi</i>			

Organizimi i orës së mësimi

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, harta e koncepteve

Në fillim të kësaj ore mësimi mes *bashkëbisedimit* rindërtojmë tiparet e romantizmit.

- Në qendër të veprave romantike vendoset qenia njerëzore, në përmasat e saj shoqërore dhe intime.
- o *Në përmasën e jetës shoqërore* kjo letërsi vë individin kryengritës, luftëtarin e lirisë, atdhetarin. Rrëfen betejat popullore, ndeshjet me të vjetrën, forcën e qëndresës dhe të vetëmohimit.
- o *Në përmasën e jetës intime* letërsia romantike bën objekt hulumtimi zemrën njerëzore, botën e brendshme të qenies me ëndrrat, ankthet, aspiratat dhe dyshimet.
- Në planin artistik romantikët i shprehin konfliktet shoqërore dhe ato brenda qenies me anë të kontrastit të fuqishëm, ku bashkohen tragjika me komiken, e bukura me të shëmtuarën, sublimja me grotesken.
- Ndër cilësitë krijuese romantikët çmonin *ndjeshmërinë* dhe *imagjinatën*, prandaj dhe i tërhoqi tema ekzotike.
- Romantikët prirën drejt së jashtëzakonshmes, madhësisë së figurave, kontrasteve që bien në sy dhe dinamizmit të ngjarjeve. Karakteristikë e tyre është dhënia e karaktereve të jashtëzakonshme në mjedise të jashtëzakonshme.
- Tjetër tipar i romantizmit është *subjektivizmi*. Në veprat e romantikëve ndihet hapur ndërhyrja e autorit përmes përshkrimit, meditimit etj.

Romantizmi european zhvillohet sipas dy modeleve, në raport me vizionin që kanë poetët për *lirinë*.

Modeli i parë:

- o poeti melankolik i dëshpëruar;
- o izolohet në vetmi, në gjirin e natyrës, larg njerëzve që s'e kuptojnë;

- o e shfrytëzon lirinë për të lëmuar formën dhe për të përsosur shprehjet poetike;
- o temat përshtaten me temperamentin e tyre – ndjesi pesimiste;
- o mjeshtëri i përshkrimit – kulti i natyrës simbolizon harmoninë universale.

Modeli i dytë:

- o poeti energjik;
- o i kushtohet një çështjeje të madhe, idealit të lartë, misionit historik;
- o lirinë e vet e vë në shërbim të lirisë së popujve;
- o mesazhet humane, politike, shoqërore, filozofike;
- o poetët nuk e ndajnë fjalën nga vepra.

Dy nxënës lexojnë punimet lidhur me detyrën e dhënë herën e kaluar dhe diskutojmë për to.

b. Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve, një pyetje-shumë përgjigje, lexim i drejtuar

Në këtë moment të orës së mësimi shënojmë në tabelë termin "Stuhi dhe vrull" dhe vjelim përmes bashkëbisedimit dhe pemës së mendimeve informacioni që kanë nxënësit lidhur me të. Mësuesi/ja bën plotësimet e duhura për të ndërtuar të plotë këtë koncept.

Stuhi dhe vrull
1770-1800
zanafilla nga takimi i
Gëtes me filozofin Herder

- Në këtë kohë vluan idetë dhe fantazia krijuese.
- Pika kulmore e zhvillimit letrar dhe intelektual në Europë.
- Periudha e artë e fuqisë krijuese gjermane.
- Synonte ringjalljen morale të kombit gjerman ndërmjet filozofisë dhe kulturës.
- Për ta gjeniu është sovran.

Epoka e gjenive
përfaqësuesit ishin në
vrullin e viteve rinore


- Në aspektin letrar lëvizja e mori emrin nga drama "Stuhi dhe Vrull" e një shkrimtari që nuk njihet.
- Filozofët - Emanuel Kanti, Johan Fihteja, Fridrih Hegeli.
- Muzikantët - Ludvig Bethoveni, Karl Veberi
- Shkrimtarët - Wolfgang Gëtja, Fridrih Shileri

Një pyetje – shumë përgjigje

– Ç'dini ju për Gëten?

– A keni lexuar diçka nga krijimtaria e tij gjeniale?

Në vazhdim, përmes *leximit të drejtuar* nxënësit nxiten të lexojnë në tekst informacionin e dhënë për periudhat e krijimtarisë së Gëtes dhe të ndëtojnë në tabelë karakteristikat e tyre më të spikatura ndërmjet metodës së klasterit. Më poshtë po prezantojmë një model



Gëtja ishte një gjeni. Ai nuk parapëlqeu të zhytej në ngjarjet e epokës, por gjithmonë mbajti një largësi të respektueshme ndaj tyre, çka e bënte fjalën e tij më të pjekur dhe më bindëse. Në kujtesën e bashkëkohësve e të pasardhësve, Gëtja zuri vend me emrin Olimpiku i Vajmarit: gjenia e tij na kujton forcën dhe vullnetin krijues të një hyji të Olimpikut.

c. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve

Në këtë çast të orës së mësimi, për të demonstruar rezultatet e arritura gjatë saj, kërkojmë nga nxënësit të angazhohen në diskutimin:

Pse themi që lëvizja “Stuhi dhe vrull” është epoka e artë e gjenive?

Ç’ të dhëna keni ju lidhur me përfaqësuesit e kësaj lëvizjeje në fusha të tjera, si filozofi dhe muzikë? Diskutojmë rreth vlerave që ata sollën.

Vlerësimi:

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë mbi përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimi. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ju jeni në moshë rinore. A vlon brenda jush ndonjë “stuhi” apo “vrull” për ide gjeniale. Mendimet tuaja shprehini në formën e një eseje.

Hulumtoni në internet lidhur me Gëten dhe krijimtarinë e tij gjeniale.

Hulumtoni rreth lëvizjes “Stuhi dhe vrull”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi njeh dhe ndërton kuptimin e duhur mbi konceptet letrare dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin hap pas hapi të letërsisë.	
Tema mësimore: Stuhi dhe vrull Gëte – gjeniu krijues			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: diskuton në grup në mënyrë konstruktive mbi temën e romantizmit; dallon zhvillimin e romantizmit dhe përfaqësuesit e tij; njeh dhe veçon lëvizjen “Stuhi dhe vrull” me tiparet e saj; fiton aftësitë e nevojshme për të kuptuar natyrën e letërsisë; njeh, kupton dhe vlerëson gjenin krijues të Gëtja.		Fjalë kyç: “Stuhi dhe vrull” klasicizmi vajmaras olimpiku i Vajmarit lirika poetike poeti dramatik themeluesi i romanit	

Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i gjuhës shqipe, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, arte, histori
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pema e mendimeve, bashkëbisedim, hartë konceptesh, leximi i drejtuar, punë e pavarur	

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, harta e koncepteve

Në fillim të orës së mësimit kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar. Dy nxënës lexojnë punimet tyre. Diskutojmë rreth tyre.

Me anë të bashkëbisedimit diskutojmë në klasë rreth koncepteve letrare që lidhen me romantizmin dhe veçanërisht me lëvizjen “Stuhi dhe vrull”.

Diskutimi përqendrohet te pyetjet e mëposhtme:

Kur u zhvillua romantizmi në Europë?

Ç’vend zë lëvizja “Stuhi dhe vrull” te kjo periudhë?

Cilat janë disa nga karakteristikat më kryesore të kësaj lëvizjeje?

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, harta e koncepteve, lexim i drejtuar, pema e mendimeve

Në këtë çast të orës së mësimit diskutimi vazhdon të përqendrohet te të dhënat e figurës së Gëtes si një gjeni krijues. Dallojmë gjatë diskutimit periudhat ku kalon krijimtaria e tij.

Më poshtë mes hartës së koncepteve mësuesja sjell në vëmendjen e nxënësve tiparet më të spikatura të krijimtarisë shumëformëshe të Gëtes. Por për të ndërtuar këto harta konceptesh mësuesja fton nxënësit që mes leximit të drejtuar të përpiqen të dallojnë në tekst tiparet e krijesisit gjeni që lëvroi të gjitha format letrare.

Lirika poetike e Gëtes.

Gëtja vlerësohet si krijuesi i poezisë së vërtetë lirike gjermane. Ai lëvroi të gjitha format poetike dhe ripërtëriu poezinë. Gëtja i përmbledhi vëllimet e shumta e të larmishme poetike me titullin e përbashkët *Poezi*.

Për Gëten, fjala *poezi* flet vetë. Ajo përfshin:

artin dhe jetën,

të vërtetën dhe misterin,

emocionin dhe mendimin,

të bukurën dhe lirinë,

pyetjen dhe përgjigjen.

Me përmbledhjen *Poezi*, Gëtja realizon një monument poetik origjinal dhe renditet ndër poetët e mëdhenj të botës.

Poezitë e tij dallohen për konkretësi, gjallëri, natyrshmëri e forcë.

Kur përmbi poetin del mendimtari, arsyeja fiton përparësi ndaj emocionit dhe poezia e thëllon karakterin meditues e filozofik.

I nxitur nga miku i tij, Herderi, që pati mbledhur e botuar një cikël të gjerë rapsodish e këngësh folklorike, Gëtja thuri shumë balada, që u bënë të famshme.

Në krijimtarinë e gjerë poetike të Gëtes, vend të veçantë zënë poezitë e vëllimit *Divani perëndimor-lindor*, me motive e frymëzim nga vendet e Lindjes. Gëzimi i jetës, dashuria, dehja, kënaqësia e çastit, erotizmi, kulti i diellit, i natyrës, e i jetës shoqërore, i japin *Divanit* të plakut Gëte një freski dhe një hijeshi të çuditshme.

Gëte – poeti dramatik

Duke qenë se fryma e lëvizjes *Stuhi dhe vrull* u përcoll në ato vite kryesisht nëpërmjet skenës (ku dialogu me publikun vendoset në mënyrë të drejtpërdrejtë), Gëtja krijoi plot vepra për teatrin, të cilave u dha forma të larmishme për të komunikuar me kategori të ndryshme njerëzish e me një numër sa më të madh shikuesish.

Në periudhën klasike, krahas veprave të mëdha *Egmonti*, *Torkuato Taso*, *Efigjenia në Tauridë*, dolën nga pena e Gëtes:

krijime dramatike të llojeve të ndryshme;

shfaqje për oborrin e Vajmarit;

drama me subjekt nga Revolucioni Francez, që shtrajnë idenë e marrëveshjes politike;

komedi gazmore dhe pjesë elegjiake.

Gëtja u shqua në zhvillimin e teatrit, veçanërisht në lëvrimin e tragjedisë:

të tragjedisë sentimentale;

të tragjedisë heroike;

të tragjedisë klasike.

Dramat *Gëci i Berlihingenit* dhe *Egmonti* kanë në qendër:

heronj të papërkulur;

gjeni të guximit e të lirisë.

Dashuria, që e flijon veten për idealet e lirisë, fiton forcë e patos të madh te veprat e Gëtes. (Bethoveni e kuptoi i pari këtë, ndaj mbi tragjedinë e Gëtes kompozoi *Egmontin* e vet.)

Por, mbi gjithçka që shkroi e la trashëgimi Gëtja, tragjedia *Fausti* radhitet e para.

Gëtja - Krijuesi i romanit gjerman

Gjatë gjithë jetës Gëtja shkroi vetëm tri romane.

Por në këto tri romane ai e ka realizuar qëllimin thelbësor të çdo proze të gjatë:

paraqitjen e jetës në kompleksitetin e saj të natyrshëm.

Romani i parë, *Vuajtjet e djaloshit Verter*, ka formën e epistolarit: heronjtë këmbëjnë

me njëri-tjetrin letra, prej nga lexuesi merr vesh për gjendjen e tyre shpirtërore dhe për ngjarjet që kanë ndodhur ndërkohë. Verteri, djalosh me kulturë e me shpirt të ndjeshëm artisti, vuan nga fanatizmi moral i kohës. Si plot të rinj intelektualë, ndien nevojën e një ndryshimi rrënjësor dhe kërkon të jetë i singertë me veten e me njerëzit.

Vuajtjet e djaloshit Verter pati sukses të jashtëzakonshëm dhe qe:

libri i parë që i siguroi letërsisë gjermane njohje botërore,

një ndër modelet më të mira të romanit psikologjik.

Me romanin *Vilhelm Majster*, Gëtja bëhet krijuesi i romanit gjerman bashkëkohor.

Me dy librat e tij: *Vitet mësimore të Vilhelm Majsterit* dhe *Vitet shtegtuese të Vilhelm Majsterit*, ai hapi udhën e romanit shoqëror-edukativ, që ka në qendër fatin e një individi dhe të disa brezave bashkë.

Vilhelm Majsteri, heroi i romanit, kalon një sere peripecish gjatë jetës rinore derisa u bë burrë. Ai gjithmonë kërkon dhe gjithmonë gjen diçka me të cilën mbush jetën. Ai u vlerësua si një ndër ngjarjet e rëndësishme të letërsisë së re.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve

Në këtë pjesë të orës së mësimin, për të demonstruar rezultatet e arritura gjatë saj, kërkojmë nga nxënësit të angazhohen në *diskutimin* e thënies së mëposhtme:

“Gjithmonë më kanë konsideruar si të privilegjuar nga lumturia... Në thelb, jeta ime ka qenë vetëm mund e punë. Mund të them fare mirë se në 75 vitet e mia nuk kam pasur më shumë se katër javë lumturie të vërtetë. Përjetësisht, guri sizifian rrëzohej dhe mua më duhej ta ngrija sërish.” (*Letër e vitit 1824, drejtuar mikut të vet Ekermanit*)

Vlerësimi:

Gjatë kësaj ore mësimore, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur

Diskutimin e filluar në klasë zhvillojeni në formën e një eseje, ndoshta duke dalë edhe nga Gëtja. Hulumtoni në internet apo edhe mes librave thënie të Gëtes dhe për Gëten.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: X
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi kupton se si përvojat letrare ndikojnë duke ndërtuar përvoja personale, vlera dhe qëndrime që vlejnë më vonë në perceptimin e botës.	
Tema mësimore: Analizë "Fausti"			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Kompetenca e të menduarit:			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: diskuton në grup në mënyrë konstruktive duke dhënë dhe marrë informacion; njuh dhe vlerëson veprën e shumëllojshme të Gëtes dhe gjeninë e tij krijues; aftësohet në analiza letrare për të kuptuar teknikat e shkrimit; diskuton rreth vlerave, strukturës, filozofisë dhe rëndësisë së "Faustit".		Fjalë kyç: Fausti Mefistofeli djall magji dashuri etapa shoqërore etapa shkencore etapa estetike etapa morale	
Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i shqipes, enciklopedi, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, arte, histori, TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve, lexim i drejtuar, ritregim, harta e koncepteve, lexim i drejtuar, metoda e Klasterit, diskutim i drejtuar.			

Organizimi i orës së mësimit**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit**

Në fillim të kësaj ore mësimi vjelim nga nxënësit nëpërmjet *bashkëbisedimit* informacionet që kanë marrë në lidhje me krijimtarinë shumëdimensionale të Gëtes dhe sidomos ç'është thënë për të. Mësuesi/ja plotëson me disa prej tyre.

Thënë nga Gëte:

Përpara se të më gjykoni, përpikuni të më kuptoni. Pyeteni veten se përse kam dashur t'i them gjërat ashtu dhe jo ndryshe.

(Poezia dhe e vërteta)

Vetëm ai që punon për t'i fituar ditë për ditë, vetëm ai i meriton lirinë dhe jetën.

(Fausti)

Një ditë e vërtetë e dëmshme është e nevojshme, sepse ajo mundet të bëjë dëm vetëm për një çast, dhe më pas na çon drejt të vërtetave të tjera, që do të jenë përherë e më të dobishme; porse një gabim i nevojshëm është i dëmshëm, sepse ai na shërben vetëm për një çast dhëna çon paskëtaj në gabime të tjera, që do të jenë përherë e më të dëmshme.

(Letër e vitit 1788, dërguar zonjës Sharlotë von Shtajn)

Thënë për Gëten

J. Gëtja do të mund ta përfaqësonte tërë letërsinë gjermane, jo pse nuk paska ndonjë shkrimtar që në një drejtim të caktuar mund të jetë më i madh se ai, po sepse vetëm ai e shpreh të plotë frymën e gjenit gjerman... thellësinë e madhe të ideve, imagjinatën plot hir, ndjeshmërinë ngaherë fantastike.

(Madamë de Stal, *Mbi Gjermaninë*)

Kur fliste, Gëtja të jepte përshtypjen se kishte mundësi t'u tregonte me gisht yjeve në qiell rrugën që ata duhej të ndiqnin.

(Hajnrih Hajne, *Me rastin e vdekjes së Gëtes*)

Vepra e Gëtes mbetet dëshmia më e mirë që mund të japë njeriu në ndihmë të dinjitetit të vet.

(Sharl Bodler, *Ese*)

Fausti sulmon Fatin dhe me forcë arrin t'i shkapëtoj atij, ditë për ditë, një grimcë më shumë nga e Vërteta.

(Romën Roland, *100-vjetori i Faustit të Gëtes*)

Gëtja në shtratin e vdekjes kërkon "Dritë!", dhe kjo është fjalë historike.

(Albert Kamy, *Dasma*)

Diskutimi shtrihet veçanërisht tek detyrat e dhëna herën e kaluar.

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, e Kllasterit, pesëvargëshi, ritregimi, lexim i drejtuar, harta e koncepteve

Në këtë pjesë të mësimit mësuesi/ja shkruan në tabelë "Fausti" dhe nxënësit ftohen që me anë të teknikës së 5-vargëshit të shprehin konceptin e tyre.

Fausti është vepra e jetës së Gëtes. Tragjedia ku pasqyrohet karakteri shumëformësh i jetës në natyrë dhe në shoqërinë njerëzore. Mes një *kllaster* pasqyrojmë burimet që i shërbyen Gëtes për të sjellë këtë kryevepër.

Legjenda e Faustit

- Fausti ishte hero i një legjende shumë të njohur, që ka një bazë historike reale. Fausti, person real, ka jetuar në fundin e shekullit XV dhe në fillimin e shekullit XVI. Ai shëtiste qytet më qytet, nëpër dhe e quante veten doktor, mburrej se zotëronte dije të shumta, si dhe artin e magjisë. Në një epokë, kur besimi në magji ishte diçka normale, rreth magjistarit shëtites mblidheshin turma të tëra njerëzish.

Realiteti i kohës ku jetonte Gëtja

- në fakt epoka e tij u cilësua si epoka e gjenive, sepse në shumë fusha të dijes dhe të artit shkëlqyen emra të mëdhenj.

Burimet e veprës

Studimet e tij

- e përmendëm gjatë jetës që kur shërbeu në oborrin e Vajmarit Gëtja u mor me: punë shteti, krijimtari, studime shkencore për mineralogjinë, paleontologjinë, botanikën, anatominë e fizikën.


Në vazhdim të procesit mësimor u kërkohet nxënësve që kanë lexuar tragjedinë të *ritregojnë* ngjarjen, duke ndërtuar subjektin dhe fabulën e saj. Mësuesja bën ndërhyrjet dhe plotësimet e nevojshme.

Pjesa I - Për të shuar etjen e madhe për dije, Fausti studion të gjitha shkencat, por më kot. Atëherë, nis të ushtrojë magjinë, me shpresë se nëpërmjet saj do të depërtojë në misterin e gjërave, por edhe kjo përpjekje nuk jep rezultat. I dëshpëruar, ai vendos të pijë helm e t'i japë fund jetës. Befas, në odën e tij, hyn melodia e kabanave, që përurojnë festën e Pashkëve. Kjo ditë e ringjalljes së Krishtit ia rikthen shpresat Faustit, i cili vendos t'i përkushtohet leximit të *Biblës*. Sakaq, shpirti i së keqes, Mefistofeli, i paraqitet dhe i premtun pushtet e lumturi, me kusht që, si këmbim, Fausti t'i japë atij kur të vdesë shpirtin e vet. Fausti i plakur mbi libra dhe i lodhur nga jeta e mbyllur e pranon marrëveshjen me djallin. Mefistofeli ia rikthen atij rininë dhe e njeh me Margaritën. Një histori e mrekullueshme dashurie zë fill ndërmjet Faustit e Margaritës: Fausti është afër lumturisë së vërtetë, por befas tek ai zgjohet epshi dhe magjia e dashurisë merr fund. Valentini, vëllai i Margaritës, del ta mbrojë me shpatë nderin e së motrës, por në gjaknxehtësi e sipër ai vritet nga dy "shokët". E turpëruar dhe e pikëlluar, Margarita e mbyt në bark fëmijën që do të lindte me Faustin dhe mbyllet në çmendinë.

Pjesa II – Në pjesën e dytë, Faustin e gjejnë në oborrin perandorak. I porositur nga perandori, ai zbrit në mbretërinë e përjetshme të Amave të jetës, prej nga sjell përpara oborrtarëve Helenën e Trojës. Fausti dashurohet marrëzisht pas gruas më të bukur të botës, bën ta kapë, por ajo është fantazmë. Megjithëkëtë, asgjë nuk është e pamundur për Faustin, i cili arrin ta ringjallë Helenën e bukur, të martohet dhe të lindë me të një djalë me emrin Euforion. Por Euforioni, fryt i brishtë i një dashurie të magjishme, dëshiron të fluturojë drejt Diellit e në fluturimin e tij ai merr edhe të ëmën. Dielli i shkrin të dy, duke i rikthyer në frymën e pasosur pas kësaj aventure të shkurtër. Fausti e kupton se udha e vërtetë që e çon njeriun drejt lumturisë, nuk është magjia fluturake, por veprimi konkret në dobi të jetës. Në këtë çast marrëveshja e tij me djallin mbaron dhe Fausti rikthehet në pleqëri e vdes. Sidoqoftë, djalli Mefistofel nuk e fiton dot bastin, sepse engjëjt zbresin për t'ia marrë shpirtin e Faustit në mbretërinë e tyre. "Ai që gjithë jetën u mundua dhe fort dëshiroi, shpëtim nga ne mund të shpresojë", këndon kori i engjëjve duke e ngritur shpirtin e Faustit në qiell, ku ai bashkohet me Margaritën.

I gjithë udhëtimi i Faustit kalon mes katër sprovash simbolike, të cilat mësuesi/ja i prezanton më poshtë mes një *klasteri* për të zbërthyer udhëtimin simbolik të Faustit.

- Fausti i Gëtes rimerr, në kushtet e reja dhe në frymën bashkëkohore, udhëtimin aventuresk të Uliksit dhe udhëtimin shpirtëror të Dantes. Ky udhëtim, i përsëritur në vende e kohë të ndryshme, tregon se çdo epokë ka nevojë të ndërmarrë udhëtimin e saj e të ketë një prijës të vetin.
- Simbolika e udhëtimeve përcillet nga njëra epokë te tjetra, nga njëri udhëtar i madh te tjetri, për të mbërritur në epokën e Gëtes dhe të aventurës së Faustit.



Etapa morale - ku ai kupton se në botë vlerat më të larta e më të arrira janë punët në dobi të jetës.

Etapa estetike - ku ai zbulon vlerat e poezisë, artit, mitit dhe kulturës.

Etapa shkencore - mes udhëtimit të tij ai kupton se natyra është e përsosur, kurse shkenca e njeriut është e kufizuar.

Etapa shoqërore - duke bashkëpunuar me institucionet e drejtësisë ai formohet si njeri shoqëror.

Në këtë çast ftojmë të gjithë nxënësit që përmes teknikës së *leximit të drejtuar* të përpiqen të ndërtojnë karakteret e personazheve. Pasi iu lihet koha e mjaftueshme për të përpiluar karakteristikat tre nxënës ndërtojnë në tabelë karakterin e personazheve të: Faustit, Mefistofelit dhe Margaritës. Më poshtë mësuesi/ja sjell një model të tillë:



Fausti:

- shpirti i ri, bashkëkohor;
- forca krijuese e njeriut ;
- njeriu i guximshëm që provon të lartësohet mes provave të rrezikshme;
- njeriu-gjeni që lufton për njerëzimin
- njeriu-vepër që jeton edhe pas vdekjes.

Margarita:

- simbol i dashurisë, pastërtisë, dlijësisë;
- simbol i zbutjes;
- simboli i humanizmit;
- simboli i shpëtimit të shpirtave;
- e përjetshmja femër.



Mefistofeli:

- djalli vetë, por me mendje inteligjente;
- mik që bën lojë të dyfishtë;
- dyzimi i vetë njeriut, pjesa djallëzore e tij;
- faktor negativ që lind kontradiktën e zhvillimit.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve

Në këtë fazë të orës së mësimin, për të demonstruar rezultatet e arritura gjatë saj, kërkohet nga nxënësit të angazhohen në *diskutimin* e mëposhtëm për vlerat e mëdha dhe filozofinë që kjo vepër mbart.

Gëtja me anë të kësaj vepre ka dashur të sjellë jo veç një tragjedi, por në fakt gjenia e tij krijuese ka mbështjellë në një pikë të vetme gati të gjitha format letrare. Mes përmes së mendimeve zbulojmë elementet që e bëjnë të tillë këtë vepër.

“Fausti” ka elemente:

- të poemës epike – sepse kori i sodit heronjtë nga jashtë;
- të dramës mister – sepse mjedisi është shumë pranë legjendës;
- të dramës qytetare – sepse linja romantike e dashurisë ndërmjet Faustit dhe Margaritës e bën të tillë;
- të romanit – sepse vepra mbart gjykime racionale estetike;
- të poezisë – sepse aty shfaqet hapur thelbi i shpirtit lirik të Gëtes.

Vlerësimi:

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimin. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënësit.

Detyrat dhe puna e pavarur

Duke pasur parasysh etapat e udhëtimit të Faustit, çiftëzoni dy prej tyre, ato që ju mendoni se janë çelësi për të arritur qëllimin. Mendimet shprehini në formën e një eseje.

Lexoni me vëmendje fragmentin e dhënë në tekst të libri i nxënësit me qëllim të kuptuarit e tij.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: X
Tematika: Epoka e romantizmit	Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.		
Tema mësimore: Koment "Fausti"			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë dhe për të zbërthyer mekanizmin e brendshëm të funksionimit të veprës; përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar; zgjeron njohuritë mbi ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike); demonstron shkathhtësitë e fituara gjatë komentit të fragmentit.	Fjalë kyç: tragjedi ide humaniste Fausti Mefistofeli protagonisti antagonisti pakt jetë dije tragjizëm		
Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i shqipes, enciklopedi, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, arte, histori, TIK		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metoda e bashkëbisedimit, puna me grupe ekspertësh, ditari dy-tripjesësh, diskutim i drejtuar, punë e pavarur.			

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, lexim i drejtuar

Në fillim të kësaj ore mësimi nëpërmjet *bashkëbisedimit* kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar.

Dy-tre nxënës lexojnë punët e tyre. Kështu nxitim diskutimin në klasë për t'u shprehur për punët e shokëve dhe shoqeve.

Në vazhdim mes *leximit të drejtuar* dhe ekspresiv lexojmë fragmentin e dhënë në tekstin e nxënësit.

Ndërtimi i njohurive të reja: puna me grupe ekspertësh, ditari dy-tripjesësh, bashkëbisedimi

Kjo fazë e zhvillimit të mësimi organizohet duke e ndarë klasën në *grupe pune* në nivel ekspertësh (pra edhe brenda grupit punët mund të pësojnë ndarje më të vogla. Kjo e fundit u lihet në dorë vetë nxënësve ta organizojnë dhe mësuesi/ja mund të vëzhgojë duke vlerësuar.)

Grupi 1 – detyrat

Gjithë dijetarët, qysh nga Sokrati grek, kanë kuptuar se njeriu nuk mund ta shterojë fushën e dijes, pasi sa më tepër mësojmë, aq më tepër gjëra për të mësuar kemi. Në cilat vargje duket kjo? Pse Fausti mendon se dituria nuk matet me natyrën?

Vargjet janë:

Studjova, ah, filozofi,

jurisprudencëe medicinë,

mjerisht edhe teologji,
që nga themeli, me zell e durim;
dhe ja ku jam unë lol trutharë
aspak më i mençur se më parë.

Model përgjigjeje - Mes tyre kuptojmë idenë e tragjizmit të dijes. Mundësitë e njeriut janë të kufizuara, ndërsa dija është e pakufizuar. Dëshpërimi i Faustit lidhet me faktin se ai ka ardhur në fund të jetës dhe nuk e ka gjetur kuptimin e saj.

Cilat detaje stilistike tregojnë se shkenca mesjetare ka ngecur në vend, pa bërë kurrfarë përparimi? Çfarë paralajmëron për jetën e Faustit shfaqja e Shpirtit të Tokës?

Disa nga figurat letrare me anë të të cilave Gëtja tregon përmnes gjuhës së Faustit se koha ka ngecur në vend janë: metaforat, epitetet, enumeracioni, shprehjet frazeologjike

Shembuj:

*lol trutharë,
kam humbur gjithë gaz e jetës,
dhaskenj të, skrivanët, papazët, doktorët,
as pronë, as pasuri, as nder,
Kështu dhe qeni s' do të rronte*

Shfaqja e Shpirtit të Tokës është paralajmërimi për ndryshimet që do të shohim tek figura e Faustit.

Fausti përcjell një botëkuptim filozofik të jetës, që pohon se njeriu lipset të synojë gjithnjë për më lart, jo duke hequr dorë nga gëzimet tokësore, por duke i vënë vetes qëllime gjithnjë e më të vështira. Po ju, a mendoni kështu?

Grupi 2 – detyrat

Gjeni vargjet që tregojnë se dëshira më e madhe e Faustit është të shkrihet me natyrën, për t'u bërë pjesë organike e harmonisë universale, ashtu si hëna dhe si shpirtërat. Ç'tregon kjo për shpirtin dhe mendjen e tij?

Çohu! Dil jashtë! N'hapësirë!...

O Shpirt i Tokës po m'afrohesh;...

Po ndjej guxim të hidhem përmes botës,...

Shpirti dhe mendja e tij janë të një gjeniu. Pavarësisht se ai ndodhet në fundin e jetës është i gatshëm të rifillojë nga e para.

Studioni: *Protagonisti dhe antagonist:*

- Siç e sugjeron titulli, Fausti është protagonist i veprës: përveç emrit, ai i jep asaj frymën e qëllimit, si edhe energjinë pohuese me të cilën është mëkuar. Si te çdokush, te Fausti dallojmë dy prirje shpirtërore: njëra e tërheq fort poshtë kah gjërat e kësaj bote, tjetra e ngre pa pushim lart drejt absolute e pafundësisë. Mbreti i skëterrës, Mefistofeli, synon t'ia shkëpusë Perëndisë shpirtin e Faustit dhe ta fitojë për vete. Për këtë qëllim, ai përdor joshjen, si armën më të sigurt për ta molepsur qenien njerëzore. Ky veprim mohues e afirmon Mefistofelin si antagonist në vepër. Fytyra e pështirosur e Mefistofelit ngjall te Fausti dëshirën për vetëpërsosje. Kontrasti e bën njeriun të kuptojë dhe të jetë në gjendje të zgjedhë udhën e vet të vërtetë.

- Në duelin sfidues të njeriut me djallin, i humbur del Mefistofeli, të cilit i duhet të vazhdojë të zhgërryhet pafundësisht në llumin e dëshirave materiale, ndërsa Fausti dhe shpirtat njerëzorë janë të aftë të aspirojnë për më lart dhe të arrijnë shumë më tepër. Por lexuesi është në çdo çast i ndërgjegjshëm se vetëm një fije peri e ndan fitoren nga humbja. Në këtë mënyrë, dueli mes protagonistit e antagonistit në veprën letrare nuk paraqitet si dyluftim didaktik, që tregon në mënyrë të thatë se i miri fiton dhe i keqi humbet, por nxjerr në pah tërë dialektikën e ndërlikuar nëpër të cilën qenia njerëzore mëson të afirmojë vetveten dhe t'i japë kuptim jetës.

Zbuloni këto elemente në këtë fragment.

Duke pasur parasysh “bastin” e Zotit me Mefistofelin nga njëra anë, dhe “paktin” e Faustit me Mefistofelin nga ana tjetër, si mendoni: njeriu, në thelbin e vet, është qenie e mirë apo e keqe? Po ju vetë, në vendin e Faustit, për ç’qëllim do ta kishit shfrytëzuar një pakt të mundshëm me Mefistofelin?

Grupi 3 – detyrat

Për të qenë sa më realist, Gëtes i duhet ta vendosë Faustin në Mesjetë, ku të gjithë besonin në skëterrë e në djaj; por, paralelisht, Gëtja i vesh Fausti mendimet e epokës së vet, asaj iluministe, që u shqua për kritikën e fesë dhe të besëtytnive. Gjeneri dhe komentoni vargjet që e shprehin këtë.

Vërtet jam m’i mençur se gjithë ata lolot
dhaskenjët, skrivanët, papazët, doktorët;
nuk më mendojnë as skrupuj, as dyshime,
s’më trembin as skëterrë, as djaj
mirëpo kam humbur gjithë gaz’ e jetës,

Fausti na paraqitet ideali i asaj epoke, i gjithëdituri, por që as veten nuk po e nxjerr dot nga errësira. Është iluministi i padritë që ka humbur kuptimin e jetës duke u dhënë kaq shumë ndër libra.

Pse Fausti vendos të merret me magji? Çfarë efekti krijon elementi i hënës?

Model përgjigjeje – Fausti vendos të merret me magji si një mënyrë për t’i shpëtuar rutinës që e kish kapluar.

Elementi i hënës nënkupton vetë misterin që ajo fsheh në errësirën e natës...

Ajo është e vetmja fije shprese për dritë në një natë të errët...

Dritën e të gjitha udhëkryqeve që njeriu mund të takojë në jetë...

Komentoni idenë e Faustit se shtëpia e njeriut është natyra, e jo ai qilari i tij i pluhurosur ku mezi hyn drita. Me ç’fjalë e paraqet autori ndryshimin ndërmjet vendit ku Fausti studion, pra, dhomës së tij, dhe objektit të studimeve, pra, natyrës. I shënoni këto fjalë në dy shtylla përballë njëra-tjetrës dhe zbuloni antitezat e mundshme. Dalloni elementet që ndryshojnë në natyrë dhe te vetë personazhi.

Sepse në fakt përshkrimi me detaje i dhomës ku Fausti ka kaluar jetën e vet, është shumë domethënës. Sipas tij çdo gjë që kalon masën kthehet në të kundërtën e vet. Librat, që janë burim i dijes njerëzore dhe dritare të botës së njeriut, vetë ato kthehen në burg për Faustin. Dija, nëse nuk të ushqen, është më e pavlefshme se vetë padija. Këtu qëndron edhe tragjizmi i Faustit. Mes ditarit dypjesësh paraqesim fjalët kyç të përshkrimit të dhomës dhe të natyrës.

dhoma	natyra
burg	drita gazplotë
birucë e nëmur	dil jashtë
dritë e turbullt	në hapësirë
xham i ngjyer	yjet
bren mola	Shpirt i Tokës
mbulon pluhuri	më rriten forcat
tavan karte i tymosur	ndizem si vera
ja bota jote	guxim të hidhem përmes botës...
botë i thënçin...	

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *metoda e bashkëbisedimit, diskutim i drejtuar*

Në këtë fazë të orës së mësimi nxënësit kanë përfunduar punën e tyre në grupet e punës dhe prezantojnë modelet e përgjigjeve. Mësuesi/ja mund të bëjë ndërhyrje nëse e sheh të nevojshme.

Pasi kemi ndërtuar tablonë e plotë të zbërthimit të tekstit diskutojmë:

Ç’lidhje kanë ndërmjet njëri-tjetrit Fausti me Mefistofelin? A janë:

- shokë;
- vëllezër;
- armiq;

- bashkëpunëtorë;
- bashkëfajtorë;
- bashkudhëtarë;
- asgjë;
- një person i dyzuar?

Zgjidhni njërën nga përgjigjet dhe argumentoni zgjedhjen tuaj.

Vlerësimi:

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur

Cili është qëndrimi i Faustit ndaj dijes dhe shkencës? Pse Fausti mund të quhet tragjedi e dijes? Ç'mendim keni ju për dijen? Pse ju duhet ajo?

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: X
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale e për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.	
Tema mësimore: Koment "Fausti"			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë dhe për të zbërthyer mekanizmin e brendshëm të funksionimit të veprës. Përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar zgjeron njohuritë mbi ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike) demonstron shkathtësitë e fituara gjatë komentit të fragmentit vëzhgon piktura dhe shpreh ndjesitë e tij emocionale		Fjalë kyç: Tragjedi Ide humaniste Në kopsht djall pakt dashuri ëndërr	
Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i shqipes, enciklopedi, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, arte, histori, TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metoda e bashkëbisedimit, puna me grupe, ditari dy-tripjesësh, lexim i drejtuar, diagrami i Venit, diskutim i drejtuar, shkrim i lirë.			

Organizimi i orës së mësimi

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *metoda e bashkëbisedimit, lexim i drejtuar*

Në fillim të kësaj ore mësimi nëpërmjet *bashkëbisedimit* kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar.

Dy-tre nxënës lexojnë punët e tyre. Kështu nxitim diskutimin në klasë për t'u shprehur për punët e shokëve.

Në vazhdim mes *leximit të drejtuar* dhe ekspresiv lexojmë me role fragmentin “Në kopsht” dhënë në tekstin e nxënësit.

Kjo teknikë nxit pjesëmarrje aktive gjatë orës së mësimi.

Ç’kuptoni me titullin e kësaj pjese? Ç’sugjeron ky titull?

b. Ndërtimi i njohurive të reja: *metoda e bashkëbisedimit, puna me grupe, diagrami i Venit, ditari dypjesësh*


Në episodin përpara këtij të titulluar “Kuzhina e shtrigës” Fausti plak ka përfituar nga magjtitë e djallit Mefistofel dhe rinohet. Kështu ai mund të bëjë realitet të gjitha ëndrrat e tij, edhe ato më të guximshmet. Fausti e di se në këtë botë nuk ka ardhur për të soditur, por tashmë ai e di se rinia është vetëm për atë që di ta gëzojë. Me ndërmjetësinë e Mefistofelit dhe Martës ai fiton dashurinë e Margaritës dhe ndien sakaq se ëmbëlsia e femrës është më e fortë se tërë aromat e botës.

Për të realizuar ndërtimin e njohurive të reja, mësuesi/ja e ndan klasën në *grupe pune* duke i nxitur në bashkëpunim. Çdo grupi i jep detyrat përkatëse.

Grupi 1 – detyrat

Margarita është një vajzë krejt naive dhe krejt shpirtpastër. Ajo nuk ka kulturë librash, po ka shumë kulturë jete. Kurse Fausti që është burrë me shumë kulturë, shumë i zgjuar dhe i sprovuar “në pakt” me djallin (Mefistofelin). Atij, megjithatë, i mungon përvoja e drejtpërdrejtë e jetës. Si shpjegohet në këtë skenë fakti që këto dy natyra krejt të kundërta ushqejnë dashuri aq të madhe për njëra-tjetrën?

Ndërtojmë mes diagramit të Venit tiparet e dy figurave:



Në këtë episod, Gëtja na jep dy skena që zhvillohen në simetri të përmbysur ndaj njëra-tjetrës. Tregoni cilat janë këto dy skena simetrike dhe për ç'qëllim autori na i paraqet të dyja njëherësh.

Skenat e dhëna në fragment janë dy

Së pari – Margarita dhe Fausti

Së dyti – Marta dhe Mefistofeli

Marta është shoqëruese e Margaritës. Pikërisht Marta bëhet ndërmjetëse për takimin e Margaritës me Faustin. Mefistofeli e mban Martën me fjalë, për t'i dhënë rast çiftit që të rrijë vetëm. Përshkruani këto karaktere dy e nga dy, duke krahasuar Martën me Margaritën dhe Mefistofelin me Faustin.

Çfarë e dallon ligjërimin e Martës nga ai i Margaritës? Nisur nga fjalët që përdorin dy vajzat, tregoni ç'interesa

kanë në jetë njëra dhe tjetra? Si ndikon kjo gjë në karakterin e secilës?

Marta dhe Margarita ngjasojnë me njëra-tjetrën veç për faktin se janë femra, ndërsa në thelbin e tyre ato ndryshojnë. Dallojmë në tekst:

Margarita i drejtohet Faustit – zotëria juaj; kurse Marta i drejtohet Mefistofelit – imzot.

Nëse çifti i parë kanë dalë enkas për t'u njohur, për t'u bërë çift, në dialogun e tyre shohim që biseda rrjedh natyrshëm, ndërsa çifti i dytë, që ka për qëllim veç t'i krijojë mundësi të parit të njihen.

Fausti dhe Mefistofeli janë thelbësisht të kundërt. Ajo që i lidh është veç pakti.

Grupi 2 – detyrat

Në kuadrin e poemës, kjo mund të quhet “skena e Margaritës”, sepse me Faustin lexuesi është njohur gjerë e gjatë më parë. Kush është Margarita? Cila është jeta e saj? Çfarë e bën këtë vajzë kaq tërheqëse dhe të paharrueshme?

Margarita është ajo që Gëtja e quan “e përjetshmja femërore”, simboli i zbutjes, i përdëllimit dhe i shpëtimit të shpirtit. Në ndërlëkimin pa fund të njerëzores me djallëzoren, Margarita është një qenie e thjeshtë. Ajo beson në: moral, nder, dashuri, mëkat. Sapo Margarita del në skenë, Gëtja qëllimisht bën që Mefistofeli dhe Fausti të zbehen, duke i lënë asaj vendin e nderit.

Si e ndien veten Margarita para Faustit? Me ç'fjalë e shpreh ajo konsideratën që ka për të dhe për veten? Si e përjeton ajo dashurinë?

Për të ndërtuar këtë përgjigje, konsultohuni me diagramin e Venit dhënë më lart dhe veçanërisht zbuloni nga teksti fjalët kyç për të marrë përgjigjet e duhura.

Grupi 3 – detyrat

Tregoni çfarë shprehin këto dy vargje të Faustit: “Besomë, e dashur, ç'quajmë zgjuarsin, shpesh është rrenë e kotësi.” A mendoni se Fausti i thotë me plot bindje këto fjalë? Çfarë e shtyn Faustin që të arrijë në një përfundim të tillë?

Fausti, pasi jetoi një jetë të tërë kushtuar dijes dhe shkencës, kuptoi se ajo s'të jep asgjë, sepse ai nuk u mbush asnjëherë. Në paktin me djallin ai fitoi rininë dhe këtë mundësi të dytë nuk mund ta linte t'i shkonte dëm. Njohja me Margaritën dhe gjithë pastërtinë e saj, bëri që të lindin te ai ndjenja të cilat s'i kishte njohur kurrë më parë. Ato po, ato ishin ndjenjat që e mbushën plot dhe e bënë të kuptonte kotësinë në të cilën kishte jetuar deri atëherë.

Si reagon Fausti kur ndodhet përballë Margaritës? A është në natyrën e Faustit, këtij dijetari që i njeh misteret e gjithësisë më mirë se askush tjetër, që të mallëngjehet ose të çuditet kaq shpejt? Cili është shkaku i çudisë dhe i mallëngjimit të tij?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *metoda e bashkëbisedimi, diskutim i drejtuar*

Në këtë fazë të orës së mësimin nxënësit kanë përfunduar punën e tyre në grupet e punës dhe prezantojnë modelet e përgjigjeve. Mësuesi/ja mund të bëjë ndërhyrje, nëse e sheh të nevojshme.

Pasi kemi ndërtuar tablonë e plotë të zbërthimit të tekstit diskutojmë lidhur me faktin se:

Gëtja punoi gjashtëdhjetë vjet për tragjedinë “Fausti”. Kur e mbaroi, në verën e vitit 1831, ai u shpreh: “Tani e tutje, ditët që më kanë mbetur mund t'i quaj dhuratë. Për mua tani nuk ka më rëndësi të di a do të mund të bëj gjë tjetër dhe çfarë do të bëj.” Megjithatë, deri pesë ditë para vdekjes, Gëtja vazhdoi ta ndreqë e ta korrigjojë kryeveprën e jetës së tij, e cila u botua në formën përfundimtare disa muaj pas vdekjes së tij, në shtator të vitit 1832.

– Ç'do të thotë kjo?

Vlerësimi:

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimin. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur

A bëjnë për njëri-tjetrin Margarita dhe Fausti? Ç'shpresë ka që dashuria e tyre të realizohet?

Përshkruani figurën e Margaritës.

Mendimet tuaja hidhini në letër në formën e një eseje.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi njih dhe ndërton kuptimin e duhur mbi konceptet letrare dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin hap pas hapi të letërsisë.	
Tema mësimore: V. Hygo – Pena e artë e romantizmit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> diskuton në grup në mënyrë konstruktive mbi temën e romantizmit; <input type="checkbox"/> dallon zhvillimin e romantizmit dhe përfaqësuesit e tij; <input type="checkbox"/> fiton aftësitë e nevojshme për të kuptuar natyrën e letërsisë; <input type="checkbox"/> njih, kupton dhe vlerëson penën e artë të Hygoit. 		Fjalë kyç: epoka romantike pena e artë franceze poeti tribun ndërgjegjja e popujve jehona e shekullit poeti profet	
Burimet: teksti i letërsisë, e-libri, fjalor i shqipes, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, arte, histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pema e mendimeve, bashkëbisedimi, harta e koncepteve, leximi i drejtuar, punë e pavarur, vëzhgimi</i>			

Organizimi i orës së mësimin**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, harta e koncepteve**

Në fillim të orës së mësimin kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar. Dy nxënës lexojnë punimet tyre. Diskutojmë mbi to.

Përmes bashkëbisedimit diskutojmë në klasë rreth koncepteve letrare që lidhen me romantizmin. Diskutimi përqendrohet te pyetjet e mëposhtme:

- Kur u zhvillua romantizmi në Europë?
- Cilat ishin disa nga karakteristikat më kryesore të kësaj periudhe?

Për të gjitha këto ndërtojme në tabelë harta konceptesh për të rikujtuar edhe njëherë romantizmin dhe zhvillimin e tij.

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, metoda e kllasterit, lexim i drejtuar, pema e mendimeve, vëzhgimi

Në këtë fazë të procesit mësimor nxënësve iu drejtojmë pyetjen:

- Ç'dini për romantikun V. Hygo?

Hedhim në tabelë informacionet që kanë nxënësit lidhur me figurën e tij dhe rolin që pati në zhvillimin e romantizmit. Mësuesi/ja bën sistemimin dhe plotësimin e informacionit për të ndërtuar të plotë figurën e këtij kolosi. Më poshtë, për të pasqyruar jetën dhe vlerat e Viktor Hygoit prezantojmë dy kllastera:

Viktor Hygoi lindi në Bézanson të Francës Lindore.

- Bir i një oficeri të ushtrisë napoleoniane.
- 15 vjeç vargjet e para mbërritën në Akademinë Franceze.
- Mbreti Luigj-Filipi i dha Hygoit titullin Par i Francës.
- Pas revolucionit u zgjodh deputet i Asamblesë Kushtetuese.
- Për të vlerësuar krijimtarinë e tij u cilësua: “poeti tribun”, “ndërgjegjja e popujve”, “jehona e shekullit”, plaku i mençur i kombit francez”

<p>Viktor Hygo (1802-1885)</p> <p>Hygoi lindi dhe u rrit bashkë me shekullin duke i njohur nga afër të gjitha ulje-ngritjet historike, politike, shoqërore e kulturore të shekullit ku jetoi.</p>		
<p style="text-align: center;">Në aspektin historik</p> <p>Revolucioni Francez me parullën: "Liri, barazi, vëllazëri" i ndërroi drejtimin historisë franceze dhe jo vetëm.</p>	<p style="text-align: center;">Në aspektin letrar</p> <p>Ndodhi një revolucion edhe në letërsi. Romantizmi francez mundi traditën dyshekullore të klasicizmit duke sjellë erën e re. Ngritën në kult ndjenjën përkundrejt arsyes, natyrës, lirisë krijuese</p> <p>V. Hygoi ndeshi i pari normat e klasicizmit duke i thyer ato.</p> <p>Data 25 prill 1830 mbahet si data simbolike e fitores së romantizmit mbi klasicizmin.</p>	<p style="text-align: center;">Në aspektin shoqëror</p> <p>Shoqëria u hap drejt politikave të reja dhe mendimeve iluministe. Arti u bë pronë shpirtërore e njerëzve.</p>

Në vazhdim të orës së mësimit përmes *leximit të drejtuar* nxisim nxënësit të dallojnë në tekstin e tyre penën e artë të Hygoit që spikati në gjini të ndryshme letrare. Me anë të *pemës së mendimeve* një nxënës prezanton në tabelë veçoritë e krijimtarisë së këtij kolosi të letrave. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën plotësimet e nevojshme.

Poeti Hygo - Vëllimet poetike të tij njohin tri motive: lirike, filozofike, satirike.

Vëllimet lirike janë më të pasura nga rinia në pleqëri.

- Karrierën poetike e nisi me: "Oda e Balada"; "Orientale"; "Soditjet" (monument i poezisë franceze, poetizoi historinë shpirtërore të individit);

- tetralogjinë me vëllimet "Gjethet e vjeshtës", "Këngët e muzgut", "Zërat e brendshëm", "Rrezet dhe hijet";

- vëllimet e pleqërisë "Këngët e rrugëve e të pyjeve", "Katër erërat e shpirtit" shënjojnë fillimet e poezisë moderne parnasiane dhe simboliste.

Poezia filozofike - Vëllimi "Legjenda e shekujve" poezi të periudhës së mërgimit. Kalim nga njeriu i shpellës tek ideali. Tri seri librash: kohët antike, koha e mesme, kohët moderne. Kjo vepër është quajtur "vepër ciklopikë", kurse Hygoi "Homeri filozof".

Satira politike - "Ndëshkimet" vëllim poetik ku mbizotëronin poezitë me karakter satirik dhe demaskues nën frymëzimin e muzës "urrejtje". Figura e Bonapartit shfaqet si prototipi i tiranisë duke e denoncuar si uzurpator. Vëllimi nis me poemën Nox - simbol i natës së zezë të terrorit dhe mbaron me poemën Lux - simboli i dritës dhe së ardhmes.

Figuracioni i pasur me metafora, antiteza, animizma, simbole. Poezia e Hygoit shërbeu si model në vargëzimin frëng, falë teknikës së lartë poetike dhe patosit njerëzor.

Në këtë fazë përmes teknikës së vëzhgimit nxisim nxënësit të dallojnë ngjashmëritë e imazhit me vargjet e dhëna në tekst. Diskutojmë mbi to.

Hygoi dramaturg – këtë zhanër e lëvroi pikërisht në kohën kur "lufta" ndërmjet klasicizmit dhe romantizmit ishte në kulmet e veta. Mësuesi/ja prezanton në tabelë mes *pemës së mendimeve* tiparet e teatrit të Viktor Hygoit.

Tiparet e teatrit të tij:

- Subjektin e veprave e merr nga historia e afërt e Francës apo vendeve fqinje.
- Ruan strukturën e pesë akteve në vargje aleksandrine.
- Intriga arrin disa pika kulmore radhazi duke shkuar deri tek e jashtëzakonshmja dhe e pabesueshmja.
- Heronjtë janë tipa të gjallë e plot energji, të furishëm, agresivë e shumë të ndjeshëm.
- Monologët lirikë janë thelbi i këtij zhanri.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim i drejtuar, punë e pavarur

Por përmbi të gjitha Viktor Hygoi me krijimtarinë e tij i dha një vend nderi letërsisë franceze me krijimet e tij në prozë, të cilat pasqyruan thellësisht njeriun e shekullit të ri, njeriun revolucionar. Te veprat e tij gjejmë të gërshetuara të gjitha llojet: filozofiken me historiken, epiken me idiliken. Romani i parë madhor i tij është "Katedralja e Parisit", kurse romani i fundit është "Viti '93". Në vazhdim nxënësit nxiten mes *punës së pavarur* të shprehin mendimet e tyre lidhur me shprehjen e mëposhtme të V. Hygoit dhe t'i sjellin ato mes *diskutimit të drejtuar*:

"Revolucioni letrar e ai politik kanë gjetur tek unë pikën e takimit..."

Vlerësimi:

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim diagnostikues me qëllim identifikimin e njohurive paraprake, interesave apo aftësive që kanë nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Për disa nxënës mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim për përgjigjet me gojë me anë të shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur

- Hulumtoni – sillni në klasë thënie nga Hygoi dhe thënie për Hygoin.
- Komentoni vargjet:

"Përpara njeri! Nënshtrimi ndaj robërimit

Është tradhtia më e madhe që mund t'i bësh njerëzimit".

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënët: Nxënësi kupton se si përvojat letrare ndikojnë duke ndërtuar përvoja personale, vlera dhe qëndrime që vlejné më vonë në perceptimin e botës.	
Tema mësimore: Analizë "Katedralja e Parisit"			
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> diskuton në grup në mënyrë konstruktive duke dhënë dhe marrë informacion; <input type="checkbox"/> njeh dhe vlerëson veprën e shumëllojshme të Hygoit dhe penën e tij të artë; <input type="checkbox"/> aftësohet në analiza letrare për të kuptuar teknikat e shkrimit; <input type="checkbox"/> interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin "Katedralja e Parisit". 		Fjalë kyç: Parisi katedralja Klod Frolo Febus Kuazimodo Esmeralda e bukura e shëmtuara	
Burimet: teksti i letërsisë, e- libri, fjalor i shqipes, vepra, enciklopedi, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, arte, histori, TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve, lexim i drejtuar, ritregim, harta e koncepteve, lexim i drejtuar, metoda e Kllasterit, diskutim i drejtuar.</i>			

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit

Në fillim të kësaj ore mësimi vjelim nga nxënësit nëpërmjet *bashkëbisedimit* informacionet që kanë marrë në lidhje me krijimtarinë shumëdimensionale të Viktor Hygoit dhe sidomos ç'është thënë për të.

- Ç'përfaqëson Viktor Hygoi?
- Cila është domethënia e tij letrare?
- Pse themi që ai është poeti tribun, ndërgjegjja e popujve, jehona e shekullit?

Dy-tre nxënës lexojnë detyrat e dhëna herën e kaluar dhe shokët e shoqet mund të shprehen duke vlerësuar punimet e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, një pyetje-shumë përgjigje, e Kllasterit, pesëvargëshi, ritregimi, lexim i drejtuar, harta e koncepteve

Me anë të teknikës "një pyetje-shumë përgjigje" ftojme nxënësit të bëhen pjesëmarrës aktivë të orës së mësimi.

- Ç'kuptoni me titullin e romanit "Katedralja e Parisit"?

Pasi sjellin zbërthimet e tyre kuptimore lidhur me këtë sintagmë, i nxisim nxënësit të thelohen në zbërthim mes metodës së *pesëvargëshit* të sjellin të organizuara mendimet

Pesëvargësh

1 emër – oaz

2 mbiemra – i qetë, i bukur

3 folje – reflekton, pastron, frymëzon

1 fjali – Katedralja duhet të jetë oazi i bukur që pastron shpirtat.

1 sinonim – vend kult

Për të ftuar nxënësit në bashkëbisedim dhe për të nxitur imagjinatën e tyre, mësuesi/ja prezanton në klasë përmes një kllasteri mjedisin ku zhvillohen ngjarjet në romanin “Katedralja e Parisit”.



Në zemër të Europës ndodhet Franca; në zemër të saj kryeqyteti i Europës, **Parisi**.

Në zemër të Parisit gjarpëron lumi Sena, e ndahet në dysh për të përqafuar ishullin e Katedrales.



Në zemër të Katedrales zemra e veprës, personazhet: Klod Frolo, Kuazimodo, Esmeralda.

Në vazhdim të orës së mësimit nxënësit që kanë lexuar veprën, përpiqen të sjellin në klasë përmbajtjen e veprës duke e ritreguar atë. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura. Prezantojmë në tabelë me anë të pemës së mendimeve karakteret e personazheve të veprës.

Esmeralda

dielli që shndriti papritur bodrumet e Parisit.
magneti që tërhoqi rreth vetes gjithçka.
femra fatale që u ndezi ethet e mishit tërë meshkujve.

Kuazimodo

gjysmënjeriu e gjysmëmonstra.
zbatuesi i pavetëdijshëm i vullnetit të Frolos.
ndërmjetësi mes turmës e Katedrales.

Klod Frolo

shpirti i Katedrales.
zembreku i romanit.
zëri i padukshëm që komandon.
hija që sheh, por askush nuk e sheh.

“Katedralja e Parisit” është vlerësuar si romani më përfaqësues i drejtimit letrar të romantizmit. Me anë të leximit të drejtuar nxisim nxënësit të dallojnë në tekst veçoritë e romantizmit.

- Përshkrimi madhështor i Katedrales dhe i ngjarjeve që zhvillohen rreth saj.

Rrëfimi vjen në stilin gotik: imiton arkitekturën gotike

- Stili: teknika e preferuar: kontrasti:

- Kontrasti është teknika e pëlqyer e romantikëve që ndërton tablotë mes pranëvënieve kundërshtuese.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve*

Nxënësit që kanë lexuar veprën përpiqen të sjellin ilustrimet përmes këtyre tipareve. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën plotësimet e rastit.

Pranëvënie kundërshtie

- Madhështia e rëndë e Katedrales përkundrejt gjallërisë së turmës.
- Shëmtimi i Kuazimodos përkundrejt bukurisë së Esmeraldës.
- Përçudnimi fizik i Kuazimodos përkundrejt përmasave të shpirtit të tij.
- E jashtëzakonshmja është rregulla – e përditshmja, realja janë përjashtim nga rregulla.

Diskutojmë në klasë lidhur me kundërshtitë e sjella më lart.

Vlerësimi:

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim për përparimin e vazhdueshëm e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim shoqërohet me shënime specifike për nivelet e të nxënësve.

Detyrat dhe puna e pavarur

- Si mund ta shpjegoni që një personazh i tillë si Kuazimodoja jo vetëm që luan rol qendror në roman, por edhe përmban çelësin për kuptimin e romanit, në një kohë që deri me ardhjen e Hygoit në letërsi, personazhe kryesore të veprave letrare ishin vetëm mbretërit e princat.
- Kërkoni në internet të dhëna mbi variante të ndryshme të ekranizimit të romanit “Katedralja e Parisit”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.	
Tema mësimore: Koment “Esmeralda”			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Kompetenca e të menduarit:			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë dhe për të zbrëthyer mekanizmin e brendshëm të funksionimit të veprës; <input type="checkbox"/> përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar; <input type="checkbox"/> zgjeron njohuritë mbi ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike); <input type="checkbox"/> interpreton figurat kryesore: epitetin, metaforën, kontrastin, antitezën, hiperbolën; <input type="checkbox"/> demonstroi shkathhtësitë e fituara gjatë komentit të fragmentit. 		Fjalë kyç: Esmeralda e bukura arti shoqëria mondane jeta parisiane kontrasti	
Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i shqipes, enciklopedi, foto, kompjuter, tabelë , shkumës, fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, arte, histori, TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Metoda e bashkëbisedimit, lexim i drejtuar, punë në grupe ekspertësh, diskutim, rrjeti i diskutimit, punë në çift, punë me grupe, ditari dypjesësh, ditari trepjesësh, punë e pavarur</i>			

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, diskutim i drejtuar


Në fillim të kësaj ore mësimi nëpërmjet *bashkëbisedimit* kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar. Dy-tre nxënës lexojnë punët e tyre. Kështu nxësim diskutimin në klasë për t'u shprehur për punët e shokëve. Nxënësit kanë kërkuar më herët në internet informacion lidhur me filmat e ndryshëm prodhuar mbi subjektin e romanit “Katedralja e Parisit” dhe në këtë çast zhvillojmë diskutimin mbi të.

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve, puna me grupe ekspertësh, rrjeti i diskutimit, ditari dy-trepjesësh

Në këtë fazë të orës së mësimi ndërtojmë skemën e karakteristikave të personazheve dhe lidhjet e tyre të varësisë. Nxënësit plotësojnë “orën” e kësaj vepre me anë të teknikës së pemës së mendimeve.

Për të realizuar këtë etapë të orës mësimore me anë të *leximit të drejtuar* lexojmë fragmentin e dhënë në tekstin e nxënësit.

Klasën e ndajmë në grupe pune dhe nxënësit punojnë në grup me detyrat e mëposhtme:



Grupi 1

- Vini re që Esmeralda nuk del në skenë, vetëm komentohet efekti që ka mbi spektatorët. Për ç'qëllim e bën autori këtë?

Model përgjigjeje: Edhe në këtë fragment autori thekson rolin që ka Esmeralda dhe efektin që ka ajo për t'i ftuar të gjithë rreth vetes diku me dashje e diku pa dashje, madje edhe vetë njerëzit e artit joshen prej bukurisë së saj. Edhe pse ajo nuk del fizikisht në këtë fragment autori qëllimisht i mëshon efektit që ajo ka mbi të tjerët. Esmeralda është bërë poli magnetik që tërheq drejt vetes pa dallim vullnetet pozitive e negative; femra fatale që ua ndez ethet e mishit tërë meshkujve: kapitenit bukurosh Febys, murgut të trishtë Frolo, Kuazimodos së shëmtuar e mbarë turmës gumëzhitëse të lypsarëve, kusarëve, parazitëve e poetëve, që festojnë rreth saj. Qëllimi pse autori e bën këtë është ndoshta fakti se boshti i veprës nuk është ai që duket Klod Frolo që zotëron gjithçka, por ajo, Esmeralda, cigania që nuk ka asgjë veç bukurisë së saj.

- Dihet që Mesjeta ishte pikërisht periudha mes Antikitetit dhe kohëve të reja që po vinin dhe si e tillë u shoqërua me ndryshimin e mënyrës së jetesës së të gjitha shtresave shoqërore, duke çuar në zhvillimin e sensit më praktik të të jetuarit. Si mendoni, a ndikoi dhe kjo në mënyrën e të bërit art, i cili deri atëherë merrej me subjekte mitologjike, që nuk u përkisnin dhe aq njerëzve të zakonshëm. Gjeni ku duket kjo në tekst.

Model përgjigjeje: E kemi theksuar faktin që vetë Viktor Hygoi luajti një rol vendimtar në kthesën e madhe të letërsisë duke i thyer rregullat e ngurta të klasicizmit. Të gjithë krijimtarinë e tij e drejtoi te njerëzorja dhe e zakonshmja dhe u përpoq që t'i bënte të jashtëzakonshme. Në këtë roman kjo duket shumë qartë në rolin që personazhet kanë. Nëse kemi thënë që ai që lëviz gjithçka dhe ka në dorë të gjithë është murgu Klod Frolo, realisht nuk është. Busulla e veprës është Esmeralda. Në tekst kjo gjë duket shumë qartë nga fillimi në fund. Grenguari ishte regjisori që i kishte ftuar të gjithë dashamirësit e artit në shfaqjen e tij, por nuk mundi t'i mbante dot vëmendjet e tyre të përqendruara deri në fund sepse ajo, një vajzë e zakonshme, tërhoqi vëmendjen e të gjithëve duke i ftuar jashtë mureve të teatrit.

- Gjeni në tekst sharjet dhe shfryrjet e inatit të Grenguarit. Për ç'qëllim i vendos autori ato në gojën e një poeti dhe një "të kulturuar" si Grenguari?

Model përgjigjeje: me anë të ditarit dypjesësh .

shembulli	nënkuptimi
- Ç'turmë gomarësh dhe injorantësh janë këta parisianët!	
- o të humbur!	
- Vij t'u shoh spektatorëve fytyrat dhe u shoh vetëm shpinat!	
- Të jesh poet dhe të korrësh atë sukses që korr një sharlatan	

Nënkuptimi i këtyre fjalëve vendosur në gojën e një njeriu të artit dhe të kulturuar është edhe më therës. Zhvlerësimi i artit nga një shoqëri që është cilësuar si më artdashësja dhe më e emancipuar

Grupi 2

- Me anë të rrejtë të diskutimit nxënësit nxiten të sjellin mendimet e tyre të argumentuara.

Po	A vëreni një ndjenjë ironie në fjalët e Grenguarit?	Jo
----	---	----

A i përkasin edhe ato situatës ku ndodhet apo karakterit të tij? Ilustrojeni me pjesë nga teksti.

Model përgjigjeje: Po, në fjalët e Grenguarit shihet qartë ironia. Ironia bën pjesë në figurat e mendimit dhe në fakt atë nuk mund ta përdorin dot të gjitha masat. Te njerëz të kulturuar si ai ironia merr formën e saj të përkryer.

- Si mendoni, pse njerëzit pëlqenin më shumë karnavalet sesa një pjesë teatrore?

Model përgjigjeje:

- Mbase ishin lodhur me ngurtësinë e rregullave të klasicizmit.
 - Mbase njerëzit kishin më shumë nevojë të qeshnin e argëtoheshin në lirinë që të ofronte natyra dhe naiviteti njerëzor sesa të mësonin përmes mesazheve të ngurta që iu ofronte teatri i zhytur mes katër mureve.
- Gjeni mjetet stilistike që përdor autori për të përshkruar ngjarjen dhe personazhet, si dhe figurat letrare të përdorura.

shembulli	mjeti stilistik	kuptimi
<i>kjo rreze shprese iu shtua</i>	epitet metaforik	
<i>korteu i harbuar i papës së gastorëve</i>	
<i>zhurmë shurdhuese</i>	antitezë	
<i>po e thyejnë qafën</i>	shprehje	
<i>Shën Mëria – Esmeralda</i>	

Nxënësit plotësojnë ditarin trepjesësh.

Grupi 3

- Si e kuptoni këtë shprehje duke e pranëvënë me situatën paralele të shfaqjes së Esmeraldës jashtë?

“Ishte pikërisht çasti kur duhej të dilte në skenë Jupiteri me rrufetë e tij. Mirëpo Jupiteri po qëndronte i palëvizur përposh në skenë.”

Model përgjigjeje: Situata ndërtohet me figurës së kontrastit. Ashtu si Jupiteri që zotëron fuqi të papërshkueshme, edhe Esmeralda ishte e zakonshme me fuqi të jashtëzakonshme. Hygoi shquhet për kthesat e befasishme të ngjarjeve dhe situatave, dhe kjo është një e tillë. Në *çastin* më kulmor të shfaqjes humbet vëmendja e spektatorëve. Lind pyetja për diskutim: A kishte qenë ndonjëherë aty vëmendja e tyre?

- A gjeni ndonjë fenomen që mbetet bashkëkohor edhe sot lidhur me profesionin e artistit? Komentojeni.

Nxënësit sipas këndvështrimit të tyre shprehin mendimet.

- Gjeni përshkallëzimin e precipitimit të ngjarjes që përshkruhet.

Zhënjimi i artistit dhe intelektualit.

Ilustrimi – *Po unë budallai? Vij t'u shoh spektatorëve fytyrat dhe u shoh vetëm shpinat! Të jesh poet dhe të korrësh atë sukses që korr një sharlatan, i cili shet nuska!*

Humbja totale e vëmendjes madje edhe e vetë aktorëve.

Ilustrimi – *Mishel Zhirbon, – klithi poeti i inatosur, – Ç'po bën aty ti? Ky është roli yt? Hip në skenë!*

Humbja e vëmendjes së pjesës më të madhe të spektatorëve.

Ilustrimi – *Sidoqoftë, – mendoj Grenguari, – edhe këta mjaftojnë për të dëgjuar fundin e misterit tim. Janë pak vërtet, por është një publik i zgjedhur, një publik i kulturuar.*

Vënia në skenë e një pjese teatrale.

Ilustrimi – *Ne me kënaqësi mund t'i bëjmë të ditur lexuesit tonë se, gjatë tërë kësaj skene, Grenguari dhe drama e tij kishin qëndruar të patundur.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, puna në grupe ekspertësh

Për të realizuar këtë fazë të orës së mësimit me anë të *metodës së bashkëbisedimit* diskutojmë mbi detyrat e dhëna grupeve të punës. Grupet e ekspertëve prezantojnë në klasë modelet e tyre të përgjigjeve dhe ftojnë nxënësit e tjerë në diskutim.

Detyrat dhe puna e pavarur

- Përshkruani si e imagjinoni ju Esmeraldën.

Për të realizuar këtë detyrë nxënësit mund të shfrytëzojnë të gjitha aftësitë e tyre artistike.

Vlerësimi:

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim për përparimin e vazhdueshëm e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënësve. Disa nxënës vlerësohen me shkrim për detyrat e sjella në klasë. Nxënësit nxiten për të realizuar punë cilësore me qëllim plotësimin e dosjes së tyre dhe vlerësimin e saj nga mësuesi/ja.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit	Situata e të nxënësve: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.		
Tema mësimore: Koment "Shtylla e turpit"			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Kompetenca e të menduarit:			

<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë dhe për të zbërthyer mekanizmin e brendshëm të funksionimit të veprës; <input type="checkbox"/> përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar; <input type="checkbox"/> zgjeron njohuritë për ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike); <input type="checkbox"/> interpreton figurat kryesore: epitetin, metaforën, kontrastin, antitezën, hiperbolën; <input type="checkbox"/> demonstroi shkathtësitë e fituara gjatë komentit të fragmentit 	<p>Fjalë kyç: shtylla e turpit e bukura e shëmtuara e mira e keqja e moralshmja e pamoralshmja</p>
<p>Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i shqipes, enciklopedi, foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, arte, histori, TIK</p>
<p style="text-align: center;">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Metoda e bashkëbisedimit, lexim i drejtuar, punë në grupe ekspertësh, diskutim, rrjeti i diskutimit, punë në çift, punë me grupe, ditari trepjesësh, puna e pavarur.</i></p>	

Organizimi i orës së mësimin

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, lexim i drejtuar

Në fillim të kësaj ore mësimi nëpërmjet *bashkëbisedimit* kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar. Dy-tre nxënës lexojnë punët e tyre. Kështu nxisim diskutimin në klasë për t'u shprehur për punët e shokëve dhe shoqeve.

Në vazhdim, me anë të *leximit të drejtuar*, lexojmë fragmentin e dhënë në tekstin e nxënësit.

Por para tij nxënësit nxiten të përfshihen në zbërthime kuptimore.

- Ç'mund të thoni lidhur me titullin e kësaj pjese "Shtylla e turpit"?

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, puna me grupe ekspertësh, rrjeti i diskutimit

Për të realizuar këtë fazë të orës mësimore, klasën e ndajmë në grupe pune dhe nëpërmjet punës në grup nxënësit punojnë me detyrat e mëposhtme:

Shënim. Punohen ushtrimet e rubrikës "Reflektoni për kuptimin" për të arritur në thellësi të të kuptuarit.

Grupi I – Ushtrimi 1:

- *Si jepet përshkrimi i Kuazimodos?*
- *Pse një përshkrim i atillë mbetet në mendje?*

Grupi II – Ushtrimi 2:

- *Si sillet turma me Kuazimodon?*
- *Si reagon ai ndaj turmës.* (Nxënësit nënvizojnë folje që shprehin sjellje dhe veprime.)

Grupi III – Ushtrimi 3:

- *Cili është roli i Esmeraldës?*
- *Çfarë simbolizon gjesti i saj?*

Të tria grupet nënvizojnë figurat letrare që hasin gjatë leximit.

Modele përgjigjesh:

Ushtrimi 1: *Kuazimodoja ishte shurdh, por për të parë shihte mirë... pickimeve prej mushkonje.*

Fytyra e tij nuk shprehte as turp, as turbullim. Ai ishte shumë larg shoqërisë njerëzore... ç'është turpi. Po

ngadalë... syri i tij prej ciklopi.

Fytyra e fatziut u zbut, zemërimi... shpëtimtarin e tij. Reja e zezë mbuloi... dëshpërim të thellë.

Ushtrimi 2:

A. Të gjithë ishin të gëzuar kur e panë Kuazimodon te shtylla. Turma e amatorëve me thumbin e talljes. I hodhi turirit një copë sfungjer të njomur në një pellg me llucë.

Turma u ngashërye e zuri të duartrokiste.

B. Së pari ai i hodhi turmës... i shponin plagën.

Zuri të hidhej... e shtyllës së turpër.

Atëherë... ta këputë kularin.

Kuazimodoja i hodhi një vështrim të dëshpëruar.

Ushtrimi 3: Nga turma doli një vajzë e veshur me rroba të çuditshme.

Realizohet pranëvënia e të kundërtave:

Shëmtimi i Kuazimodos – bukuria e Esmeraldës.

Siguron lidhjen: bukuria e saj – me fisnikërinë e shpirtit të Kuazimodos.


Sjellja e saj ndryshon turmën.

Ushtrimi 4: Për këtë ushtrim punojnë 5 nxënës që i cakton mësuesi/ja.

Në këtë fazë të orës së mësimit, me anë të diskutimit të drejtuar dhe rrjetit të diskutimit nxënësit të marrin pjesë aktive në to.

- Studioni sjelljen e turmës – zhvillohet diskutimi mbi mendimet e nxënësve.

Me anë të rrjetit të diskutimit thellojmë diskutimin



Model diskutimi

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes dhe për të arritur në përfundimin e duhur, duket lexuar edhe pjesa e parë e kërkesës së ushtrimit, si dhe fundi i fragmentit.

Ajo që shihet si e zakonshme nga shoqëria, “turma”, nuk është gjë tjetër veçse një situatë e jashtëzakonshme që thyen rregullat mbi të cilat duhet të ndërtohet një shoqëri. Fyerja, masakra nuk janë një mjet argëtimi, por ato tregojnë instinktet çnjerëzore me të cilat është ushqyer “turma”, populli i paditur.

Esmeralda – simbol i bukurisë, i së mirës, i virtytit – mësim i duhur për turmën.

Lihen nxënësit të shprehin lirisht mendimet dhe të grupohen sipas pikëpamjeve të tyre, mjafton që për zgjedhjen e tyre të sjellin argumente.

- Ushtrimi 7: Nxënësit qarkojnë alternativat duke i ilustruar me fjali:

- *Prifti uli sytë, u kthye menjëherë mbrapsht* – neveri.

- *I ra mushkës fort me mamuze sikur donte të shpëtonte* – keqdashje.

Sipas predikimit të njerëzve të fesë, njeriu duhet të tregojë dhembshuri, mirësi dhe keqardhje, gjë që nuk u zbatua nga njeriu i fesë, por nga Esmeralda.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, puna në grupe, puna e pavarur, ditari trepjesësh

Në këtë fazë të orës së mësimit, për të bërë të mundur zhvillimin e të gjitha ushtrimeve të rubrikës “Reflektoni për strukturën”, punohet sërish në grupe. Çdo grup ka detyrat e veta dhe një kohë të kufizuar për të ndërtuar modelet e përgjigjeve.

Grupi 1

- Dallohen paragrafët dhe roli që luajnë në zhvillimin e ngjarjes.

Ky ushtrim mund të punohet edhe në tekstin e nxënësit.

- Në fragment ka disa epitete që përshkruajnë në një mënyrë tepër të gjallë vuajtjet fizike e shpirtërore të Kuazimodos. Ndërsa, nga ana tjetër, kemi epitete që përshkruajnë bukurinë e Esmeraldës. Gjejini dhe tregoni efektin e tyre stilistik.

Fjalja	Figura letrare	Funksioni stilistik
<i>Fytyra e fatziut...</i>	Epitet	Përshkrim i së shkuarës dhe e tashmja
<i>Buzët e zhuritura...</i>		Përshkrimi i torturës fizike

Metafora vlerësohet si një figurë, e cila i jep një *dritësim të veçantë* objektit të emërtuar. Nënvizoni në tekst *tri metafora* kuptimplote dhe zbërtheni kuptimin e tyre.

Fjalja	Figura letrare	Funksioni stilistik
<i>Re e zymtë...</i>	Epitet metaforik	Përshkrim që paralajmëron për fatin e Kuazimodos

Grupi 2

- Shkrimi i Hygoit dallohet për forcë evokuese dhe sugjestionuese. Ai synon të prodhojë *emocione* të fuqishme. Cili çast ju duket *më emocionues* në këtë rrëfim? Në ç'mënyrë e përgatit shkrimtari shpërthimin emocional të heronjve?

Çasti më emocionues:

Esmaralda i çon ujë Kuazimodos.

- Syri i Kuazimodos shkrepiti:

- Fatkeqji zgjati buzët e tij të nxira, sikur të desh ta puthte, i hodhi asaj një vështrim që shprehte qortim dhe pikëllim të patreguar...

- Antiteza i shërben shkrimtarit romantik për të ndërtuar kontrastin ndërmjet:

- vuajtjeve të Kuazimodos – gëzimit të turmës;
- shëmtimit të Kuazimodos – bukurisë së Esmeraldës;
- egërsisë së turmës – shpirtmadhësisë së Esmeraldës.

Ilustrojini këto me tekstin.

Fjalja	Figura letrare	Funksioni stilistik
- Durimi i tij... kalitur nga kamxhiku i xhelatit... nuk u bëri dot ballë pickimeve prej mushkonje. - Një vajzë e bukur, e freskët, e kulluar, krijesë e mjerë.	Antitezë	

Grupi 3

- Kthesat e befasishme janë karakteristike e rrëfimit të Hygoit. Ku ndodh kjo në këtë fragment?

Kthesat e befasishme:

- Kjo skenë ishte vërtet madhështore...

- Edhe turma u ngashërye ...

- Hiperbola është një figurë e parapëlqyer e romantikëve: me anë të saj gjërat mund të jepen në përmasat e së jashtëzakonshmes. Gjeni në tekst *tri hiperbola* tipike dhe tregoni ç'efekt kanë ato te lexuesi.

Fjalja	Figura letrare	Funksioni stilistik
- <i>Shkreptima që lëshonte syri i tij mund të digjte.</i> - <i>Cigania do të ishte bërë shkrumb e hi.</i>	Hiperbola	

Detyrat dhe puna e pavarur

Përshkruani duke i krahasuar Kuazimodon dhe Esmeraldën, dy personazhe me ngjashmëri shpirtërore, por me kontraste fizike.

Vlerësimi

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim për progresin e vazhdueshëm të nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit. Disa nxënës vlerësohen me shkrim për detyrat e sjella në klasë. Nxënësit nxiten për të realizuar punë cilësore me qëllim plotësimin e dosjes së tyre dhe vlerësimin e saj nga mësuesi/ja

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.	
Tema mësimore: Diskutim mësimor			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> fiton aftësi për të kuptuar fragmentet e dhëna duke zbërthyer mekanizmat e brendshëm të funksionimit të letërsisë; <input type="checkbox"/> përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar; <input type="checkbox"/> demonstroi shkathtësitë e fituara gjatë komenteve të fragmenteve poetike duke bërë krahasime; <input type="checkbox"/> ndërton duke vlerësuar figurën e Hygoit, penës së artë të romantizmit. 		Fjalë kyç: Romantizmi E bukura E shëmtuara E mira E keqja Vdekja Liria	

Burimet: Teksti i letërsisë Fjalor i shqipes Enciklopedi Foto Kompjuter Tabelë Shkumës, Fletore etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Metoda e bashkëbisedimit, diskutim i drejtuar, punë e pavarur, rrjeti i diskutimit, lexim i drejtuar.</i>	

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, diskutim i drejtuar, puna e pavarur

Në fillim të kësaj ore mësimit nxënësit diskutojmë për detyrat e dhëna herën e kaluar:

- Përshkruani duke i krahasuar Kuazimodon dhe Esmeraldën, dy personazhe me ngjashmëri shpirtërore, por me kontraste fizike.

Nxënësit lexojnë punimet e tyre duke i krijuar njëri-tjetrit mundësinë e diskutimit.

- Pse thuhet se Hygoi është prijës i romantizmit francez?

Nxënësit argumentojnë duke ilustruar mendimet e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, rrjeti i diskutimit, lexim i drejtuar

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit të shprehin konceptet e tyre lidhur me:

- të bukurën dhe të shëmtuarën,
- të mirën dhe të keqen,
- të moralshmen dhe të pamoralshmen.

Me anë të metodës së bashkëbisedimit dhe rrjetit të diskutimit nxënësit shprehin lirshëm mendimet e tyre.

Diskusimi do të drejtohet nisur edhe nga konceptet e sjella përmes letërsisë dhe filozofisë.

Në vazhdim me anë të leximit të drejtuar njihemi me konceptin e V. Hygoit për dënimin me vdekje.

- Lexoni këtë mendim që ka Hygoi për dënimin me vdekje:

“Ata që gjykojnë e ndëshkojnë, e quajnë të nevojshëm dënimin me vdekje. Së pari, thonë ata, ngaqë ka rëndësi t’ia shkëpusësh bashkësisë shoqërore një anëtar, i cili e ka dëmtuar, dhe që mund ta dëmtojë ende. Bukur, nëse është fjala për kaq, burgu i përjetshëm do të mjaftonte. E ç’rëndësi do kishte vdekja? Por ju na kundërshtoni duke thënë që ka arratisje nga burgu! Atëherë zotërinj, bëjeni mirë mbikëqyrjen tuaj! Nëse nuk u zini besë fortësisë së kangjellave të hekurta, e si guxonin të keni atëherë burgje?”

S’është nevoja për xhelat aty ku mjafton rojtari i burgut. Por na thoni, nga ana tjetër, lypset që shoqëria të marrë hak, që shoqëria të ndëshkojë? Jo, kurrsesi, as njërin, as tjetrin! Hakmarrja vjen nga individi, ndëshkimi vjen nga Zoti. Shoqëria është midis të dyve. Ndëshkimi qëndron mbi të, hakmarrja nën të. Asgjë kaq e madhe dhe kaq e vogël nuk i shkon. Ajo s’ka pse “të ndëshkojë për të marrë hak”; ajo duhet të korrigjojë për të përmirësuar. Transformojeni në këtë mënyrë formulën e kriminalistëve dhe ne do ta pranojmë, do ta mbështesim.

Mbetet arsytimi i tretë dhe i fundit, teoria e shembuldhënies. Duhet bërë shembuj! Duhet trembur njerëzit me anë të ekzekutimeve, për fatin që i pret kriminelët, të gjithë ata që do të orvateshin për të bërë të njëjtën gjë!...

... Po mirë. Para së gjithash, ne e mohojmë që këtu ekzistua shembulli. E mohojmë që shfaqja e ekzekutimit shkakton efektin që pritët. Jo vetëm që popullit nuk i hapen sytë, po, përkundrazi, demoralizohet, i shkatërrojnë në vetvete çdo ndjeshmëri, madje çdo virtyt. Provat janë të shumta dhe do ta bllokoni krejt arsyetimin tonë, po qe se do t’i përmendnim. Megjithatë, po japin një fakt, ndër pesë mijë të tjerë, ngaqë është i kohëve më të fundit. Nga çasti që po shkruajmë, nuk kanë kaluar as dhjetë ditë. Është rasti i 5 marsit, dita e fundit e karnavaleve. Në Sent-Pol, menjëherë pas ekzekutimit të një zjarrvënësi të quajtur Lui Kamy, një grup njerëzish

me maska zunë të hedhin valle përreth podiumit që ende po tymonte. Hë, pra, jepini shembujt! Dita e fundit e karnavaleve ju qesh nën buzë.”

□

Një shekull pas Hygoit, cili është qëndrimi juaj ndaj kësaj çështjeje?

Me anë të rrjetit të diskutimit nxënësit sjellin disa argumente pro dhe kundër dënimit me vdekje.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, punë në grupe, punë e pavarur, ditar trepjesësh

Kjo fazë e orës së mësimit do të realizohet duke u përqendruar te thëniet e ndryshme lidhur me figurën e Hygoit. Nxënësit janë orientuar më herët të hulumtojnë rreth tyre. Me anë të diskutimit të drejtuar ndërtojmë punën për këtë fazë.

Thënie nga Hygoi:

Barazi nuk do të thotë diametër i barabartë, barazi do të thotë e drejta e të tërëve për t'u zhvilluar gjithsecili sipas diametrit të tij.

(“Gjëra të para”)

*Një mijë në qëndrofshin, do të qëndroj dhe vetë,
Po edhe njëqind në mbetshin, nuk tundem kurrsesi;
I dhjeti do të jem, po qe se mbeten dhjetë:*

E në mbettë veç një, - do të jem unë ai!

(“Ndëshkimet”)

Populli hesht. Unë do të jem përkthyesi i palodhur i kësaj heshtjeje, do të flas për memecët. Do t'u flas të mëdhenjve për të vegjlit dhe të fuqishmëve për të dobëtit. Ky është qëllimi i jetës sime. Më është ngarkuar një mision. Do të flas për të gjithë njerëzit e heshtur dhe të dëshpëruar. Do të shpreh belbëzimin e tyre të mbytur; do të shfryej qarjet dhe rënkimet e tyre; do të përkthej në gjuhë njerëzore murmurimat e turbullta të turmës, vajtimet e shprehura keq, zërat e pakuptueshëm, tërë ato britma shtazarake që vuajtja dhe padituria nxjerrin nga goja e njerëzve. Ulërima e njerëzve është e mbytur si ulërima e erës. Ata këllhasin, po askush nuk i kupton, sepse të ulërish është njëllaj si të heshtësh, e të heshtësh do të thotë të jesh i çarmatosur. Njerëzit janë çarmatosur me dhunë e thërrasin për ndihmë. E unë do t'u vete në ndihmë. Do të jem demaskues. Do të jem zëri i popullit. Raca njerëzore është në gojë dhe unë jam klithma e saj. Falë meje, gjithçka do të bëhet e kuptueshme. E kjo për të qenë një vepër e madhe.

(“Njeriu që qesh”, vëllimi II)

Thënë për Hygoin

Imagjinata është mënyra me të cilën Hygoi komunikon për gjithçka.

(E. Abry, “Histori e ilustruar e letërsisë franceze”)

Emri i plakut Hygo është i lidhur ngushtë me emrin e Republikës.

(A. Maurois, “Olimpio ose jeta e Viktor Hygoit”)

Luftë e titanëve, shpërthim ngjyrash, kapërthim i historisë, skena të paharrueshme: Revolucioni kagjetur te Hygoi njërin prej virtuozëve të tij të mëdhenj.

(G. Gengembre: Parathënie për “Vitin nëntëdhjetë e tre”)

Nxënësit janë të lirë të sjellin në diskutim thënie të gjetura prej tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkoni të dhëna mbi variante të ndryshme të ekranizimit të romanit “Katedralja e Parisit”.

Vlerësimi:

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënësve. Disa nxënës vlerësohen me shkrim për detyrat e sjella në klasë. Nxënësit nxiten për të realizuar punë cilësore me qëllim plotësimin e dosjes së tyre dhe vlerësimin e saj nga mësuesi/ja.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: X
Tematika: Punë me shkrim		Situata e të nxënit: Nxënësi njih dhe ndërton kuptimin e duhur mbi konceptet letrare, filozofike dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin hap pas hapi të letërsisë.	
Tema mësimore: Ese letraro-filozofike			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> mendon duke hedhur në fletë mendime lidhur me temën e përzgjedhur prej tij; <input type="checkbox"/> shkruan në mënyrë individuale mbi temën ku gjen veten; <input type="checkbox"/> respekton strukturën e esesë; <input type="checkbox"/> shkruan qartë, drejt dhe pa gabime duke respektuar rregullat e drejtshkrimit në gjuhën shqipe. 		Fjalë kyç: ese filozofike letrare argumentuese përshtuese	
Burimet: Teksti "Si të shkruajmë ese" B. Musai Fletë A4 me modelin e esesë Temat e dhëna Informacionet e nxënësve etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe dhe gjuhë e huaj Arte Histori	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Bashkëbisedim, shkrim i lirë, punë e pavarur

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme

Në fillim të orës mësimore nxënësve u prezantohen temat mes të cilave mund të zgjedhin një të punuar mbi të.

Temat e dhëna:

- Barazi nuk do të thotë diametër i barabartë, barazi do të thotë e drejta e të tërëve për t'u zhvilluar gjithsecili sipas diametrit të tij.*
- Vlera e së bukurës varet nga pamja apo nga thelbi?*

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesja mund t'u bëjë nxënësve një parantezë lidhur me temat duke vënë theksin aty ku synon secila nga temat

P.sh., tema e parë mund t'i orientojë nxënësit drejt gjykimit që ata kanë lidhur me të drejtën si koncept sa civil, aq edhe filozofik. Kur themi e drejtë duket sikur nënkuptojmë favorizim, por realisht në thelb e drejta përbëhet nga detyrime, të cilat lidhin veten tonë me botën dhe anasjellas. Megjithatë nxënësit janë të lirë të mendojnë individualisht.

Te tema e dytë mund të përqendrohemi te koncepti i së bukurës dhe vlerat e saj. Nxënësit mund të shprehin lidhur me këtë koncept në formën e një eseje krahasuese-argumentuese. Çfarë vlerësojnë ata tek e bukura: atë që shohin apo atë që ndiejnë, të dukshmes e saj apo të padukshmen, formën apo përmbajtjen...

Kujdes! Nxënësit duhet me doemos të bëjnë diferencën në punët e tyre mes tekstit të thjeshtë dhe modelit të

esesë, nisur edhe nga fakti që kjo nuk është përvoja e parë e shkrimit të esesë.

Ora e parë - temat e mësipërme mund të punohen nga nxënësit si modele paraprake esesh duke zhvilluar mendimet e tyre.

Ora e dytë - përgjatë orës së dytë nxënësit do të punojnë në fletët e përgatitura nga mësuesi/ja për të shkruar modelet përfundimtare të eseve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në përfundim të orëve mësimore, nxënësit duhet të dorëzojnë produktin e punës me shkrim.

Vlerësimi:

Gjatë këtyre orëve mësimore nxënësit sollën një produkt esaje, i cili do të vlerësohet me notë në mënyrë individuale për çdo nxënës. Në vlerësimin e esesë mësuesi/ja do të ketë parasysh:

- shtjellimin e idesë të sjellë nga nxënësi;
- organizimin e mendimeve të tij në mënyrë të strukturuar;
- stilin dhe origjinalitetin me të cilin nxënësi trajton idenë në punën e tij;
- respektimin e rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore të gjuhës shqipe.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: Xh. Bajroni, poeti i lirisë		Nxënësi njeh dhe ndërton kuptimin e duhur për konceptet letrare dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin hap pas hapi të letërsisë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> diskuton në grup në mënyrë konstruktive për temën e romantizmit; <input type="checkbox"/> dallon zhvillimin e romantizmit dhe përfaqësuesit e tij; <input type="checkbox"/> fiton aftësitë e nevojshme për të kuptuar natyrën e letërsisë; <input type="checkbox"/> njeh, kupton dhe vlerëson personalitetin e Xh. Bajronit. 		Fjalë kyç: Epoka romantike Lirizëm Romantizëm Poet melankolik Poet energjik Bajronizëm Formë rrëfimtare Përjetim emocional	
Burimet: Teksti i letërsisë e-libri Fjalor i shqipes Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pema e mendimeve, metoda e bashkëbisedimit, një pyetje-shumë përgjigje, harta e koncepteve, lexim i drejtuar, diskutim i drejtuar, pema e mendimeve, punë e pavarur.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *metoda e bashkëbisedimit, harta e koncepteve*

Në fillim të orës së mësimit kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar. Dy nxënës lexojnë punimet tyre. Diskutojmë mbi to.

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët **lirizëm** dhe **romantizëm** dhe mes bashkëbisedimit kërkon nga nxënësit të tregojnë ku qëndron lidhja ndërmjet tyre.

Lirizëm = Romantizëm


Nxënësit rikujtojnë njohuritë që kanë marrë për *lirizmin* (të shprehësh ndjenjat) dhe romantizmin (gjendja shpirtërore e njeriut që ëndërron për një jetë më të mirë).

Për të gjitha këto ndërtojnë në tabelë harta konceptesh.

Lirizmi dhe romantizmi:

- poezi e ndjenjës, e brendësisë
- poeti shprehet në vetën e parë
- veta I - veta e unit personal, njerëzor
- ka ambicie drejt universale
- gjëja më e shtrenjtë është liria

Më poshtë prezantojmë dy modelet e poetëve romantikë.




Ndërtimi i njohurive të reja: *metoda e bashkëbisedimit, një pyetje-shumë përgjigje, metoda e kllasterit, lexim i drejtuar, pema e mendimeve*

Në këtë fazë të procesit mësimor nxënësve u drejtojmë pyetjen:

– Ç'dini për Xhorxh Bajronin?

Hedhim në tabelë informacionet që kanë nxënësit lidhur me figurën e tij dhe rolin që pati në zhvillimin e romantizmit. Mësuesi/ja bën sistemimin dhe plotësimin e informacionit për të ndërtuar të plotë figurën e këtij

personaliteti. Me anë të metodës së kllasterit prezantojmë profilin e poetit të lirisë që frymëzoi breza të tërë poetësh të rinj anembanë Europës.



Mes metodës së *leximit të drejtuar* dhe *bashkëbisedimit* ndërtojmë në këtë fazë të orës së mësimin të dhëna mbi analizën e njëres prej veprave më të arrira të Bajronit, me anë të së cilës duket qartë misioni i tij si poet i lirisë.

“I burgosuri i Shilonit” – poemë liriko-epike ku shkrihet natyrshëm **forma rrëfimtare** dhe **përjetimi emocional**.

- Në qendër të veprës vendoset një hero i jashtëzakonshëm në një situatë të jashtëzakonshme.
- Rrëfimi zhvillohet në vetën e parë për ta ftuar më pranë lexuesin, për ta bërë më emocional dhe të besueshëm rrëfimin.
- Heroi ndodhet i burgosur në qelinë e një kështjelle bashkë me pesë vëllezërit e tij, në të njëjtën qeli ku më parë kishte vdekur i ati i tyre. Ata janë bashkë, por njëkohësisht të vetmuar.
- I vetmi vend për t’i përhumur dhimbjes për heroin është dritarja e vogël prej nga vjen një erë lirie.
- Vepra i kushtohet heroit historik **Fransua Bonivarit** që ka jetuar në shek. XVI. Ky hero është një **Promete** i kohës së re i lidhur mes hekurash duke duruar heroikisht dhimbjen që vdekja i merr para syve jetët e vëllezërve të tij.


Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim i drejtuar, metoda e kllasterit, punë e pavarur

Në këtë fazë të orës së mësimin kërkojmë nga nxënësit pjesëmarrje në diskutim lidhur me krijimtarinë e Bajronit.

Diskutimin e drejtojmë veçanërisht te vlerat që pati në thelb vepra e këtij prijësi të romantizmit europian.

- Krijimtaria e Bajronit pas luftrave napoleoniane njohu një përhapje të gjerë në mbarë Europën dhe shërbeu si model frymëzimi për brezat e rinj.
- Heronjtë e tij dallohen për një shpirt shumë të ndjeshëm por heroik dhe të paepur.
- Inteligjenca e tyre e lartë dhe virtytet shpirtërore i veçojnë nga të tjerët, duke i bërë të mbyllen në një vetmi krenare.

Më poshtë thellohemi te koncepti i bajronizmit dhe përmes *metodës së kllasterit* paraqesim vlerën e saj.



Bajronizmi – Bajroni krijoi një tip heroi karakteristik, vetmitar dhe melankolik, kryelartë dhe rebel, të zvjerdhur nga shoqëria dhe mjedisi i tij, disi të mistershëm, por gjithmonë pasionant dhe të prirë për ta shfaqur lartësinë shpirtërore në vepra sublime. Inteligjenca e lartë dhe vetitë shpirtërore e veçojnë nga të tjerët, duke e bërë të mbyllet në një vetmi krenare. Nga ndikimi i dyfishtë i Bajronit dhe i heronjve të tij krijohet kështu një “frymë” e veçantë romantike, që u quajt “bajronizëm”.

Në vazhdim nxënësit nxiten me anë të *punës së pavarur* të shprehin mendimet e tyre lidhur me shprehjen e mëposhtme të Bajronit dhe t’i sjellin ato përmes *diskutimit të drejtuar*:

“Kur dikush merr rrokullimën, të gjithë bëhen trima kundër atij që po bie...”

Vlerësimi:

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim diagnostikues me qëllim identifikimin e njohurive paraprake, interesave apo aftësive që kanë nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Për disa nxënës mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhduar me gojë me anë të shënime specifike për nivelet e të nxënës.

Detyrat dhe puna e pavarur: Hulumtoni e sillni në klasë thënie për Bajronin dhe nga Bajroni.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënës: Nxënësi kupton se si përvojat letrare ndikojnë duke ndërtuar përvoja personale, vlera dhe qëndrime që vlejné më vonë në perceptimin e botës.	
Tema mësimore: Analizë “Shtegtimet e Çajld Haroldit”			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Kompetenca e të menduarit:			

<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> diskuton në grup në mënyrë konstruktive duke dhënë dhe marrë informacion; <input type="checkbox"/> njeh dhe vlerëson veprën e Bajronit dhe personalitetin e tij artistik; <input type="checkbox"/> aftësohet në analiza letrare për të kuptuar teknikat e shkrimit; <input type="checkbox"/> interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “Shtegtimet e Çajld Haroldit”. 	<p>Fjalë kyç:</p> <p>Pelegrinazh Poemë liriko-epike Haroldi Liria e popujve Hero kolektiv Strofë spenseriane Perla të bukurisë</p>
<p>Burimet:</p> <p>Teksti i letërsisë e- libri Fjalor i shqipes Vepra Enciklopedi Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p><i>Metoda e bashkëbisedimit, diskutim i drejtuar, pema e mendimeve, pesëvargëshi, lexim i drejtuar, harta e koncepteve, metoda e kllasterit, një pyetje-shumë përgjigje, vëzhgim.</i></p>	

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, diskutim i drejtuar

Në fillim të kësaj ore mësimi vjelim nga nxënësit nëpërmjet *bashkëbisedimit* informacionet që kanë marrë në lidhje me krijimtarinë e Bajronit dhe sidomos ç’është thënë për figurën e tij.

– Ç’përfaqëson Xhorxh Bajroni?

– Ç’domethënie letrare përcjell krijimtaria e tij?

Dy-tre nxënës lexojnë thënie të shkëputura nga krijimtaria e Bajronit apo edhe thënie të personaliteteve të ndryshme për të.

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, një pyetje-shumë përgjigje, metoda e kllasterit, pesëvargëshi, lexim i drejtuar, harta e koncepteve

Me anë të teknikës një pyetje-shumë përgjigje ftojmë nxënësit të bëhen pjesëmarrës aktivë të orës së mësimi.

– Ç’kuptoni me titullin e poemës “Shtegtimet e Çajld Haroldit”?

Pasi sjellin zberthimet e tyre kuptimore, nxisim nxënësit të thellohen në zberthim me anë të metodës së *pesëvargëshit*, në mënyrë që mendimet të paraqiten më të organizuara.

Pesëvargësh

1 emër – udhëtime

2 mbiemra – interesante, romantike

3 folje – reflekton, ëndërron, frymëzon

1 fjali – Të dalësh nga “guaska” për të gjetur veten.

1 sinonim – aventura

Në këtë fazë të orës së mësimi, nxënësit që kanë lexuar veprën, me anë të metodës së bashkëbisedimit, sjellin mendime konstruktive për të ndërtuar analizën e kësaj poeme.

- Titulli i veprës “Pelegrinazhi i kalorësit Harold” vjen nën stilin e poemave mesjetare (poeti e hedh kalorësin në udhët e botës për të mbledhur ngjarje, mbresa, peizazhe dhe gjithçka që nxit kureshtjen e lexuesit).
- Bajroni përshkruan atë që sheh. Ky është një ditar poetik i poetit nga fakti se në dorëshkrimin e këngëve heroin e tij e quan Çajld Burun, sipas mbiemrit të tij të vjetër.
- Poema “Çajld Haroldi” është një rrëfim poetik, rëndësia e së cilës është shumë e madhe si në planin shoqëror, ashtu edhe në planin poetik. Në pjesën më të madhe ajo shfaqet si artikulum i etjes së popujve për liri dhe i luftës ndaj së keqes.
- Poema “Çajld Haroldi” përbëhet nga katër këngë me mbi 500 strofa.
- Poeti zuri ta shkruante atë në Janinë, më 1809, kurse e përfundoi në Itali, më 1818.

Në vazhdim me anë të *metodës së kllasterit* mësuesi/ja prezanton në klasë strukturën e veprës

Në këngën e parë njihemi me largimin e heroit nga vendlindja dhe përshkrimin e realitetit në vendet e para në të cilat shkon (në Spanjë dhe në Portugali). Në këtë këngë spikat lufta e popullit spanjoll për çlirim, figura e vajzës nga Saragoza, e cila lë kitarën dhe këngët e dashurisë dhe me pushkë në dorë hidhet në luftën kundër pushtuesit të huaj.

Në këngën e dytë poeti i këndon udhëtimit të tij në Greqi, Shqipëri e deri në Stamboll. Një pjesë e konsiderueshme e këngës e pasqyron Greqinë e viteve 1809-1811, nën zgjedhën e Perandorisë Osmane. Poeti i këndon me admirim antikitetit të këtij vendi, së kaluarës së lavdishme, por edhe gjendjes së vështirë në të cilën ndodhej populli grek. Si rrugëdalje Bajroni thekson kryengritjen. Sipas tij “kush do lirinë, i thyen hallkat vetë”. Shtegtimin të heroit të tij në Shqipëri, Bajroni i kushton 360 vargje të këngës së dytë të poemës.


Poema “Çajld Haroldi” përbëhet nga katër këngë me mbi 500 strofa. Poeti nisi ta shkruante atë në Janinë, më 1809 dhe e përfundoi në Itali, më 1818.

Në këngën e katërt poeti përshkruan Italinë. Shkruan për të kaluarën e lavdishme të këtij vendi duke përmendur figurat e rëndësishme, si Ciceronin, Cezarin, Bokaçon, Danten, Petrarkën e shumë të tjerë. Në qendër të vëmendjes është shpresa e poetit për fitoren e popullit italian ndaj atyre që kishin copëtuar vendin.

Këngën e tretë Bajroni e shkroi më 1816, gjatë qëndrimit të tij në Zvicër. Aty bëhet fjalë për luftërat e Napoleonit, dhe qëndrimin e Haroldit ndaj Republikës Franceze të shek.bXVIII. Poeti përmend këtu filozofët iluministë francezë Rusoin e Volterin, që cilësohen si “titanë të mendjes”.

- Poema shquhet për tematikën e pasur shoqërore dhe gërshetimin e shumë përvojave njëherësh.
- Popujt dhe lufta e tyre për çlirim përbëjnë boshtin tematik të poemës.
- Harta e shtegtimin të heroit u shtri nga Portugalia e robëruar, Spanja e përgjakur, fati i zymtë i Greqisë së lavdishme, Shqipëria, mëma e rreptë e burrave të egër, drejt Italisë, atdheut të mbretërve dhe lulishtes së botës.
- Poeti beson në të ardhmen dhe lirinë e popujve, ndaj edhe entuziazmohet.
- Ai zbulon një hero të ri letrar, heroin kolektiv, popullin, i cili nuk heq dorë asnjëherë nga lufta për liri dhe demaskon parinë.

Me anë të teknikës së *leximit të drejtuar* nxitim nxënësit të dallojnë në tekst mbresat që i lanë heroit viset shqiptare. I pasqyrojmë ato më poshtë mes një kllasteri.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve, vëzhgimi

Në këtë fazë të orës së mësimi përpiqemi të ndërtojmë veçoritë e poemës më të madhe të Bajronit. Ai vetë është shprehur për të: “ U zgjova në mëngjes dhe pashë se isha bërë i famshëm”. Ndërtojmë më poshtë pemën e mendimeve ku japim tiparet thelbësore të kësaj poeme.

- Botimi i Çajld *Haroldit* është ngjarja poetike më e rëndësishme e shek. XIX.
- Ajo ndahet në katër këngë, përmban 4455 vargje të shkruara në strofa spenseriane.
- Strofa spenseriane e ka marrë emrin nga poeti anglez Edmund Spenser (ajo përbëhet nga 8 vargje dhjetërrokëshe dhe 1 varg dymbëdhjetërrokësh).
- Bajroni e zgjodhi këtë strofë, sepse ajo ia ofron të gjitha mundësitë për të kapërcyer nga përshkrimet historike te hovet lirike e deri te satira shoqërore.
- Poemat e tij u quajtën perla të bukurisë.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të vëzhgojnë me vëmendje foton e Bajronit me kostum shqiptar në tekst ose foto të mundësuar mes e-librit. Nxënësit bëjnë komentet e tyre.

Mësuesi/ja drejton pyetjen:

- Çfarë ndjesish përjetoni kur shihni Bajronin të veshur me kostum shqiptar?

Dëgjoen 2-3 mendime të nxënësve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.	
Tema mësimore: Koment “Shqipëria dhe shqiptarët”			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Kompetenca e të menduarit:			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë dhe për të zbërthyer mekanizmin e brendshëm të funksionimit të veprës. <input type="checkbox"/> Përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar <input type="checkbox"/> komenton fragmentin, duke u ndalur te:shprehësia e ndjenjave, përshkrimi madhështor i natyrës, veçoritë ekzotike; <input type="checkbox"/> komenton vargjet që portretizojnë dhe tipizojnë “Bijtë e shqipes”; <input type="checkbox"/> analizon strukturën metrike dhe funksionin e sintaksës poetike: thirrorët dhe pyetjet retorike. 		Fjalë kyç: Kulti i lirisë Kulti i natyrës Figura të sintaksës Figura të intonacionit Kuptimi romantik Kuptimi realist Vendi Natyra Traditat Zakonet	
Burimet: Teksti i letërsisë Fjalori i shqipes Enciklopedi Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Metoda e bashkëbisedimit, lexim i drejtuar, punë në grupe ekspertësh, diskutim, rrjeti i diskutimit, punë me grupe, ditari dypjesësh, ditari trepjesësh, pema e mendimeve, punë e pavarur.</i>			

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, diskutim i drejtuar, metoda e kllasterit

Në fillim të kësaj ore mësimi nëpërmjet *bashkëbisedimit* kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar. Dy-tre nxënës lexojnë punët e tyre. Kështu nxisim diskutimin në klasë për t'u shprehur për punët e shokëve. Dy nxënës të tjerë plotësojnë në tabelë veçoritë e analizës së veprës “Çajld Haroldi” sipas kllasterit të mëposhtëm:



- kulti i lirisë
- kulti i natyrës
- figura të intonacionit poetik (pyetjet retorike, apostrofat)
- figura të sintaksës poetike (enumeracione)
- figura të kuptimit (antiteza, krahasime, epitete, metafora)

- poemë liriko-epike
- Struktura: 4 këngë, 4455 vargje, strofa spenseriane
- tematika: udhëtimet e Bajronit
- motivët, mesazhi, heroi i veprës.
- gjuha, stili, analiza metrike.

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, leximi i drejtuar, pema e mendimeve, puna me grupe ekspertësh, rrjeti i diskutimit, ditar dy-trepjesësh

Për të realizuar këtë fazë të orës mësimore, nëpërmjet *leximit të drejtuar* lexojmë fragmentin e dhënë në tekstin e nxënësit.

Klasën e ndajmë në grupe pune dhe mes punës në grup nxënësit punojnë me detyrat e mëposhtme:

Shënim. Me detyrat e para çdo grup orientohet të punojë duke nënvizuar gjatë leximit që i bëhet fragmentit.

Grupi I

Tregoni arsyen që e sjell heroin në brigjet shqiptare. Ç'mendim ka ai fillimisht për shqiptarët? Nga se druhen detarët dhe a kanë ata të drejtë të kenë frikë?

Vargjet ilustruese për përgjigjen e mësipërme mund të shërbejnë:

Arsyeja

Pastaj i pa kur vetë u ranë dorë,
viktimë e dallgës s'egër n'udhë e sipër,
Kur rasti i bën të liqtë më të liq;

Frika

Rrezik të zbrisnin, ca më keq të prisnin;
Detarët kishin frikë se mos binin
N'abuz katilash; zbritën më në fund,
Gjithmonë me shpirt në dhëmbë se mos vallë
Ata q'urrejnë një soj turk' e frëngun.

Në ç'kuptim jepet bashkërenditja e fjalës **luftë** me fjalën **fitore**? Ç'tregon kjo për karakterin e shqiptarit?
Nxënësit punojnë për përgjigjen e kësaj pyetjeje në *ditarin dypjesësh*.

Vargu	Komenti i nxënësve
Haroldi pa në kullët'Ali Pashës tek niseshin në luftë e fitore	

Përcaktoni llojin e strofës me të cilën është shkruar kjo poemë. Sa vargje ka ajo?

strofa	Strofa spenseriane – përbëhet nga tetë vargje dhjetërrokëshe, të cilat përmbyllen me një varg dymbëdhjetërrokësh.
rima	Rimat e kësaj strofe organizohen në formën aba-bbc-bcc.
vargu	10-12-rrokësh

Shpjegoni kuptimin e antitezës në vargun “Ç’armiq për vdekje po sa miq besnikë”. Ç’rol luan sintaksa e vargut në shprehjen e idesë së poetit.

Vargu	Figura e kuptimit	Komenti

Me anë të rrjetit të diskutimit nxënësit nxiten të sjellin mendimet e tyre të argumentuara.

Po	A jeni dakord me thënien “Ç’armiq për vdekje, por sa miq besnikë!”?	Jo
----	--	----

Grupi II

Përshkruani gjendjen emocionale të mbërritjes së poetit në brigjet shqiptare.

Për të realizuar përshkrimin e gjendjes së poetit në brigjet shqiptare, nxënësit mund të përdorin paralelisht komentet e tyre dhe ilustrimet me vargje.

Poeti përjetimin e tij e sjell me një varg ndjesish, si: frikë, kureshtje, magjepsje, kënaqësi, respekt etj...

Ndaluni te vargu: *Gjind më pak t’egër presin ca më pak*. Për ta kuptuar drejt këtë varg, duhen mbajtur parasysh dy gjëra:

- e *para*, Bajroni shkruan për lexuesin e zakonshëm anglez, që s’ka dëgjuar të flitet për shqiptarët e prandaj ka prirjen t’i konsiderojë si të egër;
- e *dyta*, që shërben për ta anuluar idenë e parë, lidhet me faktin se Bajroni i paraqet shqiptarët si model për anglezët që e mbajnë veten për të qytetëruar, por që nuk janë “më pak të egër” se shqiptarët, përderisa këta e presin mikun në kasollet e veta, ashtu siç nuk dinë të presin lordët anglezë në sallonet e tyre. Është kjo një karakteristikë dalluese e romantikëve, që e përdorin *motivin ekzotik* si mjet për të kritikuar veset e bashkëkombësve të tyre.

Ilustrojini këtë mendim edhe me vargje të tjera nga teksti.

Ç’efekt tingullor dhe ndjesor shkakton përdorimi i pyetjeve retorike dhe thirrorëve?

figurat	shembulli	shpjegimi
pyetje retorike	<i>kush e duron si ata mundimn’ e luftës?</i> ...	
thirrur	<i>O Shqipëri ku lindi Iskanderi.</i> ...	

Në vargun “Si trima turren ku t’i çojë i pari i tyre” tregoni si mbivendoset kuptimi romantik me atë realist.

Kuptimi romantik

Shpirti liridashës, energjik dhe aktiv i shqiptarëve, që vlerësohet me syrin e një poeti romantik (*si trima turren*).

Kuptimi realist

Ushtarë të bindur të udhëheqësit të tyre (Ali Pashës) – *Ku t'i çojë i pari i tyre*.

Grupi III

Evidentoni mënyrën me të cilën Bajroni e veçon përvojën shqiptare të Haroldit nga të gjitha përvojat e tjera. Bëni komentin e vargjeve: “Të rreptë bijt’ e Shqipes! Po vetitë/ nuk u mungojnë, veç t’ishin më të arrira” Sipas jush, çfarë kupton Bajroni me më të arrira?

Vargu	Komenti i nxënësve
<i>Të rreptë bijt’ e Shqipes! Po vetitë nuk u mungojnë....</i>	

Me anë të këtij ushtrimi nxënësit mund të sjellin karakteristikat e personalitetit, cilësitë dhe ndikimin e natyrës shqiptare. Përqendrohemi te shtresimi kuptimor i mbiemrit në shkallën krahasore – *më të arrira*. Me kë i krahason ai këto cilësi?

Në takimin me suljotët poeti përdor një enumeracion veprimesh. Evidentojini ato nga vargjet e poemës duke i sjellë në tabelë mes *pemës së mendimeve*.

- U dhanë dorën
- I përcollën nëpër skërka
- Ndezën zjarr
- U thanë rrobat
- Nasqirisën llambën
- Mbushën plloskën
- Shtruan sofrën...

Ç’tregojnë të gjitha këto veprime?

Me anë të *rrjetit të diskutimit* nxënësit nxiten të sjellin mendimet e tyre të argumentuara.

Po	Ato i përkasin rrëfimit epik apo lirik?	Jo
----	---	----

Epiteti e *rreptë* përforcohet me sinonimin të *egër*, çka ia shton forcën dhe intensitetin emocional jo vetëm karakterizimit të shqiptarëve, por edhe vargut të poemës. Ilustrojini këtë mendim me vargje nga poema. Shpjegoni më pas kuptimin e epitetit metaforik: *ngjyra mashkullore*.

Vargu	Figuraletrare	Komenti
O nënë e <u>rreptë</u> burrash të egër me ngjyra <u>mashkullore</u> e <u>kuqërreme</u>	Epitet Epitet metaforik	

Pasi iu lihet koha e favorshme për të punuar në detyrat e çdo grupi nxënësit nxiten të jenë aktivë në diskutimin e çdo rubrike të dhënë. Mësuesi/ja ndërhyr nëse e sheh të nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, punë e pavarur, punë në grupe ekspertësh

Për të realizuar këtë fazë të orës së mësim, me anë të punës së pavarur aktivizojmë nxënësit të punojnë me ushtrimet 12 dhe 13 te rubrika “Reflektoni për gjuhën dhe stilin” f. 76.

Ushtrimi 12

- fjalët kyç për Shqipërinë: *Iskanderi, Iskanderi tjetër, nënë, kryqi, minaret, hënës* (simboli i besimit islam), *agimi lind* (afrimi i lirisë për popullin grek), *shkëmbi i Sulit*.
- fjalët kyç për shqiptarët: *të rreptë, armiq për vdekje, miq besnikë, trima, mikpritës e bujarë, pa lajka, të shpatës, të këngës* (të argëtimit).

Ushtrimi 13 – elementet ekzotike.

- Vendi – *shkëmbi i Sulit, çunat e Pindit, t`banat e malësorëve, kulla e Ali Pashës, bregdeti me shkëmbinj të Sulit, abuz*.
- Natyra – *pyje me selvi, zogj, bisha, njerëz të egër zën` e duken, stuhi të tundin, të tundin motin që mbron*.
- Traditat dhe zakonet – *e pritën në shtëpi me gjithë të mirat, suljotët u dhanë dorën, ... i përcuall, ... pa lajka, ndezën zjarr, u thanë rrobat ... mbushën plloshën, shtruan sofrën ... përcjellësit ia nisën këngës, me këngë apo vajtim u drodhën fustanellat*.

Detyrat dhe puna e pavarur

- Bajroni, veç lavdërimeve që u ka bërë shqiptarëve, ka vënë në dukje edhe disa të meta të tyre. Mes një eseje argumentuese sillni mendimet tuaja lidhur me të metat e karakterit të shqiptarëve që duhen përmirësuar.

Vlerësimi:

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësim. Ky vlerësim shoqërohet me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur: “Vëzhgoni dhe krahasoni” në tekst.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.	
Tema mësimore: Koment “Vajza nga Saragoza”			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Kompetenca e të menduarit:			

<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë dhe për të zbërthyer mekanizmin e brendshëm të funksionimit të veprës; <input type="checkbox"/> përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar; <input type="checkbox"/> zgjeron njohuritë mbi ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike); <input type="checkbox"/> interpreton figurat kryesore: epitetin, krahasimin, metaforën, kontrastin, antitezën; <input type="checkbox"/> demonstroi shkathtësitë e fituara gjatë komentit të fragmentit 	<p>Fjalë kyç:</p> <p>Saragoza Heroina bajroniane Nga kënga në luftë Nga dashuria drejt vdekjes E brishtë Burrërore</p>
<p>Burimet:</p> <p>Teksti i letërsisë Fjalor i shqipes Enciklopedi Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK</p>
<p style="text-align: center;">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p><i>Metoda e bashkëbisedimit, lexim i drejtuar, punë në grupe ekspertësh, diskutim, rrjeti i diskutimit, punë në çift, punë me grupe, ditar trepjesësh, punë e pavarur.</i></p>	

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, lexim i drejtuar

Në fillim të kësaj ore mësimi nëpërmjet *bashkëbisedimit* kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar. Dy-tre nxënës lexojnë punët e tyre. Kështu nxisim diskutimin në klasë për t'u shprehur për punët e shokëve. Në vazhdim, me anë të *leximit të drejtuar* lexojmë fragmentin e dhënë në tekstin e nxënësit. Nga ana tjetër, nxënësit orientohen të nënvizojnë fjalët e vështira në kuptim.

Por para tij nxënësit nxiten të përfshihen në zbërthime kuptimore.

Ç'mund të thoni lidhur me titullin "Vajza nga Saragoza"?

Ndërtojmë në tabelë një fjalorth të vogël me fjalë që nxënësit i konsiderojnë të vështira në zbërthimin kuptimor.

- *Minerva* – perëndia e mençurisë dhe e luftës për romakët, siç është Athinaja për grekët e lashtë.
- *Marsi* – perëndia e luftës (për romaket e vjetër)
- *Gorgona* – sipas mitologjisë greke është një nga tri motrat me gjarpërinj në vend të flokëve, të cilat kthenin në gur këdo që i shikonte.
- *Gali* – francez; ushtar francez.
- *amazonë* – grua luftëtare. Sipas mitologjisë greke, amazonat jetonin në një ishull dhe i urrenin burrat.
- *Febi-a*: – Apolloni sipas mitologjisë greke.

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, puna me grupe ekspertësh, rrjeti i diskutimit

Për të realizuar këtë etapë të orës mësimore, klasën e ndajmë në grupe pune dhe me anë të punës në grup punojnë me detyrat e mëposhtme:

Grupi I

Si e paraqet Bajroni vajzën nga Saragoza? Argumentoni se pamja fizike dhe virtetet morale bashkohen mrekullueshëm te portreti i kësaj vajze.

Në vargjet 5-8 të strofës 54 gjeni figurën e antitezës. Thoni si plotësohet portreti i heroinës, e cila në kohë paqeje ngjan me të gjitha vajzat e tjera, por në kohë të vështira di të bëjë zgjedhjen e duhur.

Model përgjigjeje. Poeti përpiqet ta japë sa më kompleks portretin e vajzës nga Saragoza:

- nga kënga në luftë
- nga dashuria në vdekje

Shembuj vargjesh:

*E vari në shelg kitarën...
Si trime ngjeshi shpatën e kalorësit
U sul me marshin luftarak në luftë
- sa delikate, aq edhe e fortë
Ajo që zverdhej nga një shenjë plage
E i fuste datën vaji i kukuvajkës
Tani vështron si ndeshen bajonetat
- sa femërore, aq edhe burrërore*

Dalloni vargjet ku përshkruhet fizikisht vajza nga Saragoza dhe ndikimin që ajo ka në ecurinë e luftës.

Grupi II

Ç'kuptim kanë dy vargjet e fundit të fragmentit: *Kush do të kërkonte nuse në Veri / të varfrat në shtat, të mekura, të verdha?* Veriu vendoset këtu në antitezë me Saragozën dhe me Spanjën mesdhetare, e po kështu bukuria e vajzës së Saragozës vihet në antitezë me pamjen fizike të vajzave të Veriut. Tregoni cilin vend, ose cilat vende nënkupton Bajroni me përkufizimin gjeografik "Veriu" dhe jepni komentimin e përshtatshëm.

Model përgjigjeje. Poeti e kthen vazhdimisht vëmendjen drejt vendlindjes së tij për të hequr herë pas here vija paralelesh. Edhe në këtë rast ai ndihet i mrekulluar, i magjepsur nga ajo që sheh. Kur ka shkruar këtë këngë, Bajroni sapo ishte larguar nga vendi i tij dhe Spanja me Portugalinë ishin ndalesat e tij të para. Lufta e drejtë e popullit spanjoll për të mbrojtur nderin dhe vendin nga pushtuesit u kristalizua me figurën e vajzës nga Saragoza. Ai e admiron këtë vajzë duke vendosur përballë saj vajzat londineze, të cilat i shpërfill në aspektin fizik. Te strofa 54, nëpërmjet vargut 5 nga njëra anë dhe vargjeve 8-9 nga ana tjetër, ka një antitezë të dytë, të plotësuar me metonimi dhe me metaforë. Tregoni ç'efekt realizon në poemë pranëvënia e vajzës së Saragozës me hyjnitë antike Minerva dhe Marsi.

Model përgjigjeje. Bajroni e vlerëson aq shumë figurën e kësaj vajze luftëtare të lirisë, saqë kërkon t'i mbivendosë asaj vlera dhe tipare nga më të çmuarat. Këtë e realizon duke e vendosur figurativisht vajzën nga Saragoza përballë dy hyjneshave të vlerësuar për mençurinë dhe luftën. Sipas tij këto hyjnesha s'kanë asgjë më shumë se kjo vajzë...

Grupi III

Bazuar në vargun 7 të strofës 56 *Ç'vajzë u jep zemër burrave të trembur*, tregoni ç'kuptim realizon kjo këngë në tërësinë e poemës "Çajld Harold".

Model përgjigjeje. E gjithë poema është në kërkim të frymëzimit për jetën, në kërkim të heroit. E ku më mirë se tek vetë populli autori mund ta gjente atë, frymëzimin dhe heroin njëherësh. Heronjtë më të fuqishëm sipas

romantikëve gjenden aty, në gjirin e popullit, aty ku askush nuk mendon se mund t'i gjejë...

Dalloni të gjitha figurat letrare të mundshme dhe përpikuni t'i pasqyroni ato mes ditarit tri pjesësh

figura	shembulli	kuptimi
krahasime	<i>si trim e ngjeshi shpatën e kalorësit... posi mëndafshi</i>	
epitete	<i>sytë e zez..., zënë e lehtë..., zënë e ëmbël...</i>	
inversion	<i>spanjollja vajzë</i>	
metafora	<i>u sul me marshin luftarak... i fuste datën...</i>	
antiteza	<i>të sajët sprapsen – prap' i shtyn në sulm armiku thyhet – e ndjek këmba- këmbës</i>	

Pasi i u lihet nxënësve koha e favorshme për të punuar me detyrat e mësipërme diskutojmë mbi to duke e orientuar diskutimin drejt përgjigjeve të sakta.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Metoda e bashkëbisedimit, puna në grupe, puna e pavarur, ditari trepjesësh

Në këtë etapë të orës së mësimi nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur me rubrikën "Krahasoni".

Si paraqitet nga Bajroni portreti i vajzës së Saragozës? Me cilën heroinë shqiptare do të mund ta krahasoni këtë portret:

- me Argjironë e legjendës shqiptare;
- me Shote Galicën, siç e paraqesin këtë historianët dhe shkrimtarët shqiptarë;
- me Tringën e Grudës, së cilës i këndon Fishta;
- me Shkurte Pal Vatën e periudhës komuniste?

Nxënësit ndërtojnë punët e tyre duke u nisur nga njohuritë që kanë lidhur me të dhënat e mësipërme, gjithashtu edhe të mbështetur në aftësitë, shkathtësitë dhe vlerat e fituara gjatë përvojave letrare të deritanishme.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shënim. Nëse nxënësve nuk u del koha për të përfunduar detyrën e dhënë në etapën e tretë të orës së mësimi, kjo detyrë mund të lihet si detyrë shtëpie.

Vlerësimi:

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë mbi përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimi. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit. Disa nxënës vlerësohen me shkrim për detyrat e sjella në klasë. Nxënësit nxiten për të realizuar punë cilësore me qëllim plotësimin e dosjes së tyre dhe vlerësimin e saj nga mësuesi/ja.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Epoka e romantizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.	
Tema mësimore: Diskutim mësimor			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Kompetenca e të menduarit: Kompetenca qytetare:			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë dhe për të zbërthyer mekanizmin e brendshëm të funksionimit të veprës; <input type="checkbox"/> përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar; <input type="checkbox"/> zgjeron njohuritë mbi ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike); <input type="checkbox"/> demonstroi shkathtësitë e fituara gjatë komentit të fragmentit; <input type="checkbox"/> ndërton duke vlerësuar figurën e Bajronit, poetit të lirisë. 		Fjalë kyç: Kulti i lirisë Kulti i natyrës Kuptimi romantik Kuptimi realist Vendi Natyra Traditat Zakonet	
Burimet: Teksti i letërsisë Fjalor i shqipes Enciklopedi Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK	
Metodologjiadheveprimtaritë e nxënësve <i>Metoda e bashkëbisedimit, lexim i drejtuar, punë në grupe ekspertësh, diskutim, rrjeti i diskutimit, punë në çift, punë me grupe, ditar trepjesësh, punë e pavarur.</i>			

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: metoda e bashkëbisedimit, lexim shprehës

Në fillim të kësaj ore mësimi nëpërmjet *bashkëbisedimit* kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar. Dy-tre nxënës lexojnë punët e tyre. Kështu nxisim diskutimin në klasë për t'u shprehur për punët e shokëve dhe shoqeve.

Në vazhdim, me anë të leximit shprehës lexojmë me intonacionin e duhur këngën hyrëse të poemës së Bajronit duke respektuar si notat e lirizmit të theksuar, ashtu edhe gjendjen e brengosur të poetit që po largohet nga atdheu i tij.

Ndërtimi i njohurive të reja: metoda e bashkëbisedimit, leximi i drejtuar, metoda e kubimit, punë me grupe ekspertësh, rrjeti i diskutimit, ditar dy-trepjesësh

Për të realizuar këtë fazë të orës mësimore, klasën e ndajmë në grupe pune.

Grupi I “Kënga e lamtumirës” është një perlë poetike dhe modeli më i përsosur i estetikës romantike në poezi dhe i bajronizmit në veçanti.

1. Nxënësit plotësojnë në tekst tiparet e poezisë romantike që janë shumë të dallueshme të kjo këngë. Këtë detyrë nxënësit nxiten ta punojnë mes metodës së *Kubimit*

- ikja nga realiteti;
- ndihet i vetmuar;
- ndihet i zhgënjyer
- është rebel;
- heroi lirik është i trishtuar;
- niset në kërkim të lirisë së vet individuale.

2. Kthejeni këtë poezi në një prozë poetike ku të përpiqeni të shprehni edhe mendimet tuaja personale.

Grupi II

1. Në fragmentin e shkëputur nga poema “I burgosuri i Shilonit” të Bajronit, në f. 80 të tekstit të nxënësit, gjeni dhe shkruani figurat stilistike (të kuptimit dhe të sintaksës poetike). Nxënësit janë të lirë të punojnë në tekstin e tyre ose të punojnë me anë të ditarit trepjesësh si më poshtë:

Figura	Ilustrimi	Kuptimi
metafora	<i>këmbë e krah nis ndryshk të zërë...</i>	
epiteti	<i>ati i gjurë...</i>	
inversioni	<i>mirëpo nga bindjet dorë s’hoq...</i>	
aliteracioni	<i>plak... flakë... gjak...</i>	
krahasimi	<i>të lirë s’na mbajti si flamur...</i>	

Nxënësit sjellin në kujtesë të dhënat që kanë lidhur me poemën liriko-epike “I burgosuri i Shilonit”, ku shkrihen natyrshëm **forma rrëfimore dhe përjetimi emocional**.

2. Emri i Bajronit lidhet ngushtë me veprimtarinë e tij në shërbim të çlirimit të popujve dhe të lirisë së individit. Argumentoni se në këtë kuptim, jeta dhe vepra poetike e Bajronit përputhen plotësisht.

Kjo detyrë mund të punohet me anë të rrjetit të diskutimit.

Po		Jo
	A e mbështesni mendimin se jeta dhe vepra e Bajronit përputhen me po të njëjtët interesa?	

Grupi III

1. Lexoni me kujdes fragmentin e dhënë në f. 81 në tekstin e nxënësit. Kthejeni atë në një monolog në prozë duke ruajtur tiparet e kësaj forme letrare.

2. Ashtu si të piktorët europianë të periudhës romantike, edhe te Bajroni ekzotizmi përbën një aspekt kryesor të formës letrare. Tregoni ku dhe si shprehet ekzotizmi në veprën poetike të Bajronit.

Pasi u lëmë nxënësve kohën e favorshme për t’u përgatitur për përgjigjet e duhura, diskutojmë në klasë me çdonjërin prej tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, puna në grupe, puna e pavarur, ditari trepjesësh

Në këtë fazë të orës mësimore kërkohet nga nxënësit të sjellin për diskutim thëniet që ata kanë vjelë nga burimeve të ndryshme ose nga interneti në lidhje me figurën e Bajronit apo edhe shprehje tipike të veprës së tij të shkëputura gjatë leximit të saj.

Diskutimi do të përqendrohet pikërisht në këto dy linja:

- Thënie për Bajronin
- Thënë nga Bajroni

Teksti i nxënësit mund të na shërbejë si pikënisje për këtë diskutim.

Për të përfutur shijen artistike që ka lënë ky shkrimtar, kërkohet nga nxënësit të shkruajnë atë që mendojnë ata në mënyrë të pavarur lidhur me figurën e Bajronit.

Vlerësimi:

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimet. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit. Disa nxënës vlerësohen me shkrim për detyrat e sjella në klasë. Nxënësit nxiten për të realizuar punë cilësore me qëllim plotësimin e dosjes së tyre dhe vlerësimin e saj nga mësuesi/ja.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: Letërsia romantike shqiptare		Bisedojmë së bashku rreth zhvillimeve politike e sociale të Shqipërisë në fillim të shekullit XIX.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca qytetare 4. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës, varësisht nga tema mësimore.		Fjalët kyç:	
Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> - flet për periudhën dhe kushtet në të cilat u zhvillua romantizmi shqiptar; - tregon veçoritë e romantizmit shqiptar; - liston dokumentet kryesore të lëvizjes kulturore të Rilindjes Kombëtare; - rendit emrat e disa autorëve kryesorë të Rilindjes duke interpretuar edhe disa vargje të zgjedhura prej tyre. 		Rilindje Himnizim Qarqe letrare Poemë	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Teksti i nxënësit Fragmente të ndryshme letrare nga letërsia e Rilindjes Kombëtare e-libri		Historia Artet figurative	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
<i>Një pyetje - shumë përgjigje, bisedë, tabelë e strukturuar, lojë me role.</i>			

Organizimi i orës së mësimi

Parashikimi: një pyetje - shumë përgjigje

Mësuesi/ja shtron pyetjen dhe i lë nxënësit të lirë të shprehin mendimet e tyre.


– Ç`kuptoni me termin “Rilindje” në pikëpamjen historike? Po letrare?

Termi “Rilindje” në Europë shënon në pikëpamjen historike mbarimin e Mesjetës. Në pikëpamjen letrare, termi nënkupton “rilindjen” e letërsisë greke dhe latine.

Në Shqipëri, Rilindja shfaqti edhe veçanti, që kanë lidhje me vonesat historike të sajë në rrjedhat e zhvillimit perëndimor. Në pikëpamjen historike, Rilindja është lëvizja e popullit shqiptar për çlirim kombëtar nga sundimi osman. Rilindja Kombëtare Shqiptare fillon në vitet ‘30-‘40 të shekullit XIX dhe vazhdon deri me shpalljen e Pavarësisë, më 1912.



Ndërtimi i njohurive: bisedë, tabelë e strukturuar

Bisedojmë së bashku për zhvillimet historike dhe kulturore në Shqipërinë e viteve ‘30-‘40 të shekullit XIX. Përgjigjet e nxënësve do të plotësohen nga mësuesi/ja në tabelën e strukturuar.



Bisedë

Profesor Eqrem Çabej ka thënë se letërsia jonë kombëtare vjen si rrjedhojë e komunikimit dhe e kërkesës për unisim të tri qarqeve parakombëtare letrare, që janë Qarku katolik i Shqipërisë Veriore, Qarku italo-shqiptar (arbëreshët), Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore.



Letërsia romantike tek arbëreshët e Italisë

Shkrin në vetvete shqetësime të trefishta: 1. për robërimin e atdheut të të parëve nën pushtuesit osmanë; 2. për shtypjen politike që rëndonte për ta dhe mbi popullsinë italiane nga pushtuesi i huaj; 3. për gjendjen e vështirë politike-shoqërore të arbëreshëve si pakicë kombëtare.

Synoi drejt poemës për të rikrijuar në vargje historinë e lavdishme të Skënderbeut.

Një zhvillim relativ pati drama (A. Santori).

Kishte si tipar kryesor patriotizmin.

Prirja filozofike ishte më e theksuar se në letërsinë e tokës nënë.

Përforcimi i njohurive: lojë me role

Në këtë rubrikë të fundit, mësuesi/ja drejton pyetjen: – Ç`dini për këta emra të shquar të letërsisë së Rilindjes Kombëtare, si: De Rada, Naim Frashëri, S. Frashëri, A. Santori, P. Vasa etj.? Tre nxënës do të lexojnë vargje të poetëve të mëposhtëm dhe do të flasin për aktivitetin dhe krijimtarinë e tyre.


Nxënësi I



Nxënësi II



Nxënësi III



Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për: a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin për veçoritë e romantizmit shqiptar.

b) aftësinë e secilit nxënës për të harmonizuar dhe paraqitur saktë informacionin në lojën me role.

Shënim. Vëzhgoni mënyrën e vlerësimit, e cila mund të jetë me notë ose me shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Cilat janë disa nga format më të rëndësishme letrare që u kultivuan në letërsinë romantike shqiptare? (Ushtrimi 2.)

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënit: Bisedë për aktivitetin jetësor dhe letrar të De Radës.	
Tema mësimore: Jeronim de Rada, veprimtaria letrare			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
<ol style="list-style-type: none"> Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca personale Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës, varësisht nga tema mësimore:		Fjalë kyç:	
<p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> liston llojet letrare kryesore që lëvroi De Rada në krijimtarinë e tij; bëjnë raportin ndërmjet letërsisë romantike dhe poetikës origjinale të De Radës; pranëvë përballë filozofisë romantike titullin e poemës “Skënderbeku i pafan” dhe shpjegon arsyen e emërimit të tij; vështron këndvështrimin poetik të De Radës për personazhin femër; komenton gjendjen emocionale të Serafinës nga fragmenti “Këngë e Serafinës”. 		<ul style="list-style-type: none"> De Rada Lirizmi Romantizmi Heroikja Personazhi femër Figuracion spontan 	


Burimet: Teksti i nxënësit Poema “Skanderbeku i pafan”, “Serafina Topia”, “Historia e letërsisë shqiptare”, 1983, botim i Akademisë së Shkencave e-libri	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet figurative Historia
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Bisedë, stuhi mendimi, lexim i drejtuar, kllaster, punë në grupe, lexim me kodim të tekstit</i>	

Organizimi i orës së mësimit

Parashikimi: bisedë, stuhi mendimi


Mësuesi/ja pasi kontrollon detyrën e shtëpisë dhe vlerëson një nxënës për të, u drejton pyetjen nxënësve:

- Cili është aktiviteti letrar e jetësor i Jeronim de Radës? Përgjigjet e nxënësve strukturohen përmes teknikës *Stuhi mendimi* në tabelën e zezë.



Ndërtimi i njohurive të reja: lexim i drejtuar, kllaster, punë në grupe

Orientohen nxënësit që të lexojnë në tekstin e nxënësit temën: *Veprimtaria letrare e Jeronim de Radës*, ndërkohë mësuesi/ja përmbledh në dërrasë apo në tabelën interaktive veçoritë e stilit krijues të tij.



Burimet që ushqyen krijimtarinë e De Radës


Nga poezia popullore: Drejt këtij burimi e shtynë shumë faktorë: Mungesa e një tradite të zhvilluar, pasioni i njohur i romantikëve për folklorin ku ata gjenin idealin e freskisë dhe të lirisë krijuese. Përdori një stil krejt të afërt me këngën tradicionale arbëreshe, (versionet e para të “Milosaos” dhe “Serafinës”). Merr:

- atë filozofi optimiste dhe burrërore , me të cilën shqiptari kundron jetën, vdekjen, dashurinë;
- pikëzimin e karaktereve me vija të shpejta po sa domethënëse;
- motive dhe tipare të heronjve;
- thjeshtësinë e madhërisme;
- të zhveshur nga artificet, ai merr konkretësinë dhe plasticitetin me të cilat skicon sendet e dukuritë, në ngjyrat dhe lëvizjet e tyre;
- koncizitetin e rrallë;
- hyrjet e befasishme në temë;
- larminë metrike;
- begatinë figurative.

Nga estetika e poezisë antike greke-romake:
 -harmonia statike;
 -synim drejt idealit të bukurisë së përsosur;
 -perceptim idealizues të realitetit.

Nga poezia romantike:

- dualizmi
- pakënaqësia ndaj një realiteti të caktuar;
- evolimi i frymës heroike dhe i revoltës kundër pushtuesit, heronjtë bëhen përherë më aktivë, kushtrimi për luftë kundër pushtuesit shpërthen më hapur;
- altruizmi;
- ekspresiviteti i stilit, lirizmi dhe psikologjizmi arrijnë një thjeshtësi maksimale (në fillim të krijimtarisë);
- (më vonë) romantizmi i tij merr një karakter të vrullshëm, përmes situatash e karakteresh të jashtëzakonshme, tipike dhe të romantizmit kalabrez;
- synimi me idealet më të larta, patriotike, shoqërore dhe etike, shkrihet me egocentrizmin romantik, me prirjen për të vënë në qendër individin me shqetësimet e tij, për t’u thelluar në botën e tij të brendshme;
- pasioni për të jashtëzakonshmen e të madhërishtmen, por kjo nuk i mjaftoi...;
- autobiografizmi, por jo i theksuar;
- rrëfimi lirik dhe epik;
- mbështetja në poezinë popullore nuk çoi në stilizime si romantikët e tjerë, por qe më krijuese, përdori një stil të afërt me këngët arbëreshe;
- prania e kontrasteve, por nuk mjaftohet me kaq... etj.



Punë në grupe

Grupi I- Tregon shfaqjen e poetikës origjinale, rindërtimin e heroikes dhe rrëfimin në poemën “Skanderbuku i pafan”. Grupi II- Punon ushtrimin 2. Në raport me letërsinë romantike, cilat janë elementet që e bëjnë poetikën e tij origjinale?.

Poeti nuk mjaftohet vetëm me stilin romantik, por u jep elementeve që huazon prej tij, nuanca të tjera. Në vitet e para, romantizmi në veprën e tij ka një formë të matur të zbutur nga ndikimi i poezisë antike. Më vonë, romantizmi i De Radës merr një karakter të vullshëm, gjer të stuhishëm, përmes situatash e karakteresh të jashtëzakonshme, tipike dhe të romantizmit kalabrez. Në krijimtarinë e poetit tonë, synimi tek idealet më të larta patriotike, shoqërore dhe etike, shkrihet me egocentrizmin romantik, me prirjen për të vënë në qendër individin me shqetësimet e tij, për t’u thelluar në botën e tij të brendshme. Kjo ka përcaktuar edhe shkrirjen e së ashtuquajturës “temë të madhe” me të ashtuquajturën “temë të vogël”. Duke qenë romantik, De Rada ka dhe një pasion për të jashtëzakonshmen, por e zakonshmeja luan një rol të rëndësishëm, madje poetika e së zakonshmes është specifika origjinale në krijimtarinë e tij. Autobiografizmi, një tjetër tipar romantik, vjen në përmasa të tjera filozofike dhe shoqërore në veprën e De Radës. Nuk iu drejtua kurrë rrëfimit lirik, mënyrës së parapëlqyer të romantikëve, por u dha një formë objektive ndjenjave dhe kjo bëri që lirizmi i tij t’u shpëtojë

ekzaltimeve. Huazon prej folklorit, veçse nuk mbetet në stilizime si romantikët e tjerë, por ai është më krijues. Natyra jepet me nuanca të holla e të vrazhda, me kontraste si romantikët, porse ai nuk mjaftohet me tablotë e gjera dhe të përgjithshme apo me riprodhimin e hiperbolizuar të saj. Ai është mjeshtër i detajit, i konkretes, i reales.

Grupi III- Punon dhe paraqet ushtrimin 3. Ndaluni në titullin e poemës “Skanderbuku i pafan”. Pse thuhet që ai është i pazakontë në një vepër himnizuese?

Vetë titulli i veprës, “Skënderbuku i pafan” është jo i zakonshëm për një vepër poetike romantike të himnizimit. E para, sepse heroi dhe bëmat e tij rrallë paraqiten në vepër dhe e dyta, pse për fat të keq Turqia e pushtoi Shqipërinë. Ky është një qëndrim i vetëdijshëm i autorit.

Përforcimi: lexim me kodim të tekstit

Duke komentuar vargje nga “Këngë e Serafinës”, nxënësit komentojnë gjendjet shpirtërore të Serafinës dhe të Bozdarit.

Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për: a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin nxënësit për veçoritë e botëkuptimit të De Radës.

b) aftësinë e secilit nxënës për të kombinuar dhe paraqitur saktë informacionin në punën me grupe.

Shënim. Vëzhgoni mënyrën e vlerësimit, e cila mund të jetë me notë ose me shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 4. Nga ç’këndvështrim poetik e sheh De Rada personazhin femër?

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënës: Bisedë: “Midis ndjenjës dhe detyrës”	
Tema mësimore: Analizë: “Këngët e Milosaos”			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca qytetare 4. Kompetenca personale 5. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës, varësisht nga tema mësimore: Nxënësi/-ja: - flet për strukturën e poemës; - bën raportin mes dy ndjenjave në poemë: ndjenja e dashurisë dhe ndjenja atdhetare; - specifikon botën shpirtërore të Milosaos (si një hero romantik) dhe të Rinës; - zbulon pikëpamjet etike dhe filozofike të De Radës në poemën “Këngët e Milosaos”; - justifikon këndvështrimin modern të poetit përmes veçorisë së figuracionit dhe paraqitjes së këngëve.		Fjalë kyç: Subjektivizmi lirik Dashuria Atdheu Rina Milosao Pikëpamje humaniste Elemente romantike Figurat e shprehjes	

Burimet: Teksti i nxënësit Poema “Këngët e Milosaos” e-libri	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Filozofia Historia Artet figurative
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Rrëfim i subjektit, punë me role, punë në grupe, shpjegim i gërshetuar me bashkëbisedim, plotësimi i skedës, punë në grupe.</i>	

Organizimi i orës së mësimit

Përforcimi: rrëfim i subjektit

Ritregojmë fabulën e poemës lirike-epike “Këngët e Milosaos”.

Fabula e poemës është e thjeshtë.

Milosaos, djali i despotit të Shkodrës në shek. XV, dashurohet me një vashë fshatare, Rinën, dhe për hir të kësaj dashurie ndeshet me paragjykimet patriarkale dhe klasore. Atdheu rrezikohet nga turqit dhe djali i rimposht ndjenjë e nisët për në luftë. Pas kthimit të tij nga lufta, një tërmet rrafshon Shkodrën dhe duket sikur zhduk hendekun klasor midis të rinjve, që tani janë të dy të varfër. Dy të dashurit martohen, gëzohen me një djalë dhe kalojnë një periudhë të shkurtër lumturie. Po gjithçka merr fund me vdekjen e fëmijës, të cilën e pason vdekja e gruas nga hidhërimi. Heroi i mbetur vetëm, vajton për lumturinë e humbur dhe ndien brengë që se plotësoi detyrën ndaj atdheut. Në fund nisët prapë në luftë dhe vritet duke mbrojtur qytetin e tij.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë me role, punë në grupe, shpjegim i gërshetuar me bashkëbisedim

Në krye të kësaj rubrike, mësuesi nis të shpjegojë informacionin e ri duke bashkëbiseduar me nxënësit. Cakton liderin e secilit grup, i cili paraqet detyrën e caktuar një ditë më parë. Secili grup ka përgatitur nga një veçori të poemës, kjo, sipas elementeve të analizës së tekstit letrar.

Roli I (Grupi I) Struktura e poemës “Këngët e Milosaos”. Lideri paraqet punën.

Milosaos është një vepër e ndërtuar mbi një plan të vetëm subjekti. Ajo përbëhet nga tridhjetë këngë, të cilat nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën. Autori ka futur midis tyre heshtjen si një mjet të fuqishëm artistik. Nënteksti i përdorur nga De Rada ishte në atë kohë një novatorizëm i madh. Ai nuk pasqyron veprimin, por efektin e ndjenjës, përjetimet e heronjve në kulmet e jetës.

Roli II (Grupi II) Subjektivizmi lirik.

Shkrimi i Milosaos i ka të gjitha karakteristikat e shkrimit lirik të subjektit të dashuruar: erotika me shenjat shqiptare; dashuria si ndjenjë e triumfit dhe e humbjes; si forcë themelore e shfaqjes së individualitetit; imagjinata si fushë e pakufizuar e ëndrrës së dashurisë, shpërthimi i saj individual si kacafytyje me kufizimet kolektive. Nga ana tjetër, në këtë shkrim shenja autobiografike shfaqet e drejtpërdrejtë dhe natyrale.

Roli III (Grupi III) Sistemi i personazheve.

Të gjitha idetë e tij De Rada i mishëroi në personazhet e veprës.

Nëna e Milosaos, Zonja e Madhe, ndonëse paraqitet shumë pak në veprim, me hijen e saj të rëndë ajo gjendet në të gjithë poemën. Ajo ka tiparet karakteristike të pjesës së aristokracisë shqiptare që mbrojtë interesat e vendit në shek. XV: e këshillon të birin të mos i shmanget luftës; e kundërshton rreptë martesën e Milosaos me një vajzë të varfër; e ëndërron të shoqin e së bijës si prijës të një ushtrie dhe vdes me një brengë të madhe që i biri s’po shkonte në luftë.

Rina cilësohet me bukurinë, fisnikërinë, dashurinë e gruas për Milosaon, si dhe dashurinë e nënës për fëmijën. Jeta e saj shfaq ngjalljen e jetës, për të provuar tepër shpejt trishtimin për vdekjen e fëmijës, i cili e vret në fund. Në këtë mënyrë përmbillet një tregim i dashurisë arbërore në dheun arbëror.

Milosaosja është personazh romantik i idealizuar, i sprovuar ndërmjet pasionit të detyrës, i matur me dashurinë e Rinës (vashës) dhe me përkushtim atdhetar deri në vdekje. Vepra nuk rrëfen ndodhi, por paraqet gjendje, prandaj Milosaos karakterizohet me anë të gjendjeve shpirtërore e jo të veprimeve. Këto gjendje shpirtërore plotësohen edhe me pamjet e natyrës, duke shënjuar dashurinë, dhembjen e trishtimin.

Roli IV (Grupi IV) Arti poetik.

Moderniteti i poemës qëndron në dendësinë e figurave të shprehjes, kurse lidhjet ndërmjet këngëve fshehin një dialog të imagjinuar e joreal dhe herë-herë vijnë në trajtën e monologut me tone elegjiake. Duke u mbështetur në *vargun arbëresh*, De Rada krijoi në këtë vepër *vargun e lirë të shkruar shqip*, i cili ka në bazë ritmin dhe nuk e njeh rimën, e bashkë me të edhe frazën poetike, këtë masë të vështirë dhe jo të përballueshme lehtë për vargun e lirë shqip (të mëvonshëm). Situatat reale kthehen në situata simbolike, veçanërisht pamjet e natyrës, ku elementi njerëzor shërben për të krijuar harmoninë natyrore e kozmike. Me një fjalë, për të parën herë në letërsinë shqiptare De Rada krijoi një tekst të fuqishëm poetik. De Rada shkroi në të folmen arkaike të arbëreshëve të Kalabrisë. Këtë ai e përpunoi dhe e pasuroi duke e ngritur në nivelin e gjuhës artistike, me një figuracion të pasur, që nëpërmjet lakonizmit krijon imazhe simbolike e mbresëlënëse.

Më tej, mësuesi/ja plotëson në tabelë tipare të tjera të poemës lirike-epike “Këngët e Milosaos”.

Tiparet romantike:

Në bazë të kësaj poeme, De Rada ka vënë motivin e pasionit fatkeq të dy të rinjve që i pengojnë mjedisi e rrethanat. Është një motiv i shfrytëzuar nga letërsia sentimentaliste, romantike, po shkrimtari arbëresh i ka dhënë freski dhe origjinalitet.

Prania e notave autobiografike, ndonëse “Këngët e Milosaos” u frymëzua nga dashuria e parë e De Radës me të bijën një bariu, ato janë larg së qeni thjesht “një gjerdan idilësh”, siç i ka quajtur një bashkëkohës i De Radës.

Melankolia e romantikut, ngjarjet që pasqyrohen me subjektivitetin e këndvështrimin e heroit, monologët e vajzës, këngët e korit që shprehin mendimin popullor të gjendjes shqiptare. Fryma humaniste që përshkon veprën, përmes mendimit të Milosaos.

Milosaos, heroi lirik, edhe personazh veprues. Ai mishëron heroin romantik me botë të gjerë shpirtërore, që ngrihet më lart se mjedisi, njëkohësisht dhe njeriu që kryen një faj tragjik dhe disi zbehtë nga fundi, edhe heroin luftëtar.

Rina mishëron idealin romantik të vajzës së dashuruar, të bashkëshortes dhe të nënës ideale.

Në poemë përdoret forma e vetërrëfimit, e parapëlqyer nga romantikët. Megjithatë, “Këngët e Milosaos” është një shembull tipik i parregullsisë lirike romantike.

Poezia popullore e ka ushqyer këtë vepër me frymën patriotike dhe me optimizmin e natyrshëm me të cilën populli kupton jetën, vdekjen, dashurinë etj.

Koha dhe personazhi konvencional

Vepra është vendosur në shekullin XV, kur populli shqiptar udhëhiqej nga Skënderbeu. Kjo vendosje është më tepër simbolike e konvencionale.

Elementi realist shfaqet te paraqitja e tablove të gjera të realitetit shoqëror të arbëreshëve e shqiptarëve. Me një etnografizëm e etnologjizëm të përsosur gjallon krejt jeta shqiptare e kohës. Është realist në pengesat që i vë përpara dashurisë së dy të rinjve (paragjykimet, koha e vështirë që kalonte atdheu).

Fryma humaniste: një ide e rëndësishme është ajo e kërkesës për barazi ndërmjet njerëzve, sa humane, aq dhe demokratike.

Poezia popullore e ka ushqyer këtë vepër me frymën patriotike dhe me optimizmin e natyrshëm përmes të cilit populli kupton jetën, vdekjen e dashurinë. Kjo poezi i ka dhënë veprës figuracionin e pasur dhe metrikën ku zotëron vargu i bardhë tonik.

Një element me rëndësi luan **natyra**, pothuajse gjithnjë e shkrirë me ndjenjat e personazheve. Shqetësimin e djalit gjatë grindjes me të dashurën, ai e jep me lëvizjen e deleve nëpër vathë, kurse dhembjen e tij të thellë për vdekjen e gruas, e jep përmes kontrastit me përtëritjen e përhershme të natyrës.

Në poemë zë vend kulti i gëzimit i **trashëguar nga poezia antike**, po dhe dyshimet dhe melankolia e **romantikut**. Nëpërmjet kësaj jepet dialektika e jetës njerëzore. Vepra është shkruar në vetën e parë, çka

bën që ngjarjet të shihen në këndvështrimin e heroit. Po për ta zgjeruar tablonë jepen monologët e vajzës dhe këngët e korit, që shprehin mendimin popullor të gjendjes shqiptare (arbëreshe) që merr pjesë aktive në jetën e individit.

Poeti depërton thellë në botën psikologjike të personazheve të tij dhe e pasqyron atë me një larmi nuancash. Ai përshkruan po me atë forcë shprehëse dashurinë e zjarrtë të djalit (“Veç me sy të shihemi, bota të përmbysset”), ashtu dhe ndjenjën e ndrojtur të vajzës, që nuk di t’ia shpjegojë as vetes së saj (“Nga m’erdhi te kurmi gjithë ky gëzim”). Poeti është treguar mjeshtër në dhënien e mjedisit patriarkal të fshatit, ku vajzat nuk guxojnë të dalin nga dera, veçse kur nuk “janë etërit vrenjtur”; mjedis ku sundojnë thashethemet.

Përforcimi: plotësimi i skedës, punë në grupe

Pasi klasa është ndarë në grupe të vogla, secili grup do të plotësojë nga një rubrikë të skedës së poemës. Më pas ajo paraqitet e lexohet e plotë në tabelë.

Autori	Jeronim de Rada
Titulli	“Këngët e Milosaos”
Lloji	Poemë lirike-epike
Struktura	-Është ndërtuar mbi një plan të vetëm subjekti. Përbëhet nga 30 këngë, të cilat nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën. Poeti futi midis tyre heshtjen, si një mjet të fuqishëm artistik. -Më tepër sesa veprimi, pasqyrohet efekti i ndjenjës, përjetimet e heronjve.
Boshti tematik	Motivi i dashurisë është trajtuar me një mjeshtëri të veçantë nga De Rada. Ai e sheh dashurinë më shumë sesa pasion të papërmbajtur: ajo është virtyt dhe, në botën e mbushur me vese dhe etje për pushtet, dashuria e virtyti fitojnë vetëm moralisht. Kjo ide e zbut tragjizmin e kësaj poeme (vdekja e Rinës në kulmin e lumturisë) dhe të fut në meditimin e pranimit të vdekjes si diçka e dhimbshme, por dhe e natyrshme. Motivi atdhetar është i pranishëm në të gjithë poemën. Ai duket në dashurinë që ka Milosao për vendlindjen, për njerëzit, për zakonet, te shqetësimi zonjës mëmë që i biri të shkojë në luftë. Me gojën e heroit, ai u thirri shqiptarëve dhe gjithë botës me një zë krejt të ri: “Erdhi dita e arbërit”. Idetë. Një ide e rëndësishme është ajo e kërkesës për barazi ndërmjet njerëzve, sa humane, aq dhe demokratike. Në poemë spikasin idetë filozofike dhe etike të poetit. Pas fatkeqësisë lulëzon sërish gëzimi, përpos vdekjes jeta ia vlen përsëri të jetohej. Ndjenja e së bukurës është e pranishme kudo në poemë. Pa të jeta nuk do të kishte kuptim; pa të njerëzit s’do të mund të admironin natyrën, s’do të mund të vdisnin me dinjitet. Mesazhet. Jeta është një iluzion. Dhimbja dhe lumturia i japin kuptim jetës. Pavarësisht nga vdekja, jeta ia vlen të jetohej. Jeta ka kuptim kur lëmë pas gjurmë pozitive. Dashuria dhe lumturia janë të pandashme me njëra-tjetrën. S’mund të ketë lumturi vetjake pa detyrën atdhetare etj.

Konteksti historik	<p>Ngjarjet qëllimisht janë vendosur në shek. XV, si për të treguar “Motin e madh”, zhvillimet politike-shoqërore të kësaj periudhe.</p> <p>De Rada jep dhe një pasqyrë të vërtetë të realitetit shoqëror e politik të Kalabrisë dhe Shqipërisë së viteve 1833 e më tej.</p>
Gjuha	<p>De Rada shkroi në gjuhën arkaike arbëreshe të Kalabrisë. Këtë gjuhë ai e përpunoi dhe e pasuroi duke e ngritur në nivelin e gjuhës artistike, me një figuracion të pasur, që nëpërmjet lakonizmit krijon imazhe simbolike mbresëlënëse.</p> <p>Moderniteti i poemës qëndron në dendësinë e figurave të shprehjes, kurse lidhjet ndërmjet këngëve fshehin një dialog të imagjinuar e joreal dhe herë-herë vijnë në trajtën e monologut me tone elegjiake.</p> <p>Situatat reale kthehen në situata simbolike, veçanërisht pamjet e natyrës, ku elementi njerëzor shërben për të krijuar harmoninë natyrore e kozmike. Me një fjalë, për të parën herë në letërsinë shqiptare De Rada krijoi një tekst të fuqishëm poetik.</p>
Metrika	<p>Metrika. Duke u mbështetur në <i>vargun arbëresh</i>, De Rada krijoi në këtë vepër <i>vargun e lirë të shkruar shqip</i>, i cili ka në bazë ritmin dhe nuk e njeh rimën, e bashkë me të edhe frazën poetike, këtë masë të vështirë dhe jo të përballueshme lehtë për vargun e lirë shqip (të mëvonshëm).</p>

Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për: a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin nxënësit për veçoritë e poemës “Këngët e Milosaos”.

b) aftësinë e secilit nxënës për të kombinuar dhe paraqitur saktë informacionin në punën me grupe.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 2. Pse themi që “Këngët e Milosaos” është një poemë liriko-epike?

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënës: Bisedë:	
Tema mësimore: Studim teksti: “Këngët e Milosaos”, Kënga V		“Këndvështrimi humanist dhe njeriu”	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyç:			
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit			
2. Kompetenca e të menduarit			
3. Kompetenca qytetare			
4. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			

<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës, nga tema mësimore: Nxënësi/-ja: - komenton bukur idetë e vargjeve të këngës së pestë; - zbërthen kuptimin e simboleve të detit dhe të natës; - ilustron nga fragmenti elemente romantike dhe realiste; - rendit cilësitë e Rinës dhe të Milosaos; - punon me fjalorin për të kthyer në normën standarde fjalë të së folmes arbëreshe.</p>	<p>Fjalë kyç: Figurat e shprehjes Ripërtëritja e natyrës Jeta Milosao Stina e pranverës Muza poetike</p>
<p>Burimet: Teksti i nxënësit Poema “Këngët e Milosaos” e-libri.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Filozofia Historia Artet figurative</p>
<p style="text-align: center;">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim, lexim shprehës, studim teksti, punë në grupe, ditari trepjesësh, punë e pavarur, punë me fjalorin.</i></p>	

Organizimi i orës së mësimi

Përforcimi: diskutim, lexim shprehës

Orientohen nxënësit për zhvillimin e kësaj ore mësimore. Diskutohet për detyrën e shtëpisë në lidhje me mesazhin universal që përcjell poeti në këngën e parë.

Lexim shprehës

Një nxënës komenton, shpreh me fjalët e tij/saj idetë e vargjeve të këngës.

Mendimet Milosaos i vijnë si deti, i cili është i trazuar; të jep dhe përfytyrimin se ashtu si përmbyt deti, ashtu po pushton dhe ushtria osmane vendin. E kushtrimi në shpirtin e tij është: *Erdhi dita e Arbërit! Është i gatshëm të vdesë për atdheun. Trimi mendon se nëse nuk bën detyrën ndaj atdheut, do të jetë i harruar dhe atdheun do ta pllakosë nata e zezë, siç po ndodh këtë natë, kur rreziku po i shfaqet aq pranë. E në një portë tjetër të mendjes e shpirtit të tij vlon dhe dashuria për Rinën. Veç në sy të shihemi / pa dhe bota të përmbysët. Këto dy dashuri do të mbeten përherë të pashuara në shpirtin e tij.*

Ndërtimi i njohurive të reja: studim teksti, punë në grupe, ditari trepjesësh

Për të studiuar këngën e pestë, mësuesi/ja e ndan klasën në grupe pune të mëdha, më pas, një anëtar i grupit paraqet nga një ushtrim përkatës të secilës rubrikë.

Grupi I studion pyetjet e rubrikës *Reflektoni për kuptimin*.

Ushtrimi 2. Zbuloni çfarë simbolizon *deti* për poetin arbëresh.

Në këtë fragment deti simbolizon kufirin nga vjen rreziku i armikut. Ashtu siç përmbyt deti, ashtu pushton e përmbyt armiku.

Ushtrimi 3. *Ç’atmosferë* mbizotëron te vargu ku poeti kërkon *t’i hapet një derë*? Cili është lajtmotivi i këtyre vargjeve?

Në kontrast me natën e zezë, pas derës mbizotëron një atmosferë tjetër. Vetë kënga duket sikur ndahet në dy pjesë dhe kufiri mbetet dera. Dera merr një funksion të fortë stilistik. Mjedisi i lumtur e i hareshëm brenda shtëpive pas derës, ndërsa para derës qëndron Milosao, poeti që parashikon pushtimin (nata e errët e pushtimit).

Ushtrimi 4. Në këngën V kemi dy betime (ose dëshira) njëherësh. Gjejini ato dhe thoni nëse:

- kundërshtojnë njëri-tjetrin

apo

- shkrihen natyrshëm. Argumentoni mendimin tuaj.

Në këngën e pestë shfaqen dy betime (ose dëshira) njëherësh:

-njëra lidhet me motivin e luftës: *Doemos do vdesim në shtrat...*

-tjetra me motivin e dashurisë: *Veç në sy të shihemi/ pa dhe bota të përmbysset.*

Grupi II punon rubrikën *Reflektoni për interpretimin.*

Ushtrimi 5. Shpjegoni se në ç'kuptim forca e dashurisë ngrihet mbi:

- rrezikun e luftës
- përmbysjet natyrore
- ndarjen klasore

Ushtrimi 6. A mendoni se dashuria e vërtetë mposht shumë vështirësi? Sillni shembuj nga jeta juaj ose nga librat, filmat etj.

Grupi III punon rubrikën *Reflektoni për gjuhën dhe stilin.*

Ushtrimi 7. Ç'rol stilistik luan shenja paralajmëruese? Gjejini dhe thoni si realizohet ajo nga ana gjuhësore. *Përse të venë në det mendimet, zemra ime?/ Zbardhuan, anijeat/ panë këndeje e u fshehën..*

Pyetja retorike, si dhe detaji i anijeve, janë shenja paralajmëruese të ndërtuara mbi një antonim që nënkuptohet. Folja *zbardhuan* nënkupton që është errësirë, natë; rreziku gjendet shumë pranë.

Ushtrimi 8. Shpjegoni përdorimin e pyetjes retorike.

Ushtrimi 9. Zbuloni idenë që thekson poeti me anë të thirrorit.

Ritmin e këngës e ndryshon vargu i ndërtuar me thirrur:

Erdhi dita e Arbërit! dhe që pasohet nga betimi i poetit.

Ushtrimi 10. Renditni cilësitë e Rinës dhe të Milosaos që vihen në pah në këto dy këngë.

Ushtrimi 11. Gjeni epitetet për *natën*, *vashat* dhe *vashat e zemrës*. Analizoni si janë formuar dhe pse janë aq mbresëlënëse.

Në përshkrimin e vashave poeti përdor mbiemrat kompozita, të cilat karakterizojnë dhe natyrën e ndryshme të vashave:

vasha forëmadhja - me gëzim të madh, kjo është vasha prej së cilës poeti shpreson që do ta lidhë me vashën që ai dashuron.

atë buzëhieshmen - vasha që poeti dashuron është e bukur, e hijshme, e ndrojtur cilësi këto të denja për vashën e zemrës me të cilën ai do të martohet.

Ushtrimi 12. Gjeni vargjet ku shprehen notat romantike dhe notat realiste në fragmentin e mësipërm.

Përforcimi: *punë e pavarur, punë me fjalorin*

Punë me fjalorin

Nxënësit veçojnë disa fjalë nga varianti origjinal dhe shkruajnë përbri tyre fjalën përkatëse, me të cilën e ka përshtatur Dhimitër Shuteriqi. Shkruajnë përbri një fjalë tjetër të ngjashme. P.sh.:

noerit - mendimet - mendja

anizit - anijet -

sbardhëtin - zbardhuan -

Këtë detyrë e paraqesin dy nxënës në fund të orës së mësimi.

Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin duke studiuar këngën e pestë të poemës "Këngët e Milosaos".

b) aftësinë e secilit nxënës për të kombinuar dhe paraqitur saktë informacionin në punën me grupe.

Detyrat dhe puna e pavarur

Pasi të keni punuar me fjalorin, mësoni të lexoni variantin origjinal. Fillimisht shqiptoni fjalët më të vështira. Pastaj lexojeni të gjithë këngën duke respektuar ngjyresat e së folmes arbëreshe. Është shumë e rëndësishme kjo stërvitje, veçanërisht për t'u bërë aktorë të zotë në teatrin e shkollës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënimit: Bisedë: “Dashuria dhe lumturia e Rinës dhe e Milosaos”	
Tema mësimore: Studim teksti: “Këngët e Milosaos”, Skedat e komentit.			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca qytetare 4. Kompetenca personale 5. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës, varësisht nga tema mësimore: Nxënësi/-ja: - përshkruan çastin e përjetimit të dashurisë dhe të lumturisë së Rinës dhe të Milosaos; - komenton pikëpamjet humaniste dhe demokratike të De Radës në vargjet e poemës; - interpreton rolin e dialogut në poemë; - shpjegon rolin e mjeteve stilistike, si metafora, epiteti, etj. - pranëvë për të dëshifruar nëntekstin e përdorimit të fjalës kyç “ <i>lis</i> ” në fillim dhe në fund të poemës.		Fjalë kyç: Rina Milosao Dashuria Kulti i gëzimit Kulti i natyrës Humanizmi Re manushaqesh Lis	
Burimet: Teksti i nxënësit Poema “Këngët e Milosaos” e-libri CD e këngës “Moj e bukura more”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Filozofia Historia Artet figurative	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
<i>Lexim shprehës, punë në grupe, plotësimi i skedave, ditar dypjesësh, diskutim, vështrim i skedarit të muzikës, bisedë</i>			

Organizimi i orës së mësimimit

Përforcimi: lexim shprehës

Gjatë kësaj ore mësimi, do të plotësohen skedat në tekstin e nxënësit.

Komentohen skedat e këngëve: Vjershë e bijës së Kallogresë, Kënga VI, Kënga VIII, Kënga XX, Kënga XXII, Kënga XXX.

Vjershë e bijës së Kallogresë

De Rada, njohës i thellë i zemrës njerëzore, përshkruan me po atë forcë dashurinë e ndrojtur dhe naive të vajzës. Me një lirizëm të hollë ndjenjash, Rina e brishtë është në kulm të gëzimit të jetës së saj rinore. Mëngjesi është dhe agimi i fatit dhe i surprizave të bukura që do ta presin. De Rada parapërgatit dhe luan me nëntekstin e fjalëve; vëmë re, “mëngjesi - agimi, lindja e ditës dhe agimi i dashurisë që do të vijë.

Kënga VI

Përmes meditimimit të Milosaos, poeti përcjell jo vetëm me një lirizëm të hollë përjetimin dashuror të heroit, por edhe pikëpamjet humane dhe demokratike të tij. Fryma e barazisë midis njerëzve, e dashurisë së lirë dhe e mosgjykimit klasor gjallon dhe në shpirtin e Milosaos; të atij Milosaoje që adhuron jo vetëm vashën, por dhe zakonet shqiptare (arbëreshe). Dëshira për ta pasur afër është dhe shprehje se një vashë e tillë e bukur, e brishtë, e ndrojtur është e denjë për të qenë bashkëshortja e Milosaos.

Kënga XX

Më shumë se një idil dashurie, është një dialog që mbart harenë, majën e lumturisë së dy të dashuruarve, por dhe rrëfen shtjellimin e veprimit, me një zgjidhje “deux ex machina”. Lexuesi kupton se tashmë nga tërmeti, ata janë të barabartë në pasuri e pozicion klasor (zgjidhet konflikti i mosbarazisë klasore). Dialogu pasqyron të vërteta objektive, të dukshme, reale, se është çasti që dy të rinjtë nuk janë më larg njëri-tjetrit, por janë duke kurorëzuar realisht dashurinë e martesën e tyre. Elementi i gjinisë epike (dialogu mes personazheve) i fal vërtetësi ngjarjeve në zhvillim dhe tregon shqetësimet reale të Rinës. Është njëkohësisht çasti më i bukur: Pas shumë vështirësish të dy thurin plane për të ardhmen (dhe me nota realiste), e ky çast s’mund të përjetohet më mirë e më konkret se nga një dialog i drejtpërdrejtë mes dy të dashuruarve. Lexuesit i krijon vizionin se po sheh një tablo veprimi në rrjedhën e ngjarjeve ndërmjet personazheve, megjithëse kjo rrjedhë pasqyrohet nën maskën e përjetimit të ndjenjës së personazheve. Megjithëse Rina, një vajzë e thjeshtë, e ndien veten inferiore ndaj Milosaos (në më merr, ku po më shpie?/ Unë s’jam një zonjë e madhe/ si mizorja jot kunatë.), asgjë s’mund ta pengojë Milosaon të rrijë me të; nuk ka rëndësi vendi dhe mënyra e jetesës, mjaft që të jenë bashkë.

Kënga XXII

Me thellësi poetike i këndon poeti lumturisë, zbulon tërë gamën e ndjenjave që e shoqërojnë atë: shqetësimin e pakuptueshëm që ajo sjell me vete, frikën se mos e humbet, dëshirën për ta përjetësuar. Refreni “Bie po s`dua të fle”, tashmë zaptot të vërtetën e madhe: Kulmi i lumturisë së Milosaos, ai do ta shijojë këtë lumturi, nuk do t’i shpëtojë asnjë grimcë kohe pa e përjetuar lumturinë. Ai është martuar me vashën që dashuron dhe ajo ka lindur një djalë. Kjo nuse i ka hije shtëpisë, sikurse syri që ndrit në fytyrën e njeriut.

Kënga XXX

Milosaaja është plagosur në buzë të lumit, që poeti e vendos pranë Shkodrës. Ai dha jetën (*Gjaku im te Lumi i Vodhit*, inversioni e thekson këtë ide) për atdheun. Bashë me shokët e tij ushtarë e kanë mbrojtur qytetin duke luftuar. Me shumë pak vargje thuhet shumë(lakonizmi).

Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grupe, plotësimi i skedave, ditar dypjesësh, diskutim

Ndahet klasa në gjashtë grupe pune, ku secili grup do të plotësojë një skedë nga teksti i nxënësit.

Punë në grupe, ditari dypjesësh

Grupi I. Skeda: Vjershë e bijës së Kallogresë

- Kulti i gëzimit të jetës:	Gëzimi për jetën rinore (kështu përjetohet nga Rina). De Rada është mjeshtër në pasqyrimin e botës së brendshme të personazhit, jo më kot e kanë quajtur poet psikolog.
- Përsëritja e foljes:	<i>zgjohem, u zgjova, gdhihet</i> Ashtu siç lind dita e re, ashtu do të hapet një portë e re, një shpresë e re në jetën e së brishtës Rinë.
- Ndaluni te fjala e pafaj:	Mbiemri cilëson brishtësinë dhe pastërtinë e Rinës. Ajo është e ndrojtur dhe nuk është përballur me vështirësitë e jetës.

Grupi II. Kënga VI

Idetë humane dhe demokratike të De Radës:	Përmes meditimit të Milosaos, poeti përcjell jo vetëm me një lirizëm të hollë përjetimin dashuror të heroit, por dhe pikëpamjet humane dhe demokratike të tij. Fryma e barazisë midis njerëzve, e dashurisë së lirë dhe e mosgjykimit klasor gjallon dhe në shpirtin e Milosaos.
Ndaluni tek epiteti <i>zakonbukur</i> :	Milosaos adhuron jo vetëm vashën, por dhe zakonet shqiptare (arbëreshe). Këto zakone përcjellin idenë e dashurisë tjetër që gjallon në shpirtin e Milosaos, atë të dashurisë për atdheun.

Grupi III. Kënga VIII

Kulti i natyrës	Me penelatat e një romantiku, poeti pikturon dhe kultëzon natyrën, atë natyrë pranverore që sjell ripërtëritje shpirtërore dhe utilitare. Siç e dimë, edhe elementeve romantike, De Rada u jep nuanca të reja. Kështu kjo natyrë do të formësohet edhe me përmasa reale, të cilat duken në punët e përditshme dhe shqetësimet e fshatarëve për të korrat.
Metafora <i>mbi një re manushaqesh</i> :	Manushaqja është lulja që vjen me ardhjen e pranverës, rrëfen të vërtetën e madhe të ndryshueshmërisë së gjërave dhe lindjen e gëzimit e të shpresës për gjindjen, aq më tepër kur janë shumë “një re manushaqesh”.

Grupi IV. Kënga XX

Roli i dialogut në poemë:	Dialogu tregon harenë, majën e lumturisë së dy të dashuruarve, por dhe shtjellimin e veprimit, me një zgjidhje “deux ex machina”. Kjo tablo vjen dhe si gjurmë që ka lënë ngjarja në shpirtin e heronjve. (Gërshetim i elementit tregimtar me atë lirik). Lexuesi kupton se tashmë nga tërmeti (simbol), ata janë të barabartë në pasuri e pozicion klasor. Dialogu pasqyron të vërteta objektive, të dukshme, reale, se është çasti që dy të rinjtë nuk janë më larg njëri-tjetrit, por janë duke kurorëzuar realisht dashurinë e martesën e tyre. Elementi i gjinisë epike (dialogu ndërmjet personazheve) u fal vërtetësi ngjarjeve në zhvillim. Është njëkohësisht çasti më i bukur: Pas shumë vështirësish të dy thurin plane për të ardhmen, e ky çast s’mund të përjetohet më mirë e më konkretisht se nga një dialog i drejtpërdrejtë ndërmjet dy të dashuruarve. Lexuesit i krijon vizionin se po sheh një tablo veprimi në rrjedhën e ngjarjeve ndërmjet personazheve. Ka një shfaqje të notave realiste në shqetësimin e Rinës që e ndien veten inferiore ndaj Milosaos.
Krahasoni vargjet: <i>Veç në sy të shihemi, Pa dhe bota të përmbysset...</i> me vargjet: <i>yll që thot: “Vështromni dritën, bota nuk do të shkallmohet”, –</i>	Këto përjetime të shpirtit të heroit romantik: malli për të dashurën, dhimbja që është larg, ndjenja e dashurisë pasionante që kalon cakun e botës (<i>Veç në sy të shihemi, Pa dhe bota të përmbysset...</i>) dhe kulmi i ndjenjës së lumturisë, (si ylli që ndriçon botën, ashtu ndriçohet shpirti i personazhit <i>yll që thot: Vështromni dritën/ bota nuk do të shkallmohet</i>), krijojnë një lidhje të ngushtë me kohën dhe botën që rrethon individin në çastin kur është i dashuruar dhe i lumtur. Gjithçka s’ka e s’mund të ketë kuptim në botë, sipas Milosaos, kur i mungon e dashura. E në çastin kur ajo është afër tij dhe rrezullon si ylli, i jep kuptim botës; i parathotë se ky yll është pjesë e kësaj bote, e cila kurrësesi nuk përmbysset.

Grupi V. Kënga XXII

<i>Kundërvënia</i> dhe <i>krahasimi</i> si veçori kryesore e stilit të De Radës.	Komenti i nxënësit
--	--------------------

Grupi VI. Kënga XXX

Përdorimi i foljeve në përshkrimin e atmosferës së këngës:	Përdorimi i foljeve kyç jep atmosferën e ngjarjeve që kanë ndodhur: <i>frytji; rrëzoi..</i>
Gjeni vargun ku mungon folja:	Mungesa e foljes (rrodhi): <i>Gjaku im te lumi i Vodhit</i> , (elipsa), duket sikur folja është e tepërt, ai që ka rëndësi është gjaku që jepet për atdheun, atje, te lumi i Vodhit.

Më tej, së bashku, bisedojnë për hyrjen dhe mbylljen e poemës “Këngët e Milosaos”.

Diskutim: Hyrja dhe mbyllja e poemës

Poema fillon me pranverën, që sapo ka lulëzuar, dhe mbaron me dimrin. Pra, pranvera simbolizon energjinë dhe forcën rinore të jetës së njeriut, ndërsa dimri tharjen dhe fundin e saj. Ashtu si në hyrje të poemës dhe në mbyllje të saj, lisi është fjala kyç. Në rastin e parë tregohet ripërtëritja e jetës nëpërmjet lisit, ndërsa në rastin e dytë dimri sjell vdekjen. Përsëri ka një paralelizëm figurativ, si dhe metaforë (*rrëzoi hijen*).

Përforcimi: vështrim i skedarit të muzikës, bisedë

- Dëgjojmë në sfond këngën “Moj e bukura more”.
Orientohen nxënësit të vëzhgojnë pikturën. Mësuesi/ja u drejton pyetjen:
– Çfarë të përbashkëtash ka ndërmjet saj dhe këngës “Moj e bukura More”?
Bisedë rreth pikëtakimeve dhe të veçantave ndërmjet pikturës dhe këngës.

Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- rrijdhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin duke plotësuar skedat e poemës “Këngët e Milosaos”;
- aftësinë e secilit nxënës për të kombinuar dhe paraqitur saktë informacionin në punën me grupe.

Detyrat dhe puna e pavarur

Lexoni poezinë “E verbra” të De Radës. Veçoni mjetet stilistike dhe shpjegoni rolin e tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënit: Bisedë: “Dashuria është drita e jetës”	
Tema mësimore: Studim teksti “ E verbra”, Jeronim de Rada			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca qytetare 4. Kompetenca personale 5. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës, varësisht nga tema mësimore: Nxënësi/-ja: - përshkruan ndjesitë dashurore të vashës; - analizon rolin e mjeteve stilistike; - pranëvë për të shpjeguar rolin e fjalëve çelës në strofën e dytë me figurat e strofës së parë; - komenton me shkrim mesazhin e poezisë.		Fjalë kyç: Motivi erotik “E verbra” Dashuria Antonimia Malli Drita	

Burimet: Teksti i nxënësit e-libri	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Filozofia Historia Artet figurative
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Lexim me kodim i tekstit, punë e diferencuar, lexim shprehës, ditar trepjesësh, punë me shkrim.</i>	

Organizimi i orës së mësimit

Përforcimi: *lexim me kodim i tekstit*

Në fillim të orës së mësimit, do të kometojë tekstin një nxënës, me ndihmën e mësuesit/es.

E verbra vuan më shumë mungesën e të dashurit se mungesën e dritës së syve. Për të, ai (prijësi), është drita e shpirtit, është prijësi i zemrës së saj. Ai është ylli që rrezaton dritë e i zhluk terrin e syve dhe të shpirtit. Dashuria nuk është vetëm një fanar që i fal dritë, por edhe drita e ngrohtësia që buron nga pasioni i ngrohtë: *si më nxeh, si më djeg në kraharor* (metafora). E ky pasion është sa me përmasa njerëzore, aq dhe me përmasa qiellore (flakë qiellore). Antonimia kontekstuale: *ditë-dritë-e zeza*, vjen për të dhënë më dramatike situatën e përvuajtshme të largimit, të vetmisë që se pranon shpirti që kërkon dritë (shpirti i dashuruar). Ajo sheh me shkëlqimin e shpirtit. Duke pranëvënë vargun e fundit: *Zot, ti një të mirë më more/ po me shpirt ende shikoj*, me titullin *E vebra*, mesazhi është i qartë: Dashuria ndriçon shpirtin, të zbukuron jetën dhe të krijon një imazh; vizionin më të bukur për realitetin ku jetojmë. Largësia ndërmjet të dyve nuk ekziston, ai është përherë me të (ajo shpreson se ai do të kthehet), është dhënësi i jetës, i dritës së syve dhe i shpirtit.

Ndërtimi i njohurive të reja: *punë e diferencuar, lexim shprehës, ditar trepjesësh*

Studiojmë poezinë duke u përgjigjur pyetjeve nga teksti i nxënësit. (Mund të realizohet dhe me teknikën *Punë në grupe*.)

Mësuesi/ja zgjedh nxënës të niveleve të ndryshme:

Nxënësi 1. Vini re antoniminë kontekstuale: *ditë/dritë - e zeza*. Shpjegoni metaforën *prijës i shkëlqyer i dritës* duke e lidhur me epitetin metaforik *e zeza*.

Detajet kyç	Figura	Roli
<i>ditë/dritë - e zeza</i>	Antonimi kontekstuale	Të kundërtat përforcojnë, theksojnë idenë se dhe vetë vasha gjendet ndërmjet dëshirës (iluzionit) dhe realitetit. Ajo do dritën, ndjehet e mjeruar (e zezë). Bie në sy dhe huazimi folklorik: <i>e zeza</i> ; të kujton shprehjen <i>e zeza unë...</i>
<i>prijës i shkëlqyer i dritës</i>	Metaforë	Trimi himnizohet (element romantik); ai është prijës, udhëheqës shpirtëror, që i jep dritë shpirtit të vashës së dashuruar.
<i>e zeza</i>	Epitet metaforik	Epiteti metaforik përforcon mendimin se pa prijësin e dritës që i sjell shkëlqimin, vasha do të mbetet e zezë, e mjerë, e pashpresë, drejt një vuajtjeje të përhershme.

Nxënësi 2. Interpretimi litotat: *s'shohin dritë; sytë s'do m'i hapi dot* duke u mbështetur edhe tek epiteti *e zeza*.

Detajet	Figurat	Roli
<i>s'shohin dritë; sytë s'do m'i hapi dot</i> <i>e zeza.</i>	Litotë Epitet metaforik	Prania e prijësit për vashën është dritë, e ajo nuk e ka afër. Gjithë qenia e saj është në errësirë, e për këtë ajo vuan, e ndien veten të zezë.

Nxënësi 3. Ajo nuk sheh, por në vargun e dytë “larg nga ne po ikën ti” ndihet zgjatimi i metaforës “prijës i shkëlqyer” – figurë për yllin e mëngjesit.

Shpjegoni se përmes cilave elemente në strofën e parë jepet ideja e largimit jo si ndjesi fizike e imazhi, por si largim në kohë. Përqendrohuni te termi “kthimi” për të interpretuar ciklikën e kohës.

Detajet që japin idenë e largimit fizik në kohë janë: *larg, po ikën, kthimi yt*. Ato në fakt rrëfejnë të vërtetën e madhe: largimi-kthimi i tij, një ciklikë e kohës; ai vjen ikën, vjen e ikën për të ardhur përsëri (shpresa se do të kthehet).

Nxënësi 4. Krahasoni fjalët çelës të strofës së dytë që japin idenë e kohës me figurat e strofës së parë.

Fjalët çelës të strofës së dytë	Figurat e strofës së parë	Roli i tyre
<i>një kohë që të shikoja tani</i> <i>kur</i>	<i>Prijës i shkëlqyer</i> <i>ditë/dritë - e zeza</i> <i>s'shohin dritë; sytë s'do m'i hapi dot</i>	Vasha ka mbetur peng i kohës së kaluar, sepse është ajo kohë kur ajo kishte dritë në sy e në shpirt. Gjithçka lidhet me praninë e prijësit. Ai më parë ishte, sot nuk është. Malli për të e djeg, ndaj kujton atë kohë.

Nxënësi 5. Vëreni përdorimin e elementeve gjuhësore që tregojnë kohë: *kohë, tani, muzg e agim, kur* dhe interpretimin në të njëjtat vargje të shenjave që tregojnë imazhe, si: *rrezet e tua që flakëronin, bukuri, o shkëlqimplot*.

Nxënësi 6. Interpretoni shkallëzimin ngjites: *si më nxeh, si më djeg* dhe lidhjen e tij me metaforën: *më djeg në kraharor*.

Nxënësi 7. Shpjegoni ndërtimin e metaforës së vargut të fundit *me shpirt ende shikoj* duke u rikthyer në fillim të poezisë te titulli *E verbra*.

Ajo sheh me shkëlqimin e shpirtit. Duke pranëvënë vargun e fundit: *Zot, ti një të mirë më more/ po me shpirt ende shikoj*, me titullin *E verbra*, mesazhi është i qartë: Dashuria ndriçon shpirtin.

Përforcimi: *punë me shkrim*

Shkruani mesazhin që vjen nga kuptimi dhe imazhi estetik.

Prania e dashurisë është bukuri që rrezaton e zbuquron shpirtin, por që i jep dhe dritë e bukuri natyrës (*rrezet e tua që flakëronin, muzg e agim me bukuri*). Dashuria sjell dhe një ndjesi e shkëlqim qiellor (*flakë qiellore*), mbetet dritëdhënëse, energjdhënëse përherë, ndaj një shpirt i dashuruar është një fanar në çdo kohë.

Vlerësimi:

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin gjatë studimit të poezisë *E verbra*.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 2. Çfarë nxjerr në pah studiuesi E. Çabej për veçantinë e poezisë së De Radës?

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënit: Duke dëgjuar disa vargje nga vëllimi “Lulet e verësë”, bisedojmë rreth këndvështrimit të Naimit për krijimin e botës.	
Tema mësimore: Naim Frashëri - vepra			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca qytetare 4. Kompetenca personale 5. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës, varësisht nga tema mësimore. Nxënësi/-ja: -reciton bukur vargje nga poema “Bagëti e Bujqësija”; -rendit nuancat romantike në krijimtarinë e N. Frashërit; -shpjegon botëkuptimin naimian për dukuritë e panteizmit, të metempsikozës etj.; -tregon se si realizohet himnizimi i heroit dhe i atdheut në krijimtarinë e tij poetike.		Fjalë kyç: Iluminist Romantik Panteist Himnizon Atdheu Heroi lirik	
Burimet: Teksti i nxënësit Vëllimi “Bagëti e bujqësija”, “Lulet e verësë” e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Filozofia Historia Artet figurative	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Recitim, stuhi mendimi, shpjegim i gërshetuar me bashkëbisedim, punë në grupe, punë e pavarur</i>			

Organizimi i orës së mësimit

Parashtrimi: *recitim, stuhi mendimi*


Nis ora e mësimit duke recituar bukur ca vargje nga poema “Bagëti e bujqësija”.



Stuhi mendimi

Orientohen nxënësit të vështrojnë foton e Naim Frashërit në tekstin mësimor, ata bisedojnë me njëri-tjetrin për krijimtarinë dhe elementet romantike që shfaqen në poezinë e tij. Këto informacione i shkruan në tabelë mësuesi/ja, qoftë dhe duke i zgjeruar njohuritë, sidomos për nuancat romantike në poezinë e N. Frashërit.


Dimë për Naimin se:



Naimi si një romantik

1. Himnizimi

5. Huazon elemente nga folklori
6. Karakteri soditës
7. Mahnitjen prej bukurisë
8. Altruist
9. Ekzaltimi i së kaluarës
10. Kulti i natyrës etj.




2. E krahason veten me drurët e tharë nga koha
3. Vuajtja që i shkakton kujtimi për ditët e djalërisë, për vendlindjen, për zjarrin e dashurisë së dikurshme.. Vuajtja në një mënyrë të bukur poetike
4. I vetmuar

Ndërtimi i njohurive të reja: *shpjegim i gërshetuar me bashkëbisedim, punë në grupe*

Përmes punës me grupe, mësuesi/ja synon të evidentohen tiparet e stilit krijues të Naim Frashërit. Nxënësit për këtë temë mësimore janë lajmëruar një orë më parë, ndaj informacioni që ata servirin mund të jetë i bollshëm. Në fund, mësuesi/ja plotëson informacionet që kanë sjellë nxënësit dhe strukturon qartë në tabelë veçoritë e botës poetike të poetit.

Grupi I. Bota poetike në motivin meditativ-filozofik të krijimtarisë së Naimit.

Motivi meditativ-filozofik, botëkuptimi




-Botëkuptimi i tij si mendimtar është mburrur nga literatura fetare (i përkiste besimit bektashian).
-Teizmi (besimi te një zot i vetëm dhe i gjallë).
-Deizmi (beson në ekzistencën e Zotit, por mohon përfytyrimin për të.)

që e identifikon zotin me botën.

-Pranon teorinë e Darvinit, Kantit, Laplasit.
-Tri elementet e krijimit të materies sipas filozofëve të lashtë grekë (zjarri, uji, ajri).

Grupi II. - Mendime filozofike prej marrëdhënies së natyrës me njeriun




- Cikli rrethor
- Dukuria e përsëritjes (natyra, epoka e lavdishme e Skënderbeut)
- Dukuria e metempsikozës (Gjithçka që ekziston, nuk humbet; përsëritet në një formë tjetër).
- Dukuria e hedonizmit (doktrinë, sipas së cilës morali qëndron në kërkimin e kënaqësisë si rrugë për ruajtjen e lirisë së shpirtit.)



- I mahnitur
- Lumturia, dhimbja
- Jeta, simbol i saj = pranvera (ripërtëritëse e natyrës, nxitëse edashurisë) - Vdekja, simbol i saj = dimri (nëkuptimin e humbjes së njerëzve të dashur, në kuptimin filozofik)
- Naimi si poet dhe individ

Grupi III. Himnizimi



Përforcimi: *punë e pavarur*

Është çasti që në këtë rubrikë të fundit, nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 1 dhe ushtrimin 2. Ushtrimi 1. Kulturat kryesore që ndikuan në formimin e Naimit si poet dhe mendimtar.

Në Janinë, në gjimnazin "Zosimea", pati mundësi të njihet me letërsinë dhe filozofinë klasike greke e romake, me pikëpamjet e iluminizmit frëng dhe me historinë e Europës, sidomos të revolucionit borgjez. Kjo kulturë, gjuhët që mësoi në shkollë e jashtë shkollës, si frëngjisht, italisht, greqishte e re dhe e vjetër, latinisht e persisht, bënë që i riu të krijonte një horizont të gjerë dhe të përcaktonte themelet e botëkuptimit të vet. Në Vjenë ai njihet me qytetërimin evropian. Naimi shprehet me admirim për racionalizmin e Dekartit, iluminizmin e Volterit e të Rusoit, propagandon teorinë planetare të Kantit, Laplasit dhe teorinë e Darvinit mbi prejardhjen e qenieve të gjalla. Po kështu, pranon dhe mendimin fetar bektashian.

Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin nxënësit për veçoritë e botëkuptimit naimian;
- b) aftësinë e secilit nxënës për të kombinuar dhe paraqitur saktë informacionin në punën me grupe.

Shënim. Vëzhgoni mënyrën e vlerësimit, e cila mund të jetë me notë ose me shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4. Si realizohet në veprën e Naimit:

- himnizimi i heroit,
- himnizimi i atdheut?

Ushtrimi 1. Në ç'raporte janë vendosur jeta, vdekja dhe koha e shkuar në poezinë meditative të Naim Frashërit?

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar	Situata e të nxënës: Bisedojmë me njëri-tjetrin rreth himnizimit që i bën N. Frashëri ndjenjës së dashurisë.		
Tema mësimore: Analizë "Lulet e verësë"			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca qytetare 4. Kompetenca personale 5. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			

<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës, varësisht nga tema mësimore.</p> <p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon se si realizohet në veprën e Naimit himnizimi i dashurisë; - evidenton planet e Dashurisë dhe të Bukurisë sipas këndvështrimit naimian; - tregon marrëdhënien e ngushtë midis Dashurisë dhe Bukurisë; - jep shembuj për portretin e gruas, së cilës i këndon poeti. 	<p>Fjalë kyç:</p> <p>Dashuria Bukuria Himnizimi Vuajtja Vasha Naimi</p>
<p>Burimet:</p> <p>Teksti i nxënësit vëllimi “Lulet e verësë” e-libri</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhët e huaja Artet figurative Historia</p>
<p align="center">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP</p>	

Organizimi i orës së mësimi

Parashikimi: Një pyetje-shumë përgjigje, bisedë

Kjo rubrikë e parë e orës së mësimi nis me diskutimin e detyrës së shtëpisë: Në ç’raporte janë vendosur jeta, vdekja dhe koha e shkruar në poezinë meditative të Naim Frashërit?


Përgjigjet e nxënësve do të jenë të shumta, por mësuesi/ja në fund mund t’i përmbledhë ato dhe të paraqesë informacionin e duhur.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim, tabelë e strukturuar, lexim i drejtuar, diskutim

Në krijimtarinë e Naim Frashërit, sidomos në përmbledhjen “Lulet e verësë”, me gjithë mbizotërimin e elementeve patriotike, nuk janë të rralla dhe vjershat lirike me motive shoqërore e filozofike. Vend me rëndësi zë cikli “Bukuria”, të vetmet krijime shqip të poetit kushtuar dashurisë. Ndaj mësuesi/ja do të përqendrohet së bashku me nxënësit për të analizuar motivin erotik në këtë vëllim poetik.

Informacionin e ri, mësuesi/ja e përmbledh në tabelën e mëposhtme:

Tabelë e strukturuar



Karakterin soditës, mahnitjen prej bukurisë dhe vuajtjen nga dashuria si tipare romantike, do t’i gjejmë të shprehura edhe në ciklin “Bukuria” me një dritë të re poetike. Sipas Naimit, Bukuria dhe Dashuria janë në lidhje të pandashme dhe të përjetshme me njëra-tjetrën: Bukuria perceptohet nëpërmjet ndjenjës së

dashurisë, po njëkohësisht, dashuria s'mund të ekzistojë pa cilësinë e së bukurës.

E bukura në poezinë e tij shfaqet në dy plane: filozofik dhe njerëzor, si bukuri hyjnore dhe tokësore. Në këtë cikël, me tërë bukurinë artistike të krijimit, shprehet pikëpamja panteiste e Naimit: Bukuria është kudo në univers aty ku gjendet perëndia dhe shfaqjen e saj më të përsosur e gjen te vetë njeriu:

*Kudo është bukuria,
Në qiej, në dhe, në hënë,
Në diell, në shenjë, në yj,
Ndër lule, ndër drurë, ndër pyj.
Çdo vent që të ketë zënë,
Atje çfaqet perëndia,
Po këtu është e tërë
Dhe ajo ti është bërë.*

Bukuria si cilësi njerëzore: trupore dhe shpirtërore, nxit lindjen e ndjenjës së dashurisë te njeriu:

*Posa pashë bukurinë
Zemrën e varfërë ma piku,
Ndjeva në të dashurinë,
Që më erth e më s'më iku.*

Kulmi i ndjeshmërisë naimiane arrihet në vargjet ku poeti thotë se është e kotë ta shpjegosh dashurinë dhe bukurinë; ato mund të zotërohen vetëm me anë të ndjenjës.

Në përshkrimin e ndjenjës së dashurisë, Naimi shfaqet një poet idealist. Dashuria për të është një ndjenjë platonike. Naimin nuk e shqetëson mungesa e marrëdhënieve reciproke në dashuri. Për poetin ka rëndësi që ekziston objekti i dashurisë, pavarësisht se ai qëndron larg tij. Gjithçka më pas: lumturia, hareja, emocioni, brenga, vuajtja që i shkakton dashuria, janë të tijat, krejtësisht personale. Kënaqësia e vuajtjes së tij, si tipar i romantizmit, arrin deri në vetëflirijim.

Dashuria shfaqet në dy plane:

- Dashuria hyjnore si cilësi e perëndisë, me anë të së cilës arrihet harmonia e fenomeneve dhe e trupave qiellorë.
- Dashuria tokësore si një ndjenjë njerëzore e shkallës më të lartë, që e bën njeriun të ndihet njësoj, *i lartë midis aqë perëndive*. Nga ana tjetër, ndjenja e dashurisë ndikon në përtëritjen fizike e shpirtërore të njeriut.

Në krijimet erotike të Naimit vihet re origjinaliteti i tij në drejtim të pasurisë leksikore dhe të larmisë metrike. Ai ka shfrytëzuar simbolin e qiririt, të trëndafilut, e bilbilit (nga poezia persiane) duke ua përshtatur ndijimeve e përjetimeve të tij.

Nga poezia popullore shqiptare bie më tepër në sy një figuracion i tillë si: *vasha si thëllëzë, sorkadhe qafëgjatë, pëllumbeshë*, apo në konceptimin e përgjithshëm të vargjeve: *Të keqen e këmbës sate.../ t'iu bëfsha atij syri...*

Në krijimet erotike larmia e përsiatjeve të ndryshme ka sjellë edhe larmi të formave poetike, rimës, ritmit, strofave dhe vargjeve të ndryshme: dymbëdhjetërokësh, tetërokësh, gjashtërokësh, pesërokësh etj.

Lexim i drejtuar

Më pas, një nxënës lexon në tekstin mësimor temën: *Misteri i krijuesit*, për të cilin bisedojnë së bashku për unin lirik, unin fetar, unin naimian dhe unin filozofik që shfaqet te poezitë *Fjalët e qiririt* dhe *Fyelli*.

Përforcimi: Ditari dypjesësh, punë në grupe

Pasi mësuesi/ja e ndan klasën në tri grupe të mëdha, secili grup do të paraqesë punën e vet në tabelën e zezë përmes teknikës *Ditari dypjesësh*.

Grupi I. Vargjet që shprehin pikëpamjen panteiste të Naimit.

Pikëpamja	Vargjet
Panteizmi	<i>Kudo është bukuria, Në qiej, në dhe, në hënë, Në diell, në shenjë, në yj..... Atje çfaqet perëndia..</i>

Grupi II. Portreti i vashës me të cilën është dashuruar poeti.

Portreti i gruas	Vargjet
I mungojnë cilësitë fizike. Ndonëse poeti përdor krahasime, ato mbeten tepër abstrakte. Edhe kur këto krahasime janë konkrete, ato nuk ndihmojnë për të krijuar një përfaqësim konkret për vashën. Naimi e sheh gruan si simbol të vetë dashurisë, të fuqisë së saj ripërtëritëse, por edhe të dhimbjes, pa të cilën jeta do të humbiste kuptimin e vet.	<i>Me qepallatë si shtijë Mos më vra, mos më plagos.. Me vështrim posi shkëndijë.. Si thëllëzë e bukur mos shko.. Mos vështro si pëllumbeshë..</i>
Është përherë e re dhe e bukur, i mungon mosha, shfaqet me një ecje të mrekullueshme.	<i>E pashë dje tek shkonte, Soje ndrinte gjithë jeta...</i>

Grupi III. Përjetimet shpirtërore të unit lirik.

Përjetimet e unit lirik/ naimian	Vargjet
Kënaqësia e vuajtjes si tipar i romantizmit arrin deri në vetëflimim.	<i>Do të shkrihem Të venitem, Si kandili kur s`ka vaj, Balt` e pluhur Do të bëhem, Të më shkëlqejë këmb` e saj</i>
Këto katër vargje japin gjithë intensitetin e dhembjes për humbjen , duke i veshur me të errët katër figurat mbretërore të lirikës poetike të Naimit: Diellin, Verën, Shpirtin e Zotin.	<i>Dielli zënë në rezë Vera në qelqe të zezë Shpirti mbrenda në qivure Zot i madh në katër mure!</i>

Vlerësimi:

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin nxënësit për veçoritë e vëllimit poetik "Lulet e verësë";
- aftësinë e secilit nxënës për të harmonizuar dhe paraqitur saktë informacionin në punën me grupe.

Shënim. Vëzhgoni mënyrën e vlerësimit, e cila mund të jetë me notë ose me shprehje.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 1. Si realizohet në veprën e Naimit himnizimi i Dashurisë?

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënësve: Mësuesi/ja u drejton nxënësve pyetjen: Ç'lidhje ka sipas këndvështrimit të Naimit, Dashuria me Bukurinë? Bisedë me shembuj nga jeta e përditshme.	
Tema mësimore: Studim teksti: <i>Bukuria</i>			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca qytetare 4. Kompetenca personale 5. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës, varësisht nga tema mësimore: Nxënësi/-ja: - flet për konceptin dhe ndjeshmërinë e Naimit në lidhje me ndjenjën e dashurisë; - shpjegon mënyrën si janë ndërtuar nga ana gjuhësore dhe rolin kuptimor të figurave, si: epiteti, krahasimi dhe simboli. - nënvizon disa fjalë dialektore dhe i kthen ato në gjuhën standarde; - ilustron vargje sipas ndikimit të konceptimit popullor.		Fjalë kyç: Adhurim Bukuri Vashë Dashuri platonike Krahasim Uni lirik Romantik	
Burimet: Teksti i nxënësit Vëllimi "Lulet e verësë" e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët e huaja Artet figurative Historia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Një pyetje-shumë përgjigje, punë në grupe, ditari dypjesësh, punë në dyshe.</i>			

Organizimi i orës së mësimit

Parashikimi: një pyetje-shumë përgjigje

Mësuesi/ja shtron pyetjen: Meqë sipas Naimit, Dashuria dhe Bukuria janë të pandashme dhe nga Bukuria lind Dashuria, a mund të lindë Dashuria nga e Shëmtuara?

Nxënësit mund të marrin si shembull për përgjigjen e tyre dhe mendimin e Bodlerit për të Bukurën.

Ndërtimi i njohurive: punë në grupe, ditari dypjesësh

Ndahet klasa në grupe të vogla, të cilat do të punojnë ushtrimet në tekst.

Grupi I. 1. Përpiquni të gjeni lidhjet ndërmjet fragmenteve poetike me tematikat përkatëse.

2. Ndaluni në këto vargje dhe flisni për konceptin dhe ndjeshmërinë e Naimit në lidhje me ndjenjën e dashurisë.

Vargjet	Kuptimi
<i>Pse s'ka fjalë të dëftenjë Dashurinë e bukurinë, Nuk e them dot atë ndjenjë, Nuk e them dot perëndinë. Mos u mundo kot, Nukë thuhet dot.</i>	Sipas Naimit, Bukuria dhe Dashuria janë në lidhje të pandashme me njëra-tjetrën: Bukuria perceptohet nëpërmjet ndjenjës së dashurisë, po njëkohësisht dashuria s'mund të ekzistojë pa cilësinë e së bukurës. Ajo që i kurorëzon të gjitha këto është perëndia. Kulmi i ndjeshmërisë naimiane arrihet në vargjet ku poeti thotë se është e kotë ta shpjegosh Dashurinë dhe Bukurinë; ato mund të zotërohen vetëm me anë të ndjenjës.

Grupi II. 3. Për Naimin, Dashuria lind virtytin. Ky është një mendim filozofik, që është shprehur që në filozofinë antike. Madje këtë e nënvizon me forcë edhe feja. Duke u nisur nga kjo, si e kuptoni vargun e Naimit se pa dashuri *bota* është e ligë. Po ju si mendoni?

Dashuria tokësore është një ndjenjë njerëzore e shkallës më të lartë (e dhuruar nga perëndia), që e bën njeriun të ndihet *njësoj, i lartë, midis aq perëndive*. E kështu shpirti njerëzor merr vlerë, ka dashuri për njeriun dhe perëndinë. E një njeri i tillë është dhe njeriu i virtytshëm, që arrin në lartësinë e perëndive.

Nga ana tjetër, ndjenja e dashurisë ndikon në përtëritjen fizike e shpirtërore të njeriut:

*Se nuri e dashuria
E gjoksi plot bukuri
Hijeshia, bardhësia,
më bëjnë prapë të ri.*

4. A është *urrejtja* e kundërta e *dashurisë*? Diskutojeni këtë në dy plane:

- në planin personal;
- në planin shoqëror.

5. A mendoni se lumturia dhe dhimbja janë të pandashme nga dashuria? Pse?

Grupi III. 6. Në përshkrimin e bukurisë së vashës poeti përdor më tepër epitetin, krahasimin dhe simbolin. Ndajini ato në fletore në tri shtylla.

Thoni si janë ndërtuar nga ana gjuhësore dhe ç'funksion kuptimor e mbresëlënës kanë?

Figura retorike	Funksioni	Ndërtimi gjuhësor
Simbolet: pjeshkat - për gjirin, jasminën e bardhë - për dorën, qiririn - për poetin.	Të përcjellë bukurinë e vashës përmes elementeve të natyrës, duke dhënë një përfytyrim dhe sipas objektit që e identifikon, si: pjeshka për t'u shijuar, jasemini - dora e bardhë dhe me erë të mirë, e bukur ashtu si lulja. Qiriri - poeti po tretet si qiriri për ndjenjën e tij, adhuron e mrekullohet deri në altruizëm.	Emrat konkretë si pjeshka, jasemini apo qiriri shërbejnë për të emërtuar të veçantën e bukurisë së vashës. Ajo është për t'u shijuar; është e bukur, e bardhë dhe aromëmirë si jasemini.
Krahasimet: si <i>thëllëzë, leshrat si tërshërë, qepallat si gërshërë, si shtijë; me vështrim porsit shkëndijë.</i>	Këto krahasime të kujtojnë konceptimet e këngëve popullore për bukurinë e vashës. Portreti i saj himnizohet duke i dhënë një përfytyrim bukurisë së saj në lidhje me elementet e natyrës që na rrethojnë: e lehtë dhe tërheqëse, me zërin cicëruës si thëllëza, vështrimin shkëlqyes e vezullues si një shkëndijë.	Si thëllëzë = lidhëz krahasore + emër, emërore e pashquar. Leshrat (emër) + lidhëz krahasore + emër. Me (parafjalë e rasës kallëzore) + emër në kallëzore (vështrim) + lidhëz krahasore (porsi) + emër. Elementi i krahasuar (vështrimi) + krahasuesi (shkëndijë)
Epitetet: <i>perëndia bukuroshe, shtat i florinjët</i>	E bukura është atribut i perëndisë, ndaj ajo s'ka si të mos jetë ndryshe, është një bukuri e shkallës më të lartë që rrok mendja njerëzore, pra perëndia është bukuroshe. Shtat i florinjët, cilësohet si një shtat që shkëlqen dhe me vlerë si floriri, e çmuar. Epitetet cilësojnë dhe theksojnë duke e himnizuar më tej, por në një mënyrë të bukur, të mrekullueshmen vashë të Naimit.	Emër + mbiemër i panyjshëm Emër + mbiemër i nyjshëm

Grupi IV. 7. Në vargun: *I dha shijë gjithësisë* veçoni fjalën *shijë*. Gjeneri:

• kuptimin konkret: Poeti ka përjetim specifik. Fjala shije përcjell përjetimin në brendësi të njeriut për të bukurën. Vetë shija është proces i brendshëm, që realizohet jo me dëgjim dhe shikim, por me ndijim.

• kuptimin figurativ. Në kuptimin figurativ është metaforë emër, e cila thekson një përfytyrim dhe rol të së bukurës. E bukura veçse të mrekullon; ajo i jep dhe kuptim gjithësisë.

8. Gjeneri dallimin gjuhësor e kuptimor të këtyre dy vargjeve:

Perëndi e bukurisë - Emri në gjinore thekson përkatësinë e Perëndisë.

Perëndia bukuroshe - Mbiemri si epitete thekson cilësinë e Perëndisë.

9. Vini re mënyrën e konceptimit të këtyre vargjeve:

Çdo vend që të ketë zënë

Atje çfaqet Perëndia,

Po këtu është e tërë

Dhe ajo, Ti është bërë.

Ç'funktion stilistik ka fituar zëvendësimi i vetës së tretë të përemrit vetor me vetën e dytë? Kush është *Ti* në kuptimin konkret dhe në kuptimin simbolik?

Grupi V. 10. Ndaluni në metaforat e këtyre vargjeve:

a.

Dhe në mejtim të math rashë

Më ra në det mendja, m'u mbyt,

Më la vetëm e të shkret

Edhe të mjer' e të gjorë.

b.

O ditët e djalërisë

Që kishit shumë gëzime,

Ratë në det t'arratisë,

Më latë në hidhërime.

Pasi të rilexoni fragmentin e 5-të dhe të 14-të, gjeneri shkaqet e ndryshme që sollën gjendjen e rëndë shpirtërore të poetit. Cilën dhimbje do të zgjidhni ju? Pse?

11. Ku shprehet ndikimi nga konceptimi popullor në vargjet e mëposhtme?

Më erth shtriga pleqëria

Fshehtazi si qen'i qetë.

Opopo, ç'më gjet, o shokë!

Do të qanj me thes në kokë.

• Vini re se sa pranë qëndrojnë notat tragjike me ato komike në shprehjen e hidhërimit. Ç'funktion stilistik merr kjo në poezi?

Grupi VI. 12. Lexoni fjalët: *pjeshkëtë, bënetë, zëmrënë, zëmërë, shpirtinë, qepallatë, fletëtë*. Ç'mund të thoni për përdorimin e ë-së fundore? A sjell ajo ndonjë ndryshim në theksin e fjalës?

Në fjalët dialektore: *pjeshkëtë, bënetë, zëmrënë, zëmërë, shpirtënë, qepallatë, fletëtë*, përdorimi i ë-së fundore sjell ndryshim në theksin e fjalës. Nëse do t'i kthenim në gjuhën standarde, poezisë do t'i prishej melodia dhe rima.

Përforcimi: *punë në dyshe*

13. Kujtoni rregullën për përdorimin e ë-së së theksuar para bashkëtingëlloreve *m, n, nj*. A gjeneri zbatim ajo te vargjet e Naimit? Konkretizoni përgjigjen me shembuj nga vjersha.

Zanorja e theksuar: Shkruhen me e (dhe jo me ë) fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe ndiqet ose ka qenë ndjekur në të kaluarën nga një bashkëtingëllore hundore (*m, n, nj*). Me e shkruhen gjithashtu fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit. (*dhemb, mend, çmend, vend, shemb* etj.)

14. Flisni për **ritmin** dhe llojin e strofës, të rimës e të vargut.

15. Gjeni lidhjen ndërmjet gjendjeve të ndryshme emocionale të poetit dhe formave të ndryshme metrike që u përgjigjen atyre.

Vlerësimi:

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin nxënësit gjatë studimit të tekstit.
- b) aftësinë e secilit nxënës për të harmonizuar dhe paraqitur saktë informacionin në punën me grupe.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Parafrazoni fragmentin e 15-të.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënit: Bisedë për bukurinë e vargjeve naimiane.	
Tema mësimore: Studim teksti: "Fyelli"			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca qytetare 4. Kompetenca personale 5. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës, varësisht nga tema mësimore: Nxënësi/-ja: - nënvizon vargjet ku shprehet dëshira humane dhe dhimbja poetike; - interpreton bukur mesazhin e poezisë <i>Fyelli</i> ; - shkodon simbolet e fyellit dhe të zjarrit; - përshkruan me imtësi ndjesitë e unit lirik, unit naimian dhe unit filozofik.		Fjalë kyç: Uni lirik Uni naimian Uni filozofik Uni fetar Humanizëm Altruizëm Poezi meditative-filozofike	
Burimet: Teksti i nxënësit e-libri		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet figurative Historia Filozofia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Lexim me kodim të tekstit, punë në grupe, ditar dypjesësh, punë e pavarur</i>			

Organizimi i orës së mësimimit

Përforcimi: lexim me kodim të tekstit

Pasi bisedojmë për detyrën e shtëpisë (mënyrën si kanë parafrazuar nxënësit fragmentin e 15-të), një nxënës me ndihmën e mësuesit/es do të komentojë poezinë *Fyelli*.

Fyelli (simboli) është vetë poeti apo njeriu (në përgjithësi) që flet, këndon, vajton, shpreh idealet e tij. Poezia është ndërtuar në formën e një ligjërate poetike, në të cilën janë shkruar bukur e ëmbël katër unë: uni lirik, vetë simboli i fyellit, i cili është mishëruar e përzierë me zjarrin e brendshëm të shpirtit poetik; uni naimian, uni humanist që rri me njerëzit tok, ka dashuri për ta, shqetësohet për paditurinë e tyre, sakrifikohet për ta, thërret që ta kuptojnë etj.; uni fetar, që vjen me përmasën e shkruarjes së zjarrit të perëndisë (që krijoi botën) me zjarrin e shpirtit të poetit (për njerëzimin) dhe gjen shprehje me shkruarjen e njeriut me zotin; uni filozofik, i cili është uni që përmes forcës së pashtershme të shpirtit të zjarrtë e të trazuar, është përzierë me zjarr e me zjarrin e perëndisë (që krijoi botën) bëhet një dhe i përjetshëm.

Ndërtimi i njohurive: *punë në grupe, ditar dypjesësh*

Secili grup do të punojë ushtrimet në tekstin e nxënësit në faqen 127.

Grupi I. Reflektojmë për kuptimin 1. Gjeni dhe lexoni me zë vargjet ku shprehet:

Kuptimi	Vargjet
- ndjenja humane	<i>Dhe me botën e gëzuar bëhem shok dhe marr pjesë, dhe me njerëz të helmuar bëhem mik me besa-besë.</i>
- dashuria = shija e jetës	<i>O rremet i njerëzisë! Zëri i fyellit s'është erë, Ky është zjarr i dashurisë, që i ra kallamit mjerë</i> <i>I dha erë trëndafilin, i dha dritë bukurisë...</i>
- dhimbja poetike	<i>Puna sido që të bjerë, unë qaj me mallëngjime, me çdo vend e kurdoherë psherëtin zemëra ime!</i>
- dashuria = ekzistencë	<i>Nga ky zjarr, zot'i vërtetë, Që ka ngrehur gjithësinë hodh një shkëndijë në jetë dhe bëri soje njerinë</i>

2. Cili është mesazhi i përbashkët që përshkon poezitë *Fyelli* dhe *Fjalët e qiririt*?

Poeti flet hapur për misionin e tij si poet me dhunti hyjnore, të cilat i vë në shërbim të njerëzimit. Ai u fal të tjerëve dashuri, mirësi, përkushtim; sakrifikohet për njerëzimin, duke i dhënë mesazhin njerëzimit se këto veprime e bëjnë njeriun të virtytshëm e më pranë perëndisë.

Grupi II. Reflektojmë për interpretimin 3. Cilat janë shkaqet e vuajtjes së poetit? Ndajini ato në:

- shkaqe personale
- shkaqe sociale, kombëtare

Grupi III. 5. Ç'është zjarri në kuptimin filozofik?

Zjarri në kuptimin filozofik është zjarri i përjetësisë. Nga zjarri u krijua bota (kujtojmë se ai pranon filozofinë e antikitetit se bota u krijua nga zjarri, uji, ajri). Zjarri është dhuratë e perëndisë. Perëndia e krijoi botën nga zjarri (perëndia është e përjetshme), por është dhe zjarri i shpirtit të poetit e të çdo individit në botë, i cili do të ketë përherë zjarrin e dëshirës, të dashurisë e të sakrificës. Ai zjarr që ishte, është dhe do të jetë.

– Ç'është zjarri si simbol poetik? (Ndaluni në tri strofat e fundit.)

Si simbol poetik:

a) është zjarri i jetës: zjarri është forca jetëdhënëse, krijuese, që hodhi perëndia për të krijuar njeriun, botën;

- b) është zjarri i dëshirës humaniste të Naimit për njerëzimin;
 c) është zjarri i procesit krijues të poetit, i cili i jep frymëzim poetik.

6. A ju ndodh të brengoseni për të tjerët: shumë, pak apo aspak? Sido që të jetë, përpiquni të tregoheni të çiltër në përgjigjen tuaj.

Ditari dypjesësh

Grupi IV. 7. Reflektojmë për gjuhën dhe stilin. Në këtë poezi poeti e ndërton ligjëratën poetike mbi katër veta. Ilustrojeni këtë me vargjet përkatëse.

Katër vetat mbi të cilat ndërton poeti ligjëratën poetike.	vargjet
Uni lirik - figura simbolike e fyellit	<i>Gjithë bota më dëgjojnë po së jashtëmi më shohin,...</i> <i>Zëri i fyellit s'është erë,..</i> <i>Unë me ty jam përzjerë,</i>
Uni filozofik - dukuria e përjetësisë, nga zjarri u krijua bota. Zjarri i jetës së shpirtit të poetit, i krijimit poetik që e bën atë të pavdekshëm.	<i>Ajy zjarr ra dhe ne qiej edhe duke përvëluar, u bënë kaq yj e diej</i> <i>O more zjarr i bekuar! Unë me ty jam përzjerë,</i>
Uni fetar - shkrirja e njeriut me zotin	<i>Nga ky zjarr, zot'i vërtetë, Që ka ngrehur gjithësinë hodh nje shkëndijë në jetë dhe bëri soje njerinë.</i> <i>O more zjarr i bekuar! Unë me ty jam përzjerë,</i>
Uni naimian - njeriu human dhe që flijohet	<i>Kraharorë e kam çpuar E kam bërë vrima vrima</i> <i>Dhe me botën e gëzuar bëhem shok dhe marr pjesë, dhe me njerëz të helmuar bëhem mik me besa-besë.</i> <i>Ky është zjarr i dashurisë,</i>

Ç'ndikim sjell ndryshimi i vetes në anën kuptimore dhe emocionale të poezisë?

8. Ku qëndron bukuria e saj aq mbresëlënëse:

në përfytyrimin konkret

apo

në përfytyrimin abstrakt që na ngjall? (Argumentoni përgjigjen tuaj.)

Grupi V. **9.** Ndaluni në dy strofat e mëposhtme.

A. *I ra qiellit, e ndriti,*

i ra zemrës, e nxehu,

*i ra verës, e buçiti
i ra shpirtit dhe e dehu*

*B. I dha erë trëndafilin,
i dha dritë bukurisë,
i dha këngëtë bilbilit,
i dha shije gjithësisë*

Mbi cilat folje realizohet përsëritja anaforike? (Nënvizojini ato). Cila strofë ndërtohet mbi:

- shkakun dhe pasojën e veprimt; A
- pasojën e veprimt? B

10. Çfarë idesh nënvizon poeti kur spikat cilësitë kryesore të sendeve dhe të fenomeneve natyrore? Si shprehet lidhja e tyre me shpirtëroren dhe njerëzoren?

Përforcimi: punë e pavarur

Reflektojmë për metrikën

12. Gjeni llojin e rimës, strofës dhe vargut. Si harmonizohen ato me trajtat e ndryshme të ligjëratës poetike?

Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin gjatë studimit të tekstit.
- b) aftësinë e secilit nxënës për të harmonizuar dhe paraqitur saktë informacionin në punën me grupe.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4. Ndjenja e vetmisë është një nga veçoritë më dalluese të poetëve lirikë (veçanërisht të poetëve romantikë). Duke u nisur nga kjo, çfarë zbuloni në natyrën poetike dhe njerëzore të Naimit? Mendimin tuaj ilustrojeni me vargjet përkatëse.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Romantizmi shqiptar		Situata e të nxënit: Bisedë për dëshirën altruiste dhe dashurinë për njeriun.	
Tema mësimore: Studim teksti: "Fjalët e qiririt"			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit 3. Kompetenca qytetare 4. Kompetenca personale 5. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës, varësisht sipas nga tema mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none">- interpreton bukur mesazhin që përcjell poeti;- dekodifikon kuptimet e simboleve të qiririt dhe të fluturës;- përimiton (përshkruan me imtësi) procesin e aktit të vetëflijimit të poetit;- analizon rolin e rimave foljore në ritmin e vargut;- pranëvë për të shpjeguar kuptimet e simboleve: natë dhe ditë.		Fjalë kyç: Ligjëratë poetike Fjalët e qiririt Humanizmi Flutura Simboli Ditë Natë Dukuria e metempsikozës	

Burimet: Teksti i nxënësit e-libri https://www.youtube.com/watch?v=M2mvoxSLINM	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet figurative Historia Filozofia
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Vështrim i një dokumentari, lexim me kodim të tekstit, punë në grupe, ditari dypjesësh, lexim me kodim të tekstit, punë e pavarur.</i>	

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja me njohuritë e mëparshme: *vështrim i një dokumentari, lexim me kodim të tekstit*

Për disa minuta, së bashku, do të shohin dokumentarin në adresën: <https://www.youtube.com/watch?v=M2mvoxSLINM>

Lexim me kodim të tekstit

Koment i kuptimit të poezisë:

Poezia *Fjalët e qiririt* është shkruar në trajtën e vetërrëfimit, ku qiriri simbolikisht paraqet poetin. Poeti flet hapur për misionin e tij si poet me dhunti hyjnore, të cilat i vë në shërbim të njerëzimit. Uni lirik shkrihet natyrshëm me unin filozofik, me unin fetar, me unin naimian.

Uni lirik gjen shprehje te figura simbolike e qiririt (simboli i qiririt marrë nga poezia persiane).

Uni filozofik gjen shprehje te dukuria e metempsikozës.

Uni fetar gjen shprehje tek asgjësimi i fluturës që lidhet me shkrirjen e njeriut me zotin.

Uni naimian gjen shprehje te njeriu human që flijohet në emër të dashurisë për njerëzimin (në përgjithësi) dhe të atdheut të vet (në kuptimin konkret).

Janë disa arsye për të cilat poeti dëshiron të vetëflijohet:

Dëshira për njeriun	<i>Në shpirtin tim kam dashurinë Pa digjem për njerëzinë...</i>
Dëshira për të sjellë dituri	<i>Se ma k'ënda t'u bënj mirë, Të mos mbeti n'errësirë...</i>
Qëllimi për drejtësi	<i>Mirësin e urtësinë, Në bëhi shokë me mua...</i>
Dëshira për trashëgimi	<i>Kur më shihni që jam tretur, Mos pandehni se kam vdekur; Jam i gjall e jam ndë jetë, Jam në dritë të vërtetë...</i>
Qëllimi për pastrim shpirtëror	<i>Mbase krahët t'i përvëlton, Po dhe shpirtin ta shenjtëron..</i>

Ndërtimi i njohurive: *punë në grupe, ditari dypjesësh, lexim me kodim të tekstit*

Për të studiuar tekstin, secili grup do të punojë ushtrimet e tekstit Letërsia 11.

Grupi I. Reflektojmë për kuptimin 1. Pse dëshiron të vetëflijohet poeti? Shënoni me S (e vërtetë) dhe G (e gabuar) për alternativat e mëposhtme.

- Nuk e përballon dot dhimbjen.
- Nga dashuria për njeriun.
- Për shenjtërinë e tij shpirtërore.
- Nga dëshira për lavdi.
- Nga fanatizmi fetar.

2. Meqenëse kjo është vjersha e parë e Naimit e botuar në shqip, cili është mesazhi që u jep Naimi bashkatdhetarëve në vargjet:

*Andaj po digjem si trimi
Se ma k'ënda t'u bëj mirë,
Të mos mbeti n'errësirë ...*

Grupi II. Reflektojmë për interpretimin 3. Ndaluni te nënteksti i vetëflijimit. Akti i ndriçimit lidhet me çlirim energjie. Cilat janë:

- energjitë shpirtërore,
- energjitë mendore,
- energjitë fizike,

që çliron poeti prej vetvetes? Plotësojeni mendimin tuaj duke u ndalur edhe te vargu:

Dhe kurrë s'dua të shuhem. A e kundërshton ai vargun e mësipërm: Asnjë çikë të mos mbetem!

Nënteksti i vetëflijimit. Akti i ndriçimit lidhet me çlirimin e energjive të poetit nga vetvetja:

- energjitë shpirtërore: kur u fal të tjerëve dashuri, mirësi, përkushtim.
- energjitë mendore: kur u jep të tjerëve dituri nga përvoja dhe veprat e tua.
- energjitë fizike: kur lufton me të gjitha forcat t'i realizosh synimet.

Në këto çlirime energjish përmbledhet i gjithë misioni i poetit kombëtar, Naim Frashëri, i cili gjatë periudhës së Rilindjes ishte poeti, mendimtari, ideologu dhe mësuesi i shqiptarëve në ditët e tyre më të vështira. Reflektojmë për gjuhën dhe stilin.

4. Poezia është ndërtuar në formën e ligjëratës oratorike. Ç'ndikim emocional ka ajo në transmetimin:

- e patosit qytetar,
- e frymës meditative,
- e notave didaktike?

Patosi qytetar	<i>Unë jam në shpirtin tuaj, Mos më kini për të huaj, M'është falurë durimi, Andaj po digjem si trimi...</i>
Fryma meditative-filozofike	<i>Dhe unë si ju jam ndruar E jam përzjer' e ndryshuar, Po jam bërë shumë herë Zjarr e uj' e balt' e erë. Jam një shkëndijë prej qielli Dhe një drudhëzë prej dielli..</i>
Notat didaktike	<i>Në më doni si u dua, Njëri-tjetrin të doni Të paudhë mos punoni...</i>

Grupi III. 5. Ndaluni në simbolin e qiririt dhe të fluturës. Ç'kanë të përbashkët dhe ku ndryshojnë nga njëri-tjetri? Figura simbolike e qiririt që vetëshkrihet dhe e fluturës që vetëdigjet, është e pranishme në poezinë e Lindjes, por Naimi i ka shfrytëzuar dhe trajtuar në mënyrë origjinale, si në formën poetike, ashtu edhe në mesazhet që përcjell.

6. Në vargun: *Natënë t'ua bënj ditë* gjeni kuptimet e figurshme të këtyre fjalëve:

Në vargun: *Natënë t'ua bënj ditë* gjejmë disa korresponduese të këtyre simboleve:

Nata	Paditura Veset Skillavëria Varfëria
Dita	Ditura Virtytet Liria Mirëqenia

Grupi IV. 7. Ç'rol luajnë lloji i vargut dhe rimat foljore në ritmin e kësaj ligjërate oratorike?

Rimat luajnë një rol të rëndësishëm në ritmin e kësaj ligjërate oratorike. Ato përgjithësisht janë krijuar nga foljet, të cilat mund të merren edhe si antonime në kontekstin stilistikor:

kullohem-përvëlohem
ndruhem-shuhem
përvëlon-shenjtëron
tretëm-mbetet
fluturonj-qëndroj

-Ka dhe rima që ndërtohen me mbiemra në cilësinë e epiteteve:

Trupn' e shkretë-zotn' e vërtetë
kec i pirë-gjeth i mbirë

-Ka dhe rima me emra abstraktë apo konkretë:

dritë-ditë; durimi-trimi; dashurinë-njerëzinë; qielli-dielli.

Përforcimi: punë e pavarur

Shkruani. Krahasoni poezitë *Fjalët e qiririt* dhe *Fyelli* dhe gjeni të përbashkëtat dhe dallimet në figuracionin dhe konceptimin e tyre.

Këtë detyrë nxënësit mund ta përfundojnë dhe në shtëpi.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

a) rrjedhshmërinë e të folurit dhe saktësinë e informacionit shkencor që paraqesin nxënësit gjatë studimit të tekstit.

b) aftësinë e secilit nxënës për të harmonizuar dhe paraqitur saktë informacionin në punën me grupe.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Portofoli i nxënësit		Situata e të nxënët:	
Tema mësimore: Portofoli i nxënësit		Rëndësia dhe roli i portofolit dhe performancës së nxënësit.	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale Kompetenca për të nxënë Kompetenca për sipërmarrjen			
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> dallon letërsinë si art dhe si shkencë; <input type="checkbox"/> zbulon mesazhe kontekstuale të veprave të ndryshme; <input type="checkbox"/> bashkëpunon mes një grupi të caktuar duke sjellë produkte të plota letrare; <input type="checkbox"/> krijon një panoramë të qartë të asaj që është mësuar gjatë tremujorit të dytë; <input type="checkbox"/> demonstroi përparimin e tij duke u bazuar në rezultatet e identifikuara; <input type="checkbox"/> nxiti mendësinë e vetëvlerësimit të nxënësit; <input type="checkbox"/> bëri ballafaqimin e dokumentuar të performancës së nxënësve me njëri-tjetrin dhe nxitjen e krijimtarisë. 		Fjalë kyç: Portofol Letërsi Arte Romantizëm shqiptar Romantizëm evropian Vendlindje Interpretim	
Burimet: Libri i nxënësit Autorët dhe veprat e punuara Interneti Biblioteka Dhuntitë personale etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe dhe gjuhë e huaj Arte Histori TIK Qytetari etj.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metoda e bashkëbisedimit, punë e pavarur-individuele, punë në grup, punë e drejtuar, metoda e kllasterit, diagrami i Venit, hulumtim, interpretim.

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *metoda e bashkëbisedimit, punë e drejtuar*

Për realizimin e kësaj ore mësimi duhet të sjellim në vëmendjen e nxënësve me anë të metodës së bashkëbisedimit se ç'është portofoli i të nxënët dhe cili është roli i tij. Sa dhe si e njohin nxënësit atë.

Nëpërmjet portofolit mësuesi/ja i drejton nxënësit në koleksionimin e rezultateve/arritjeve të të nxënët sipas një rendi të strukturuar mirë me qëllim vlerësimin, vetëvlerësimin dhe shkëmbimin e këtyre arritjeve.

Portofoli i të nxënët është një qasje bashkëkohore që bazohet në kriteret e cilësisë dhe dokumenton kontributin e nxënësve në veprimtari mësimore të orientuara nga kompetenca.

Portofoli i nxënësit:

- mbështet zbatim**in e kurrikulës së bazuar në kompetenca;
- krijon qëndrueshmëri** në procesin e realizimit të saj;
- ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në **garantimin e cilësisë** së zbatimit të kurrikulës dhe të arritjes së të nxënësit.

Karakteristikat e portofolit të të nxënësit:

- reflekton **rezultatet e identifikuara të nxënësit** bazuar në pritshmëritë e RN (rezultateve të të nxënësit) të kurrikulës;
- përqendrohet në **përvojat e të nxënësve të bazuara në performancë**, si dhe në përvetësimin e kompetencave kyç (njohurive, aftësive dhe qëndrimeve);
- përmban **shembuj të punës që shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor** dhe jo në disa ditë të shkëputura të vitit;
- përmban **produkte të punëve të nxënësve që përfaqësojnë një shumëllojshmëri** rezultatesh për t'u vlerësuar;
- përmban një **shumëllojshmëri të modeleve të punës dhe vlerësime** të kësaj pune nga vetë nxënësit, shokët, mësuesit e tjerë, prindërit etj.

Ndërtimi i njohurive: metoda e bashkëbisedimit, puna individuale, kllaster, diagrami i Venit, hulumtimi, interpretimi

Kështu, gjatë tremujorit të dytë nxënësit janë njohur me zhvillimet letrare të periudhës së romantizmit shqiptar. Mësuesi/ja në procesin e planifikimit, të realizimit dhe të reflektimit/vlerësimit mban parasysh përmbushjen nga nxënësit të të gjitha kompetencave kyç dhe atyre të fushës.

Kjo është arsyeja e rëndësishme që merr portofoli si një mjet për të dokumentuar, treguar, krahasuar dhe vlerësuar mbërritjen të qëllimi i artikuluar në kurrikul.

Portofoli është pasqyrim i mësimdhënies së bazuar në dëshmi.

- Mësimdhënia dhe të nxënësit, të vështruar nëpërmjet portofolit, ndihmojnë për eksplorimin dhe zhvillimin e qasjeve për një mësim efektiv.
- Nëpërmjet portofolit pasqyrohen dhe dokumentohen qasjet e mësimit të bazuar në kompetenca/performancën e nxënësit.
- Në thelbin e tij portofoli me dokumentacionin që e përbën, argumenton përgjegjësitë e mësuesit në lidhje me mësimdhënien dhe të nxënësit.

Qysh në fillim të tremujorit ose hap pas hapi mësuesi/ja u ka dhënë nxënësve të klasës detyrat, të cilat ata duhet të përmbushin përgjatë këtij tremujori në pasurimin e portofolit të tyre.

Më poshtë po shënojmë detyrat e dhëna nxënësve:

1. Krahasoni me anë të diagramit të Venit romantizmin shqiptar me atë europian. (30 pikë)
2. Bëni një listë me autorët kryesorë të Rilindjes dhe veprat e tyre (duke përfshirë llojin letrar). (10 pikë)
3. Shkruani një poezi të shkurtër ose një prozë poetike për vendlindjen duke përdorur nota romantike. Ndonjë nxënës me dhunti mund ta sjellë këtë përjetim në pikturë a në forma të tjera arti. (20 pikë)
4. Veçoni disa fjalë nga varianti origjinal "i Këngëve të Milosaos" dhe shkruani përbri tyre fjalën përkatëse, me të cilën e ka përshtatur Dhimitër Shuteriqi. Përpiquni të shkruani përbri një fjalë tjetër të ngjashme. P.sh:
noerit - mendimet - mendja
anizit - anijet - ... (20 pikë)
5. Interpretoni vargje të shkëputura nga krijimtaria e Naim Frashërit. (20 pikë)

Për të realizuar vlerësimin e portofolit mund të ndiqen disa mënyra si më poshtë.

- Nxënësit mund të paraqesin të gjithë portofolin ose pjesë të tij.
- Në disa raste nxënësit mbrojnë punën e tyre.

- Në raste të tjera, nxënësit i shfaqin punimet e portofolit të tyre në formë ekspozite.
- Në raste të tjera nxënësit zhvillojnë një pjesë të portofolit të tyre duke reflektuar interesat individuale akademike apo të karrierës.

Gjatë kësaj ore mësuesi/ja është e lirë të zgjedhë mënyrën më efektive për t'u dhënë nxënësve mundësinë e prezantimit të portofolit të tyre. Kështu mund të bëhet dhe një alternativë mënyrash vlerësimi pasi vetëm një orë nuk mjafton për t'i paraqitur punët e të gjithë nxënësve të klasës.

Demonstrimi i rezultateve të arritura

Në këtë fazë të orës mësimore mësuesi/ja dhe nxënësit janë të lirë të japin gjykimet e tyre lidhur me punët e prezantuara, duke paraqitur pika e tyre të forta dhe pikat e dobëta, madje edhe duke dhënë këshilla dhe sugjerime për punë edhe më cilësore në vazhdimësi.

Mësuesi/ja mund t'i përdorë të dhënat e portofolit për qëllime të ndryshme specifike, duke përfshirë:

- nxitjen e të mësuarit të vetëdrejtuar;
- krijimin e një panorame të qartë të asaj që është mësuar nga nxënësi;
- nxitjen e të nxënësve për të nxënë;
- demonstrimin e përparimit të nxënësit duke u bazuar në rezultatet e identikuara;
- nxitjen e mendësisë së vetëvlerësimit të nxënësit;
- ballafaqimin e dokumentuar të performancës së nxënësve me njëri-tjetrin dhe nxitjen e krijimtarisë;
- përfshirjen e prindërve në procesin e të nxënësve.

Vlerësimi

Për të realizuar këtë fazë të procesit mësimor, mësuesi/ja duhet të përgatisë për çdo nxënësi vlerësimin e portofolit sipas tabelës së mëposhtme:

Komponenti që vlerësohet	Nivelet e arritjes				Komente/ Shënime
	1	2	3	4	
Detyra 1 – 30 pikë					
Detyra 2 – 10 pikë					
Detyra 3 – 20 pikë					
Detyra 4 – 20 pikë					
Detyra 5 – 20 pikë					

TOTALI I PIKËVE 100 _____

Duhet përmirësim _____

Ka përparim _____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: IX
Tematika: Epoka e realizmit		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: Lexime të komentuar		Nxënësi njih dhe ndërton kuptimin e duhur mbi konceptet letrare dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin hap pas hapi të letërsisë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> diskuton në grup në mënyrë konstruktive mbi epokën realiste përmes veprave konkrete; <input type="checkbox"/> dallon zhvillimin e realizmit dhe përfaqësuesit e tij; <input type="checkbox"/> njih dhe veçon parime të estetikës realiste me tiparet e saj në fragmente të ndryshme tekstesh letrare; <input type="checkbox"/> vendos në plane krahasuese vepra të ndryshme realiste dhe krahason veçori të stilit për secilin nga shkrimtarët duke bërë dallime nga njëra letërsi realiste europiane në tjetrën, nga njëri lloj letrar në tjetrin. 		Fjalë kyç: Periudhë letrare Epoka e realizmit Natyralizmi Vepër realiste Elemente realiste Shkrimtarë realistë Tolstoi Gogol Stendal Ibsen	
Burimet: Teksti i letërsisë Fjalor i gjuhës shqipe Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Bashkëbisedimi, harta e koncepteve, stuhi mendimi, një pyetje-shumë përgjigje, lexim i drejtuar, punë e pavarur, hulumtim.</i>			

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: bashkëbisedim

Mësuesi/ja u prezanton nxënësve mënyrën e veçantë të organizimit të punës për këtë orë mësimore. U ka kërkuar që nxënësit të hulumtojnë në shtëpi për shkrimtarë të caktuar dhe vepra e tyre si përfaqësuesit më në zë të epokës realiste: Tolstoi, Gogoli, Stendali, Ibseni.

I kërkon secilit grup të bëjë prezantimin e jetës dhe krijimtarisë së shkrimtarit që kanë si detyrë

Ndërtimi i njohurive të reja: diskutim i drejtuar, punë në grup ekspertësh, harta e koncepteve


Në një tabak letre mësuesi/ja ka parapërgatitur karakteristika të veprës realiste, të cilat i rishikon në mënyrë specifike me secilin grup. Ai gjithashtu mund t'ua shpërndajë grupeve të nxënësve me fisha dhe të kërkojë kërkon që pasi të hulumtojnë në mënyrë të pavarur tekstin që u është caktuar, t'i përcaktojnë këto veçori për secilin prej tyre.

Nxënësit hedhin në tabelën e mëposhtme karakteristikat për secilin fragment.

Karakteristikat e veprës realiste

Klasifikimi i veprave letrare si realiste u atribuohet atyre veprave që përmbajnë ngjarje të cilat ndodhin në jetën e përditshme, në kohë dhe hapësira të mundshme, me personazhe të ngjashme nga jeta reale (të krijuara nga shkrimtarët duke u bazuar në trillim dhe jo në imitim të realitetit).

- Ngjarja ndodh në botën reale.
- Ngjarjet janë të besueshme. Autori mbështetet në ndodhitë e jetës së përditshme të treguara me vërtetësi edhe pse shumica e tyre nuk janë të vërteta.
- Përdorim i gjuhës së zakonshme.
- Fabula përfshin konflikte ose tensione që rrotullohen rreth një problemi dhe zgjidhjes së tij.
- Problemet huazohen nga jeta e përditshme, si: marrëdhëniet me familjen e miqtë, jeta (përpjekjet për t'u rritur dhe për t'ia dalë i vetëm), vdekja dhe tema që kanë të bëjnë me mbijetesën;
- Zgjidhja është e besueshme.
- Temat reflektojnë përvoja jetësore njerëzore, mesazhe për njerëzit.
- Personazhet janë njerëzore dhe sillen në mënyra reale.
- Personazhet përdorin atë lloj dialogu që i bën ata të duken të vërtetë.
- Struktura dhe elementet narrative organizohen në rend kohor.



	Elementet realiste			
	Në ballo	Takimi me njeriun e madh	Beteja e Vaterlosë	Shtëpi kukulle
Vepra nga është shkëputur fragmenti				
Gjinia	prozë	prozë	prozë	dramë
Lloji	roman	novelë	roman	dramë
Tema				
Personazhi (detajet) Ku gjendet? Çfarë ndodh me të? Si ndihet? Si vepron? Çfarë mendon? Çfarë thotë? Si është veshur?				
Konflikti				
Si realizohet zgjidhja e konfliktit në fragment?				
Si do ta interpretojnë nxënësit zgjidhjen e këtij konflikti?				
Gjuha				
Rrëfimi				
Përshkrimi				
Rrëfimtari (rol i tij në rrëfim)				
Dialogu (rol i tij në rrëfim)				
Mjedisi (përshkrimi i mjedisit, detajet)				

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që gjatë punës me tekstin të përcaktojnë momentet kyç për secilin fragment duke identifikuar etapat ethurjes kompozicionale (hyrja, lidhja, zhvillimi).

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *diagrami i Venit*

Tabela e plotësuar nga çdo grup u krijon mundësi nxënësve të krahasojnë veçoritë e veprave dhe të stilit të shkrimtarëve.

Në fragmentin e veprës:

1. “Lufta dhe Paqja” të Tolstoit spikat:

Evidentimi i emocioneve të një vajze të re, e cila merr pjesë në ballo për herë të parë. Shkrimtari përqendrohet jo vetëm në zbërthimin e botës së brendshme shpirtërore, karakterin e vajzës, përjetimin emocional dhe veprimet e saj përmes detajeve të caktuara, por edhe në përshkrimin fizik e veshjen, të cilat janë në funksion të këtij zbërthimi.

Specifika e shkrimtarit qëndron pikërisht në dhënien e detajeve, të cilat vendosin në qendër individin dhe në vetvete janë shumë të thjeshta (kjo në kundërvënien me të madhërishtmen, ekzotiken apo edhe kundërshtitë e forta..., të cilat i kemi hasur në veprat romantike)

Gërshetim të përshkrimit me dialogun ndërmjet personazheve.

2. " Takimi me njeriun e madh" të Gogol spikat:

Mënyra e veçantë e rrëfimit.

Rrëfyesi e paraqet veten si dëshmitar i pranishëm dhe aktiv; ka raste kur ndërhyt dhe jep mendimin e tij mbi atë çfarë ndodh;.

Paraqitje realiste e fakteve, vdekja e personazhit, e cila është e gërshtuar me elemente të simbolizmit, e cila i jep një shkallë të lartë universalitetit të veprës dhe kuptimit filozofik të saj.

Përdorimi i ironisë.

3. " Beteja e Vaterlosé" të Stendalit spikat:

Përshkrimi i realist i fushës së luftës (duke mos u përqendruar në shpirtin heroik dhe në elemente të madhërisme, siç është bërë rëndom në romantizëm), por në pamjen tragjike, në fatin e ushtarëve, pasojat e luftës, dhimbjen, gjakderdhjen...

Përjetimin nga ana e ushtarit të thjeshtë të pamjes së luftës dhe pjesëmarrjes në të (në veprat romantike zakonisht theksi vihet te heroi i jashtëzakonshëm që lufton në kushte të jashtëzakonshme. Përshkrimi nuk bëhet së jashtëmi nga autori, por nga pozitat e përjetimit të vetë personazhit).

Autori thjesht rrëfen përjetimin e personazheve dhe nuk ndikon në mënyrën si e lexon lexuesi (impersonalizmi). (Mësuesi/ja bën dallimin me stilin e Gogolit.)

4. "Shtëpi kukulle" të Ibsen spikat:

Trajton një temë të thjeshtë të marrëdhënies bashkëshortore, ku godet moralin e dyfishtë për burrat dhe gratë.

I jep trajtimit të kësaj teme karakter universal duke e shtruar si problem të të gjithë shoqërisë.

Dialogu është i shkruar në prozë (jo në vargje)

Fjali të shkurtra që bartin dramaticitet... etj.

Vlerësimi

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimi. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënësit.

Detyrë

Sillni në klasë informacion për jetën dhe krijimtarinë e Balzakut.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: IX
Tematika: Epoka e realizmit		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: Balzaku, jeta dhe vepra		Bisedë mbi jetën dhe krijimtarinë letrare të Balzakut	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:			
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale Kompetenca qytetare Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyç:	
Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> njeh dhe klasifikon sipas etapave, krijimtarinë letrare të Balzakut; <input type="checkbox"/> përcakton strukturën e <i>Komedisë njerëzore</i>; <input type="checkbox"/> flet mbi temat kryesore dhe llojin e personazheve mbizotërues në krijimtarinë e tij; <input type="checkbox"/> diskuton mbi parimet krijuese, metodën e tipizimit, artin dhe idetë e Balzakut; <input type="checkbox"/> heq vija paralele ndërmjet <i>Komedisë hyjnore</i> të Dantes me <i>Komedinë njerëzore</i> të Balzakut. 		Etapa të krijimtarisë Struktura e komedisë njerëzore Tematikë Tipizim i personazheve Art Stili proliks	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Teksti i letërsisë Fjalor i gjuhës shqipe Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.		Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<i>Bashkëbisedimi, stuhi mendimi, lexim i drejtuar, punë e pavarur, punë në grup, pema e mendimit.</i>			

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *stuhi mendimi, bashkëbisedim*


Në fillim të kësaj ore mësuesi/ja bën kontrollin e detyrës së shtëpisë. Diskutohet mbi elementet të realizmit në fragmentet e shkëputura të leximeve të komentuara: “Në ballo”; “Takimi me njeriun e madh”; “Beteja e Vaterlosë”; “Shtëpi kukulle”.

Mësuesi/ja shënon në tabelë veçoritë për secilin fragment dhe bën krahasimin mes tyre. (Për këtë moment të orës së mësimi mund të shfrytëzohet tabela e dhënë si material shtesë në mësimin pararendës.)

Mësuesi/ja shënon në tabelë thënien e Honore dë Balzakut (të shkëputur nga vepra “Xha Gorio”) përmes bashkëbisedimit diskuton mbi kuptimin e saj:

Unë jam një poet i madh. Nuk i hedh poemat në letër, ato qëndrojnë në veprime dhe ndjenja.

Me anë të stuhisë së mendimeve nxënësit paraqesin informacionin që kanë për jetën dhe krijimtarinë e Balzakut.



Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, lexim i drejtuar, punë në grup, pema e mendimit

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe diskuton me ta mbi tematikat e krijimtarisë së Balzakut, parimet krijuese, artin e tij, tipat e personazheve të krijuara etj.

Temat	Tipat e personazheve/metoda e krijimit	Iluzioni i plotësisë së jetës	Stili prolis
Epoka, zakonet, sjelljet dhe morali; jeta e kryeqytetit, e qyteteve të provincës dhe e fshatit; politika, shtypi, financa, drejtësia dhe lufta; feja, filozofia dhe arti; vesi, virtyti dhe krimi; dashuria dhe ideali; roli i parasë; tema e dashurisë; fati i të riut në shoqërinë bashkëkohore.	Zgjedh individin më përfaqësues dhe krijon me të tipin letrar: duke bashkuar vetitë e shumë karaktereve të njëlojta (Grandeja, Evgjenia). Teoria e pasionit mbizotërues që u jep një individualizim të fuqishëm tipave të caktuar. Heronjtë kthehen në maniakë të çuditshëm, duke iu nënshtruar pasionit mbizotërues. Personazhet janë individë në lëvizje të përhershme; ata që nisen nga shtresat e ulëta të shoqërisë dhe mbërrijnë në majë ose anasjelltas. Personazhet dytësore sigurojnë dinamikën e brendshme të veprës, duke krijuar sfondin e nevojshëm ku ngrihen e bien kryeheronjtë.	Krijimtaria e tij shquhet për forcën e imagjinatës dhe dhuntinë e trillimit artistik; intuitën e pagabueshme për të kuptuar thelbin e realitetit të shfaqur dhe për ta modeluar këtë sipas fantazisë së vet. Veprat e tij krijojnë iluzionin e plotësisë së jetës, e këtu qëndron gjenialiteti i krijuesit.	stilin prolis: përshkrime, hollësi e stërzgjatje, që ndonjëherë e rëndojnë subjektin, artist i detajit. I jep dramacitet subjektit, e çon atë në mënyrë të natyrshme drejt pikave kulmore, monologët shpërthyes. Figuracioni i fuqishëm, gjykime përgjithësuese që marrin formën e sentencave morale.
	kushërinjtë e varfër, fshatarët		

c. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, pema e mendimeve

Në këtë pjesë të orës së mësimi, për të demonstruar rezultatet e arritura gjatë saj, kërkojmë nga nxënësit të angazhohen në diskutimin e analogjisë mes *Komedisë hyjnore* të Dantes me *Komedinë njerëzore* të Balzakut.

	Komedia hyjnore (Dante)	Komedia njerëzore (Balzak)
Temat		
Personazhet		
Struktura e veprës		

Vlerësimi:

Gjatë kësaj ore mësimore, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimi. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur

Në detyrën e nisur në klasë, mësuesi/ja mund t’u kërkojë nxënësve si detyrë nga fusha e historisë të njohin kohën dhe kontekstet në të cilat kanë jetuar shkrimtarët, të cilët në njëfarë mënyre kanë ndikuar në krijimin e personazheve të tyre (duhet të mbahet parasysh që Dantja ka në veprën e tij disa lloje personazhesh: të trilluara, historike, bashkëkohëse të tij etj. Ndërsa Balzaku përdor një teknikë tjetër në krijimin e tyre për të cilën i është dashur të vëzhgojë imtësisht realitetin në të cilin jetonte.)

Hulumtoni në internet apo edhe mes librave thënie të Balzakut dhe për Balzakun.


Tematika: Epoka e Realizmit	Situata e të nxënit:
Tema mësimore: Analizë, “Xha Gorioi”	Nxënësi kupton se si përvojat letrare ndikojnë duke ndërtuar përvoja personale, vlera dhe qëndrime, që vlejnë më vonë në perceptimin e botës.
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca personale	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <input type="checkbox"/> njih subjektin e romanit; <input type="checkbox"/> përcakton temën dhe idenë e tij; <input type="checkbox"/> dallon strukturën dhe elemente të stilit; <input type="checkbox"/> analizon personazhet, marrëdhëniet ndërmjet tyre tyre, mjedisin, rolin dhe funksionin e tyre.	Fjalë kyç: Personazh Temë Ide Mjedis Marrëdhënie Strukturë Stil

Burimet: Teksti i letërsisë Fjalor i gjuhës shqipe Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Bashkëbisedim, stuhi mendimi, lexim i drejtuar, punë në grup, ditar dypjesësh, harta e koncepteve diagrami i Venit</i>	

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *bashkëbisedim*

Mësuesi/ja e nis mësimin me kontrollin e detyrës së shtëpisë mbi krijimin e personazheve i mbështetur edhe në kontekstin jetësor. Synimi i kësaj detyre lidhet me karakteristikën e Balzakut mbi tipizimin e personazheve, për të dalë diskutimi në mënyrë të natyrshme të romani “Xha Gorioi”.



Ndërtimi i njohurive të reja: *lexim i drejtuar, punë në grup, ditar dypjesësh, harta e koncepteve*

Me anë të hartës së koncepteve mësuesi/ja së bashku me nxënësit shënon veçori të përgjithshme që lidhen me romanin “Xha Gorioi”.

Romani “Xha Gorioi” zë një vend të veçantë në tërësinë “e Komedisë njerëzore”. Ai shërben si udhëkryq ku takohen disa prej heronjve kryesorë të veprës së Balzakut.

Autori e ka shkruar këtë vepër duke u mbështetur në elementin bazë në të cilin ndërtohet shoqëria, prandaj pohon: *Për mua elementi bazë i shoqërisë nuk është individi, por familja.*

Romani rrëfen për:

- prindin fatkeq, (sakrificën e tij në emër të familjes, vajzave të tij)
- bijat mosmirënjohëse,

duke përcaktuar *njëkohësisht temën dhe idenë kryesore* të kësaj vepre. Rreziku i shkatërrimit të familjes vë një pikëpyetje të madhe themelet e shoqërisë, prandaj në këtë roman ajo ndihet si shenjë alarmuese.

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të tregojnë mbi subjektin e romanit “Xha Gorioi”.


Ngjarjet kryesore ndodhin në pensionin e zonjës Voker, në fundin e nëntorit të vitit 1819, ku jetojnë mbledhur shtatë bujtës në nevojë: në katin e dytë - zonjusha e re Viktorina Tajfer me një kushërirë të largët, madamën Kutyr; në katin e tretë - një nëpunës që ka dalë në pension, Puareja dhe një zotëri enigmatik në mesmoshë me

emrin Votren; në katin e katërt - një vashë lëneshë, madmuazel Mishono, një ish-tregtar bukësh, Gorioi dhe studentin Eugjen de Rastinjak, i cili ka ardhur në Paris nga Angulema etj...

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe me anë të metodës *lexim i drejtuar* plotëson tabelën për personazhet dhe karakteristikat e tyre.

Personazhi	Çfarë përfaqëson	Funksioni i tij
Znj. Voker		
Bijat e xha Gorioit		
Rastinjaku		
Xha Gorioi		
Personazhe dytësore		

Subjekti shoqërohet edhe me analizën e personazhit kryesor xha Gorio. Me anë të skemës më mëposhtme mund të paraqesim kompleksitetin e Gorioit si personazh.



Pas analizës së personazheve mësuesi/ja drejton pyetjen:


Pse është një vepër realiste? Cilat veçori të veprës realiste gjejmë në të?

Shënim. Këto pyetje e përqendrojnë vëmendjen e nxënësit jo vetëm në identifikimin e veçorive të veprës realiste, por edhe në elemente specifike të stilit të Balzakut, si: në elementet e përmbajtjes, detajet artistike dhe strukturë. Mësuesi/ja është i lirë të shënojë edhe detaje dhe elemente të tjera, të cilat shërbejnë për pasurimin e mëtejshëm të veçorive të stilit të Balzakut në tabelë. Në fund të analizës nxënësi mund të japë mendimin e tij mbi vlerësimin: *Balzaku dhe krijimtaria e tij u bënë themelues të epokës letrare të realizmit*.

Veçoritë	Karakteristika të veçorive	Fragmente të ilustruara
Tema		
Struktura e veprës		
Mjedisi		
Koha		
Marrëdhënia personazh-mjedis		
Përplasja e pasioneve dhe interesave		
Konflikti / zgjidhja e tij		
Mesazhi që transmeton		

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *diagrami i Venit, bashkëbisedim*

Me anë të diagramit të Venit mësuesi/ja u kërkon nxënësve të vendosin në plane krahasuese veprën e Balzakut “Komedia njerëzore” me atë të Dantes “Komedia hyjnore”.



Nëse vepra e Dantes përfundon me një fund të lumtur, a ka të njëjtin fund vepra e Balzakut? (Referojuni veprave kryesore të krijimtarisë së Balzakut.)

Vlerësimi:

Gjatë kësaj ore mësimore, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mëimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrë (shkrim i lirë, ese)

Shkruani një ese duke marrë në konsideratë pyetjet:

- Ku qëndron drama e xha Gorioit?
- Pse ai është ndër personazhet më fatkeqë?

Për të shkruar esenë tuaj lexoni fragmentin “Vdekja e xha Gorioit” në tekst.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: IX
Tematika: Epoka e Realizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.	
Tema mësimore: Koment “Xha Gorio”			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë dhe për të zbërthyer mekanizmin e brendshëm të funksionimit të veprës; <input type="checkbox"/> përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar; <input type="checkbox"/> zgjeron njohuritë mbi ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike); <input type="checkbox"/> demonstroi shkathtësitë e fituara gjatë komentit të fragmentit. 		Fjalë kyç: Roman Personazhe “Xha Gorio” Vajzat Dashuri prindërore Marrëdhënie Familje Para Jetë Atdhe Monolog Tragjizëm	

Burimet: Teksti i letërsisë Fjalor i gjuhës shqipe Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Bashkëbisedimi, kllaster, lexim i drejtuar, punë në grup, punë me grupe ekspertësh, ditari dy-trepjesësh, diskutim i drejtuar, punë e pavarur.</i>	


Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: bashkëbisedim, kllaster

Mësuesi u kërkon nxënësve të lexojnë detyrën e shtëpisë (ese, shkrim i lirë):

“Ku qëndron tragjizmi i Gorioit?”

Me anë të bashkëbisedimit nxënësit hedhin idetë e tyre mbi tragjizmin e personazhit në skemën e mëposhtme. (skema është sugjeruese, ajo mund të përmbajë edhe ide e shënime të tjera që vijnë prej nxënësve)



Ndërtimi i njohurive të reja: lexim i drejtuar, punë në grup, grupi i ekspertëve, ditari trepjesësh

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe në nivel ekspertësh (pra edhe brenda grupit punët mund të pësojnë ndarje më të vogla. Kjo e fundit u lihet në dorë vetë nxënësve ta organizojnë dhe mësuesi/ja mund të vëzhgojë duke vlerësuar.) dhe u sugjeron që me anë të teknikës së leximit të drejtuar të zbulojnë në fragment elemente që kanë të bëjnë me të kuptuarin e fragmentit, interpretimin, gjuhën dhe stilin.

Grupi I:

- përshkruan marrëdhëniet e Gorioit me të bijat (referuar monologut të Gorioit);

Personazhi	Karakteristika të marrëdhënies	Detaje nga teksti
Gorioi	marrëdhënia familjare në bazë të interesit	
	sipërfaqësore	
	egoiste	
	individualiste	
	mungojnë parimet dhe vlerat	
	mungon dashuria e sinqertë etj.	

diskuton mbi raportet e vajzave kundrejt të atit dhe anasjellas (faji i Anastasisë dhe i Delfinës kundrejt Gorioit, faji i Gorioit kundrejt tyre);

Vajzat		Gorio
	Faji	

- veprimi i Gorioit (bekimi që ky u jep të bijave, megjithëse vdes i braktisur prej tyre)
- diskutojnë mbi zgjidhjen finale të romanit si veprim brenda natyrës së personazhit.

Përgjigje e mundshme. *Veprimi i Gorioit është i justifikueshëm brenda natyrës së tij. Ai është baba dhe si i tillë është detyra e tij të pranojë fëmijët e tij ashtu siç janë. Gorioi e pranon të vërtetën e tij me dhimbje, por pa frikë. Me anë të dëshmisë së tij reale ai i bën apel shoqërisë të ndërgjegjësohet dhe të dijë të ndërtojë marrëdhënie të drejta në familje, e cila është baza e shoqërisë dhe shtetit. Veprimi i tij është rrjedhë logjike e të gjithë marrëdhënies së ndërtuar dhe dashurisë që ai ka për vajzat. Si i tillë nuk do të kishte kuptim të ndodhte ndryshe. Si prind ai e luan detyrën e tij më së miri, përtej vuajtjes madhore, ndien të nevojshme të bëjë autokritikë, të moralizojë, të kërkojë ngritjen e parimeve dhe vlerave, të martirizohet në emër të dashurisë prindërore.*

Grupi II

Komentoni si e kuptoni dhe interpretoni:

- shprehjen e xha Gorioit “Paraja të jep gjithçka, edhe vajzat”. Cili është gjykimi i Balzaku në lidhje me këtë? Thoni dhe ju mendimin tuaj.

Përgjigje e mundshme. *Edhe pse vepra e Balzaku është shkruar në shek. XIX ajo përmban një të vërtetë të madhe të kohëve moderne: moralin e gënjeshtërt shoqëror në ndërtimin e marrëdhënies me bazë interesi. Ky gjykim i Balzaku vjen si pasojë e vëzhgimit dhe studimit të hollësishëm të realitetit shoqëror duke përcjellë një mesazh karakter universal të të gjitha kohërave.*

- si mund të përkufizohet dashuria e Gorioit për të bijat; çfarë efektesh artistike maksimale arrin Balzaku nëpërmjet një personazhi si xha Gorioi?

Përgjigje e mundshme. *Vetë Gorio është fajtor për ndërtimin e gabuar të marrëdhënies së tij me vajzat, e cila ka dëmtuar dashurinë prindërore dhe atë të fëmijëve kundrejt prindërve. Është normale që dashuria atërore për vajzat të jetë e pakufishme, por jo e dëmshme, sepse në të kundërt ajo shkatërron marrëdhëniet, familjen dhe gjithë shoqërinë. Vuajtja nga pranimi i së vërtetës dhe nga mungesa e dashurisë shkakton rritjen e tensionit artistik dhe ndjeshmërisë të lexuesit në një shkallë maksimale. Përjetimi i lexuesit ndaj dramës së Gorioit nuk do të ishte i njëjtë nëse nuk do të shoqërohej nga shkalla e lartë e sinqeritetit, e ndjenjave, e vetëgjyimit të veprimeve, e apelit ndaj shoqërisë.*

- Cili është mendimi i Balzaku për familjen dhe si konkretizohet përmes historisë së xha Gorioit?

Përgjigje e mundshme. *Me anë të fjalëve të shprehura përmes personazhit të tij: Atdheu do të shkatërrohet në qoftë se prindët merren nëpër këmbë. Kjo është e qartë. Boshti rreth të cilit sillet shoqëria, gjithë bota, është atësia; të gjitha do të shemben, nëse fëmijët nuk i duan prindët e tyre... Balzaku pranon hapur se baza e një shoqërie është vetëm familja. Prandaj shkatërrimi i saj sjell shkatërrimin e pashmangshëm të shoqërisë. Ajo duhet të punojë fort me anë të edukimit të parimeve të vlerave për ta ruajtur familjen.*

Grupi III

Ky grup mund ta ndajë punën e tij në dy pjesë. Në përcaktimin e varësisë së temës me specifikën stilistike të shkrimtarit për të tipizuar personazhet dhe në përcaktimin e funksionit gjuhësor e stilistik të detajeve të caktuara gjuhësore.

1. Me anë të punës së ekspertëve në ditarin dypjesësh përcakton:

temat kryesore	tipizimin e personazhit / individualizmin e tij
familja	Përmes mënyrës së të menduarit, të sjelljes, të shprehjes së ndjenjave, të veprimeve (guximi për të pranuar të vërtetën dhe për ta thënë hapur atë. Gorio tregon pa asnjë vështirësi, por me dhimbje dhe vuajtje marrëdhënien me vajzat)
paraja	Dobësinë përpara ndjenjës së dashurisë atërore. Pafuqinë për të bërë si duhet detyrën e tij si prind. etj
fati i individit	Tragjizmi (janë pikërisht marrëdhëniet e vendosura ato që vendosin për fatin tragjik të Gorioit)
mbijetesa	
degradimi i moralit shoqëror e individual	

Shprehjet gjuhësore të gjendjes psikologjike të rënduar	Funksioni	Veçoria stilistike


Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Në këtë fazë të mësimit nxënësit punojnë të pavarur me ushtrimet 10, 11, dhe 12 në tekstin e nxënësit.

10.

Shprehja gjuhësore	Kuptimi	Argumenti
martirizim		

11.



Në zhvillimin e këtij ushtrimi mësuesi/ja është mirë t'u vijë në ndihmë nxënësve me përkufizimet që sjell fjalori për secilën fjalë:

sëmundj/e, -a f. sh. -e(t) 1. çrregullim ose dëmtim i veprimtarisë së zakonshme në trupin e njeriut a të kafshës ose te bimët, i shkaktuar nga viruse, infektive etj.; gjendje e keqe e shëndetit: *sëmundje e rëndë (e lehtë, e gjatë)*; *sëmundje ngjitëse (e trashëgueshme)*; *sëmundjet mendore (profesionale)*; *sëmundjet e fëmijërisë* fruthi, lia etj.; *sëmundja e ftohtë (euf.)* tifoja; *sëmundja (lëngata) e hënës* sëmundja e tokës, epilepsia;

sëmundja e ligë (euf.) epilepsia; sëmundja e sheqerit sëmundje e shkaktuar nga tepria e glukozës në gjak; diabet; sëmundja e tokës epilepsia; sëmundja e hirit (e mykut) te bimët; sëmundja e bronzit sëmundje që u bie fletëve të agrumeve, të cilat marrin një ngjyrë si ajo e bronzit; kaloi (hoqi) një sëmundje; ia ngjiti sëmundjen.

2. fig. diçka që pengon, që dëmton e që prish zhvillimin e rregullt të gjërave; dobësi e rëndë: sëmundja e burokratizmit. 3. fig. ves: e ka sëmundje të flasë pa leje; i është bërë sëmundje.

mëkat,-i m. sh. -e(t) 1. fet. shkelje e rregullave të fesë; veprim a sjellje kundër këtyre rregullave: bie në mëkat. 2. bised. veprim i turpshëm; gabim, faj: kishte ca mëkate të vjetra.

12.

Shprehjet që përmbajnë ironi	Shpjegimi / funksioni

Vlerësimi:

Gjatë kësaj ore mësimore, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimin. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrë (shkrim i lire, ese)

Krahasoni gjendjen shpirtërore e morale të xha Gorioit me Mbretin Lir të Shekspirit.

Imagjinoni një situatë ku ju jeni një personazh i shquar në shoqëri, ndërsa prindi juaj një njeri i thjeshtë. Si do të sillleshit ju me prindin tuaj në sy të të tjerëve? Mendimet tuaja shkruajini në formën e esesë, të tregimit ose të poezisë (sipas prirjes që keni).

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: IX
Tematika: Epoka e realizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.	
Tema mësimore: Koment “Xha Gorio”			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit			

<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë dhe për të zbërthyer mekanizmin e brendshëm të funksionimit të veprës; <input type="checkbox"/> përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar; <input type="checkbox"/> zgjeron njohuritë mbi ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike); <input type="checkbox"/> demonstroi shkathtësitë e fituara gjatë komentit të fragmentit. 	<p>Fjalë kyç:</p> <p>Xha Gorio Para Jetë Tragjizëm Vdekje Varrim</p>
<p>Burimet:</p> <p>Teksti i letërsisë Fjalor i gjuhës shqipe Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Bashkëbisedim, punë në grup, puna me grupe ekspertësh, ditari dy-trepjesësh, diskutim i drejtuar, shkrim i lirë</i></p>	

Organizimi i orës së mësimimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: bashkëbisedim

Në fillim të kësaj ore mësimi, nëpërmjet bashkëbisedimit kontrollojmë detyrat e dhëna herën e kaluar.

- Dy-tre nxënës lexojnë punët e tyre.
- Nxënësit që kanë lexuar romanin bëjnë lidhjen kuptimore ndërmjet fragmentit dhe të gjithë veprës, duke komentuar mbi funksionin që luan ky fragment.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë me grupe ekspertësh, ditari dy-trepjesësh, bashkëbisedim

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve ta ndajnë fragmentin në dy paragrafë dhe t'u vendosin atyre nga një titull:

- paragrafi I në të cilën përshkruhet varrimi i Xha Gorioit dhe përjetimet e Rastinjakut në lidhje me të.
- paragrafi II në të cilin përshkruhet vetmia e Rastinjakut dhe domethënia e saj.

Mësuesi/ja e përqendron vëmendjen e nxënësve në detajet domethënëse të secilit paragraf.

Grupi I

– Çfarë përfytyrimi dhe ndjesish ju ngjall përshkrimi i varrimit të Xha Gorioit?

Diskutoni mbi komentet e tyre. Tabela e mëposhtme i ndihmon nxënësit të evidentojnë detajet, të cilat kanë nevojë për koment. (Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për kuptimin e domethënies, simbolikës së tyre.)

Ngjarja	Mjedisi (detajet)	Personazhet	Si veprojnë?	Si ndihen?	Komente të autorit
Kur e vunë kufomën në karrocën e të vdekurve, erdhën dy karroca me emblema, po bosh, ajo e kontit Dë Resto dhe ajo e baronit Dë Nysingen, dhe e përcollën të vdekurin gjer në varreza.	Kishte zënë të ngrysej, një muzg i lagësht të cingëriste nervat	dy karroca me emblema, po bosh, ajo e kontit Dë Resto dhe ajo e baronit Dë Nysingen,	<i>e përcollën të vdekurin</i>		
Më ora gjashtë, trupi i xha Gorioit u zbrit në varr, rrotull ishin karrocierët e të bijave, po dhe ata u zhdukën menjëherë bashkë me priftërinjtë, me të mbaruar lutja e shkurtër që u këndua për bablokun me të hollat e studentit.		ishin karrocierët e të bijave	<i>u zhdukën menjëherë bashkë me priftërinjtë</i>		
		dy varrmihësit	<i>Si hodhën ca lopata dhe mbi tabutin për ta mbuluar, u ngritën dhe njëri syresh i kërkoi Rastinjakut bakshishin</i>		
		Eugjeni	<i>futi dorën në xhep, po s'gjeti asnjë dhjetësh; u shtrëngua t'i merrte hua Kristofit njëzet solda. ai vështroi varrin dhe mbuloi në të lotin e fundit të djalërisë, kryqëzoi duart dhe soditi retë;</i>		Ky rast që në vetvete s'kishte asnjë rëndësi, e mbushi Rastinjakun me një trishtim të thellë, atë lot të shkëputur nga emocionet e shenjta të një zemre të kulluar, një nga ata lot që, nga toku ku bien, çohen gjer në kupë të qiellit.

Mjedisi (detajet)	Personazhet	Si veprojnë?	Si ndihen?	Komente të autorit
ku zunë të llamburisnin dritat pa Parisin, që gjarpëronte nga të dyja anët e lumit Senë	Rastinjaku mbeti vetëm	bëri disa hapa në të përjetën e varrezave Sytë e tij u mbërthyen me lakmi në mes të shtyllës së sheshit Vandomë dhe kubesë së Shtëpisë së Invalidëve, atje ku jetonte ajo shoqëri e lartë e Parisit, objekti i synimeve të tij. -Tani të shohim se kush do të fitojë, unë apo ti: Dhe, duke i hedhur sfidën kësaj shoqërie, ai shkoi për drekë te zonja Dë Nysingen.		Eugjeni i hodhi asaj koshereje që zukiste, një vështrim, si t'i thithte që më parë mjaltin , e tha këto fjalë të madhërishtme:

Grupi II

Si i kuptoni fjalët e Rastinjakut:- si kërcënim që i bën shoqërisë së lartë;

- si premtim që i bën vetvetes;
- si synim për të arritur në jetë?

Përgjigje e mundshme. Fjalët e Rastinjakut u referohen të tria kuptimeve njëkohësisht. Duke marrë në konsideratë shtresën së cilës i përket dhe mënyrës si janë ndërtuar marrëdhëniet ndërmjet vetë shtresave të shoqërisë, ai e “kërcënon” shoqërinë e lartë si fajtorë për fatin e Xha Gorioit dhe fatin e të gjithë atyre njerëzve të cilët pushteti i parasë i ndëshkon padrejtësisht. Rastinjaku e ka kuptuar si funksionon shoqëria dhe duke qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë i rastit të Xha Gorioit, ai nuk do ta lejojë veten të ketë të njëjtin fat. Duke qenë se është i ri dhe pjesë e një psikoze dhe mendësie shoqërore prej së cilës nuk del dot, ai do të synojë ngjitjen drejt shtresave të pasura shoqërore duke mos ndryshuar shumë nga personazhet e tjera në roman. (Madje me anë të kësaj fjalie të fundit, Balzaku, nëpërmjet specifikave të stilit të tij tipizimit, paralajmëron rishfaqjen e personazheve në vepra të tjera të tij.)

Grupi III

Evidentoni në fragment elemente të tipizimit të personazheve. Në fragmentin e mësipërm shfaqen **detaje të tipizimit të personazheve nëpërmjet veprimeve dhe pasionit mbizotërues po nëpërmjet tyre:** p.sh.:

- *erdhën dy karroca me emblema, po bosh, ajo e kontit Dë Resto dhe ajo e baronit Dë Nysingen, dhe e përcollën të vdekurin gjer në varrezat Perë-Lashezë... ishin karrocierët e të bijave, po dhe ata u zhdukën menjëherë bashkë me priftërinjtë, me të mbaruar lutja e shkurtër që u këndua për bablokun me të hollat e studentit.*

Me anë të këtyre detajeve shfaqjen sjellje tipike të shtresës që përfaqësojnë: përcjellja e një të vdekuri të parëndësishëm nga karroca bosh me emblema që prezantojnë titujt e familjeve.

- *të dy varmihësit u ngritën dhe njëri syresh i **kërkoj Rastinjakut bakshishin***
- *...mbuloi në të **lotin e fundit të djalërisë, atë lot të shkëputur nga emocionet e shenjta të një zemre të kulluar, një nga ata lot që nga toka ku bien, çohen gjer në kupë të qiellit..***
- ***Sytë e tij u mbërthyen me lakmi në mes të shtyllës së sheshit Vandomë dhe kubesë së Shtëpisë së Invalidëve, atje ku jetonte ajo shoqëri e lartë e Parisit, objekti i synimeve të tij.***

Mësuesi/ja, përveç këtyre detajeve simbolike, mund t'u kërkojë nxënësve të evidentojnë elemente të tipizimit dhe pasionit mbizotërues edhe nga fragmente të tjera të romanit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: shkrim i lirë

Duke iu referuar fjalëve të fundit të Rastinjakut, si dhe duke u mbështetur në thënien e mëposhtme të shkëputur nga romani:

E dini si e çan njeriu rrugën e tij këtu? Ose me shkëlqimin e gjenisë, ose me artin e të korruptuarit. Duhet të hysh në këtë masë njerëzish si një gjyle topi ose të depërtosh si murtajë. Ndershmëria s'pi ujë. (Xha Gorio); mësuesi u kërkon nxënësve që nëpërmjet një shkrimi të lirë ta komentojnë atë.

Vlerësimi:

Gjatë kësaj ore mësimore, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimi. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrë

- Shkruani disa argumente pro dhe kundër mënyrës se si e shfaqin prindërit e sotëm dashurinë për fëmijët.
- Sillni në klasë informacion për Gustav Floberin dhe krijimtarinë e tij.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: IX
Tematika: Epoka e realizmit		Situata e të nxënit: Diskutim mbi krijimtarinë dhe veçori të stilit të Balzakut.	
Tema mësimore: Diskutim mësimor, Balzaku			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale Kompetenca qytetare Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> diskutojnë mbi praninë e metodës natyraliste në krijimtarinë e Balzakut; <input type="checkbox"/> analizojnë lidhjen dhe marrëdhënien e tematikave të trajtuara me natyrën e personazheve; <input type="checkbox"/> shpjegojnë lidhjen e emrit të Balzakut me drejtimin letrar të realizmit; <input type="checkbox"/> veçojnë elemente të stilit dhe i vendos në plane krahasuese me drejtimin letrar të romantizmit; <input type="checkbox"/> vlerësojnë figurën e Balzakut duke u mbështetur në thënien e Balzakut dhe vlerësime të shkrimtarëve e filozofëve të tjerë për të; <input type="checkbox"/> shpreh mendimin dhe mban qëndrim individual mbi idetë që përcjell vepra e Balzakut. 		Fjalë kyç: Metodë natyraliste, drejtim letrar, realizëm, veçori të stilit.	

Burimet: Teksti i letërsisë Fjalor i gjuhës shqipe Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Bashkëbisedim, punë në grup, ditar dypjesësh, shkrim i lirë.</i>	

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *bashkëbisedim*

Duke qenë se tema është diskutim mësuesor në nivel të përgjithshëm mbi Balzakun dhe krijimtarinë e tij, mësuesi/ja duhet të synojë përmes saj evidentimitin e elementeve më të rëndësishme të krijimtarisë së tij. Me anë të metodës së bashkëbisedimit mësuesi/ja piketon çështjet kryesore që lidhen me: metodën që ai ndjek, personazhet dhe tematikën, stilin dhe drejtimin të cilit i përket krijimtaria e tij. Për këtë arsye ndan klasën në grupe duke i përfshirë të gjithë nxënësit në diskutim.

Grupi I

- Balzaku ndikohet nga shkencat natyraliste. Si shprehet ky ndikim në konceptimin e *Komedisë njerëzore* dhe në personazhet e saj?

Grupi II

- Tematika e romaneve të Balzakut është e gjerë. Çfarë kanë të përbashkët ato me njëra tjetrën?

Grupi III

- Emri i Balzakut është i lidhur me drejtimin letrar të realizmit. Ku e bazon ai këtë mendim dhe si e shpreh në disa nga veprat e tij?

Grupi IV

- Cilat veçori individuale dhe artistike e dallojnë Balzakun prej autorëve të mëdhenj të letërsisë romantike?

Ndërtimi i njohurive të reja: *bashkëbisedim, ditar dypjesësh*

Në këtë fazë të mësimit, pasi janë rikujtuar dhe sjellë në vëmendje të nxënësit specifika të krijimtarisë së Balzakut, mësuesi/ja e përqendron vëmendjen e nxënësve në shprehjen e mendimeve të pavarura, mbajtjen e qëndrimeve dhe vlerësimeve individuale mbi figurën e Balzakut dhe krijimtarisë së tij. U sugjeron nxënësve të ndërtojnë një organizues grafik të ditarit dypjesësh, ku të vendosin në ballafaqim thënie të Balzakut të shkëputura nga vepra e tij dhe vlerësime të shkrimtarëve të letërsisë botërore mbi veprën dhe krijimtarinë e tij dhe të diskutojnë rreth tyre. Në këtë mënyrë, nxënësi do ta ketë të lehtë të kuptojë dhe të vlerësojë figurën e Balzakut nga shumë këndvështrime.

	Thënie të Balzakut	Kanë thënë për Balzakun
Mendime për shkrimtarin	Poeti i vërtetë duhet të qëndrojë i fshehur njëlloj si Zoti, në qendër të botëve të veta, e të bëhet i dukshëm vetëm nëpërmjet krijesave të tij. (<i>Modestë Minjon</i>)	Vetëm një gjë i mungoi Balzakut gjatë jetës së tij të shkurtër e shumë aktive: koha. (Stefan Cvajg, <i>Balzaku</i>)
		Jeta e Balzakut ka më shumë vepra sesa ditë. (Viktor Hygo, <i>Fjalim i përmotshëm</i>) Balzaku ka qenë vërtetë një Napoleon në jetën letrare të Francës, sepse ai shkatërroi idetë feudale në letërsi në një mënyrë po aq të ndërgjegjshme si edhe udhëheqësi i madh që shkatërroi sistemin feudal në jetën politike. (Ralf Foks, <i>Romani dhe populli</i>)
Mendime për veprën	Ideja e <i>Komedisë njerëzore</i> më erdhi nga një krahasim midis njerëzimit e kafshërisë. (Parathënie për <i>Komedinë njerëzore</i>)	Në <i>Komedinë njerëzore</i> ai na tregon se si do ta kishte krijuar botën po të ishte Zot. (Gaetan Pikon, parathënie për <i>Iluzionet e humbura</i>)
		Balzaku i lejon vetes të gjykojë vetëm pas një analize të saktë, që nxjerr në pah kontradiktat, gjë që përbën një qëndrim shumë shkencor... Ne kemi shumë për të mësuar nga Balzaku, me kusht që të dimë shumë qysh më parë. (Bertold Brecht, <i>Mbi realizmin</i>)
Mendime për qenien dhe shoqërinë njerëzore	Veshja është çështje me rëndësi për njeriun që dëshiron të duket se ka atë që i mungon. (<i>Iluzionet e humbura</i>)	
	E dini si e çan njeriu rrugën e tij këtu? Ose me shkëlqimin e gjenisë, ose me artin e të korruptuarit. Duhet të hysh në këtë masë njerëzish si një gjyle topi ose të depërtosh si murtajë. Ndershmëria s'pi ujë. (<i>Xha Gorio</i>)	
	Njeriu, shoqëria, njerëzimi do të përshkruhen, gjykoohen, analizohen, në një vepër që do t'i shëmbëllejë <i>Një mijë e një netëve të Perëndimit</i> . (Letër e vitit 1834 drejtuar Zj. Evelinë Hanska)	

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: shkrim i lirë

Referuar fragmentit të dhënë në tekst, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të sjellin argumentet pro dhe kundër fjalëve të tij të shprehura në kërkesën e mëposhtme të ushtrimit të tekstit.

Shënim. Nëse koha për kryerjen e këtij ushtrimi nuk mjafton, mësuesi/ja mund ta sugjerojë vazhdimin e tij si detyrë shtëpie.

Votreni është si vëlla shpirtëror i Mefistofelit që e grish Rastinjakun drejt aventurës, lavdisë dhe suksesit. Pasi të lexoni fragmentin që paraqet “mësimet”, të cilat Votreni ia jep Rastinjakut.

Vlerësimi

Përgjatë kësaj ore mësimi, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit

Detyrë

Shkrim i lirë

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: IX
Tematika: Epoka e realizmit		Situata e të nxënit: Nxënësi kupton se si përvojat letrare ndikojnë duke ndërtuar përvoja personale, vlera dhe qëndrime, që vlejnë më vonë në perceptimin e botës.	
Tema mësimore: Gustav Floberi, jeta dhe vepra			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • diskuton në grup në mënyrë konstruktive, duke dhënë dhe marrë informacion; • njuh dhe vlerëson veprën e Floberit për kontributin e saj në letërsinë realiste e sidomos për lëvrimin e romanit psikologjik; • aftësohet në analiza letrare për të kuptuar teknikat e shkrimit.		Fjalë kyç: Shkrimtar realist Stil Metodë natyraliste Subjekt psikologjik Bovarizëm Objektivizëm Impersonalizëm	
Burimet: Teksti i letërsisë Fjalor i gjuhës shqipe Foto Kompjuter Tabelë Shkumës Fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe Gjuhë e huaj Arte Histori TIK	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Bashkëbisedim, stuhi mendimi, lexim i drejtuar, punë në grup, ditar dypjesësh, diskutim i drejtuar

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: **bashkëbisedim, stuhi mendimi**


Në fillim të kësaj ore mësimi, nëpërmjet metodës së *bashkëbisedimit* vjelim nga nxënësit informacionet që kanë marrë në lidhje me jetën, vlerësimet e bëra ndaj Floberit dhe veprave të tij.

Duke u nisur nga teksti i mëposhtëm mbi stilin e Floberit, të cilin mësuesi/ja e ka shkruar në një tabak të bardhë dhe e prezanton përpara nxënësve, përmes stuhisë së mendimit nxit diskutimin për stilin e Floberit dhe karakteristikat e krijimtarisë së tij.

Si në romanet filozofike, "Tundimi i Shën Antonit", "Bugar dhe Pekyshe", në skicat "Shtatë djemtë e dervishit" dhe në romanet në kuptimin e thjeshtë të fjalës, si "Edukimi i ndjenjave", "Zonja Bavari" dhe "Salambo", autori, sa më shumë futet në botën e krijësave të tij, aq më tepër bëhet një me ta. Të lindura prej imagjinatës, ato do të kenë të njëjtin fat me të, sepse më kot do të vënë të gjitha forcat e tyre në kërkim të dashurisë, të lumturisë, të së vërtetës. E vetmja rrugë shpëtimi larg botës tragjike të njerëzve për shkrimtarin do të jetë pasqyrimi i jetës nëpërmjet artit.

Floberi kishte bindjen se për të shprehur një të vërtetë ka një mënyrë dhe vetëm një, ndoshta jo të qartë, por të bukur, dhe kështu vihej në kërkim të saj derisa ta gjente. Më 2 maj 1880, disa ditë para se të vdiste, ai i shkruan mbesës Karolinë, lidhur me një të dhënë botanike: "... kisha të drejtë, sepse estetika është e vërteta, dhe në njëfarë shkalle intelektuale (kur ke metodë) nuk gabohesh". Përpara se ta shprehte me magjinë e fjalës, ai punonte jashtëzakonisht shumë për të njohur të vërtetën, edhe kur duhej të rremonte për të në thellësitë e kohërave.

Një kult në letërsinë franceze dhe europiane



Ndërtimi i njohurive të reja: **punë me grupe ekspertësh, ditari dy-trepjesësh, bashkëbisedim**

Mësuesi/ja paraqet një tabelë, ku u kërkon nxënësve të ndarë në grupe të shënojnë veprat më të njohura të Floberit dhe karakteristikat e tyre.

<i>Edukimi i ndjenjave</i>	<i>Buvar e Pekyshe</i>	<i>Tundimi i Shën Antuanit</i>	<i>Zonja Bovari</i>
Tematika që trajton vendoset në traditën e njohur “të romanit të edukimit”; vë në qendër <i>historinë shpirtërore të një të riu</i> , e gërshetuar kjo me temën sociale dhe aventurën morale të një brezi të tërë.	<i>Paraqitet në forma groteske aventura intelektuale e epokës moderne</i> . Vepër me shumë “çelësa” ose libër “kurth”, <i>Buvar e Pekyshe</i> lë hapur shumë interpretime. Përbën një kritikë pa kompromis kundër injorancës, budallallëkut, konformizmit, dogmatizmit e mashtrimeve të çdo lloji.	E merr subjektin nga bota greko-latine e shekullit IV p.K. në epokën e konsolidimit të krishterimit. Floberi e quan <i>vepra e jetës së tij</i> . Për thjeshtësi e emërton roman, por një vepër si kjo nuk ka gjini të përcaktuar dhe i kapërcen kornizat emërtuese. Ajo është ndërthurje llojesh nga më të ndryshmet: prozë poetike, roman historik, dramë misteresh, ese filozofike.	Është një roman që dëshmon se vepra e artit mund të ndërtohet mbi çdo lloj teme e çdo lloj personazhi, duke u bërë kjo një pikënisje për të gjithë letërsinë natyraliste.

Mësuesi/ja diskuton me nxënësit mbi metodën krijuese realiste të Floberit.

- Veprat e tij i shkruante gjatë udhëtimeve që zhvillonte.
- Mblidhte të dhëna të hollësishme në biblioteka dhe në terren.
- Bën objekt të trajtimit të romaneve të tij tema nga më të rëndomt.
- Krijon heronj të zakonshëm dhe përshkruan me detaje, përveç jetës së tyre të thjeshtë, edhe botën shpirtërore e psikologjike.
- Hapi një perspektivë të re për trajtimin e materialit letrar dhe zhvillimin e letërsisë në përgjithësi.
- Krijoi heroin pasiv të dobët që nuk bën asgjë në jetë.
- Ngjarjet rrjedhin në mënyrë të natyrshme drejt atij fataliteti që ka caktuar historia etj.

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të ilustronjë këto specifika nga informacionet që kanë marrë për Floberin dhe nga veprat që kanë lexuar. (P.sh., nëse i referohen romanit “Zonja Bovari” personazhet e tij janë të zakonshme; i kushtohet më shumë vëmendje botës së Emës si personazh kryesor sesa ngjarjeve; personazhi ndiqet nga fataliteti i fatit të vet; autori e përshkruan me objektivitet dhe mban qëndrim impersonal ndaj saj, pavarësisht mendimit që ka për të etj.)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutim i drejtuar

Duke iu referuar veprave të Floberit që keni lexuar, diskutoni se cilit përbërës i kushton më shumë rëndësi Floberi në veprat e tij:

- Subjektit
- Idesë
- **Stilit**

A mund të bëjmë një krahasim me Balzakun në këtë nivel?

Vlerësimi

Gjatë kësaj ore mësimore, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimin. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënësve.

Detyrë

Shkruani subjektin e romanit “Zonja Bovari”.


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tematika: Letërsia shqipe në gjysmën I të shekullit XX.		Situata e të nxënësve: Nxënësit bisedojnë me njëri-tjetrin për rëndësinë e bukurisë e vargut fishtian.	
Temat mësimore: Gjergj Fishta, simboli i madhësisë së poezisë shqipe			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç:			
<ul style="list-style-type: none"> · kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; · kompetenca e të menduarit; · kompetenca qytetare; · kompetenca personale; · kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës varësisht nga tema mësimore.		Fjalë kyç:	
<i>Nxënësi/-ja:</i> - vë në dukje elementet që i japin madhësi verbit fishtian; - komenton vargjet e poetit; - zbulon rolin e mjeteve stilistike në poezinë <i>Nji lule vjeshtet</i> ; - analizon vargjet nga ana metrike.		lirika, himnizimi, toni kryengritës, fe dhe atdhe, ironia, krahasimi, dhimbja, trajta e vetërrëfimit, jeta, vdekja, metrika.	
Burimet: teksti i letërsisë, <i>Fjalor i gjuhës shqipe</i> , <i>Mrizi i Zanavet</i> , <i>Vallja e Parrizit</i> , foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore, material nga youtube: https://youtu.be/NMysLsWAdIU , etj...		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Histori, Sociologji, Arte figurative	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP, vështrim i një dokumentari, bisedë, lexim i drejtuar, organizuesi grafik, punë në grupe, ditari dypjesësh.			

Parashtrimi: Vështrim i një dokumentari, Bisedë.

Mësuesi orienton nxënësit për qëllimin e orës dhe u paraqet një dokumentar të marrë nga interneti, adresa të cilit është: <https://youtu.be/NMysLsWAdIU>. Mund dhe të shfaqet një punim i vetë nxënësve, i përgatitur më parë. Bisedë për madhësinë e veprës së Fishtës.

Ndërtimi i njohurive të reja: lexim i drejtuar, organizuesi grafik

Më tej, orientohen nxënësit të lexojnë në heshtje informacionin, *Lirikat*, që jepen në tekstin *Letërsia 11*. Përmes teknikës organizuesi grafik, përmbledhim në tabelë çështjet rreth krijimtarisë së tij lirike.



Përforcimi: Lexim shprehës, Punë në grupe, Ditari dypjesësh

Është çasti që një nxënës (parapëlqehen ata që e njohin dialektin gegë) të lexojë bukur poezinë *Nji lule vjeshtet*.

Secili grup do të zhvillojë një ushtrim të tekstit mësimor.

Ushtrimet/ Pyetjet Komentet e nxënësve

- Figura e bartjes, e cila i përgjigjet mospërkimit mes fundit të një fjalie dhe fundit të vargut, pra kur një fjali “bartet” në vargun pasardhës, është mbizotëruese në këtë poezi. P.sh.:

- Vëreni ku përdoret dhe zbuloni cili është efekti stilistik që përftohet nga përdorimi i kësaj figure, duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me një poezi lirike, në të cilën vajtohet për humbjen e një qenieje të dashur.

Si kumbë lired t'inglueshme, qi prej s'largut //Ndihet tue rá...

Pas përshkrimit të syve, poeti përqendrohet te goja (portreti i njeriut të tij të dashur që ka vdekur) e kryesisht te fjalët dhe zëri:

*T'janë sosun fjalët e ambla e plot urti
E ai zâ t'âsht kputë, i cilli bite m'zëmer
Si kumbë lired t'inglueshme, qi prej s'largut
Ndihet tue rá, kur dora e prekë e msueme!*

- Ai ishte i ditur, kurse me përshkrimin e zërit ai e forcon idenë e hedhur në vargun tjetër, duke theksuar se fjala e tij peshonte, ishte me vlerë, por dhe kumbonte bukur, si melodia e lirës që vazhdon e tingulli i saj ndihet larg... (similitudë). Përdorimi i figurës së bartjes, pra “këputja/thyerja e vargut”, krijon paralelizëm me jetën e këputur në mes të njeriut të dashur, që po vajton poeti. Krahasimi i zgjatur i zërit me lojën melodioze të lirës, nuk është gjë tjetër, veçse një tregues i përsosmërisë poetike fishtiane.

• Analizoni nga ana metrike vargjet e kësaj poezie duke kujtuar se:

- në vargun **parafundor**, kur theksi bie në rrokjen e parafundit të vargut, numri i rrokjeve numërohet atë sa është;
- në vargun **fundor**, kur theksi bie në rrokjen e fundit të vargut, numri i rrokjeve në varg numërohet një më shumë.
- në vargun **tejfundor**, kur theksi bie në rrokjen e tretë nga fundi të vargut, numri i rrokjeve numërohet një rrokje më pak. Për shembull, te një varg tetërrokësh, nëse theksi është parafundor, numërohen 8 rrokje, kur theksi është fundor, numërohen 9 dhe kur theksi është tejfundor, numërohen 7 rrokje.

• Një figurë tjetër shumë e përdorur të tërë krijimtaria e Fishtës në përgjithësi, por edhe në këtë poezi është figura e anasjellës (inversionit). Hetojini rastet kur përdoret kjo figurë në tekst dhe interpretoni efektet poetike që jep ky ndryshim i rendit të gjymtyrëve në fjali, si p.sh. në vargun: *Qi e përshpirtshme një dorë t'a vû te kryeni.*

• Në poezinë e mësipërme, ashtu si në gjithë poezinë e Fishtës, hetohet përdorimi i shumë figurave që kanë të bëjnë me heqjen e fonemave, kryesisht në fund e fillim të fjalës. Këto figura janë:

- *afereza*, heqja e një foneme (germe) në fillim të fjalës;
- *apokopa*, heqja e një foneme në fund të fjalës;
- *elizioni*, heqja e një foneme zanore kur fjala pasardhëse në varg fillon po me një zanore.

Të tria këto figura ndeshen shpesh në këtë poezi. Gjeneri në tekst përdorimin e figurave të mësipërme dhe interpretoni efektin e tyre poetik, si p.sh. në rastin: *T'traklloi, e ti kalove porsj voesa*, ku figura e apokopës shoqërohet me aliteracionin (përsëritjen e një foneme ose grupi fonemash bashkëtingëllore) për të krijuar efektin zanor të trokitjes.

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues, me qëllim identifikimin e njohurive paraprake, interesave apo aftësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me temën e lirikës së Fishtës. Për disa nxënës, mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhduar me gojë me anë të shënimeve specifike për nivelet e të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur: 1. Kërkoni disa studime kritike për poemën *Lahuta e Malcis*.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tematika: Letërsia shqipe në gjysmën I të shekullit XX.		Situata e të nxënit: Bisedë për bukurinë dhe madhështinë e vargut të Fishtës. Diskutim: Lahuta dhe Malsia.	
Temat mësimore: 1. Analizë: <i>Lahuta e Malcis</i> , Gjergj Fishta. 2. Koment <i>Vranina</i> .			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: <ul style="list-style-type: none"> kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; kompetenca e të menduarit; kompetenca qytetare; kompetenca personale; kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës varësisht nga tema mësimore. <i>Nxënësi/-ja:</i> Ora I - kujton disa veçori të epit; - bisedon me shokun për veçoritë artistike të poemës <i>Lahuta e Malcis</i> ; - plotëson, së bashku me anëtarët e grupit ku bën pjesë, rubrikat e skedës së veprës. Ora II - komenton vargje të këngës duke dalluar qëndrimin e poetit; - përimiton (përshkruan me imtësi) portretin madhështor të Oso Kukës; - shpjegon rolin e mjeteve stilistike.		Fjalë kyç: lahuta, tradita shqiptare, epope kombëtare, këngë, mitologji, zanat, hiperbola, Tringa, elemente fantastike, elemente reale, Oso Kuka, Vranina, kode morale, trimëria, Zana, mesazhi, vargu 8-rrokësh.	
Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i shqipes, libri <i>Lahuta e Malcis</i> , foto, kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj...		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Sociologji, Arte figurative	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë me hapa, bisedë, pyetje-përgjigje, lexim i drejtuar, punë në grupe.			


Organizimi i orës së mësimit Ora I

Hapi I: Bisedë

Për të studiuar poemën e Fishtës, *Lahuta e Malcis*, mësuesi në fillim të orës nxit një bashkëbisedim rreth ngjarjeve historike në Shqipërinë e viteve 1853, 1878-1913, kryesisht në trevat e Shqipërisë së Veriut.

Më tej, orienton nxënësit që së bashku të kujtojnë anën formale të ndërtimit të epit. Gjatë paraqitjes së veçorive të epit klasik, mësuesi/ja mund të tregojë dhe ndonjë shmangie që ka bërë Fishta në poemën *Lahuta e Malcis* nga forma klasike e epit.

Përmbledhet informacioni që doli gjatë bashkëbisedimit në tabelë.



Hapi II: Pyetje-përgjigje

Është çasti që të zbulohen hap pas hapi ngjarjet e poemës, nga kënga e parë deri në atë të tridhjetë (mund të mos arrihet deri në këngët e fundit, proces ky, që mund të vazhdojë në orët vijuese).

Përmes pyetjeve, të tilla si:

Duke e përqendruar vëmendjen te kuptimet parësore të dy fjalëve të titullit të veprës, thoni ç`ide rrjedhin prej tyre?

a-Lahuta - vegël muzikore që shoqëron këngët e trimërisë;

b-Malcia - mjedis gjeografik shqiptar.

Mendohet se Fishta qëllimisht tregon që në krye të poemës se do t'u këndojë me frymë himnizuese, si një rapsod, ashtu siç janë kënduar këngët e ciklit të kreshnikëve, ashtu do t'u këndojë dhe heronjve malësorë shqiptarë, që luftuan deri në vetëmohim për të ruajtur trojet, traditat dhe nderin e vendit. E Malsia, thotë Fishta, qëndron e paepur ndaj sulmeve pushtuese, kështu qëndresa e saj duhet kënduar me lahutë.

Sa këngë ka në total vepra?

Vepra ka në total 30 këngë.

Ç`rrefehet në këngët e para të saj? Po më tej?

(Kënga I- Cubat). Pas thirrjes që i bën poeti Zotit në fillim të këngës,(karakteristikë e eposeve), ka një plan të shkurtër të ngjarjeve historike se pas 500 vjetësh nën sundimin e Perandorisë Osmane, tashmë dhe shqiptarët, si popujt e tjerë të Ballkanit, kishin nisur të thyenin zgjedhën turke, si dikur, veçon Fishta, në kohën e Kastriotave. Knjaz Nikolla i Malit të zi, duke parë gjendjen e ligisht të Perandorisë Osmane, do të bëjë të vetën pjesën veriore të Shqipërisë. Për t'ia arritur qëllimit e nxit Cari i Rusisë, i cili synon të shtijë në dorë Stambollin. Ky i fundit i shkruan një letër duke i premtuar ndihmën e vet, mjaft që të mos e lërë të qetë Turqinë. Knjazi bind Vulo Radoviçin, serdarin e Vasoviçit, të formojë një çetë cubash e të sulmojë Vraninë.

(Kënga II- Oso Kuka) Në një mbledhje, Avdi pasha, me dredhi, ankohet për mizoritë që Vulo Radoviçi kishte nisur të kryente në Vraninë. Oso Kuka, pasi dëgjon fjalët e pashait turk, i cili thotë se Shqipëria kishte mbetur me vasha, i vlon gjaku, por nuk ngutet. E i thotë se Shqipëria ka djem si zana, të gatshëm kurdoherë të vdesin aty ku i lypë mbreti, atdheu, Kanuni, feja e besa. Ai vetë zotohet se do të luftojë me cubat e Knjazit ose t'u ndalë hovin ose të shkrihet në flakët e barutit. Në krye të javës Oso Kuka me 40 djem nisen për në Vraninë... Kështu mund të vazhdohet dhe me disa këngë të tjera të poemës.

Hapi III: Lexim i drejtuar, Punë në grupe

Orientohen nxënësit të lexojnë informacionin në tekst për pak minuta dhe më pas në grupe të vogla pune, ata do të analizojnë veçoritë artistike të poemës.

Grupi I: Ushtrimi 14. Me ç'lloje këngësh përbëhet vepra? Çfarë karakteristikash të veçanta kanë ato?

Grupi II: Personazhet, heronjtë dhe qeniet mitike.

Grupi III: Ushtrimi 15. Çfarë i bën origjinale këngët e *Lahutës* në raport me këngët popullore?

Grupi IV: Mbështetja në jetën autentike.

Grupi V: Veçantia e shprehjes poetike.

Grupi VI: Metrika.

Hapi IV: Plotësimi i skedës së veprës.

Në fund, liderët e grupeve të mësipërme, do të plotësojnë rubrikat përkatëse (të cilat lidhen me detyrat e punëve në grupe që kanë punuar më lart) të skedës së poemës *Lahuta e Malcis*.

Titulli: *Lahuta e Malcis*

Autori: Gjergj Fishta

Struktura:

Kënga I: Cubat

Kënga II: Oso Kuka

Kënga III: Preja

Kënga IV: Vranina

Kënga V: Deka

Kënga VI: Dervish Pasha

Kënga VII: Kuvendi i Berlinit

Kënga VIII: Ali Pasha i Gucis

Kënga IX: Lidhja e Prizrenit

Kënga X: Mehmet Ali Pasha

Kënga XI: Lugati

Kënga XII: Marash Uci

Kënga XIII: Te kisha e Shnjonit

Kënga XIV: Te ura e Rzhanicës

Kënga XV: Kasneci

Kënga XVI: Kulshedra

Kënga XVII: Në Qafë Hardhi

Kënga XVIII: Te Ura e Sutjeskës

Kënga XIX: Patër Gjoni

Kënga XX: Lekët

Kënga XXI: Ndërmjetësia

Kënga XXII: Tringa

Kënga XXIII: Tbanat e Curr Ulës

Kënga XXIV: Zana e Vizitorit

Kënga XXV: Gjaku i marrun

Kënga XXVI: Koha e re

Kënga XXVII: Xhemjeti

Kënga XXVIII: Dedë Gjo` Luli

Kënga XXIX: Lufta e Balkanit

Kënga XXX: Konferenca e Londonit

Personazhet:

Personazhet historike: Oso Kuka, Dedë Gjo` Luli, Ali Pashë Gucia, Abdyl Frashëri, Knjaz Nikolla, etj.

Heronj të tjerë: Tringa, Patër Gjoni, Rrushman Hasani, etj. Qëllimi i Fishtës ishte që me paraqitjen e një shumësie luftëtarësh të ringjallë frymën epike, rikthimin e kultit të lirisë dhe të vetëflijimit për lirinë e atdheut, për ruajtjen e trojeve e të traditave shqiptare. Nga madhështia e heronjve të *Lahutës* lexuesit i duket sikur ka përballë heronjtë e *Ciklit të kreshnikëve*. Kështu, njëri është trim e me tri zemra (Oso Kuka), tjetri i fortë si zana, një tjetër i fortë si dragua, apo i hidhur si gjarpri. Nuk mbeten pas dhe luftëtarët malazezë, kjo, për të kumtuar se me luftëtarë të tillë shqiptarët dëshmojnë trimërinë e vetëflijimin e tyre. Qeniet mitike Zana e Frymëzimit, Zana e Madhe, Zana e Miliskaut, Zana e Sharrit, Ora e Shqipërisë, Ora e Shalës, Ora e Trojanit, Ora e Dormitorit, dragonjtë, kuçedra, shtrigat.

Fishta e thërret Zanën e Frymëzimit për të kënduar bashkë me të jetën e malësorëve, zor se malësorët do ta pranonin këngën e tij pa ndihmën e saj. Kjo për të thënë se shqiptarët kanë dhe një kult të këngës, një kult të fjalës së bukur që vjen vetëm si frymëzim i magjishëm prej qenieve mitologjike. Zana e Frymëzimit është thirrur jo vetëm si *alter autor*, por dhe si një *alter ego*.

Rrëfimi, përshkrimi, dialogu. Shpërthimi lirik

Fishta ruajti prej epik klasik: kumtin, përshkrimin, dialogun, veprimin, por e ndryshoi ndërtimin kompozicional. në bosht të poemës nuk ka një ngjarje kryesore, ka disa që lidhen me njëra-tjetrën në rrafshin e kuptimësisë. Nga ngarkesa dramatike, rrëfihen ngjarje reale e fantastike. Në vend të një personazhi kryesor, ka një shumësi personazhesh etj.

Përshkrimi: i mjedisëve reale/fantastike, i natyrës, i personazheve, i betejave madhështore.

Shpërthimi lirik: Faqet më tronditëse të *Lahutës së Malcis* janë ato ku bashkohen e harmonizohen veprimet epike me shpërthimet lirike dhe lirinë e imagjinatës së autorit, duke krijuar kështu një dramacitet të paparë në letrat shqipe. Fuqinë më të madhe poetike Fishta e derdhi në veprat e tij epike, sepse atje kishte mundësi. Vetëm mjedisi shqiptar i jepte mundësi poetit të derdhte shpërthimet personale si karakteristika të lirikës së tij.

Konteksti historik. Mbështetja në jetën autentike.

Rrëfimi i ngjarjeve të viteve 1858, 1878-1913 në këndvështrimin e parë është qëllimi kryesor i veprës, veçse nëntekstohet, sepse nga ngjarjet konkrete theksohet përpjekja e shqiptarëve për të ruajtur trojet, doket, artin e tyre ashtu siç kanë qenë në kohë të kaluar (në kohën e Burrit, Lekës, Kastriotit) e duke parashikuar qëllimisht dhe vizionin e së ardhmes.

Mesazhi/et:

1. Trajtimi i mendësisë, fatit të shqiptarit dhe i atdheut të tij nëpër kohë.
2. Zgjidhimi i ndërgjegjes kombëtare për të gjithë shqiptarët.
3. Bashkimi i shqiptarëve, pavarësisht përkatësisë fetare.
4. Domosdoshmëria e flijimit për atdhe.

Gjuha, stili: Gjuha është e pasur e plot ngarkesa kuptimore, kjo vërehet përmes metaforave, hiperbolave, krahasimeve, paralelizmave të shumta. Fishta fut në tekstin e tij format e dendura apo të shkurtra të letërsisë gojore, jo si citat, por si mbindërtim, zakonisht më fuqishëm, në trajtën e urimeve e të mallkimeve:

Metrika: Vargu i poemës, një tetërokësh i ngjashëm me vargun më të njohur popullor shqiptar, e popullarizoi veprën që në nismë.

Ora II

Hapi V: Rrëfim i subjektit së këngës *Vranina*

Knjaz Nikolla mbledh i shqetësuar krerët e Malit të Zi për ngjarjet në pikën kufitare të Vraninës, në anën veriore të liqenit të Shkodrës. Shkaku është trimëria e Oso Kukës dhe e trimave shqiptarë që mbajnë të paepur Vraninën. U paraqet të pranishmëve premtimet e Carit të Rosisë, premtime që nuk mund të realizohen pa u vrrarë trimi shkodran. I pari që flet pas Knjazit, është cetinjani, Mirkja. Ai vë në dukje trimërinë e shqiptarëve, por thotë se me shqiptarët aty ku s'punon trimëria, ka për të ecur dredhia, parja, fitimet e dasia. Ai kërkon nga Cetina 700 vetë e 400 prej Biocet nën Gjokoviç Peren, e me ta do shkojë në Vraninë. Fishta thërret Zanën që të lajmërojë Oson për vendimet e armiqve. Përgjigjja e Zanës është një ankesë e përvajshme, jo aq për vdekjen e Oso Kukës, sesa për copëtimin e trojeve të Burrit, Lekës e Kastriotit. Kënga mbyllet me një kushtim të thekshëm të poetit që u drejtohet shqiptarëve të ndjekin shembullin e trimit shkodran, qoftë dhe duke u sakrifikuar për trojet, traditat e fenë e tyre.

Lexim i drejtuar

Një nxënës (preferohet me origjinë shkodrane) lexon bukur fragmentin e këngës së katërt *Vranina*.

Hapi VI: Punë në grupe, Ditari dypjesësh

Më tej, klasa, e ndarë në grupe pune, do të punojë ushtrimet, të cilat gjenden në tekstin e nxënësit. Pasi punojnë me njëri-tjetrin, anëtarët e grupeve paraqesin punët e tyre.

Grupi I - Ushtrimi 1. Gjeni detajet me të cilat poeti përshkruan: portretin moral e portretin fizik

1. Flitni për cilësitë e Oso Kukës. Ç'përfytyrim ju ngjallin ato?
2. Me cilat anë lidhet trimëria e Oso Kukës?
3. Me cilat dukuri natyrore lidhen bëmat e Osos Kukës?

Vargjet	Komenti i nxënësve
<i>Ushton mali, thonë, kur t'flaë, Dridhet fusha kah t'vikasë; Thue se rfeja shkrepë për anë:</i>	

Grupi II- 5. Krahasoje Oso Kukën me ndonjë hero nga Këngët e kreshnikëve.

Mësuesi/ja mund t'u sugjerojë që ta krahasojnë figurën e Oso Kukës me atë të kreshnikëve, si Muji, Halili apo Gjergj Elez Alia.



Oso Kuka
Gjergj Elez Alia
- portreti i tyre është
madhështor;
- paraqitja fizike bëhet me
elemente reale dhe fantastike;
- kanë forcë dhe shtat vigani;
- karakterizohen nga trimëria
dhe vetëmohimi;
- janë përçues dhe mbrojtës
të kodeve morale e
shpirtërore të
shqiptarëve.

4. Cilat janë ato tipare të trimit, që poeti i merr nga mitologjia popullore shqiptare?

P.sh.: trim si zana _____

Vargjet	Përgjigjja e nxënësve
<p><i>Burrë kaproç e trim si Zana, Thonë me kmishë e bani nana; Edhe, thonë, ka le drangue, Pse tri zemra i kan qillue, E pse i ka tri pupla t'arta</i></p>	

Si e plotësojnë ato grupin e parë të figurave me portretizimin e heroit?

Grupi III-6. Cila është figura stilistike bazë, mbi të cilën ngrihen figurat e tjera? Si realizohet ajo nga ana gjuhësore? Ç'funksion stilistik luan? Mbi cilin model poetik realizohet?

7. Shkruani dy vargjet që përmbledhin porosinë morale dhe të trimërisë që jep poeti.

Vargjet	Komentet e nxënësve
<p><i>Se per t'gjallë rodi i Shqyptarit S'i bjen n'dorë kurr Gospodarit.</i></p>	

Grupi IV-8. Me ç'lloj vargu dhe rime është ndërtuar kjo këngë? Cilin model ju kujton ajo? Skema e përsëritjes në vargjet hyrëse, për ç'lloj kënge është tipike?

Vargu më i përdorur nga Fishta, tetërrokëshi, është, në fakt, vargu popullor, ndoshta kjo e vënë qëllimisht prej tij, si për të shprehur forcën dhe bukurinë e vargut popullor.

Në poemë përsëriten vargje e formulësime, që janë pjesë e natyrshme e stilit epik.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- identifikimin e disa veçorive të epit;
- përshkrimin e ngjarjeve historike dhe veçorive artistike që trajton poeti në poemën *Lahuta e Malcis*;
- plotësojnë skedën e veprës, në bashkëpunim me anëtarët e grupeve ku bëjnë pjesë;
- komentojnë vargjet e Fishtës.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë: Në *Lahutën e Malcisë*, krahas heronjve realë, gjejmë dhe një llojshmëri të mrekullueshme personazhesh nga mitologjia shqiptare, si: zanat, orët, floçkat, dragonjtë etj.

Gjeni në *Lahutë* figura të tjera mitologjike dhe komentoni funksionin e tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tematika: Letërsia shqipe në gjysmën I të shekullit XX.		Situata e të nxënimit: Bisedojmë për kultin e trimërisë që ndërton Fishta në poemën <i>Lahuta e Malcis</i> .	
Temat mësimore: Koment <i>Kënga e Lulashit</i> (Fragment i marrë nga <i>Kënga Pater Gjoni</i>)			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç:			
<ul style="list-style-type: none"> · kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; · kompetenca e të menduarit; · kompetenca qytetare; · kompetenca personale; · kompetenca e të mësuarit për të nxënë. 			
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës varësisht nga tema mësimore.		Fjalë kyç:	
<i>Nxënësi/-ja:</i> - tregon dhe përshkruan përmasat e qenieve mitike që ka sjellë Fishta në poemë; - spikat disa tipare të figurës së malësorit shqiptar; - zbërthen kuptimin e mesazhit që përcjell poeti; - analizon përmbajtjen gjuhësore të <i>Këngës së Lulashit</i> .		Kënga e Lulashit, malësorët, feja, atdheu, kushtrimi, me pushkë e penë, Leka, Kastrioti, sokola, flijimi, fitorja, metrika, gjuha.	
Burimet: teksti i letërsisë, fjalor i shqipes, libri <i>Lahuta e Malcis</i> , kompjuter, tabelë, shkumës, fletore etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
		Histori, Filozofi, Sociologji, Arte figurative	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: PNP, bisedë, pyetje-përgjigje, ditari dypjesësh, punë me shkrim.			

Organizimi i orës së mësimi

Parashtrimi: Bisedë, Rrëfimi i ngjarjeve të këngës *Pater Gjoni*

Bisedë për detyrën e shtëpisë

Gjeni në *Lahutë* figura të tjera mitologjike dhe komentoni funksionin e tyre.

Nxënësit ilustronë me foto të ndryshme figurat mitologjike që ka vënë Fishta në poemë.



Funksioni i qenieve mitike në veprën *Lahuta e Malcis*.

Të mëvetësishme dhe të veçantë “Lahutën e Malcis” e bëjnë edhe qeniet mitike, që në të kanë një domethënie e funksion të shumëfishtë, si: zanat, orët, kuçedra (dragoi dhe shtriga janë vetëm mjete që i japin imazhit dhe mesazhit përmasën e shumësisë mitike e përdoren sidomos për krahasime). Këto ndërlidhen me qenësinë kuptimore të veprës dhe i japin asaj përmasën e fiktivitetit, që, në vështrim të parë, nuk i përgjigjet realisht shqiptimit të konkretes jetësore, po pikërisht bëjnë njërin nga përbërësit më qenësor të veprës... Dimensionimi fiktiv-mitik nuk sforcohet, po shfrytëzohet e funksionalizohet me mjeshtëri dhe vihet me shkathtësi në shërbim të realitetit historik, të forcimit të vetëdijes historike. Në esencë realiteti historik dhe realiteti fiktiv në veprën e tij shkrihen në një realitet unik, që sa krijohet e ekziston në vetëdije-ekzistenca metafizike nacionale-, pra është realitet që sa lidhet me një kohë, me një hapësirë dhe me njerëz të një periudhe, po aq lidhet me trashëgiminë shpirtërore shqiptare të krijuar e të ruajtur shekuj me radhë. Pikërisht nëpërmjet vetëdijes historike dhe vetëdijes mitike poeti ka shtrirë dhe ka shprehur realitetin historik dhe, nëpërmjet retrospektivës, brenda një periudhe ka futur cilësitë e disa periudhave (nëpërmjet personazheve, ngjarjeve, e luftërave). Kjo shtrirje në kohë bëhet sidomos me anën e qenieve mitike dhe të virtyteve e tipareve pozitive të trashëguara nga diakronia historike e kohëve të lashta: e Burrit, e Lekës...

Sipas Anton Nikë Berishës

Ndërtimi i njohurive të reja: Pyetje-përgjigje, Ditari dypjesësh

Rrëfimi i ngjarjeve te kënga *Patër Gjoni*

Zana e Milisvakut mallkon shqijatë, të cilët s'po e lënë rehat Shqipërinë e Veriut. Poeti e qorton t'i lërë mallkimet e i kujton se shqiptarët përherë kanë ruajtur dashurinë për atdheun, dëshirën për liri, fenë, besën e ndershmërinë. Të mbledhur nga Ali Pasha, ndër malësorë, autori dallon një njeri të veshur me zhgun të zi e me një kryq, ai është frati i Kelmendit, Pater Gjoni. Në Vishnjevë, në festën e bajrakut, në fund të meshës u dha kushtrimi se shkjaun ra në Guci. Flet Pater Gjoni, i cili është i gatshëm të luftojë për mbrojtjen e trojeve. Pasi u kryen ritet fetare udhëheqësi shpirtëror, nisen për në luftë. Duke shkuar, Lulash Ndreu (ndihmësi i fratit), ia merr këngës, e cila mbyllet:

Për Shqypni t` mos dhimet jeta

Mâ mirë dekë nen dhë m`u kjá,

.....

Për dhë t`vet kush dekë ka rá

Aj ska dekun, por ká lè

.....

Shkjau s` do t` shklasë, jo, njetij bregut

Der sa t` rrjedhe vala e Drinit

Pyetje-përgjigje, Ditari dypjesësh

Kënga e Lulash Ndreut është fundi i këngës së Pater Gjonit. Kjo është një nga këngët më autoriale të Fishtës në Lahutë. Ajo përmbledh tërë idetë themelore që dalin në poemë. 1. Kënga e Lulashit është: këngë që jep ngjarje apo këngë kushtrimi? Pse?

Kënga e Lulashit është një këngë që më shumë jep një kushtrim për shqiptarët.

2. Lexoni me zë të lartë ato vargje ku shprehet se atdhetarizmi dhe flijimi janë vlerat më të larta morale për Fishtën.

Ma mire dekë nën dhe m` u kja,

Se me marre gjall mbi dhe;

Për dhe t` vet kush dekë ka ra,

Aj s` ka dekun, por ka le. Burri,

*Leka e Kastriotë Amanet
Shqypnin na e lane,*

3. Mbi cilën trashëgimi kulturore dhe morale mbështetet Fishta në mesazhin e tij poetik?

a. _____

b. _____

Në cilat vargje del ideja e rilindësve, se Shqipëria mund të shpëtohet veç me pushkë e me penë? Ç'tregon kjo për lidhjet e fuqishme të poetëve të mëdhenj të kombit? Mbi ç'ide të përbashkëta mbështeten këto lidhje?

4. Me cilin poet të Rilindjes afron Fishta në këtë poezi, për nga: notat e kushtrimit dhe ngjyrimi poetik e moral. (Ndaluni te P. Vasa e N. Frashëri dhe gjeni poezitë përkatëse).

Bini! Toskë, ju n' pikë të vrapit,
Mos t' u ndalin mal as zall:
Naim Frashri i ra Qitapit
Mos m' e Ishue Shqypnin për t' gjall.

5. Në këtë poezi, përveç detajeve të traditës, Fishta fut edhe detaje të vetat, të përdorura më parë, si: *Prá, vetë ferri m'kambë m'u çue Me sa çeta ka n'at jetë...* Ç'efekt stilistik merr ky detaj, kur vihet përballë trimërisë dhe qëndresës shqiptare?

7. Gjeni cilësitë metrike të këngës. Ku ndryshon ajo nga Vranina? Autori është mbështetur në letërsinë e shkruar apo në letërsinë popullore? Përse?

Përforcimi: Punë me shkrim

Për të cilësuar shqiptarët, Fishta përdor disa emërtime; djelma, sokola, burra, bij të Skanderbeut, bij të Dukagjinit. Çfarë cilësisht të tyre do të theksojë ai?

Përshkruani figurën e malësorit shqiptar, siç e formëson poeti.

Pas përfundimit të detyrës me shkrim, mësuesi/ja u korrigjon punët dy-tre nxënësve, më tej ata e paraqesin atë para klasës.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- dallimin dhe përshkrimin bukur të portretit dhe të qenieve mitike në poemë;
- komentimin e mesazhit poetik që përcjell autori;
- analizimin e këngës nga aspekti gjuhësor.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Struktura e kësaj kënge kalon nëpër disa shkallë:

- njoftimi i lajmit për pushtim;
- ndërhyrja e poetit në vetën e dytë (i drejtohet hasmit);
- kushtrimi;
- ndërhyrja e poetit (mesazh moral);
- pyetjet retorike dhe përfundimi me një bindje absolute.

Ilustrojeni këtë me vargje.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Tekstet letrare dhe joletrare			
Tema: Pararendësit e modernitetit shqiptar N. Mjedja		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon poemat, interpreton <i>Andrra e jetës</i> - struktura, idetë, heroi.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën III: I. Komunikues efektiv: 1; II. Mendimtar kreativ: 1; III. Nxënës i suksesshëm: 9.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën III: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 1; Të lexuarit: 4; Të shkruarit: 2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Poeti paramodern			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Njih poetin paramodern, Mjedjen; • Lexon biografinë e Mjedjes; • Përmend disa nga veprat letrare të tij. 		Fjalët kyç: Mjedja, jeta, vepra.	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • • • 			
Burimet: teksti i nxënësit.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Kultura.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<p>Hyrja: Nxënësve u parashtrohen këto pyetje: – <i>Cili nga poetët mendoni se është poet paramodern?</i> – <i>Cilat mendoni se janë karakteristikat e tij më të mëdha?</i> – <i>Po ju kujtohet ndonjë vepër e tij?</i></p> <p>Realizimi i kuptimit: Mësimdhënësi ose një nxënës lexon bukur biografinë e autorit dhe nxënësit e tjerë mbajnë shënime në fletoret e tyre. Pasi të lexohet biografia, nxënësit do ta lexojnë në heshtje tekstin <i>Poeti paramodern</i>. Shpjegohet për pjesën e tekstit.</p> <p>Reflektimi: Mësimdhënësi në mes të tabelës e shkruan <i>Juvenilja</i>. Nxënësit do të tregojnë se përse e shkroi mësimdhënësi këtë titull të librit. Ata duhet të tregojnë se Ndre Mjedja nisi botimin e vjershave më 1887, po librin e vet të parë e botoi mbas 30 vjetësh, më 1917. Titulli <i>Juvenilja</i> tregonte që përmbante vjersha të rinisë. Ky libër dëshmon përkushtimin poetik të autorit dhe mjeshtërinë në krijimin e vargut e të figurës poetike. Libri përmban poezi e poema origjinale dhe disa vjersha të përkthyer. Poemat e Mjedjes të <i>Juvenilja</i> kanë ende ndjeshmëri romantike, për një strukturim të ri poetik, ku elementi rrëfimtar zvogëlohet në dobi të sintetizimit, që bëhet zotërues i strukturës poetike.</p>			
Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruajnë në fletore për disa nga veprimtaritë kryesore atdhetare të Mjedjes.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Tekstet letrare dhe joletrare			
Tema: Pararendësit e modernitetit shqiptar N. Mjedja		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon poemat, interpretin <i>Andrra e jetës</i> - struktura, idetë, heroi.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën III: I. Komunikues efektiv: 1; II. Mendimtar kreativ: 2; III. Nxënës i suksesshëm: 1.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën III: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 2; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 4.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: "Andrra e jetës" - analizë			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Analizon poemën "Andrra e jetës"; Zbulon karakterin filozofik dhe estetik të poemës; Flet për tri personazhet femra. 		Fjalët kyç: analizë, <i>Andrra e jetës</i> , karakter filozofik, estetik, personazhet femra.	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • • • 			
Burimet: teksti i nxënësit, poema "Andrra e jetës".			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): /			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<p>Hyrja: Mësimdhënësi lexon strofën e mëposhtme dhe kërkon nga nxënësit të tregojnë se nga cila poemë është shkëputur kjo strofë:</p> <p><i>Del, o bij' prei shpijes sate, Del prei t'vorfenit katund; Njato flak qi n'zembrë pate Do t'përcjellin tjetërkund</i></p> <p>Nxënësit duhet të tregojnë se kjo strofë është marrë nga kënga e tretë e poemës së Zogës, e cila nis si himn i dashurisë e në vazhdim kthehet në realitetin e përditshëm, në një shkollë të përvojës jetësore, mbi martesën, mbi besnikërinë etj. Martesa është një realitet që do të vijë domosdo, prandaj vjersha kthehet në thirrje.</p>			

<p>Realizimi i kuptimit: Nxënësit udhëzohen ta lexojnë tekstin “Andra e jetës” dhe më pas të shpjegojnë për karakterin filozofik dhe estetik të poemës.</p> <p>Reflektimi: Diskutohet për tri personazhet femra.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësve: Sipas gjykit të mësuesit, me gojë.</p>
<p>Detyrat dhe puna e pavarur: Cilat poema janë shkruar në trajtën e shkrimit poetik-mitik-historik? Ç’kuptoni me këtë? 8. Mjedja kishte projektuar të shkruante historinë poetike të kombit të vet në Antikë. Thoni cilat prej këtyre veprave u realizuan e cilat jo.</p>
<p>Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:</p>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Tekstet letrare dhe joletrare			
Tema: Pararendësit e modernitetit shqiptar F. S. Noli		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon strukturën poetike të vargut të autorit-motivet personale/biblike, figura, idetë, alegoria.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën III: I. Komunikues efektiv: 3; II. Mendimtar kreativ: 2; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën III: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 1; Të lexuarit: 4; Të shkruarit: 1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Autobiografia” - F. Noli			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Njeh veprimtarinë kulturore të Nolit; Përmend figurat e shquara, me të cilat identifikohet Noli; Flet për veprat origjinale, studimet dhe përkthimet e Nolit. 		Fjalët kyç: <i>Autobiografia,</i> veprat, studimet, përkthimet.	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> • • • 			
Burimet: teksti i nxënësit, ilustrime, interneti.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Kultura.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Hyrja:

Mësimdhënësi në tabelë në një skemë e shkruan *AUTOBIOGRAFIA* dhe lexon paragrafin e mëposhtëm:
Emri i Fan Nolit është i lidhur me gjithë kulturën e re shqiptare të shek. XX. Ai i shërbeu tërë jetën kulturës së shkruar, si poet, dramaturg, historian, biograf, publicist, kritik, stilist e orator, dhe mbi të gjitha si një përkthyes i rrallë. Noli e pa Shqipërinë si një idealist dhe u mundua ta ndryshojë si politikan. Ishte shkrimtar dhe veprimtar udhëheqës, dhe të dyja këto patën ndikim të madh te njëra-tjetra.

Pas leximit të paragrafit, ai pyet nxënësit për arsyen se pse e shkroi *autobiografia* dhe përse e lexoi këtë paragraf. Nxënësit duhet të thonë se paragrafi u lexua, sepse *autobiografia* është vepra më e rëndësishme e Nolit.

Realizimi i kuptimit:

Kërkohet nga nxënësit ta lexojnë pjesën e tekstit “Autobiografia”, pastaj të lexojnë për përkthimet, kritikën dhe oratorinë. Nxënësit e ndarë në grupe parashetrojnë pyetje për nxënësit e grupeve të tjera, në mënyrë që përmes pyetjeve dhe përgjigjeve të mësojnë sa më mirë për veprimtarinë e Nolit.

Reflektimi:

Një nxënës lexon biografinë e Nolit, ndërkaq nxënësit e tjerë dëgjojnë.

Vlerësimi i nxënësve: Sipas gjykimit të mësuesit, me gojë ose me shkrim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Hulumtoni në internet për disa nga veprat kryesore që përktheu Noli, si dhe për cilësitë e tij të veçanta në fushën e përkthimit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Tekstet letrare dhe joletrare			
Tema: Pararendësit e modernitetit shqiptar F. S. Noli		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon strukturën poetike të vargut të autorit-motivet personale/biblike, figura, idetë, alegoria.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën III: I. Komunikues efektiv: 2; II. Mendimtar kreativ: 3; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën III: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 2; Të lexuarit: 3; Të shkruarit: 2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: "Samsoni e Dalila" - koment			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Lexon dramën "Samsoni e Dalila"; • Komenton atë; • Flet për personazhet. 		koment, <i>Samsoni e Dalila</i> , personazhet.	
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> • • • 			
Burimet: teksti i nxënësit.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlydhura (korrelacioni): Kultura, teatri.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Hyrja: Bëhet vlerësimi i detyrave të shtëpisë.			
Realizimi i kuptimit: Përzgjidhen dy nxënësit më të mirë të klasës, të cilët kanë prirje për aktrim. Një vajzë luan rolin e Dalilës dhe një djalë të atij të Samsonit. Dalin te tabela dhe i interpretojnë rolet e tyre. Pas interpretimit të roleve, nxënësit e tjerë do të komentojnë për përmbajtjen e tekstit.			
Reflektimi: Le të bisedojmë së bashku: - <i>A është dashuria e Dalilës mashtrim?</i> - <i>A është lidhja e Samsonit me Dalilën vetëm ligështim i çastit?</i> - <i>A është ky konflikt një konceptim modern i botëkuptimit të Nolit?</i>			
Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit që japin përgjigje të sakta.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Bëhen përgjigjet e pyetjeve të pjesa "Studim teksti", me shkrim. Lexon përgjigjet.			
Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Tekstet letrare dhe joletrare			
Tema: Pararendësit e modernitetit shqiptar A. Z. Çajupi		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon tipare të lirikës (elegjia <i>Vaje</i>) dhe analizon komeditë.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën III: I. Komunikues efektiv: 2, 3; II. Mendimtar kreativ: 1; III. Nxënës i suksesshëm: 2.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën III: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 1, 2; Të lexuarit: 4; Të shkruarit: 2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Modeli kritik			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • Lexon biografinë e Çajupit; • Përmend veprat e tij; • Flet për <i>Baba Tomorrin</i> dhe temat sociale. 		modeli kritik, A. Z. Çajupi, vepra, jeta.	
Kriteret e suksesit:			
<ul style="list-style-type: none"> • • • 			
Burimet: teksti i nxënësit.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Kultura, teatri.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
<p>Hyrja: <i>A keni lexuar më parë për A. Z. Çajupin? Çka dini për të?</i> Lexohet biografia e Çajupit: <i>Çajupi lindi më 1866 në fshatin Sheper të Zagorisë së Gjirokastrës. Mësimet e para i bëri në një shkollë greke, mësoi edhe në një lice francez në Nivan. Më 1882 shkon në Misir tek i ati dhe kryen liceun në Aleksandri. Për herë të fundit në vendlindje ishte më 1887. Çajupi studioi për drejtësi në Zvicër. Këtu dhe u martua, mirëpo gruaja i vdiq shpejt duke ia lënë djalin të vogël. Kjo situatë personale do të frymëzojë tek ai krijimin e elegjisë së famshme <i>Vaje</i>. Çajupi hyn herët në lëvizjen kulturore e kombëtare shqiptare, duke adhuruar para së gjithash Naim Frashërin, të cilin shkoi ta vizitonte në Stamboll dhe të cilit i kushtoi elegjinë tjetër të famshme, <i>Naim-Be Frashëri</i>. Çajupi ka vdekur më 1930 në qytetin Heliopolis të Egjiptit.</i></p>			
<p>Realizimi i kuptimit: Nxënësit lexojnë në heshtje tekstin “Modeli kritik” dhe pjesën e veprës “Baba Tomorri”, duke folur më pas njëkohësisht për temat sociale që trajtohen. Ata shpjegojnë tekstin dhe ndërkohë nxënësit e tjerë kanë për detyrë të parashtrajnë pyetje për atë që shpjegon tekstin. Mësimdhënësi shton dhe pyet nxënësit në përgjithësi në lidhje me tekstet.</p>			
<p>Reflektimi: Diskutohet për pyetjen: <i>Ç’ nënkupton Çajupi me fjalën “mëmëdhe”?</i></p>			
Vlerësimi i nxënësve: Në bazë të përgjigjeve të nxënësve, me gojë.			

Detyrat dhe puna e pavarur: Bëni një shkrim të shkurtër, me temën: “Femra në poezitë e Çajupit”.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: V	Klasa: XI
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Tekstet letrare dhe joletrare			
Tema: Pararendësit e modernitetit shqiptar A. Z. Çajupi		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon tipare të lirikës (elegjia <i>Vaje</i>) dhe analizon komeditë.	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën III: I. Komunikues efektiv: 3; II. Mendimtar kreativ: 1; III. Nxënës i suksesshëm: 3.			
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën III: I. Të dëgjuarit dhe të folurit: 2; Të lexuarit: 2; Të shkruarit: 4.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: “Vaje” - koment			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none">• Lexon poezinë “Vaje”;• Komenton atë;• Flet për metrikën.		Fjalët kyç: elegjia, <i>Vaje</i> , metrika.	
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none">•••			
Burimet: teksti i nxënësit.			
Përdorimi i TIK-ut: Po.			
Çështjet e ndërlydhura (korrelacioni): /			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE I RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Hyrja: <i>Sa prej jush mendoni se e dini çka është elegjia?</i> Menjëherë pas përgjigjeve, mësimdhënësi lexon poezinë.			
Realizimi i kuptimit: Punohet në pjesën <i>Reflektoni për kuptimin</i> . Nxënësit përgjigjen në pesë pyetjet e mëposhtme dhe më pas i lexojnë përgjigjet e tyre: 1. <i>Cilat janë faktet reale që poeti i ngre në poezi?</i> 2. <i>Gjeni dhe lexoni vargjet ku shprehet: - malli për gruan e vdekur; - rëndësia e dashurisë së nënës për fëmijën; - vetëdërgjegjësimi për t’iu përshtatur realitetit; - revolta kundër perëndisë.</i> 3. <i>Zakonisht, poezitë elegjiake krijohen në momentin kur vdes njeriu i dashur, ndërsa Çajupi këtë cikël e krijoi dhjetë vjet pas vdekjes së Evgjenisë. Çfarë tregon kjo për lidhjen e tyre shpirtërore?</i>			

4. *Vuajtja e personazhit tragjik është dyfishe. Ai vuan - dramën e bashkëshortit; - dramën e babait. Argumentojeni këtë mendim duke e ilustruar me vargje.*

5. *Në vargjet: "Me se rrojnë foshnjat? Ç'i rrit çiliminjtë? Dashuri e mëmës dhe përkëdhelitë... çfarë e shtyn poetin të mendojë kështu?"*

Reflektimi:

Punohet në pjesën *Reflektoni për gjuhën dhe stilin*. Nxënësit me gojë përgjigjen në katër pyetjet e dhëna në tekst:

6. *Çajupi i drejtohet gruas me fjalët ëngjëll i bukur dhe dritë, që ia lakmoi Zoti. Çfarë cilësish shpirtërore dhe fizike të Evgjenisë zbuloni prej tyre?*

7. *Çfarë funksioni stilistik marrin në sintaksën poetike fjalitë pyetëse, lutëse, habitore etj.?*

8. *Gjeni ngjashmëritë e kësaj elegjie me elegji popullore.*

9. **Metrika** - *Si ndikon lloji i vargut, i rimës dhe i theksave ritmikë në të shprehurin e notave elegjiake. Ndaluni konkretisht në katër vargje të poezisë.*

Vlerësimi i nxënësve: Duke u bazuar në përgjigjet e sakta që nxënësit i japin.

Detyrat dhe puna e pavarur: Mësoni përmendsh 20-25 vargje që ju pëlqejnë më shumë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Portofoli i nxënësit		Situata e të nxënit:	
Njësia mësimore: Portofoli i nxënësit		Rëndësia dhe roli i portofolit dhe performancës së nxënësit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale Kompetenca për të nxënë Kompetenca për sipërmarrjen			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon letërsinë si art dhe si shkencë; • zbulon mesazhe kontekstuale të veprave të ndryshme; • bashkëpunon mes një grupi të caktuar duke sjellë produkte të plota letrare; • krijon një panoramë të qartë të asaj që është mësuar gjatë tremujorit të dytë; • demonstroi përparimin e tij duke u bazuar në rezultatet e identifikuar; • nxiti mendësinë e vetëvlerësimit të nxënësit; • bën ballafaqimin e dokumentuar të performancës së nxënësve me njëri-tjetrin dhe nxitjen e krijimtarisë. 			Fjalë kyç: Portofol Letërsi Arte Realizëm Simbolizëm Tipizim Komedi njerëzore Bovarizëm
Burimet: Libri i nxënësit Autorët dhe veprat e punuara Interneti Biblioteka Dhuntitë personale etj.			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe dhe gjuhë e huaj Arte Histori TIK Qytetari etj.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metoda e bashkëbisedimit, punë e pavarur-individuale, punë në grup, punë e drejtuar, metoda e kllasterit, diagrami i Venit, hulumtim, interpretim.

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *metoda e bashkëbisedimit, punë e drejtuar*

Për realizimin e kësaj ore mësimi duhet të sjellim në vëmendjen e nxënësve me anë të metodës së bashkëbisedimit se ç'është portofoli i të nxënit dhe cili është roli i tij. Sa dhe si e njohin nxënësit atë.

Nëpërmjet portofolit mësuesi/ja i drejton nxënësit në koleksionimin e rezultateve/arritjeve të të nxënit sipas një rendi të strukturuar mirë me qëllim vlerësimin, vetëvlerësimin dhe shkëmbimin e këtyre arritjeve.

Portofoli i të nxënit është një qasje bashkëkohore që bazohet në kriteret e cilësisë dhe dokumenton kontributin e nxënësve në veprimtari mësimore të orientuara nga kompetenca.

Portofoli i nxënësit:

- **mbështet zbatimin** e kurrikulës së bazuar në kompetenca;
- **krijon qëndrueshmëri** në procesin e realizimit të saj;

- ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në **garantimin e cilësisë** së zbatimit të kurrikulës dhe të arritjes së të nxënësve.

Karakteristikat e portofolit të të nxënësve:

- reflekton **rezultatet e identifikuarat të nxënësve** bazuar në pritshmëritë e RN (rezultateve të të nxënësve) të kurrikulës;
- përqendrohet në **përvojat e të nxënësve të bazuara në performancë**, si dhe në përvetësimin e kompetencave kyç (njohurive, aftësive dhe qëndrimeve);
- përmban **shembuj të punës që shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor** dhe jo në disa ditë të shkëputura të vitit;
- përmban **produkte të punëve të nxënësve që përfaqësojnë një shumëllojshmëri** rezultatesh për t'u vlerësuar;
- përmban një **shumëllojshmëri të modeleve të punës dhe vlerësime** të kësaj pune nga vetë nxënësve, shokët, mësuesit e tjerë, prindërit etj.

Ndërtimi i njohurive: metoda e bashkëbisedimit, punë individuale, kllaster, diagrami i Venit, hulumtim

Kështu, gjatë tremujorit të tretë nxënësve janë njohur me zhvillimet letrare të periudhës së realizimit dhe simbolizimit.

Mësuesi/ja në procesin e planifikimit, të realizimit dhe të reflektimit/vlerësimit mban parasysht përbushjen nga nxënësve të të gjitha kompetencave kyç dhe atyre të fushës.

Kjo është arsyeja e rëndësishme që merr portofoli si një mjet për të dokumentuar, treguar, krahasuar dhe vlerësuar mbërritjen të qëllimit të artikuluar në kurrikulë.

Portofoli është pasqyrim i mësimdhënies së bazuar në dëshmi.

- Mësimdhënia dhe të nxënësve, të vështruar nëpërmjet portofolit, ndihmojnë për eksplorimin dhe zhvillimin e qasjeve për një mësim efektiv.
- Nëpërmjet portofolit pasqyrohen dhe dokumentohen qasjet e mësimit të bazuar në kompetenca/performancën e nxënësve.
- Në thelbin e tij portofoli me dokumentacionin që e përbën, argumenton përgjegjësitë e mësuesit në lidhje me mësimdhënien dhe të nxënësve.

Qysh në fillim të tremujorit ose hap pas hapi mësuesi/ja u ka dhënë nxënësve të klasës detyrat, të cilat ata duhet të përbushin përgjatë këtij tremujori në pasurimin e portofolit të tyre.

Më poshtë po shënojmë detyrat e dhëna nxënësve:

1. Të ndërtojë estetikën e realizimit dhe përfaqësuesit më në zë të këtij drejtimi letrar.

(20 pikë)

2. Metoda e tipizimit balzakian përbën një nga themelet e realizimit. Si e realizon ai këtë tipizim? Ilustrojeni me disa emra personazhesh.

Ose

Ku qëndron analogjia ndërmjet “Komedisë njerëzore” dhe “Komedisë hyjnore”?

(20 pikë)

3. Si e gjykoni zonjën Bovari: fajtores, të pafajshme, as fajtores e as të pafajshme? Për zgjedhjen tuaj parashtroni të paktën dy argumente.

Ose

Përshkruani me realizëm portretin e prindërve tuaj në jetën e tyre të përditshme familjare dhe në marrëdhënie me njëri-tjetrin, duke u përpjekur të kuptoni çfarë pëlqejnë ata te njëri-tjetri dhe çfarë jo.

(20 pikë)

4. Rilexoni njërin nga poezitë e Fan Nolit, “Krishti me kamçikun” ose “Marshi i kryqësimit” dhe krahasojeni atë me legjendën e Inkuizitorit të Madh.

(20 pikë)

5. Interpretoni një poezi simboliste që u ka mbetur në mendje.

(20 pikë)

Për të realizuar vlerësimin e portofolit mund të ndiqen disa mënyra si më poshtë.

- Nxënësit mund të paraqesin të gjithë portofolin ose pjesë të tij.
- Në disa raste nxënësit mbrojnë punën e tyre.
- Në raste të tjera, nxënësit i shfaqin punimet e portofolit të tyre në formë ekspozite.
- Në raste të tjera nxënësit zhvillojnë një pjesë të portofolit të tyre duke reflektuar interesat individuale

akademike apo të karrierës.

Gjatë kësaj ore mësuesi/ja është e lirë të zgjedhë mënyrën më efektive për t'u dhënë nxënësve mundësinë e prezantimit të portofolit të tyre. Kështu mund të bëhet dhe një alternativë mënyrash vlerësimi pasi vetëm një orë nuk mjafton për t'i paraqitur punët e të gjithë nxënësve të klasës.

Demonstrimi i rezultateve të arritura

Në këtë fazë të orës mësimore mësuesi/ja dhe nxënësit janë të lirë të japin gjykimet e tyre lidhur me punët e prezantuara, duke paraqitur pika e tyre të forta dhe pikat e dobëta, madje edhe duke dhënë këshilla dhe sugjerime për punë edhe më cilësore në vazhdimësi.

Mësuesi/ja mund t'i përdorë të dhënat e portofolit për qëllime të ndryshme specifike, duke përfshirë:

- nxitjen e të mësuarit të vetëdrejtuar;
- krijimin e një panorame të qartë të asaj që është mësuar nga nxënësi;
- nxitjen e të nxënësve për të nxënë;
- demonstrimin e përparimit të nxënësve duke u bazuar në rezultatet e identifikuar;
- nxitjen e mendësisë së vetëvlerësimit të nxënësve;
- ballafaqimin e dokumentuar të performancës së nxënësve me njëri-tjetrin dhe nxitjen e krijimtarisë;
- përfshirjen e prindërve në procesin e të nxënësve.

Vlerësimi

Për të realizuar këtë fazë të procesit mësimor, mësuesi/ja duhet të përgatisë për çdo nxënës vlerësimin e portofolit sipas tabelës së mëposhtme:

Komponenti që vlerësohet	Nivelet e arritjes				Komente/ Shënime
	1	2	3	4	
Detyra 1 – 20 pikë					
Detyra 2 – 20 pikë					
Detyra 3 – 20 pikë					
Detyra 4 – 20 pikë					
Detyra 5 – 20 pikë					

TOTALI I PIKËVE 100

Duhet përmirësim _____

Ka përparim _____

Grupi i dytë – detyrat

- Kush është F. Dostojevski?
- Përmendni disa nga veprat e tij.
- Cila është kryevepra e tij?
- Cilat janë disa nga vlerat e romanit “Vëllezërit Karamazovë”?
- Përmendni disa risi që solli Dostojevski me veprën e tij.
- Cila është përshtypja juaj për këtë shkrimtar?

Grupi i tretë – detyrat

- Kush është Sh. Bodleri?
- Përmendni disa nga veprat e tij.
- Cila është kryevepra e tij?
- Cilat janë disa nga vlerat e veprës “Lulet e së Keqes”?
- Përmendni disa risi që solli Bodleri me veprën e tij.
- Cila është përshtypja juaj për këtë shkrimtar?

Nxënësve u lihet kohë e favorshme për të ndërtuar punët e tyre dhe më pas me anë të diskutimit të drejtuar ndërtojmë bashkëbisedimin për përsëritjen e lëndës së zhvilluar gjatë tremujorit të tretë.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: metoda e bashkëbisedimit, punë e pavarur, diskutim i drejtuar

Në përfundim të kësaj ore mësimi, nxënësit nxiten me anë të punës së pavarur dhe diskutimit të drejtuar të shprehin mendimet e tyre lidhur me tri autorët e lartpërmendur.

- Cila është përshtypja juaj për këta shkrimtarë?

Vlerësimi

Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Ky vlerësim mund të shoqërohet edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit. Disa nxënës vlerësohen me shkrim për detyrat e sjella në klasë. Nxënësit nxiten për të realizuar punë cilësore me qëllim plotësimin e dosjes së tyre dhe vlerësimin e saj nga mësuesi/ja.

Emri, mbiemri: _____

Klasa: _____

TAKIMI ME NJERIUN E MADH
(fragment nga novela “Manteli”, Nikolai Gogol)

Cili ishte ky njeri i madh dhe ç'punë bënte, nuk dihet gjer sot e kësaj dite. Duhet t'ju them, që ta dini se ky njeri i madh ish bërë i madh vetëm aty para pak kohe dhe se më parë nuk kish qenë njeri i madh. Veç kësaj, posti që mbante nuk quhej as tani si post i madh në krahasim me poste të tjera më të larta. Po ju do të gjeni kurdoherë një rreth njerëzish për të cilët është njeri i madh ai që për një rreth tjetër, nuk është aspak i madh. Nga ana tjetër, ky njeri i madh përpiqej ta shtonte famën e tij me lloj-lloj mjetesh e mënyrash: kishte urdhëruar që nëpunësit që ndodheshin nën urdhrin e tij, të dilnin të gjithë bashkë e ta prisnin në shkallë kur ky vinte në zyrë; që askush të mos hynte drejtpërsëdrejti në zyrën e tij, po kjo punë të bëhej sipas një hierarkie të caktuar: regjistratori i kolegjit t'i raportonte sekretarit të gubernës, sekretari i gubernës t'i raportonte sekretarit titullar ose një tjetri, dhe vetëm pastaj puna të arrinte në dorën e tij. Kështu qëndron puna në Rusinë e shenjtë, të molepsur nga fryma e imitacionit: të gjithë e imitojnë si majmuni shefin e tyre. Madje thonë se një këshilltar titullar, kur u bë shef i një kancelarie të vogël, u veçua menjëherë në një dhomë më vete, të cilën e pagëzoi “dhoma e këshilltarit”, dhe vuri të rrinin te dera disa shërbëtorë me jaka të kuqe e me pantallona me shirita, të cilët kapnin dorezën e derës dhe nuk linin të hynin brenda veçse ata që u donte qejfi, megjithëse kjo “dhomë e këshilltarit” mezi nxinte një tavolinë zyre nga ato të zakonshmet. Ceremonia e pritjes dhe zakonet e njeriut të madh ishin solemne, madhështore, po jo aq të ngatërruara. Themeli më i rëndësishëm i sistemit ishte rreptësia. “Rreptësi, rreptësi dhe përsëri rreptësi”, thoshte ai zakonisht dhe, kur shqiptonte fjalën e fundit, e vështronte rëndë-rëndë personin me të cilin fliste. Nga ana tjetër, as që ish nevoja për një shikim të këtitillë, sepse ata dhjetë nëpunës që përbënin tërë mekanizmin e kancelarisë së tij, ishin mjaft të trembur. Kur e shikonin nga larg që po vinte, braktisnin çdo gjë dhe prisnin duke marrë drejtqëndrim gjersa shefi të hynte në dhomë. Bisedimi i tij i zakonshëm me nëpunësit që kish nën urdhër ish plot rreptësi dhe përbëhej pothuaj gjithnjë nga disa fjalë: “Qysh guxonit? A dini me cilin flisni? A e kuptoni përpara kujt gjendeni?” Megjithatë, ishte njeri shpirtmirë, i sjellshëm e u bënte shërbime shokëve, po ia kish rritur shumë mendjen grada e gjeneralit. Që kur kish fituar këtë gradë, e kish humbur pusullën e qe fryrë në pendë, sa nuk dinte ç'të bënte. Kur ndodhej me njerëz që kishin po atë gradë, të barabartë, ish njeri i mirë, njeri me mend në kokë, madje edhe i zgjuar, po kur ndodhej në një rreth me njerëz që ishin qoftë edhe vetëm një gradë më të ulët se ai, bëhej me të vërtetë i padurueshëm. Rrinte i heshtur. Qëndrimi i tij të bënte që të vinte keq për të, madje aq shumë, sepse edhe ai vetë e kuptonte se mund ta kalonte kohën shumë më mirë. Në sytë e tij dukej një dëshirë e zjarrtë për të marrë pjesë në bisedim, për t'u bashkuar me një rreth të lezetshëm, po e ndalte frika se mos kjo gjë do të ish si e tepruar nga ana e tij, se kësaj do të tregonte shumë familjaritet dhe do ta ulte prestigjin e tij. Duke bërë hesape të këtilla, rrinte ngaherë i heshtur, duke shqiptuar rrallë e tek ndonjë tingull njërrokësh dhe në këtë mënyrë fitoi titullin: njeri shumë i mërzitshëm.

Këtij njeriu të madh i vajti e iu paraqit Akaki Akakieviçi ynë, mirëpo rastisi në një çast fare të pagoditur për njeriun e madh. Njeriu i madh ndodhej në kabinetin e tij dhe po bisedonte me qejf të madh me një mik e shok të vjetër të vogëlisë, që kish ardhur para një kohe në Petërburg dhe të cilin nuk e kish parë prej shumë vjetësh. Në këtë kohë e lajmëruan se kish ardhur njëfarë Bashmaçkin. Njeriu i madh pyeti shkurt:

– Cili është ky?

Iu përgjigjën:

– Një nëpunës.

– Ashtu? Le të presë, tani s'kam kohë, - tha njeriu i madh.

Këtu ne duhet të themi se njeriu i madh gënjente qind për qind: kohë kish boll, sepse e kish mbaruar

bisedimin që kish pasur me mikun, i kishin thënë të gjitha ato që kishin pasur për të thënë dhe tani kishin nisur të bënë ndërprerje të mëdha në bisedim, i binin lehtë-lehtë njëri-tjetrit në kofshë duke thënë orë e çast:

– Kështu, pra, Ivan Abramoviç!

– Ja, kështu, Stepan Varllamoviç!

Megjithatë, dha urdhër që nëpunësi të priste, kështu që t'i tregonte mikut të tij - një njeri që kish lënë prej kohe shërbimin dhe që tani jetonte në fshat – se sa kohë duhej ta prisnin atë nëpunësit në dhomën e pritjes. Më në fund, mbasi folën sa folën dhe më shumë heshtën, dhe mbasi pinë ca puro të trasha, të fundosur nëpër ata kolltukët e butë, me mbështetëse që lëviznin, bëri sikur iu kujtua diçka edhe i tha sekretarit që ish ndalur te dera me ca shkresa.

– Më duket se aty po më pret një nëpunës: i thoni të hyjë.

Kur e pa qëndrimin e përvuajtur të Akaki Akakieviçit dhe atë uniformën e tij të vjetër, u kthye e i foli me të prerë:

– Ç'kërkon? – Këtë pyetje e bëri me një zë të thatë e urdhërues, që e kish mësuar e përgatitur në shtëpinë e tij, brenda në dhomë, duke qëndruar para pasqyrës, një javë para se të merrte këtë post dhe gradën e gjeneralit që mban tani. Akaki Akakieviçi kish ndier me kohë se qysh e kish zaptuar njëfarë droje, u hutua e u ngatërrua, i shpjegoi mesa iu dha duke shtuar kësaj here akoma më dendur fjalën “këtë”, se kish pasur një mantel të ri fare dhe këtë mantel ia kishin grabitur në mënyrë çnjerëzore dhe se i drejtohej atij që të ndërhynte në një mënyrë ose tjetër, t'i shkruante komandantit të përgjithshëm të policisë ose ndokujt tjetër, që t'i gjenin mantelin. Sjellja e Akaki Akakieviçit nuk di se për ç'arsye iu duk gjeneralit si tepërfamiljare.

– Ç'po bën kështu, o zotëri i nderuar? – i tha ai me të prerë. – Nuk i njeh rregullat? A di se ku ke hyrë apo jo? Nuk e di ti se ç'rregull duhet të ndjekë çdo punë? Mbi këtë çështje më parë duhet të paraqesësh një kërkesë në kancelari, kjo kërkesë do t'i shkojë shefit të zyrës, pastaj shefit të seksionit, ky do t'ia japë sekretarit dhe pastaj ky i fundit do të ma paraqitë mua...

– Mirë, shkëlqesi..., – i tha Akaki Akakieviçi duke mbledhur atë guxim që i kishte mbetur dhe duke ndier në të njëjtën kohë se e kishte mbuluar djersa dhe po e mbyste: - Guxova ta shqetësoj shkëlqesinë tuaj, sepse këta sekretarët nuk... nuk janë njerëz që mbarojnë punë...

– Si the, si the? – i bërtiti njeriu i madh... - Nga na i nxore këto të gjitha? Nga i ke marrë këto ide? Ç'është vallë kjo kryengritje e të rinjve kundër shefave edhe eprorëve?

Me sa duket, njeriu i madh nuk kishte vënë re se Akaki Akakieviçi i kish kaluar të pesëdhjetat, pra nuk mund të thuhej se ishte i ri, veçse në krahasim me ndonjë që ishte shtatëdhjetë vjeç.

– A e di se me cilin flet? A e kupton para kujt gjendesh? Të pyes: a e di apo jo?

Si tha këto fjalë, gjenerali përpoqi këmbën dhe e ngriti zërin kaq fort, sa mund të trembej jo vetëm Akaki Akakieviçi, po edhe kushdo tjetër që të kish qenë aty. Akaki Akakieviçi mbeti gojëhapur, u tund e u lëkund i tëri e nuk ishte në gjendje të mbahej më këmbë. Po të mos ishin sulur portierët që ta mbanin për krahu, do të ishte shembur përdhe. E nxorën jashtë pothuaj pa ndjenja. Në këtë mes, njeriu i madh, i kënaqur pa masë kur pa se ç'efekt kishin bërë të bërtiturat e tij, i dehur nga gazi se kishte qenë në gjendje ta bënte njeriun që t'i zihej fryma, e pa me bishtin e syrit mikun e tij, që të “shihte se ç'do të thosh”, dhe vuri re me kënaqësinë më të madhe se miku i tij nuk dinte ç'të bënte dhe se kish filluar edhe ai vetë të kish frikë.

Akaki Akakieviçi nuk i kujtohej se qysh zbriti shkallët, se qysh doli në rrugë – asgjë, asgjë! Nuk i ndiente as duart, as këmbët. Kurrë në jetën e tij nuk e kish marrë kështu nëpër këmbë një gjeneral, dhe aq më shumë një gjeneral që nuk ishte i dikasterit të tij. Ecte gojëhapur nëpër tufanin e dëborës që fërshëllente rrugëve, pengohej nëpër trotualet. Sipas zakonit të Petërburgut, era frynte nga të katër anët, nga të gjitha rrugicat. Aty për aty filloi t'i dhembte fyti. Kur arriti në shtëpi, nuk ishte në gjendje të nxirrte një fjalë goje. Ish ënjtur i tëri nga angina dhe iu desh të shtrihej në shtrat. Ja se ç'fuqi të madhe ka ndonjëherë një e bërtitur si ajo që i bëri njeriu i madh!

Të nesërmen kishte zjarrllëk të madh. Në sajë të ndihmës dorëplotë të klimës së Petërburgut, sëmundja u zhvillua më shpejt sesa mund të pritej, kështu që, kur i vajti doktori dhe i kontrollloi pulsën, nuk mundi të bënte gjë tjetër, veçse të porosiste që t'i vinin ca kompresa, dhe këtë e bëri vetëm e vetëm që i sëmuri të mos mbetej

pa ndihmën fisnike të mjekësisë. Aty për aty doktori tha se pas një dite e gjysmë i sëmuri patjetër do të vdiste. Pastaj iu kthye zonjës së shtëpisë dhe i tha:

– Tani, ti moj nënë, mos e humb kohën më kot, por porositi një qivur me dërrasa bredhi, sepse dërrasat e lisit janë shumë të shtrenjta.

A i dëgjoi vallë Akaki Akakieviçi këto fjalë të kobshme që i takonin drejtpërsëdrejti? Dhe, në i dëgjoi, a e tronditën vallë? A i vinte keq për jetën e tij të mjerë? Asgjë nuk dihet për këtë, sepse tërë kohën kishte zjarrllëk edhe fliste përçart. Kish rënë në kllapi dhe shikonte pa pushim gjëra të habitshme. Herë e shihte Petroviçin dhe e porosiste t'i qepte një mantel me ca si çarqe që ta ruanin kundër vjedhësve (i dukej sikur këta ishin fshehur nën krevat, madje i lutej zonjës së shtëpisë të kapte njërin nga vjedhësit që kishte hyrë nën jorgan), herë e pyeste pse i varej para syve dollomaja e vjetër, herë se kishte mantelin e ri, herë se ndodhej para gjeneralit, duke dëgjuar qortimet e tij të ashpra e duke thënë: “Ju lutem, shkëlqesi, të më falni”; herë, më në fund, niste e shante, duke shqiptuar fjalë të hatashme, saqë plaka e shtëpisë bënte kryq, sepse nuk e kishte dëgjuar kurrë të nxirrte nga goja fjalë të këtilla, aq më fort sepse këto të shara vinin gjithnjë pas fjalës “shkëlqesi”. Pastaj shqiptonte fjalë që nuk kishin asnjë lidhje e asnjë kuptim: vihej re vetëm një gjë: të gjitha mendimet e të gjitha fjalët silleshin rreth mantelit.

Më në fund, i mjeri Akaki Akakieviçi dha shpirt. Autoritetet nuk e vulosën dhomën dhe sendet e tij, sepse, e para, nuk kishte trashëgimtarë, dhe e dyta, sepse trashëgimi që kishte lënë ishte shumë i vogël dhe pikërisht: ca pena pate për të shkruar, një top me letër të bardhë zyrtare, tri a katër çorapë, dy a tri kopsa të rëna nga pantallonat, dhe atë dollomanë që ia njehe shumë mirë lexuesi. Se kush i mori të gjitha këto sende, vetëm një perëndi e di. Duhet të them se për këtë çështje nuk u interesua as ai që po tregon këtë ngjarje.

Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Gogoli është përfaqësues: (1 pikë)

A) i simbolizmit; B) i natyralizmit; C) i realizmit; Ç) i romantizmit.

2. Gogoli e shkroi këtë novelë nisur nga: (1 pikë)

A) realiteti i kohës; B) përvoja vetjake si nëpunës; C) të dyja së bashku.

3. Cili është qëllimi i papërcaktueshmërisë së kohës dhe personazheve në tekst? (1 pikë)

- A) universalizmi;
- B) mungesa e karakterit të personazheve është bazë e mungesës së identitetit;
- C) pozita e tyre shoqërore;
- Ç) asnjëra.

4. Çfarë simbolizon “Manteli”? (1 pikë)

- A) veshjen e ngrohtë;
- B) mburojën e njeriut të dobët ndaj realitetit të ashpër;
- C) statusin social;
- Ç) fasadën fizike të njeriut.

5. Cili është nënteksti i fjalëve të mjekut në fjalinë e mëposhtme? (1 pikë)

“ – Tani, ti moj nënë mos e humb kohën më kot... sepse dërrasat e lisit janë shumë të shtrenjta”

- A) varfëria e mjerimi i Akaki Akakieviçit si qenie pa identitet
- B) kryerja e misionit fisnik të mjekut
- C) qëndrimi i autorit

6. Thelbi i fragmentit paraqet në mënyrë realiste: (1 pikë)

- A) administratën cariste;
- B) hierarkinë burokratike të vlerave;
- C) hierarkinë burokratike e anashkalon dhe e përçmon hierarkinë e vlerave;
- Ç) të gjitha së bashku.

7. a) Cilat janë shkaqet që çojnë Akaki Akakieviçin në depresion? Cili është kuptimi i shprehjes “Akaki e kish ndier me kohë se qysh e kish zaptuar një farë ndroje...” ? Argumentoni përgjigjen. (4 pikë)

b) Gjeni detaje që japin sjelljet e njeriut të madh dhe Akakit. Çfarë realizon autori me këtë kundërvënie? (4 pikë)

8. Në vdekjen e Akaki Akakieviçit ndërthuret paraqitja realiste me elementin simbolik. Përcaktojini këto elemente. Tregoni si e plotësojnë njeri-tjetrin dhe çfarë drejtimi i jep interpretimit të rrëfimit kjo pleksje e tyre.

- a) _____ (1 pikë)
- b) _____ (1 pikë)
- c) _____ (1 pikë)

9. Cili është roli i rrëfyesit në fragment? Jepni detaje ku duket ky rol. (2 pikë)

10. Ku shfaqet prania e ironisë në fragment? Jepni detaje. Cili është qëllimi i saj? (3 pikë)

Nota	5	6	7	8	9	10
Pikët	1-6	7-11	12-14	15-18	19-21	22-24

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Projekt kurrikular		Situata e të nxënit:	
Njësia mësimore: Prezantim projekti (ora III)		Nxënësi njih dhe ndërton kuptimin e duhur mbi konceptet letrare, filozofike dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin e letërsisë hap pas hapi.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale Kompetenca për të nxënë Kompetenca për sipërmarrjen			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon letërsinë si art dhe si shkencë; dallon periudhën letrare në të cilën bën pjesë autori i zgjedhur; dallon veçoritë e stilit të autorëve të përzgjedhur për temën e projektit kurrikular; thellohet në analiza të plota të veprave të letërsisë shqiptare dhe të huaj; zbulon mesazhe kontekstuale të veprave të përzgjedhura; bashkëpunon me një grup të caktuar duke sjellë produkte të plota analizash letrare. 		Fjalë kyç: Projekt kurrikular Bisedë Diskutim Grupe pune Periudha letrare Analizë vepre Etapa	
Burimet: Libri i nxënësit Vepra e zgjedhur nga çdo grup Interneti Biblioteka		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe dhe gjuhë e huaj Arte Histori TIK Qytetari	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Punë e pavarur - individuale, punë në grup, punë e drejtuar, bashkëbisedim.

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme

Për realizimin e kësaj ore mësimi duhet të kujtojmë së pari se kjo orë është vazhdimësi e orëve të projektit kurrikular prezantuar gjatë tremujorit të parë.

Me anë të punës në grup dhe veçanërisht punës me projekt nxënësit duhet të jenë të prirë të angazhohen maksimalisht.

Më herët klasa është ndarë në grupe pune dhe secili grup ka përzgjedhur një autor shqiptar apo të huaj të periudhave nga romantizmi deri te simbolizmi.

Ndërtimi i njohurive

Në këtë moment të orës mësimore çdo grup do të prezantojë punën e tij mbi temën dhe autorin e zgjedhur, si dhe detyrat e caktuara nga lideri i grupit.

Grupi i parë. Nëpërmjet liderit të grupit bëhet prezantimi i anëtarëve të grupit dhe detyrave të secilit prej tyre. Çdo anëtar i grupit prezanton punën e tij duke përcjellë në orën prezantuese të projektit kurrikular sa më shumë pozitivitet dhe cilësi.

- Paraqitja e projektit përfundimtar prej **grupit të parë** dhe mbrojtja e tij përballë një publiku të gjerë (nxënës klase, nxënës shkolle, mësues, të ftuar, të interesuar etj.)
- Paraqitja përfundimtare e albumit me fotografi për autorin e zgjedhur nga ky grup.
- Paraqitja e një reklame.
- Paraqitja e një posterit.
- Paraqitja e një fletëpalosjeje.

Për më tepër konsultohemi edhe me broshurën e përgatitur për nxënësit si udhërrëfyes në punën e tyre.

Në vazhdim të orës prezantohet grupi i dytë.

Grupi i dytë. Nëpërmjet liderit të grupit bëhet prezantimi i anëtarëve të grupit dhe detyrave të secilit prej tyre. Çdo anëtar i grupit prezanton punën e tij duke përcjellë në orën prezantuese të projektit kurrikular sa më shumë pozitivitet dhe cilësi.

- Paraqitja e projektit përfundimtar prej **grupit të dytë** dhe mbrojtja e tij përballë një publiku të gjerë (nxënës klase, nxënës shkolle, mësues, të ftuar, të interesuar etj.)
- Paraqitja përfundimtare e albumit me fotografi për autorin e zgjedhur nga ky grup.
- Paraqitja e një reklame.
- Paraqitja e një posterit.
- Paraqitja e një fletëpalosjeje.

Për më tepër konsultohemi edhe me broshurën e përgatitur për nxënësit si udhërrëfyes në punën e tyre.

Në vazhdim të orës prezantohet grupi i tretë.

Grupi i tretë. Nëpërmjet liderit të grupit bëhet prezantimi i anëtarëve të grupit dhe detyrave të secilit prej tyre. Çdo anëtar i grupit prezanton punën e tij duke përcjellë në orën prezantuese të projektit kurrikular sa më shumë pozitivitet dhe cilësi.

- Paraqitja e projektit përfundimtar prej **grupit të tretë** dhe mbrojtja e tij përballë një publiku të gjerë (nxënës klase, nxënës shkolle, mësues, të ftuar, të interesuar etj.)
- Paraqitja përfundimtare e albumit me fotografi për autorin e zgjedhur nga ky grup.
- Paraqitja e një reklame.
- Paraqitja e një posterit.
- Paraqitja e një fletëpalosjeje.

Për më tepër konsultohemi edhe me broshurën e përgatitur për nxënësit si udhërrëfyes në punën e tyre.

Shënim. Klasa është e ndarë edhe në grupe të tjera, puna e të cilëve do të prezantohet orën tjetër.

Demonstrimi i rezultateve të arritura

Në këtë fazë të orës mësimore mësuesi/ja dhe nxënësit janë të lirë të japin gjykimet e tyre lidhur me punën e grupeve të prezantuara, duke paraqitur pikat e forta dhe të dobëta të punës në grup dhe të asaj individuale.

Vlerësimi

Vlerësimi i punëve të nxënësve do të bëhet duke pasur parasysh disa pika:

- planin e projektit kurrikular për çdo grup
- zbatimin e tij nga secili grup
- menaxhimin e informacionit
- etikën e punës në grup
- përfundimet e nxjerra nga secili grup pune
- punët krijuese të çdo grupi
- mënyrën e prezantimit

KRITERET E VLERËSIMIT

Niveli I: (NOTA 4)

Nëse nxënësi nuk sjell asnjë material që ka lidhje me detyrat e ngarkuara.

Niveli II: (NOTA 5)

- Përgatit materialin e kërkuar me gojë ose me shkrim dhe e paraqit (dorëzon atë në afatet e kërkuara)

Niveli II: (NOTA 6)

- Trajton temën e kërkuar duke përdorur informacionin e dhënë dhe respekton kriteret e kërkuara (me shkrim elektronik jo më pak se 2 faqe e shkruar dhe paraqitje me gojë jo më shumë se 5 minuta)

Niveli III: (NOTA 7)

- Shtjellon argumentin e kërkuar nga tema dhe respekton afatet dhe kriteret e vendosura më sipër.

Niveli III: (NOTA 8)

- Përdor shembuj dhe citime nga bibliografia e rekomanduar që shërben për trajtimin e temës.
- Rendit qartë dhe logjikisht materialin.
- Përdor një gjuhë korrekte dhe pa gabime.

Niveli IV: (NOTA 9 - 10)

- Ka origjinalitet në trajtimin e temës.
- Përdor saktë dhe me korrektësi bibliografinë.
- Përdor një gjuhë të qartë dhe pa gabime.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tematika: Projekt kurrikular		Situata e të nxënit: Nxënësi njih dhe ndërton kuptimin e duhur mbi konceptet letrare, filozofike dhe historike, duke perceptuar edhe zhvillimin hap pas hapi të letërsisë.	
Njësia mësimore: Prezantim projekti (ora IV)			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale Kompetenca për të nxënë Kompetenca për sipërmarrjen			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon letërsinë si art dhe si shkencë; dallon periudhën letrare në të cilën bën pjesë autori i zgjedhur; dallon veçoritë e stilit të autorëve të përzgjedhur për temën e projektit kurrikular; thellohet në analiza të plota të veprave të letërsisë shqiptare dhe të huaj; zbulon mesazhe kontekstuale të veprave të përzgjedhura; bashkëpunon me një grup të caktuar duke sjellë produkte të plota analizash letrare. 		Fjalë kyç: Projekt kurrikular Bisedë Diskutim Grupe pune Periudha letrare Analizë vepre Etapa	
Burimet: Libri i nxënësit Vepra e zgjedhur nga çdo grup Interneti Biblioteka		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe dhe gjuhë e huaj Arte Histori TIK Qytetari	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Punë e pavarur - individuale, punë në grup, punë e drejtuar, bashkëbisedim.

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme

Për realizimin e kësaj ore mësimi duhet të kujtojmë së pari se kjo orë është vazhdimësi e orëve të projektit kurrikular prezantuar gjatë tremujorit të parë.

Me anë të punës në grup dhe veçanërisht punës me projekt nxënësit duhet të jenë të prirë të angazhohen maksimalisht.

Më herët klasa është ndarë në grupe pune dhe secili grup ka përzgjedhur një autor shqiptar apo të huaj të periudhave nga romantizmi deri te simbolizmi.

Ndërtimi i njohurive

Në këtë moment të orës mësimore çdo grup do të prezantojë punën e tij mbi temën dhe autorin e zgjedhur, si dhe detyrat e caktuara nga lideri i grupit.

Grupi i katërt. Nëpërmjet liderit të grupit bëhet prezantimi i anëtarëve të grupit dhe detyrave të secilit prej tyre. Çdo anëtar i grupit prezanton punën e tij duke përcjellë në orën prezantuese të projektit kurrikular sa më shumë pozitivitet dhe cilësi.

- Paraqitja e projektit përfundimtar prej **grupit të katërt** dhe mbrojtja e tij përballë një publiku të gjerë (nxënës klase, nxënës shkolle, mësues, të ftuar, të interesuar etj.)
- Paraqitja përfundimtare e albumit me fotografi për autorin e zgjedhur nga ky grup.
- Paraqitja e një reklame.
- Paraqitja e një posterit.
- Paraqitja e një fletëpalosjeje.

Për më tepër konsultohemi edhe me broshurën e përgatitur për nxënësit si udhërrëfyes në punën e tyre.

Në vazhdim të orës prezantohet grupi i pestë.

Grupi i pestë. Nëpërmjet liderit të grupit bëhet prezantimi i anëtarëve të grupit dhe detyrave të secilit prej tyre. Çdo anëtar i grupit prezanton punën e tij duke përcjellë në orën prezantuese të projektit kurrikular sa më shumë pozitivitet dhe cilësi.

- Paraqitja e projektit përfundimtar prej **grupit të pestë** dhe mbrojtja e tij përballë një publiku të gjerë (nxënës klase, nxënës shkolle, mësues, të ftuar, të interesuar etj.)
- Paraqitja përfundimtare e albumit me fotografi për autorin e zgjedhur nga ky grup.
- Paraqitja e një reklame.
- Paraqitja e një posterit.
- Paraqitja e një fletëpalosjeje.

Për më tepër konsultohemi edhe me broshurën e përgatitur për nxënësit si udhërrëfyes në punën e tyre.

Në vazhdim të orës prezantohet grupi i gjashtë.

Grupi i gjashtë. Nëpërmjet liderit të grupit bëhet prezantimi i anëtarëve të grupit dhe detyrave të secilit prej tyre. Çdo anëtar i grupit prezanton punën e tij duke përcjellë në orën prezantuese të projektit kurrikular sa më shumë pozitivitet dhe cilësi.

- Paraqitja e projektit përfundimtar prej **grupit të gjashtë** dhe mbrojtja e tij përballë një publiku të gjerë (nxënës klase, nxënës shkolle, mësues, të ftuar, të interesuar etj.)
- Paraqitja përfundimtare e albumit me fotografi për autorin e zgjedhur nga ky grup.
- Paraqitja e një reklame.
- Paraqitja e një posterit.
- Paraqitja e një fletëpalosjeje.

Për më tepër konsultohemi edhe me broshurën e përgatitur për nxënësit si udhërrëfyes në punën e tyre.

Demonstrimi i rezultateve të arritura

Në këtë fazë të orës mësimore mësuesi/ja dhe nxënësit janë të lirë të japin gjykimet e tyre lidhur me punën e grupeve të prezantuara, duke paraqitur pikat e tyre të forta dhe pikat e dobëta të punës në grup dhe të asaj individuale.

Vlerësimi

Vlerësimi i punëve të nxënësve do të bëhet duke pasur parasysh disa pika:

- planin e projektit kurrikular për çdo grup
- zbatimin e tij nga secili grup
- menaxhimin e informacionit
- etikën e punës në grup
- përfundimet e nxjerra nga secili grup pune
- punët krijuese të çdo grupi
- mënyrën e prezantimit

KRITERET E VLERËSIMIT

Niveli I: (NOTA 4)

Nëse nxënësi nuk sjell asnjë material që ka lidhje me detyrat e ngarkuara.

Niveli II: (NOTA 5)

- Përgatit materialin e kërkuar me gojë ose me shkrim dhe e paraqit (dorëzon atë në afatet e kërkuara)

Niveli II: (NOTA 6)

- Trajton temën e kërkuar duke përdorur informacionin e dhënë dhe respekton kriteret e kërkuara (me shkrim elektronik jo më pak se 2 faqe e shkruar dhe paraqitje me gojë jo më shumë se 5 minuta)

Niveli III: (NOTA 7)

- Shtjellon argumentin e kërkuar nga tema dhe respekton afatet dhe kriteret e vendosura më sipër.

Niveli III: (NOTA 8)

- Përdor shembuj dhe citime nga bibliografia e rekomanduar që shërben për trajtimin e temës.
- Rendit qartë dhe logjikisht materialin.
- Përdor një gjuhë korrekte dhe pa gabime.

Niveli IV: (NOTA 9 - 10)

- Ka origjinalitet në trajtimin e temës.
- Përdor saktë dhe me korrektësi bibliografinë.
- Përdor një gjuhë të qartë dhe pa gabime.

Punë me shkrim

Ese/ Tekst _____

Klasa: _____

Emri, mbiemri: _____

Tema: _____

Shtjellimi i idesë	Organizimi dhe struktura	Stili dhe origjinaliteti	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi)	Gjithsej
2 pikë / nota	2 pikë/nota	2 pikë/nota	2 pikë/nota	8 pikë/nota

- 1. Gabimet në strukturën e esesë ose të teksteve të tjera.**
- 2. Plotësia:** a) mungojnë teknikat e shkrimit të tekstit _____; b) të shtohen të dhëna që mungojnë; c) koncepte të panevojshme; ç) mendime të përsëritura; d) ide të gabuara; dh) nuk i përmbahet temës, etj.
- 3. Stili dhe origjinaliteti:** a) nuk ka koncepte – fryt të përpunimit personal; b) mendime pa vlerë etj.
- 4. Koherenca:** a) çështjet nuk janë renditur në mënyrë të rregullt; b) lidhjet e mendimit nuk janë në mënyrë korrekte; c) ide në kundërshtim me njëra-tjetrën; ç) ide jokohërente; d) mungesa e koherencës ndërmjet fjalëve dhe fjalive; dh) mendime jashtë teme; e) stili jo i përshtatshëm me situatën komunikuese; ë) kapërcimi i stileve etj.
- 5. Leksiku dhe kuptimet:** a) fjala pa kuptimin e saj të saktë; b) fjalët e tekstit të jenë fjalë të gjuhës shqipe; c) mungesa e koherencës ndërmjet fjalëve etj.

6. Sintaksa: a) llojet e fjalive; b) fjalitë pa kuptim; c) përsëritja e fjalive dhe fjalëve pa kriter; ç) ndërpret kuptimin e fjalisë; d) kallëzuesi i papërshtatur me kryefjalën në vetë dhe në numër; dh) mungesa e koherencës ndërmjet fjalive; e) rendi i fjalëve në fjali; ë) lidhëzat nuk përdoren drejt për të lidhur pjesët e fjalisë etj.

7. Morfologjia: a) mbiemrat nuk përshtaten me emrat; b) format e shumësit e të njëjësit; c) gjinia; ç) përemrat nuk janë në formën e duhur; d) mënyrat dhe kohët e foljeve nuk janë në formë të rregullt etj.

8. Gabimet drejtshkrimore: a) fjalët me *-r* dhe *-rr*; b) fjalët me *-ë* dhe pa *-ë*; c) grupet e zanoreve *-ue-*, *-ye-*, *-ie-*; ç) grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng*, *ngj*; d) fjalët bashkë, ndaras apo me vizë në mes; dh) shkronjat e mëdha në emra të përgjithshëm apo të përveçëm; e) ndarja e fjalëve në fund të rreshtit; ë) zanorja *-e*; f) takimi i dy zanoreve të njëjta; g) apostrofi; gj) përdorimi i thonjzave; h) shkrimi i nyjës së përparme; i) shkrimi i pjesëzave dhe i parafjalëve; j) shkurtime të emrave të shteteve, institucioneve etj.; k) emrat e popujve; l) emrat e ditëve, javëve, muajve dhe stinëve; ll) shkrimi i datave.

9. Shenjat e pikësimit: a) pika; b) presja; c) dy pikat etj.

10. Të tjera a) ç - q etj.

Shënim. Në shkrimin e nxënësit (fleta me nr. 1) mësuesi/ja vendos numrin dhe germën përkatëse ku është gabimi p.sh., *punojn*, 8/b. Mbi të mësuesi/ja vendos nr. 8/b, që korrespondon me: 8. Gabimet drejtshkrimore: b) fjalët me *-ë* dhe pa *-ë*.

Nxënësi shikon numrat/ gabimet në faqen e parë dhe i lidh me rregullat, çështjet në faqen e dytë.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:82-82(075.3)(072)

Gjuha shqipe dhe letërsia 11 : libër mësuesi për tekstin shkollor : (për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore dhe për gjimnazin e shkencave natyrore) / Mentor Hajrizi...et al. – Prishtinë : Albas, 2019.

– 288 f. : ilustr. ; 24 cm.

1. Hajrizi, Mentor

ISBN 978-9951-15-084-2

11

LIBËR MËSUESI për tekstin shkollor GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI



Çmimi 5 euro

ISBN 978-9951-15-084-2



9 789951 150842

